VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM LABORATORIK MBI CANDIDA ALBICANS.....	266
LABORATORY OVERVIEW OF CANDIDA ALBICANS.....	267
THE ROLE OF LABORATORY TESTS IN PATIENTS WITH COVID-19.....	268
ESCHERICHIA COLI SI SHKAKTAR PRIMAR I INFEKSIONEVE URINARE	269
LEUKOCITIZAT DHE LLOJET E SAJ , NGA NJË INFEKSION BAKTERIAL DERI NË MALINJITET	270
LEUKOCYTOSIS AND ITS TYPES, FROM A BACTERIAL INFECTION TO MALIGNANCY.....	271
ANALIZAT E BASHKËBISEDIMIT TEK FËMIJËT ME DËMTIM TË TË FOLURIT PRAKTIK: NJË MJET EKOLOGJIK NË NJË VLERËSIM FORMAL.....	273
CONVERSATIONAL ANALYSIS IN CHILDREN WITH PRAGMATIC LANGUAGE IMPAIRMENT: AN ECOLOGICAL TOOL INTO A FORMAL ASSESSMENT	274
REHABILITIMI I FËMIJËS ME HUMBJE DEGJIMI TË IMPLANTUAR, ME AFTËSI TË KUFIZUARA	275
REHABILITATION OF THE IMPLANTED DEAF CHILD WITH ASSOCIATED DISABILITIES	276
PROCESIMI GJUHËSOR GESTALT NË FËMIJËT ME ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT TË AUTISMIT	277
GESTALT LANGUAGE PROCESSING IN CHILDREN WITH AUTISM SPECTRUM DISORDERS	278
MARRËDHËNIA MES LEKSIKUT, SEMANTIKËS DHE PRAGMATIKËS	279
THE RELATIONSHIP BETWEEN LEXICS, SEMANTICS AND PRAGMATICS.....	280
NDIKIMI I TEKNOLOGJISË ELEKTRONIKE NË SHËNDETIN E FËMIJES DHE ADOLESHENTIT.....	281

THE IMPACT OF ELECTRONIC TECHNOLOGY ON THE HEALTH OF CHILDREN AND ADOLESCENTS	282
EFEKTIVITETI I PËRDORIMIT TË PECS NGA MËSUESIT MBËSHTETËS PËR NXËNËSIT ME AUTIZËM JOVERBAL NË ARSIMIN 9-VJEÇAR GJITHËPËRFSHIRËS	283
THE EFFECTIVENESS OF THE USE OF PECS BY SUPPORT TEACHERS FOR STUDENTS WITH NON-VERBAL AUTISM IN 9-YEAR-OLD INCLUSIVE EDUCATION	284
EFEKTIVITETI I TERAPISË MIOFUNKSIONALE NË ÇRREGULLIMET E GËLLTITJES DHE PËRTYPJES: SERIA E RASTEVE	285
THE EFFECTIVENESS OF MYOFUNCTIONAL THERAPY IN DISORDERS OF SWALLOWING AND MASTURATION: CASSE SERIES	286
NDIKIMI I DYANSHËM I ÇRREGULLIMEVE TË GJUHËS E KOMUNIKIMIT DHE GJENDJES PSIKOEMOCIONALE SI DHE RËNDËSIA E KOMBINIMIT TË TERAPISË SË TË FOLURIT E ZËRIT ME KONSULENCË PSIKOEMOCIONALE	287
THE BOTH IMPACT OF LANGUAGE AND COMMUNICATION DISORDERS AND THE PSYCHOEMOTIONAL STATE, THE IMPORTANCE OF COMBINATING SPEECH AND VOICE THERAPY WITH PSYCHOEMOTIONAL COUNSELING	288
ROLI I INFERMIERIT TEK FËMIJËT ME HIPERAKTIVITET	289
THE ROLE OF NURSES IN CHILDREN WITH HYPERACTIVITY	290
METODAT E KOMUNIKIMIT TEK FËMIJËT QË NUK DËGJOJNË.....	291
METHODS OF COMMUNICATION WITH CHILDREN WHO CAN'T LISTEN.....	293
VLERËSIMI I SHËNDETIT MENDOR TË PRINDËRVE TË FËMIJËVE ME ÇRREGULLIM TË SPEKTRIT TË AUTIZMIT (ÇSA).....	295
ASSESSMENT OF MENTAL HEALTH OF PARENTS OF CHILDREN WITH AUTISM SPECTRUM DISORDER (ASD)	296
DISFAGIA.....	297
DYSPHAGIA	298
AKTUALITET MBI PROFESIONISTËT E LOGOPEDISË NË SHQIPËRI	299
NEWS ABOUT SPEECH PEDIATICS PROFESSIONALS IN ALBANIA	301
TRAUMA PSIKOLOGJIKE DHE TRANSMETIMI I SAJ; MBARTJA E TRAUMËS NDËR BREZA	303
PSYCHOLOGICAL TRAUMA AND ITS TRANSMISSION; THE TRANSMISSION OF TRAUMA BETWEEN THE GENERATIONS	305
NDËRHYRJA E HERSHME PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA ZHVILLIMORE	307
EARLY INTERBENTION FOR CHILDREN WITH DEVELOPMENTAL DISABILITIES	308
“TRAJTIMI LOGOPEDIK I INTEGRUAR ME TERAPI ZHVILLIMI NËTRAJTIMIN E PARALIZËS CEREBRALE INFANTILE”	310
"LOGOPEDIC TREATMENT INTEGRATED WITH DEVELOPMENT THERAPY IN THE TREATMENT OF INFANTILE CEREBRAL PALSY"	311
PËRTEJ BARRIERAVE, NJË ANALIZË PËRMBAJTJEJE E PREZENCËS ONLINE TË LOGOPEDISTËVE SHQIPTARË.....	312
BEYOND BARRIERS, A CONTENT ANALYSIS OF THE ONLINE PRESENCE OF ALBANIAN SPEECH THERAPISTS.....	313

RËNDËSIA E ANGIO-CT KORONARE DHE TEKNIKA E KRYERJES NË “KAWASAKI DISEASE”	315
IMPORTANCE OF CT CORONARY ANGIO AND PERFORMING TECHNIQUE IN "KAWASAKI DISEASE"	316
ROLI I IMAZHERISTIT NË KRYERJEN E NJË EKZAMINIMI CILËSOR EKOGRAFIK	317
THE ROLE OF IMAGING TECHNICIAN IN PERFORMING A QUALITY ULTRASOUND EXAMINATION	318
CTA E AORTËS: ECG TRIGER VS CTA E THJESHTË	319
AORTIC CTA ECG TRIGGERING VERSUS SIMPLE AORTIC CTA	320
MBROJTJA NGA RREZATIMI JONIZUES	321
RADIATION PROTECTION.....	322
SIGURIA E KONTRASTEVE JODIKE DHE ME BAZË GADOLINIUM NË SHTATZËNI DHE GJIDHËNIE.....	323
THE SAFETY OF IODINATED AND GADOLINIUM CONTRAST MEDIAON PREGNANCY AND LACTATION	324
AVANTAZHET E SOFTUERE-VE TË SIMULIMIT TË MRI NË ARSIM DHE KËRKIM SHKENCOR PËR TEKNIKËT E IMAZHERISË; NJË ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE	325
ADVANTAGES OF MRI SIMULATION SOFTWARE IN EDUCATION AND RESEARCH FOR IMAGING TECHNICIANS; A COMPREHENSIVE ANALYSIS.....	326
IMAZHERIA MJEKËSORE E DREJTUAR NGA AI	327
AI-POWERED MEDICAL IMAGING.....	328
ROLI I CT NË TUMORET PRIMARE TË TRURIT	329
THE ROLE OF CT IN PRIMARY BRAIN TUMORS	330
ROLI I CT PERFUZION NË GODITJET NË TRU (STROKE).....	331
CT PERFUSION ROLE IN BRAIN STROKE	332
MENAXHIMI I ARTIFAKTEVE NGA IMPLANTET METALIKE NË RM	333
DEALING WITH ARTIFACTS FROM METALLIC IMPLANTS IN MRI.....	334
ROLI DIAGNOSTIKUES I TOMOGRAFISË SË KOMPJUTERIZUAR NË TRAUMAT KRANIALE NË MOSHAT PEDIATRIKE	335
THE DIAGNOSTIC ROLE OF COMPUTED TOMOGRAPHY IN PEDIATRIC HEAD TRAUMA	336
ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE SADISFAKSIONI QË KANË TEKNIKËT E IMAZHERISË NË SHQIPËRI PËR PROFESIONIN E TYRE	337
PROFESSIONAL DEVELOPMENT AND SATISFACTION OF IMAGING TECHNICIANS PROFESION IN ALBANIA	338
SA KOLIMOJNË TEKNIKËT RADIOLOGË... NJË ANALIZË RETROSPEKTIVE TË KOLIMIT TË RADIOGRAFIVE PULMONARE TE PACIENTËT PEDIATRIKË DHE NEONATË.....	339
HOW RADIOGRAPHERS COLLIMATE...A RETROSPECTIVE ANALYSIS OF COLLIMATION OF PULMONARY RADIOGRAPHS IN PEDIATRIC PATIENTS AND NEONATES	340
PET-CT NË DEMENCË.....	341

PET-CT IN DEMENTIA.....	342
RËNDËSIA E RADIOKIRURGISË STEREOTAKTIKE TË FRAKSIONUAR NË SHVANOMËN VESTIBULARE	343
THE IMPORTANCE OF FRACTIONATED STEREOTACTIC RADIOSURGERY GUIDED BY IGRT IN VESTIBULAR SCHWANNOMA.....	344
ROLI I TEKNIKUT TË IMAZHERISË NË RADIOLOGJINË INTERVENCIONUESE.....	345
THE ROLE OF THE IMAGING TECHNICIAN IN INTERVENTIONAL RADIOLOGY	346
TEKNIKAT E KRYERJES SË CT TEMPORALE (KOLESTEATOMA).....	347
TECHNIQUES OF PERFORMING TEMPORAL BONE CT (KOLESTEATOMA)	348
MRI FETALE	349
FETAL MRI	350
EKZAMINIMI SKANERIK REDUKTIMI I RISKUT TË RREZATIMIT TË PACIENTËT PEDIATRIKË QË I.....	351
NËNSHTROHEN EKZAMINIMEVE SKANERIKE	351
CT SCAN EXAM RADIATION RISK REDUCTION IN PEDIATRIC PATIENTS WHO ARE SUBJECT OF CT SCAN EXAMS	352
ROLI I I RTT-VE NË IGRT TË AVANCUAR.....	353
THE ROLE OF RADIATION THERAPISTS IN ADVANCED IGRT	354
PATOLOGJITË E KOLONËS LUMBARE.....	355
LUMBAR SPINE PATHOLOGIES	356
ROLI I CT NË PATOLOGJITË KARDIOVASKULARE	357
THE ROLE OF CT IN CARDIOVASCULAR DISEASES.....	358
MENAXHIMI I MBETJEVE RADIOAKTIVE TË PRODHUARA NË NJËSINË E MJEKËSISË BËRTHAMORE	359
MANAGEMENT OF RADIOACTIVE WASTE IN NUCLEAR MEDICINE DEPARTMENT	360
DIAGNOSTIKA IMAZHERIKE DHE ROLI I MAMOGRAFISË NË KANCERIN E GJIRIT	362
DIAGNOSTICIMAGING AND THE ROLE OF MAMMOGRAPHY IN BREAST CANCER	363
PROFILI PROFESIONAL I FIZIOTERAPISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....	365
THE PROFESSIONAL PROFILE OF PHYSIOTHERAPY IN THE REPUBLIC OF ALBANIA..	366
EFEKTET E TERAPISË MANUALE NË KOKSARTROZË: RISHIKIM I QËLLIMSHËM I LITERATURËS.....	367
EFFECTS OF MANUAL THERAPY ON COXARTHROSIS, A SCOPING REVIEW	368
APLIKIMI I TEKNIKËS SË PNF-SË NË PACIENTËT PPOST ACV-SË	369
APPLICATION OF PNF TECHNIQUE IN PPOST ACV PATIENTS	370
FORCE RUN; NJË TEKNOLOGJI INOVATIVE PËR VLERËSIMIN BIOMEKANIK TË ECJES DHE VRAPIMIT DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJINË E QELIZAVE TË NGARKESËS.....	371
FORCE RUN; A NEW TECHNOLOGY FOR THE BIOMECHANISC ASSESSMENT OF RUNNING AND GAIT USING THE FORCE TECHNOLOGY	372

FIZIOTERAPIA RESPIRATORE. NDIKIMI I SAJ NË PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SHËNDETËSORE TEK FËMIJËT E HOSPITALIZUAR ME BRONCHIOLIT.....	373
RESPIRATORY PHYSIOTHERAPY. ITS IMPACT ON THE IMPROVEMENT OF THE HEALTH STATUS OF CHILDREN HOSPITALIZED WITH BRONCHIOLITIS.....	374
NEVOJA PËR SHËRBIME FIZIOTERAPEUTIKE PUBLIKE NË SHQIPËRINË RURALE DHE PERIFERIKE.....	375
THE NEED FOR PUBLIC PHYSIOTHERAPEUTIC SERVICES IN RURAL AND SUBURBAN ALBANIA	376
EFIKASITETI I KINESIOTAPIT NË PËRMIRËSIMIN E DHIMBJES LUMBARE	377
“THE EFFICIENCY OF KINESIOTAPE IN IMPROVING LUMBAR PAIN”	378
TRAJTIMI KONSERVATIV I SKOLIOZËS, NËPËRMJET KORSSES DHE METODËS PSSE-SCHROTH.....	379
CONSERVATIVE TREATMENT OF SCOLIOSIS, WITH BRACE AND PSSE-SCHROTH METHOD	380
NDIKIMI I PNF NË PËRMIRËSIMIN E EKUILIBRIT NË STROKE KRONIK	381
THE EFFECT OF PNF ON BALANCE IMPROVEMENT IN CHRONIC STROKE	382
REHABILITIMI PËR PACIENTËT PAS RIKONSTRUKSIONIT TË ACL	383
REHABILITATION FOR PATIENTS FOLLOWING ACL RECONSTRUCTION.....	384
REHABILITIMI I FRAKTURËS COLES	385
COLLES FRACTURE AND REHABILITATION	386
ROLI I FIZIOTERAPISË NË TRAJTIMIN E TORTIKOLIS (RISHIKIM LITERATURE).....	387
THE ROLE OF PHYSIOTHERAPY IN THE TREATMENT OF TORTICOLIS (systematic review)	388
BENEFITET E FIZIOTERAPISË TE PACIENTËT PAS INFARKTIT TE MIOKARDIT (RISHIKIM LITERATURE).....	389
BENEFITS OF PHYSIOTHERAPY IN PATIENTS AFTER MYOCARDIAL INFARCTION (LITERATURE REVIEW).....	390
EFEKTSHMËRIA E KOMBINIMIT TË METODËS BOBATH DHE TERAPISË PASQYRË NË REHABILITIMIN E PACIENTËVE ME HEMIPLEGI	391
THE EFFECTIVENESS OF THE COMBINATION OF THE BOBATH METHOD AND MIRROR THERAPY IN THE REHABILITATION OF PATIENTS WITH HEMIPLEGIA.....	392
PROTOKOLLET E REHABILITIMIT TË PACIENTËVE ME BURSIT SUBACROMIAL	393
REHABILITATION PROTOCOLS FOR PATIENTS WITH SUBACROMIAL BURSTITIS	394
“RËNDËSIA E FIZIOTERAPISË NË FIBROZËN KISTIKE”	395
"THE IMPORTANCE OF PHYSIOTHERAPY IN CYSTIC FIBROSIS"	396
PËRQASJA E QYTETARËVE TË TIRANËS ME SHKENCËN MJEKËSORE TË FIZIOTERAPISË DHE KREDIBILITETI TE MJEKËT SHQIPTAR.....	397
APPROACH OF CITIZENS OF TIRANA WITH MEDICAL SCIENCE OF PHYSIOTHERAPY AND CREDIBILITY AMONG ALBANIAN DOCTORS	398
DHIMBJA E SHPINËS ILIOPSOAS, SHKAQET DHE TRAJTIMI	399
BACK PAIN OF ILIOPSOAS; CAUSES AND TREATMENT.....	400

REHABILITIMI PULMONAR NE BRONKIEKTAZINE E FIBROZES JOCISTIKE	401
PULMONARY REHABILITATION IN NONCYSTIC FIBROSIS BRONCHIESTASIS.....	402
VLERËSIMI I TEKNIKAVE SPECIFIKE FIZIOTERAPEUTIKE NË TRAJTIMIN KONSERVATIV TË ADOLESHENTËVE ME SKOLIOZË IDIOPATIKE, RISHIKIM LITERATURE.....	403
EVALUATION OF SPECIFIC PHYSIOTHERAPEUTIC TECHNIQUES IN THE CONSERVATIVE TREATMENT OF ADOLESCENTS WITH IDIOPATHIC SCOLIOSIS. A LITERATURE REVIEW	404
“MARRËDHËNIA NDËRMJET STABILITETIT BAZË (CORE), LËVIZJES FUNKSIONALE DHE PERFORMANCËS, NË TË RINJTË QË MERREN ME AKTIVITET FIZIK”	405
“THE RELATIONSHIP BETWEEN CORE STABILITY, FUNCTIONAL MOVEMENT AND PERFORMANCE IN YOUNG PEOPLE ENGAGED IN PHYSICAL ACTIVITY”	406
VLERËSIMI PSIKOMETRIK I VERSIONIT SHQIPTAR TË INVENTARIT TË VETËKUJDESIT TEK SËMUNDJET KRONIKE NË SHQIËRI.....	407
PSYCHOMETRIC CHARACTERISTICS OF SELF CARE OF CHRONIC ILLNES INVENTORY IN ALBANIA	408
EFIKSITETI I TERAPISË SË PASQYRËS (MIRROR THERAPY) NË REKUPERIMIN E FUNKSIONIT MOTORR TË HEMIPLEGJISË SË DORËS POST-IKTUSIT CEREBRAL: NJË RISHIKIM LITERATURE.....	409
EFICACY OF MIRROR THERAPY IN RECOVERY OF MOTOR FUNCTION OF HAND HEMIPLEGIA POST CEREBRAL STROKE; A LITERATURE REVIEW	410
“EFIKASITETI I REHABILITIMIT KARDIO PULMONAR NË PACIENTËT E PREKUR NGA DESHTIMI KRONIK I ZEMRES”.....	411
EFFICACY OF CARDIOPULMONARY REHABILITATION IN PATIENTS AFFECTED BY CHRONIC HEART FAILURE.....	412
“ANALIZA PSIKOMETRIKE E PYETËSORIT TË GATISHMËRISË NË SHKALLËT E MËSIMDHËNIES NDËRPROFESIONALE (RIPLS)”.....	413
"PSYCHOMETRIC ANALYSIS OF INTERPROFESSIONAL TEACHING READINESS QUESTIONNAIRE (RIPLS)"	415

ABSTRAKTE INFERMIERI

SESIONI 1

PRAKTIKA E BAZUAR NË EVIDENCA NË INSTITUCIONET E KUJDESIT SHËNDETËSOR NË ITALI. OPINIONET E INFERMIERËVE DHE MENAXHERËVE

IVZIKU Dhurata RN, PhD¹, NOTARNICOLA Ippolito RN, PhD, FFMRCSP², ROCCO Gennaro RN, PhD, FAAN², D'ANGELO Daniela RN, PhD³, STIEVANO Alessandro RN, PhD, FAAN FFMRCSP³.

1-Fondazione Policlinico Universitario Campus Bio-Medico, Rome, Italy.

2-Catholic University "Our Lady of Good Counsel", Tirana, Albania.

3-Centre of Excellence for Nursing Scholarship OPI Roma, JBI Affiliated Center, Rome, Italy.

ABSTRAKT

Për të siguruar kujdesin më të mirë të mundshëm, profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të bazojnë punën e tyre të përditshme në provat e prodhuara nga kërkimi shkencor. Kur kujdesi nuk bazohet në prova, ai shpesh rezulton në përdorim të pamjaftueshëm, keqpërdorim ose mbipërdorim të burimeve dhe mund të ketë një ndikim negativ në sigurinë, cilësinë dhe koston e kujdesit shëndetësor. Pavarësisht se shkenca e zbatimit të provave ka prodhuar njohuri të ndryshme se çfarë funksionon dhe si të promovohet ndryshimi në praktikën klinike, transferimi i kësaj njohurie te profesionistët e kujdesit shëndetësor mbetet i kufizuar.

Objektivat: Ky hulumtim synon të ekzaminojë dhe të kuptojë opinionet dhe bindjet e infermierëve dhe menaxherëve të infermierëve në lidhje me përdorimin e provave shkencore (EBP) në praktikën klinike.

Metodat: U përdor një projekt studimi përshkrues, vëzhgues dhe ndër-seksional. Infermierët dhe menaxherët e infermierëve nga spitalet dhe mjediset e komunitetit ishin të përfshirë. Pjesëmarrja ishte vullnetare dhe plotësisht anonime. Mbledhja e të dhënave u krye nëpërmjet pyetësorëve të përgatitur në Google Forms. Lidhja iu dërgua pjesëmarrësve përmes postës elektronike të punës ose personale. Mbledhja e të dhënave është kryer nga nëntori 2023 deri në prill 2024. Është kryer analiza përshkruese-korrelacionale.

Rezultatet: Ne morëm 327 anketa të përfunduara, 79% nga infermiere femra (64.5%) me një moshë mesatare 40.6 vjeç (SD 10.4), shumica që punonin në spitale (91.4%). 49.6% e infermierëve dhe 69.6% e menaxherëve kanë marrë pjesë në trajnime për praktikën e bazuar në prova. Opinioni për rezultatin mesatar të EBP ishte 51.9 (SD 6.6) në rangun 32-80, dhe ishte i lidhur ndjeshëm me nivelin e arsimimit dhe trajnimit në EBP. Janë vërejtur dallime të rëndësishme midis gjinive, por jo ndërmjet infermierëve dhe menaxherëve.

Përfundime: Rezultatet e këtij studimi kontribuojnë në zgjerimin e njohurive rreth opinionëve dhe besimeve të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, infermierëve dhe menaxherëve të infermierëve në lidhje me përdorimin e provave shkencore në praktikën klinike. Literatura dokumenton se besimet në lidhje me EBP janë përcaktues të rëndësishëm për zbatimin e provave. Prandaj, këto rezultate do të jenë të dobishme për identifikimin e trajnimit dhe promovimin e ndërhyrjeve për Praktikën e Bazuar në Evidencë (EBP) në mjedisin e punës dhe në nivel rajonal.

Fjalë kyçe: EBP, infermiere, menaxhere infermiere, besime, praktikë klinike.

EVIDENCE BASED PRACTISE (EBP) IN HEALTHCARE SETTINGS IN ITALY: NURSES AND NURSE MANAGERS OPINIONS

IVZIKU Dhurata RN, PhD¹, NOTARNICOLA Ippolito RN, PhD, FFMRCSP², ROCCO Gennaro RN, PhD, FAAN², D'ANGELO Daniela RN, PhD³, STIEVANO Alessandro RN, PhD, FAAN FFMRCSP³.

1-Fondazione Policlinico Universitario Campus Bio-Medico, Rome, Italy.

2-Catholic University "Our Lady of Good Counsel", Tirana, Albania.

3-Centre of Excellence for Nursing Scholarship OPI Roma, JBI Affiliated Center, Rome, Italy.

ABSTRACT

Background: To ensure the best possible care, healthcare professionals should base their daily work on the evidence produced by scientific research. When care is not based on evidence, it often results in underuse, misuse, or overuse of resources and can have a negative impact on the safety, quality, and cost of healthcare. Despite the science of implementing evidence having produced various knowledge on what works and how to promote change in clinical practice, the transfer of this knowledge to healthcare professionals remains limited.

Objectives: This research aims to examine and understand the opinions and beliefs of nurses and nurse managers regarding the use of scientific evidence (EBP) in clinical practice.

Materials and Methods: A descriptive, observational, and cross-sectional study design was used. Nurses and nurse managers from hospitals and community settings were involved. Participation was voluntary and completely anonymous. The data collection was carried out through questionnaires prepared on Google Forms. The link was sent to participants via their work or personal email. Data collection was carried out from November 2023 until April 2024. Descriptive-correlational analysis was performed.

Results: We received 327 completed surveys, 79% from female nurses (64,5%) with a mean age of 40,6 anni (SD 10,4), the majority working in hospitals (91,4%). The 49,6% of nurses and 69,6% of managers have participated in training about evidence based practice. The opinion on EBP mean score was 51,9 (SD 6,6) range 32-80, and was significantly correlated with the level of education and training on EBP. Significant differences were observed between genders but not between nurses and managers.

Conclusions: The results of this study contribute to expanding the knowledge about the opinions and beliefs of healthcare professionals, nurses, and nurse managers regarding the use of scientific evidence in clinical practice. Literature documents that the beliefs regarding EBP are important determinants for the implementation of evidences. Therefore, these results will be useful for identifying training and promotion interventions for Evidence-Based Practice (EBP) at the work setting and regional levels.

Keywords: EBP, nurse, nurse managers, beliefs, clinical practice.

SA I RËNDËSISHËM ËSHTË BESIMI NË MARRËDHËNIET MIDIS MENAXHERËVE DHE INFERMIERËVE? GJETJET NGA NJË STUDIM VËZHGUES

Dhurata IVZIKU1 PHD, RN; Lucia FILOMENO2 Studente e doktoraturës; Federica Maria Pia FERRAMOSCA2 doktorante; Daniela FORTE2 studente e doktoraturës; Alessandro STIEVANO3 PhD, RN, FFMRCISI, FAAN; Gennaro ROCCO4 PhD, MscN, EdM, RN, FFMRCISI, FAAN; Marzia Lommi5 PHD, RN; Daniela TARTAGLINI1, Professore e Asociuar; Raffaella GUALANDI1, PhD, RN

(1)Departamenti i Profesioneve Shëndetësore, Fondazione Policlinico Universitario Campus Bio-Medico, Romë Itali

(2)Departamenti i Biomjekësisë dhe Parandalimit, Universiteti Tor Vergata, Romë, Itali

(3) Qendra e Ekselencës për Bursën e Infermierisë OPI Romë, Romë, Itali

(4) Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri

(5) Profesor ndihmës, Departamenti i Infermierisë, Universiteti Tor Vergata, Romë, Itali
Autorja korresponduese: Dhurata Ivziku, d.ivziku@policlinicocampus.it

ABSTRAKT

Hyrje: Besimi është pritshmëria që lind brenda një komuniteti të sjelljes së rregullt, të ndershme dhe bashkëpunuese, bazuar në normat e përbashkëta. Besimi është kritik në marrëdhëniet midis liderëve dhe ndjekësve dhe kontribuon në suksesin e liderit.

Objektivat: Studimi aktual eksploroj besimin e infermierëve të drejtuesit të tyre dhe analizoi efektet në disa rezultate infermiore.

Metodat: Ne përdorëm një dizajn kryq seksional bazuar në teorinë e shkëmbimit social. Për të eksploruar besimin kemi përdorur shkallën Trust Me dhe për të matur rezultatet kemi përdorur shkallën e QEEW 2.0. Ne administruam një anketë online për infermierët që punojnë në gjashtë spitale në Itali. Kemi kryer analizën e regresionit linear.

Rezultatet: Ne morëm 174 pyetësorë nga infermierët. Besimi të menaxherit u mat me tre nën-shkallë. Harmonia ka të bëjë me një kombinim pozitiv të ndjenjave të perceptuara nga infermierët në marrëdhënien me liderin, si ndjenjat e vërteta të menaxherit për çështje të rëndësishme, konsiderata e lartë për suksesin e menaxherit ose ngrohtësia në marrëdhënie. Besueshmëria konsiston në sjelljet sistematike që infermierët vëzhgojnë të drejtuesit që lidhen me kujdesin për dëshirat dhe çështjet e rëndësishme të infermierëve, ose një drejtues që mban premtimet dhe ndërmerr veprime që janë të qëndrueshme. Shqetësimi do të thotë që infermierët llogarisin në ndihmën e udhëheqësit, çiltërsinë, faljen dhe mos dëmtimin e qëllimeve. Rezultatet mesatare të vëzhguara treguan se infermierët shprehin nivele neutrale ose të lehta të besimit të menaxherit të tyre. Harmonia, besueshmëria dhe shqetësimi parashikuan statistikisht kënaqësinë e infermierit në punë, përkushtimin me organizatën dhe kënaqësinë. Perceptimet në lidhje me Harmoninë ishin një parashikues i synimit të infermierëve për t'u larguar nga profesioni, ndërsa ato që lidhen me besueshmërinë dhe shqetësimin ishin parashikues të synimit të infermierit për t'u larguar nga organizata e kujdesit shëndetësor. Nuk janë vërejtur dallime të rëndësishme statistikisht në shkallët e besimit për moshën dhe përvojën e punës.

Përfundime: Këto gjetje sugjerojnë rolin kyç që luajnë menaxherët e infermierëve në promovimin e kënaqësisë në punë dhe mbajtjen e fuqisë punëtore infermiore brenda organizatës dhe profesionit. Ndërtimi i besimit midis bashkëpunëtorëve nuk është vetëm një veprim i mirë shoqëror, por është një aftësi e shëndoshë menaxheriale për të ndërtuar marrëdhënie efektive. Bazat e forta të besimit, qasjet e ndershme dhe të kujdesshme me infermierët janë teknika të rëndësishme që të gjithë menaxherët duhet të përdorin për të promovuar mirëqenien dhe mbajtjen e infermierëve.

Fjalë kyçe: besim, infermiere, menaxhere infermiere, mirëqenie, përkushtim.

HOW IMPORTANT IS TRUST IN THE RELATIONSHIP AMONG MANAGERS AND NURSES? FINDINGS FROM AN OBSERVATIONAL STUDY

Dhurata IVZIKU¹ PHD, RN; Lucia FILOMENO² PHD Student; Federica Maria Pia FERRAMOSCA² PhD student; Daniela FORTE² PHD student; Alessandro STIEVANO³ PhD, RN, FFMRCSE, FAAN; Gennaro ROCCO⁴ PhD, MScN, EdM, RN, FFMRCSE, FAAN; Marzia Lommi⁵ PHD, RN; Daniela TARTAGLINI¹, Associate Professor; Raffaella GUALANDI¹, PhD, RN

(1) Department of Health Professions, Fondazione Policlinico Universitario Campus Bio-Medico, Rome Italy

(2) Department of Biomedicine and Prevention, University Tor Vergata, Rome, Italy

(3) Centre of Excellence for Nursing Scholarship OPI Rome, Rome, Italy

(4) Catholic University "Our Lady of Good Counsel", Tirana, Albania

(5) Adjunct Professor, Department of nursing, University Tor Vergata, Rome, Italy

Corresponding author: Dhurata Ivziku, d.ivziku@policlinicocampus.it

ABSTRACT

Background: Trust is the expectation arising within a community of regular, honest, and cooperative behaviour, based on commonly shared norms. Trust is critical in relationships between leaders and followers and contributes to leadership success.

Objectives: The present study explored nurses' trust in their leaders and analyzed effects on some nursing outcomes.

Methods: We used a cross sectional design based on the social exchange theory. To explore trust we used the Trust Me scale and to measure outcomes we used scales of QEEW 2.0. We administered an online survey to nurses working in six hospitals in Italy. We performed linear regression analysis.

Results: We received 174 questionnaires from nurses. Trust in the manager was measured with three sub-scales. Harmony regards a positive combination of feelings perceived by nurses in the relationship with the leader such as manager's true feelings about important issues, high consideration about manager's success, or warmth in the relationship. Reliability consists of systematic behaviors that nurses observe in leaders related to caring for nurses' desires and important issues, or a leader that keeps promises and take actions that are consistent. Concern means that nurses count on leader's help, openness, forgiveness and not hurting intentions. The mean scores observed indicated that nurses express neutral or light agreement levels of trust in their managers. Harmony, Reliability and Concern statistically predicted nurse's pleasure at work, commitment with the organization, and satisfaction. Perceptions regarding Harmony were a predictor of nurses intention to leave the profession whereas those related to Reliability and Concern were predictors of nurse's intention to leave the healthcare organization. No statistically significant differences in the trust scales were observed for age and work experience.

Conclusions: These findings suggest the key role played by nurse managers in promoting pleasure at work and keeping nursing workforce within the organization and the profession. Building trust among collaborators is not only a socially nice action, it is a sound managerial skill to build effective relationships. Solid foundations of trust, honest and caring approaches with nurses are important techniques that all managers should use to promote nurses well-being and retention.

Keywords: trust, nurses, nurse managers, well-being, commitment.

PËRKTIMI, VËRTETIMI DHE VETITË PSIKOMETRIKE TË VERSIONIT SHQIP TË SHKALLËS SË KOMPETENCËS PROFESIONALE TË INFIRMIERËVE. FORMULAR I SHKURTËR

Vlora Ejupi, Blerina Duka, Alessandro Stievano, Rosario Caruso, Emanuela Prendi, Florian Spada

ABSTRAKT

Hyrje: Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte përkthimi dhe vërtetimi psikometrik i Formularit të Shkurtër të Shkallës së Kompetencës Profesionale të Infermierit Shqiptar për aplikim të mëtejshëm në mjediset e kujdesit shëndetësor shqiptar. Ky instrument mund të përdoret për të vlerësuar kompetencat profesionale të infermierisë.

Metodologjia: Në këtë studim u përdor një dizajn shumëfazor. Faza e parë përbënte përkthimin gjuhësor dhe përshtatjen e NPCS-SF me kontekstin kulturor shqiptar. Faza e dytë kishte të bënte me vlefshmërinë e përmbajtjes së A-NPCS-SF, dhe faza e tretë përfshinte një koleksion të dhënash ndërseksionale për të vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e A-NPCS-SF.

Instrumentet: Ne përdorëm versionin e shkurtër të NPCS nga Nilsson et al. (2018). NPCS-SF bazohet në kërkesat formale të kompetencës të lëshuara nga Këshilli Suedez për Shëndetin dhe Mirëqenien. Ne analizuam të dhënat duke përdorur softuerin SPSS 24 (SPSS Inc., Chicago, IL) dhe paketën statistikore R. Janë kryer analiza përshkruese dhe multivariate të të dhënave. U rekrutua një kampion i përshtatshëm (n=342), duke përfshirë infermierët e regjistruar, mamitë e regjistruara dhe kryeinfermieret.

Rezultatet: Formulari i shkurtër i Shkallës së Kompetencës Profesionale të Infermierit Shqiptar tregoi vlefshmërinë e duhur të përmbajtjes. Analiza e faktorëve konfirmues mbështeti strukturën e shkurtër gjashtë-faktorësh të Shkallës së Kompetencës Profesionale të Infermierit Shqiptar dhe shpjegoi mbledhjen e të dhënave.

Diskutime: Në këtë punim, ne kemi përvijuar procesin e përshtatjes gjuhësore dhe kulturore të A-NPCS-SF, si dhe vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tij psikometrike. Kriteret e miratuara në studimin tonë ndoqën rekomandimet e njohura për përkthimin kulturor në kërkimin ndërkulturor. Është e rëndësishme për disiplinën e infermierisë dhe mamisë të kuptojë se si kompetencat profesionale mund të ndikojnë në praktikën klinike, sjelljet profesionale dhe identitetin, dhe mbi të gjitha, në kulturën profesionale.

Konkluzionet: Formulari i shkurtër i Shkallës së Kompetencës Profesionale të Infermierit Shqiptar paraqiti dëshmi të vlefshmërisë dhe besueshmërisë në matjen e katër kompetencave profesionale. Pasja e një shkalle të përshtatshme në shqip për vetëvlerësimin e kompetencës profesionale nga infermierët përbën një hap thelbësor në zhvillimin e edukimit infermieror në vend.

Fjalët kyçe: Kompetencat Infermieristike, Analiza e Faktorëve Konfirmues, Analiza e Faktorëve Eksplorues, Kompetencat Profesionale, Psikometrika.

TRANSLATION, VALIDATION AND PSYCHOMETRIC PROPERTIES OF THE ALBANIAN VERSION OF THE NURSES PROFESSIONAL COMPETENCE SCALE SHORT FORM

Vlora Ejupi, Blerina Duka, Alessandro Stievano, Rosario Caruso, Emanuela Prendi, Florian Spada.

ABSTRACT

Introduction: The primary aim of this study was the translation and psychometric validation of the Albanian Nurse Professional Competence Scale Short Form for further application in Albanian healthcare settings. This instrument can be utilized to assess professional nursing competencies.

Methods: A multiphase design was used in this study. The first phase constituted the linguistic translation and adaptation of the NPCS-SF to the Albanian cultural context. The second phase concerned both the content and face validity of the A-NPCS-SF, and the third phase involved a collection of cross-sectional data to evaluate the validity and reliability of the A-NPCS-SF.

Instruments: We used the short-form version of the NPCS by Nilsson et al. (2018). The NPCS-SF is based on the formal competency requirements issued by the Swedish Council for Health and Welfare. We analysed data using SPSS 24 (SPSS Inc., Chicago, IL) software and the R statistical package. Descriptive and multivariate data analyses were performed. A convenience sample (n=342) was recruited, including registered nurses, registered midwives and nursing head nurses.

Results: The Albanian Nurse Professional Competence Scale Short Form showed adequate content validity. Confirmatory factor analysis supported the Albanian Nurse Professional Competence Scale Short Form's six-factor structure and explained the data collection.

Discussion: In this paper, we have delineated the linguistic and cultural adaptation process of the A-NPCS-SF as well as its psychometric validity and reliability. The criteria adopted in our study followed the well-renowned recommendations for cultural translation in intercultural research. It is relevant for the nursing and midwifery discipline to understand how professional competencies can influence clinical practice, professional behaviours and identity, and above all, professional culture.

Conclusions: The Albanian Nurse Professional Competence Scale Short Form presented evidence of validity and reliability in measuring four professional competencies. Having an appropriate scale in Albanian for professional competence self-assessment by nurses constitutes an essential step in developing nursing education in the country.

Keywords: Competence nursing, confirmatory factor analysis, exploratory factor analysis, professional competence, psychometrics

ROLI I INFERMIERËVE NË PARANDALIMIN E INFEKSIONEVE NOSOKOMIALE

Elvana Podvorica¹, Nexhmije Gori², Xhemajl Dugolli²

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Mjekësisë –Divizioni i Infermierisë¹

Oda e Infermiereve të Kosovës OIK²

ABSTRAKT

Hyrje: Një komponent jetik i mbrojtjes së pacientit është të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së infeksioneve të fituara nga ofrimi i kujdesit shëndetësor që mund të komplikojnë trajektoren e trajtimit dhe rikuperimit. Infermierët përdorin një sërë metodash për të mbrojtur pacientët nga infeksioni i ri ose i përkeqësuar në praktikën e zakonshme, e njohur gjerësisht si kontrolli i infeksionit. Kontrolli i infeksionit përfshin larjen e duarve, higjienën e frymëmarrjes, dezinfektimin e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve dhe masat paraprake të izolimit dhe është pjesë e përgjegjësive të përditshme të të gjithë profesionistëve të kujdesit shëndetësor.

Metodat: Një studim ndër-seksional është realizuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nga muaji Prill-Qershor 2023. Metoda e randomizuar është përdorur për të marrë një mostër prej 180 infermierësh të anketuar. Instrumentët matës janë pyetësorët e standartizuar nga OBSH, një pyetësor për të vlerësuar njohuritë e infermierëve dhe tjetri përciptimi i tyre për HD, janë vetë-administruar nga infermierët që janë në marrdhënje të rregullta të punës.

Rezultatet: Moshë mesatare ishte 36.5±9.1 vjeç. Dominonte grup-moshë 25-39 vjeç (22.2%), pasuar nga grup-moshë 40-44 vjeç (18.1 vjeç).Për sa i përket njohurive mbi praktikën e higjienës së duarve (HD), për të parandaluar transmetimin e mikrobeve të pacientit, niveli i përgjigjeve të sakta është i ndryshëm dhe ndoshta “shkel” konceptin e të pasurit njohuri të sakta për higjienën e duarve. Kështu, 79% deklarojnë se transferimi i mikrobeve të pacientit parandalohet nëpërmjet higjienës së duarve dhe 63% deklarojnë se HD duhet të kryhet menjëherë përpara një procedure të pastër/aseptike $p>0.001$.Ndërkohë, 60% e të intervistuarve japin përgjigjen e gabuar në lidhje me aplikimin e HD menjëherë pas rrezikut të ekspozimit ndaj lëngjeve trupore (dhe vetëm 40% japin përgjigjen e duhur). Po kështu, gati 53% e të intervistuarve japin përgjigje të gabuara për aplikimin e HH pas ekspozimit në mjedisin më të afërt të pacientit (dhe 47% japin përgjigje të sakta) $p>0.001$.

Përfundimi: Dallimi midis përciptimit dhe njohurive tregoi se higjiena e duarve kryhet më tepër si rutinë sesa si praktikë e dokumentuar. Për të arritur këtë, është elementare rritja e edukimeve të vazhdueshme brenda institucioneve të kujdesit shëndetësor, e kombinuar me monitorimin e vazhdueshëm dhe të sofistikuar të pajtueshmërisë. Ne supozojmë se pandemia e koronavirusit, e cila ndryshoj në mënyrë agresive zakonet tona çdo ditë, mund të jetë një mundësi optimale.

Fjalët kyçe: Infeksionet nozokomiale, parandalimi i infeksioneve, përgjegjësitë i infermierit.

THE ROLE OF NURSES IN THE PREVENTION OF NOSOCOMIAL INFECTIONS*Elvana Podvorica¹, Nexhmije Gori², Xhemajl Dugolli²**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Mjekësisë –Divizioni i Infermierisë¹**Oda e Infermiereve të Kosovës OIK²***ABSTRACT**

Introduction: A vital component of patient advocacy is to help prevent the spread of healthcare acquired infections (HAIs) that may complicate the treatment and recovery trajectory. Nurses use a variety of methods to protect patients from new or worsening infection in common practice, broadly known as infection control. Infection control includes handwashing, respiratory hygiene, environmental sanitization, waste management, and isolation precautions, and is part of the daily responsibilities of all healthcare professionals.

Methods: A cross-sectional study was conducted at the University Clinical Center of Kosovo from April - June 2023. The randomized method was used to obtain a sample of 180 surveyed nurses. The measuring instruments are the WHO standardized questionnaires, one questionnaire to assess the knowledge of nurses and the other their perception of HD, were self-administered by nurses who are in regular working relationships.

Results: The mean age was 36.5±9.1 years. The age group 25-39 years old dominated (22.2%), followed by the age group 40-44 years old (18.1 years old). Regarding the knowledge of hand hygiene practices (HD), to prevent the transmission of germs to the patient, the level of correct answers is different and probably "violates" the concept of having correct knowledge about hand hygiene. Thus, 79% state that the transfer of microbes to the patient is prevented through hand hygiene and 63% state that HD should be performed immediately before a clean/aseptic procedure $p>0.001$. Meanwhile, 60% of the interviewees give the wrong answer regarding the application of HD immediately after the risk of exposure to body fluids (and only 40% give the correct answer). Likewise, nearly 53% of interviewees give wrong answers about the application of HH after exposure to the patient's closest environment (and 47% give correct answers) $p>0.001$.

Conclusion: The difference between perception and knowledge showed that hand hygiene is performed as a routine rather than a documented practice. To achieve this, increased continuing education within health care institutions, combined with ongoing and sophisticated compliance monitoring, is essential. We assume that the coronavirus pandemic, which aggressively changes our habits every day, may be an optimal opportunity.

Keywords: Nosocomial Infections, Prevention of Infections, Nurses' responsibilities

ROLI I INFERMIERIT NË ADMINISTRIMIN E MEDIKAMENTEVE DHE PARANDALIMIN E GABIMEVE GJATË ADMINISTRIMIT

MSC Mirva Hoxha- Koordinatorë dhe pedagoge, Universiteti ALDENT

MSC. Eglena Hoxha - Asistente pedagoge, UNIVERSITERTI ALDENT

ABSTRAKT

Administrimi i medikamenteve është një nga rolet kryesore të një infermieri në çdo mjedis të kujdesit shëndetësor. Dëshmitë tregojnë se gabimet mund të ndodhin në çdo fazë të procesit të përdorimit të medikamenteve (përshkrimit, dokumentimit, shpërndarjes, administrimit dhe monitorimit) duke përbërë rreziqe të konsiderueshme për pacientët. Duke u ndalur në pasojat serioze të gabimeve gjatë administrimit ata infermierë që përfshihen në këto gabime jo vetëm që rezultojnë me norma të ulëta raportimi, por gjithashtu mund të pengojnë zbulimin e faktorëve që cojnë drejt këtyre gabimeve.

Qëllimi i punimit: Të eksplorojmë dhe të vlerësojmë faktorët që ndikojnë në kryerjen e gabimeve medikamentoze dhe barrierat e infermierëve në lidhje me shkallën e raportimit me qëllim zvogëlimin e shkallës së gabimeve në administrim të medikamenteve.

Rezultatet e punimit: Në këtë punim morën pjesë 60 infermierë, të cilët ushtrojnë profesionin e tyre në spitalin universitar të Traumës si edhe në spitalin universitar Nënë Tereza. Moshë mesatare është 36 vjeç dhe shumica e infermiereve janë femra. 55 % e infermierëve të intervistuar kanë eksperiencë në punë 5-15 vite, 17 % shprehen se kanë mbi 15 vite që ushtrojnë profesionin e tyre. Një përqindje e lartë e infermiereve saktësisht 68 % shprehen se kanë 5-10 pacient mesatarisht gjatë turnit të tyre. Shumica e tyre shprehen se kanë gabuar në dozën e administruar dhe është aplikuar medikamenti në kohën e gabuar. Infermierët administrojnë medikamente pas një urdhri verbal të mjekut në 69% të rasteve. Rreth 58% aprovojnë se shkrimi nuk është shumë i qartë, dhe 10% e infermierëve tregojnë se shkrimi i mjekut në kartelë nuk është aspak i qartë.

Përpos bërjes së gabimit në administrimin e medikamenteve vetëm 37% kanë raportuar për gabimin e bërë. 45% e infermierëve të intervistuar, nuk kanë raportuar gabimin e bërë sepse kanë patur frikë se mos humbin vendin e punës. Shkaku më i rëndësishëm i gabimeve është numri i pakët i infermierëve në turn si edhe ngarkesa gjatë turnit.

Rekomandimet: Infermierët duhet të marrin pjesë në trajnime në mënyrë që ata të thellojnë njohuritë e tyre në lidhje me gabimet në administrimet e medikamenteve. Në mënyrë që të jenë sa më të pakta duhet të përmirësohen kushtet në të cilat ata punojnë. Të inkurajohet nga stafi menaxherial raportimi i gabimeve nga infermierët.

Fjalë kyçe: mjekim, gabime, infermiere, administroj, parandaloj, shëndet.

THE ROLE OF THE NURSE IN THE ADMINISTRATION OF MEDICATIONS AND THE PREVENTION OF ERRORS DURING THE ADMINISTRATION

¹MSc. Mirva Hoxha;²MSc. Eglena Hoxha

¹Coordinator and lecturer, ALDENT University

²Lecturer assistant, ALDENT University

ABSTRACT

Introduction: Medication administration is one of the main roles of a nurse in any health care setting. Evidence shows that errors can occur at any stage of the medication use process (prescribing, documentation, dispensing, administration and monitoring) posing significant risks to patients. By focusing on the serious consequences of administration errors, those nurses who engage in these errors not only result in low reporting rates, but may also hinder the discovery of the factors that lead to these errors.

The purpose of the paper: To explore and evaluate the factors that influence the commission of medication errors and the barriers of nurses in relation to the rate of reporting in order to reduce the rate of medication administration errors.

Methodology: Sixty nurses participated in this work, who practice their profession in the trauma university hospital as well as in the Mother Teresa university hospital. The average age is 36 and most nurses are female.

Results: The 55% of the nurses interviewed have 5-15 years of work experience, 17% state that they have been practicing their profession for over 15 years. A high percentage of nurses, exactly 68%, state that they have 5-10 patients on average during their shift. Most of them state that they made a mistake in the dose administered and the medication was applied at the wrong time. Nurses administer medications after a verbal doctor's order in 69% of cases. About 58% approve that the writing is not very clear, and 10% of nurses indicate that the doctor's writing on the chart is not clear at all. Besides making a mistake in the administration of medications, only 37% reported the mistake made. The 45% of the interviewed nurses did not report the mistake made because they were afraid of losing their job. The most important cause of errors is the small number of nurses on shift as well as the workload during the shift.

Recommendations: Nurses should participate in training so that they can deepen their knowledge about medication administration errors. In order to make them as few as possible, the conditions in which they work must be improved. Reporting of errors by nurses should be encouraged by management staff.

Keywords: Treatment Errors, Nurses, Medication Administration, Prevent, Health.

NUTRICIONI KLINIK TEK PACIENTI PAS CISTEKTOMISË RADIKALE - STUDIM RASTI

Hasan Gashi^{1,2}, Blerta Kryeziu², Nexhmije Gori², Besnik Rrmoku², Xhemajl Demolli²

1. Alma Mater Europaea Campus Kolegji "Rezonanca" Prishtinë

2. Qendra Klinike Universitare e Kosovës

ÁBSTRAKT

HYRJE: Studimi ynë i rastit do të fokusohet në kujdesin infermieror tek pacientët pas largimit radikal të fshikës urinare. Infermierët janë të përfshirë në të gjitha aspektet e kujdesit gjatë ushqyerjes së pacientit, janë përgjegjës për të identifikuar nevojat ushqyese dhe aplikuar ushqim tek pacientët. Sipas të dhënave të literaturës, kequshqyerja te pacientët kirurgjik shkon nga 9 deri 44%. Shumica e pacientëve që i nënshtrohen cistektomisë radikale ushqehen për disa ditë me ushqim total parenteral.

QËLLIMET E PUNIMIT: Të evidentojë çfarësasi të nevojave energjetike, proteinike dhe përbërësve tjerë ushqimor kishte marr pacientit gjatë periudhës pre dhe postoperative. Të diskutojë a janë plotësuar nevojat ushqyese gjatë trajtimit të pacientit me ushqim total parenteral pas cistektomisë radikale. Të jap sugjerime për rëndësinë e ushqyerjes totale parenterale të pacientit me cistektomi radikale

MATERIALI DHE METODA: Studim rasti tek pasienti i trajtuar me kancer të fshkëzës urinare në Klinikën e Urologjisë në QKUK.

REZULTATET DHE PËRFUNDIMI: Cistektomia radikale është prej operacioneve më të mëdha në urologji, si rezultat pacientëve i'u duhet kohë e gjatë e shërimit pas intervenimit kirurgjik. Nëpërmjet këtij studim rasti evidentohej se ushqimi total parenteral është një element shumë i rëndësishëm gjatë trajtimit dhe kujdesit të pacientit me cistektomi radikale që kontribuon në të parandalimin e komplikimeve dhe rikoperimin e pacientit.

Rasti i hulumtuar, tregoi së terapia e përshkruar deri më tani nuk i plotëson as 75% të nevojave ushqyese, e cila vlerë është minimumi i sasisë së përbërësve ushqimor i rekomanduar nga nutricionistët. Duke marrë parasysh rezultatet pozitive të fituara te pacientit me terapi ushqyese pas ditës së 7-të postoperative, rëndësia e ushqimit total parenteral duhet të përfshihet në një trajtim multidisiplinar te kanceri i fshikës urinare.

FJALËT KYÇE: Nutricioni klinik, kujdesi infermieror, cistektomia radikale.

CLINICAL NUTRITION IN PATIENTS AFTER RADICAL CYSTECTOMY - CASE STUDY

Hasan Gashi^{1,2}, Blerta Kryeziu², Nexhmije Gori², Besnik Rrmoku², Xhemajl Dugolli²,

1. Alma Mater Europaea Campus College "Resonanca" Pristina

2. University Clinical Center of Kosovo

ABSTRACT

INTRODUCTION: This case study focuses on nursing care for patients after radical bladder removal. Nurses play a crucial role in patient feeding care, responsible for identifying nutritional needs and implementing appropriate nutrition strategies. Literature reports indicate that malnutrition rates among surgical patients range from 9% to 44%. Many patients undergoing radical cystectomy receive total parenteral nutrition for several days.

OBJECTIVES: The objectives of this paper are to document the energy, protein, and other nutrient intake of patients during pre- and postoperative periods, to assess the adequacy of nutritional support provided through total parenteral nutrition following radical cystectomy, and to underscore the significance of total parenteral nutrition for patients undergoing radical cystectomy.

MATERIALS AND METHOD: We present a case study of a patient treated for bladder cancer at the Clinic of Urology at UCCK.

RESULTS AND CONCLUSION: Radical cystectomy is a major procedure in urology, necessitating an extended recovery period post-surgery. This case study highlights the crucial role of total parenteral nutrition in the treatment and care of patients undergoing radical cystectomy, contributing to complications prevention and patient recovery. Our findings reveal that the current therapy falls short of meeting at least 75% of the patient's nutritional requirements the minimum recommended by nutritionists. Given the positive outcomes observed in patients receiving nutritional therapy from the 7th day postoperatively, we emphasize the integration of total parenteral nutrition in the multidisciplinary approach to bladder cancer treatment.

KEYWORDS:: Clinical nutrition, nursing care, radical cystect

MENAXHIMI INFERMIEROR I DHIMBJES: NJË RISHIKIM I UDHËZIMEVE

Armelda Teta, Mitilda Gugu, Elona Gaxhja, Rezarta Stena, Albana Sula

Universiteti i Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani', Faakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

ABSTRAKT

Trajtimi gjithëpërfshirës i pacientëve me dhimbje kërkon bashkëpunimin e ekipit multidisiplinar. Sipas literaturës një pengesë e rëndësishme për menaxhimin adekuat është mungesa e njohurive e stafit infermieror në lidhje me dhimbjen. Ky studim përmbledh në mënyrë të sintetizuar udhëzimet e publikuara. Për të evidentuar rolin e infermierëve në menaxhimin e dhimbjes u krye një rishikim literature gjatë periudhës shtator 2021- korrik 2022. Kërkimi u realizua në: PubMed, Google Scholar dhe MEDLINE duke përdorur fjalët kyçe; 'dhimbje', 'infermier', 'menaxhim', 'evidenca' dhe 'udhëzime'. Kërkimi u fokusua në udhëzimet e publikuara gjatë 5 viteve të fundit. 184 artikuj u përzgjedhen fillimisht për tu shqyrtuar. Pas aplikimit të kriterëve të përfshirjes dhe përjashtimit u identifikuan 5 punime të cilët përmbanin udhëzuesit mbi menaxhimin e dhimbjes, që përmbushnin më së miri qëllimin tonë. Artikujt e përzgjedhur ishin të publikuar nga American Academy of Pain Medicine, American Society for Pain Management Nursing, Center for Disease Control, WHO, International Association for the Study of Pain. Infermierët janë përgjegjës për një menaxhim efektiv të pacientëve me dhimbje dhe për sigurimin e mirëqenies së tyre. Diferencimi i dhimbjes dhe njohja e vlerësimit të saj në kohë ndikon në mënyrën sesi një infermier menaxhon këto pacientë. Nga studimet e rishikuara nënvizohet nevoja për zhvillim dhe edukim të mëtejshëm të stafit për të përmirësuar aftësitë infermiere rreth kësaj çështje.

FJALË KYÇE:: dhimbje, infermier, menaxhim, evidencë, udhëzime.

NURSING MANAGEMENT OF PAIN: A REVIEW OF THE GUIDELINES

Armelda Teta, Mitilda Gugu, Elona Gaxhja, Rezarta Stena, Albana Sula

University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani", Faculty of Technical Medical Sciences

ABSTRACT

Comprehensive treatment of patients with pain requires the cooperation of the multidisciplinary team. According to the literature, an important barrier for adequate management is the lack of knowledge of the nursing staff regarding pain. This study summarizes in a synthesized manner the published guidelines. In order to highlight the role of nurses in pain management, a literature review was conducted during the period September 2021-July 2022. The search was carried out in: PubMed, Google Scholar and MEDLINE using the keywords; 'pain', 'nurse', 'management', 'evidence' and 'guidelines'. The revision focused on guidelines published over the past 5 years. 184 articles were selected initially for review. After applying inclusion and exclusion criteria, 5 papers were identified that contained pain management guidelines that best met our goal. The selected articles were published by the American Academy of Pain Medicine, American Society for Pain Management Nursing, Center for Disease Control, WHO, International Association for the Study of Pain. Nurses are responsible for the effective management of pain patients and for ensuring their well-being. Differentiating pain and knowing how to assess it in time affects how a nurse manages these patients. The reviewed studies highlight the need for further development and education of staff to improve nursing skills on this issue.

KEYWORDS: pain, nurse, management, evidence, instructions.

ROLI INFERMIERIT NE REPARTIN E DJEGIE-PIASTIKËS

Erind Thartori , Erikena Kasa, Xhulia Thartori

Përgjegjës Sektori Infermieristik-QSUNT, Specialiste Sektori Infermieristik-QSUNT, Infermiere Spitali Amerikan

ÁBSTRAKT

Hyrje. Shërbimi i Djegie Plastikës, në QSUNT është i vetmi që ofron shërbim terciar për një numër të lartë pacientësh të djegur, nga Tirana dhe e gjithë Shqipëria. Rastet e djegieve kritike përbëjnë dhe incidencën e djegieve madhore në vendin tonë që rezulton në 7 pacientë për 100,000 persona në vit. Nisur nga ky fakt, me rëndësi të madhe është roli, detyrat dhe kujdesjet infermiere që ofrohen në këtë shërbim.

Qëllimi. Ky material do të përqëndrohet më tepër tek roli i infermierit në pritjen e një pacienti urgjent me djegie dhe menaxhimin e mëtejshëm sipas gjëndjes së tij .Nëpërmjet këtij materiali synojmë përditësimin dhe përmirësimin e kujdesjeve infermiere tek këta pacientë si një nga shërbimet bazë në kushtet spitalore.

Metodologjia. Bazuar në vëzhgimet që kemi kryer pranë këtij shërbimi në QSUNT, gjithashtu bazuar edhe në informacione të marra nga studime shkencore të kryera nga specialistë të fushës është arritur të paraqesim një material i cili do të ndihmojë personelin infermieror të të gjitha niveleve të sistemit shëndetësor (primare, sekondare, terciare). Në mënyrë skematike trajtimi i të sëmurit të djegur në urgjencë kryhet me anën e vlerësimit Primar, vlerësimit Sekondar dhe trajtimit të tij. Me rëndësi për tu theksuar është njohja e infermierit me thellësinë dhe sipërfaqen e zonave të djegura, si dhe të dinë të japin shërbimin duke respektuar të gjithë teknikat aseptike gjatë mjekimit të plagëve duke patur prioritet pacientin e djegur me të gjithë problematikat që ai ka.

Konkluzion. Përparimet në trajtimin dhe kujdesin ndaj djegieve të rënda kanë rezultuar në rritje të mbijetesës dhe ulje të mortalitetit. Këto përmirësime i atribuohen: kryerjes së rehidrimit në mënyrën e duhur, trajtimit adekuat kirurgjikal të plagës së djegies, përdorimit efektiv të antibiotikëve, avancimeve në mbështetjen e gjendjes së përgjithshme nutricionalë.

Fjalët kyçe: Incidenca e djegieve, teknikat aseptike, vlerësimi primar, vlerësimi sekondar, trajtimi

THE ROLE OF NURSES IN THE DEPARTMENT OF PLASTIC BURNS

Erind Thartori¹, Erikena Kasa², Xhulia Thartori³

Head of the nursing sector-QSUNT¹, Specialist in the nursing sector-QSUNT², General nurse in American Hospital³

ABSTRACT

The Plastic Burn service at QSUNT is the only one that offers a tertiary service for a high number of burn patients, from Tirana and all of Albania. Cases of critical burns also make up the incidence of major burns in our country which results in 7 patients per 100 000 people per year. Based on this fact, the role, tasks and nursing care offered in this service are of great importance.

Purpose: This material will focus more on the role of the nurse in the reception of an emergency patient with burns and further management according to his condition. Through this material we aim to update and improve nursing care for these patients as one of the basic services in hospital conditions.

Methodology: Based on the observations we have made at this service at QSUNT, also based on the information obtained from scientific studies conducted by specialists in the field, we have managed to present a material that will help the nursing staff at all levels of the health system (primary, secondary and tertiary). In a schematic way, the treatment of the burned patient in the emergency is carried out by means of the primary, secondary assessment and its treatment. It is important to emphasize that the nurse is familiar with the depth and surface of the burned areas, as well as knowing how to provide the service respecting all aseptic techniques during wound treatment, giving priority to the burned patient with all the problems he has.

Conclusion: Advances in the treatment and care of severe burns have resulted in increased survival and decreased mortality. These improvements are attributed to appropriate rehydration, adequate surgical treatment of the burn wound, effective use of antibiotics, advances in supporting overall nutritional status.

Keywords: Incidence of burns, aseptic techniques, primary assessment, secondary assessment, treatment

LINDJET CEZARIANE, TENDENCA NË RITJE, FAKTORËT DHE ROLI I INFERMIEREVE MAMI NË ULJEN E NUMRIT TË LINDJEVE CEZARIANE

Shqipe Luta¹, Albana Sula¹, Rajmonda Hida¹, Elona Dybeli¹, Juxhin Luta², Klea Cela²

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

2. Msc ne Infermieri

Email: shqipeluta@yahoo.com

ABSTRAKT

Lindja Cesareane është një procedure kirurgjikale e kryer përmes një prerjeje në abdomen. Ndërsa lindjet Cesareane mund të jenë të nevojshme dhe të shpëtojnë jetën, në raste të caktuara lindin shqetësime për rritjen e pajustificuar të numrit të ketyre lindjeve, duke marrë parasysh që lindja vaginale është e sigurt për shumicën e grave dhe foshnjave.

Objektivat: Qëllimi i këtij studimi është të kuptohet dhe të analizohet më mirë fenomeni i lindjeve cezariane, duke ju përqëndruar ndryshimeve në tendencat e tyre, faktorëve determinues të zgjedhjes së tyre dhe ndikimit të tyre në shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Metodologjia: Është përfshirë literatura e burimeve të fundit dhe të përditësuara në hulumtim. Janë siguruar informacione mbi zhvillimet më të reja, tendencat aktuale dhe studimet e fundit në fushën e lindjeve Cezariane. Gjithashtu, u përftua informacion nga rregjistrat dhe kartelat e Maternitetit, Spitali Rajonal "Xh. Kongoli", Elbasan, fokusuar në lindjet Cezareane në vitin 2020 - 2022. Ky studim është një studim kuantitativ retrospektiv kohor.

Rezultatet: Rezultatet e studimit tregojnë se ndikimi i infermiereve mami në edukimin e grave shtatzëna për të ulur numrin e lindjeve Cezariane është i rëndësishëm. Infermieret mami duhet të kenë njohuri të thella në lidhje me përparësitë e lindjeve natyrale, rrezikun për secilen metodë të lindjes.

Konkluzionet; Në përfundim, për të ulur numrin e lindjeve cezariane duhet ofruar edukim, përkrahje dhe përkujdesje. Mamitë mund të ndihmojnë gratë shtatzëna të marrin vendime të sigurta në lidhje me lindjen e tyre. Kjo përfshin promovimin e lindjeve vaginale të sigurta dhe mbështetjen e prindërve në procesin e lindjes. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet roli i edukimit dhe informimit të prindërve rreth përfitimeve dhe rreziqeve të secilës metode të lindjes.

Fjale kyçe: Lindje, cezareane, tendencat, roli i infermiereve mami.

CESAREAN BIRTHS, INCREASING TRENDS, FACTORS AND ROLE OF MIDWIVES IN REDUCING THE NUMBER OF CESAREAN BIRTHS

Shqipe Luta¹, Albana Sula¹, Rajmonda Hida¹, Elona Dybeli¹, Juxhin Luta², Klea Cela^{2,1}.

1. Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani".

2. MSc in Nursing

Email: shqipeluta@yahoo.com

ABSTRACT

Cesarean delivery is a surgical procedure performed through an incision in the abdomen. While Caesarean births can be necessary and life-saving, in certain cases there are concerns about the unjustified increase in the number of these births, considering that vaginal birth is safe for most women and babies.

Objectives. The purpose of this study is to better understand and analyze the phenomenon of cesarean births, focusing on the changes in their trends, the determining factors of their choice and their impact on the health of the mother and the child.

Methodology. The literature of recent and updated research sources is included. Information was provided on the newest developments, current trends and recent studies in the field of Caesarean births. Also, information was obtained from the registers and records of the Maternity, Regional Hospital Xh. Kongoli, Elbasan, focused on Cesarean births in the year 2020 - 2022. This study is a quantitative retrospective cohort study.

Results. The results of the study show that the influence of midwifery nurses in educating pregnant women to reduce the number of cesarean births is significant. Nurse midwives should have a thorough knowledge of the advantages of natural childbirth, the risks of each method of delivery.

Conclusions. In conclusion, to reduce the number of births, education, support and care must be maintained. Midwives can all pregnant women make safe decisions about their birth. This promotion of safe vaginal births and parents in the birth process. It is important to emphasize the role of educating and informing parents about the past and each birth method.

Keywords: Birth, caesarean section, trends, role of midwifery nurses

INSERIMI I SONDËS NAZO-GASTRIKE TEK TË SËMURËT NË SPITALIN RAJONAL TË VLORËS

Msc. Stiliana Brokaj, PhD Juljana Xhindoli, PhD(c) Vasilika Prifti; PhD(c). Emirjona Kiçaj; PhD(c) Rudina Çerçizaj, PhD Rezarta Lalo
Departamenti i Kujdesit, Fakulteti I Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Email: stela.brokaj@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Vendosja e sondës nazogastrike është një procedurë infermierore dhe vendosja dhe mirëmbajtja e saj ka rëndësi në arritjen e qëllimit që është përmirësimi i gjendjes së pacientit sa më shpejt. Ky studim u krye me qëllimin e rritjes së informacionit mbi vendosjen e sondës gastrike tek të sëmurët e shtruar në Spitalin Rajonal Vlorë.

Metodologjia: Ky është një studim kros seksional i kryer në periudhën Shkurt 2019 deri në Qershor 2020. Në studim morën pjesë 80 infermier të përzgjedhur rastësisht dhe në mënyrë vullnetare, pjesë e spitalit rajonal Vlorë, që kanë inseruar SNG. Infermierët ju përgjigjën në pyetësori me 23 pyetje të bazuara gati plotësisht mbi literaturën bashkëkohore, që përdoret gjerësisht në insitucionet spitalore.

Rezultatet: Infermierët e intervistuar ishin 36.25% meshkuj dhe 63.75% femra; me grupmoshë dominante 32-41 vjeç (33.75%); 91% e të intervistuarve me arsim të lartë. 32% e të intervistuarve kanë 10-15 vite pune; 68% e të intervistuarve e njohin protokollin e vendosjes së sondës nazo-gastrike; 39% e infermierëve janë në gjendje për të vendosur sondë gastrike; në 70% të rasteve vendosja e sondës është bërë sipas protokollit. 97% të rasteve infermierët që inserojnë sondën e bëjnë provën e sondës; në 80% e rasteve sonda-gastrike ka funksionuar më së miri; sonda është mirëmbajtur në afro 85% të rasteve të vendosjes së saj; shumica e intervistuesve pohojnë se duhet të jetë infermieri që duhet të vendosë sondën nazogastrike.

Konkluzione. Nuk ka lidhje sinjifikative midis moshës dhe vendosjes së sondës. Nuk kemi gjithashtu lidhje sinjifikative midis eksperiencës së punës dhe vendosjes së sondës. Kemi një lidhje sinjifikative midis repartit të punës dhe arritjes së vendosjes së sondës. Gjithashtu kemi një lidhje sinjifikative midis arritjes së vendosjes së sondës dhe mirëmbajtjes së saj.

Fjalë kyçe: sondë nazogastrike, infermier, inserim, mirëmbajtje.

INSERTION OF NASOGASTRIC TUBE IN REGIONAL VLORE HOSPITAL

Msc. Stiliana Brokaj, PhD Juljana Xhindoli, PhD(c) Vasilika Pifti; PhD(c). Emirjona Kiçaj; PhD(c) Rudina Çerçizaj, PhD Rezarta Lalo
Department of Care, Faculty of Health, University "Ismail Qemali" Vlorë
Email: stela.brokaj@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Insertion of a nasogastric tube is a fully nursing procedure and its maintenance is important in achieving its goal of insertion, so that the patient condition improves faster. Our study was performed in order to increase the information on nasogastric tube insertion in patients of Vlore hospital.

Methods and materials: This is a cross sectional study conducted during February 2019 to June 2020. Part of the study were 80 nurses of various wards of Vlore hospital, who were chosen randomly and wanted to be part of the study. They completed a questionnaire with 23 questions in order to collect information on the demographic parameters, procedure knowledge, practicing maintenance, respecting the protocol etc.

Results: 36.25% of the nurses were males and 63.75 females, dominating age group 32-41 years old (33.75%); 91% had university education. 32% had 10-15 years working; 68% knew the proper protocol on NG tube insertion, in 70% of the cases they respected the protocol of the procedure; 97% of the cases the nurses prove the NG tube, 80% of the cases the NG tube functioned properly, in 85% of the cases the NG tube is maintained properly. Most of the nurses state that it should be the nurse who inserts the NG tube.

Conclusions: There is no statistical significance between age and work experience and NG tube insertion. There is a statistical significance between the ward and tube insertion and knowing how to insert the NG tube and its maintenance.

Keywords: nasogastric tube, nursing procedure, insertion, maintenance

CVVH NË PACIENTËT POST KIRURGISË KARDIAKE*Anida Zalla¹**Kryeinfermiere Reanimacioni, Spitali Amerikan 1¹**anida.zalla@spitaliamerikan.com***ABSTRAKT**

Continuos Venovenous Hemofiltration (CVVH) është përdorur gjerësisht në pacientët e shtruar në ICU për patologji të ndryshme. Një grupim i rëndësishëm pacietësh janë ata të cilët i nënshtrohen kirurgjisë kardiake. Pacientë të tillë paraqesin një sfidë për personelin mjekësor pasi vetë kirurgjia kardiake dhe sëmundjet shoqëruese të këtyre pacienteve e bejnë të vështirë trajtimin multidisiplinor të tyre. CVVH përbën një ndihmesë të rëndësishme në menaxhimin sa më të kujdesshëm të pacientëve me probleme renale postoperatore.

Studimi:

Në këtë punim të shkurtër ne kemi studiuar 30 raste pacientësh të cilët kanë kryer ndërhyrje kardiake të cilët kanë pasur nevojën e asistencës me CVVH në periudhën 2017-2019. Është vënë re një tolerim shumë i mirë hemodinamik i CVVH tek këto pacientë pamvarësisht alterimeve dhe përdorimit të drogave inotrope. Gjithsej ishin 30 raste (19M, 11F) nga të cilët 23 raste urgjente dhe 7 të planifikuar, me moshë që varioje nga 40-80 vjeç. Nga keto paciente 16 ju nënshtroan CABG, 11 zëvendesim të valvulave dhe 3 raste me disekacion të aortes. 22 pacientë kishin nevojën e përdorimit të drogave inotrope pozitive në periudhën post-operatore. CVVH është përdorur në një periudhë 28-120 orë. Rekuperimi i funksionit renal ishte prezent te 23 pacientë ndërkohë që 3 pacientë kaluan në insuficencë renale kronike. Jetëgjatësia pas 18 muaj ndjekje ishte 57% (17 paciente).CVVH u fillua direkt në periudhën postoperatore tek 12 pacientë ndërkohë që 17 pacientë të tjerë kishin nevojën e CVVH pas 24 orëve të para. Azotemia dhe kreatinemia nuk u moren si kritere për fillimin e CVVH. Oligoanuria, parametrat e renduar hemodinamike, statusi pulmonar dhe ekuilibri acido-bazik i alteruar ishin kritere kryesore për fillimin e CVVH.

Rezultatet:

Gjatë eksperiencës sonë me CVVH është vënë re një benefit shumë i madh në drejtim të menaxhimit dhe të rezultatit përfundimtar tek pacientet e kirurgjisë kardiake. 23 prej tyre kanë përfituar maksimalisht nga CVVH duke rifituar funksionin renal brenda disa ditëve nga ndërprerja e terapisë. Vetëm 3 pacientë e humbën përfundimisht funksionin renal duke u bërë pjesë e rrugullt e programit të hemodializës. Duke ndihmuar në rregullimin e ekuilibrave acido-bazike, CVVH ndihmoi në efektshmerine më të mirë të drogave inotrope duke rezultuar në një ndërprerje më të shpejtë të tyre. Gjithashtu u vu re që kompromentimi hemodinamik ishte pothuajse inegzistent në të gjithë rastet e studiara. CVVH ndihmon në filtrimin e mediatoeve të inflamacionin si IL-1,IL-6,IL-8 dhe TNF- α . Si rezultat është parë që në pacientët që i nënshtrohen CVVH niveli i tyre plazmatik ulet nga ora e 12-të dhe sidomos pas orës së 36-të duke ndikuar në uljen e SIRS-it. U vu re një ulje në frekuencen dhe amplituden e atakeve të temperaturës pa ndryshim rrenjësor të antibiotiko-terapisë. E gjithë procedura ndihmoi maksimalisht për mobilizimin më të shpejtë dhe stabilizimin më të mirë të gjendjes së përgjithshme të pacienteve post kirurgjisë kardiake.

CRRT IN PATIENTS AFTER CARDIAC SURGERY*Anida Zalla¹**Reanimation Head-Nurse, American Hospital nr. 1¹***ABSTRACT**

CVVH has been widely used in ICU patients who are being treated for several pathologies. An important group of patients are those undergoing cardiac surgery. Such patients represent a big challenge for the medical staff because the surgery itself and the coexisting medical conditions makes it difficult the multidisciplinary approach. CVVH plays a crucial role in managing postoperative renal complications of cardiac patients.

Study:

In this short study we have evaluated 30 cases between 2017 – 2019 which have had cardiac surgery and needed postoperative renal replacement therapy. Despite using positive inotropic drugs and having unstable hemodynamics, we have observed that these patients tolerate very well CRRT. A total of 30 cases (19M, 11F), 23 urgent and 7 planned with age varying from 40-80 years old. 16 cases of CABG, 11 valve replacements and 3 cases of aortic dissection. 22 patients required the use of positive inotropic drugs in the postoperative period. CRRT was applied for a period of 48-120 hours. We had good improvement of the renal function after CRRT in 23 patients while 3 patients underwent chronic renal failure. Life expectancy after a 18 month follow-up was 57% (17 patients). CRRT was considered as a good choice in the first portoperative hours in 12 patients while we had to wait the first 24 hours to begin CRRT in 17 patients. BUN and creatinine were not classified as good criteria to begin CRRT. Major criteria to begin CRRT are oligoanuria, altered acid-base equilibrium and hemodynamics.

Results:

Our experience with CRRT showed us some great benefits regarding the treatment and the final outcome in cardiac patients. 23 of them gained full renal function after several days of assistance. Only 3 patients needed CRRT and eventually hemodialysis in a long term follow up. Since CRRT helps regulating acid-base disorders it eventually assists us to lower the dosages of positive inotropic drugs. Hemodynamic instability was almost not present in any of the cases. CRRT is very helpful to lower the inflammatory mediators such as IL-1, IL-6, IL-8, TNF- α . As a result in patients under CRRT we observe lowering of inflammatory mediators after the first 12 hours and especially after 36 hours helping the SIRS to slow down. We observed less frequent attacks of high temperature without modifying antibiotic therapy. The procedure helped maximally for a quick recovery and early mobilization of these patients.

IMPAKTI I DHUNËS NË VENDIN E PUNËS NDAJ PERSONELIT INFERMIEROR NË ELBASAN

Albana SULA¹ Elona DYBELI¹ Ilda TAKA¹ Rajmonda HIDA¹ Shqipe LUTA¹ Elona ZHIVA¹ Jonida BAHJA²

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit, "Aleksandër Xhuvani"

²RSA CICIGNANO Montemurlo Itali

*albana.sula@uniel.edu.al*¹

ABSTRAKT

Dhuna në vendin e punës ndaj personelit shëndetësor aktualisht mund të përcaktohet si një problem global.

Qëllimi: Identifikimi i karakteristikave kryesore të episodeve të dhunës ndaj personelit infermieror në prefekturën e Elbasanit dhe analizimi i pasojave afatshkurtëra dhe afatgjata të tij.

Metodologjia: Është studim cross-seksional i realizuar nëpërmjet administrimit të një pyetësi të strukturuar, punonjësve infermier në: Spitalin Rajonal, Poliklinikën e Specialiteteve dhe Qendrat shëndetësore në Elbasan. Formulimi i pyetësit u bë nëpërmjet përdorimit të platformës Google Forms. Periudha e plotësimit nga 18-28 Prill 2023. Të dhënat u analizuan nëpërmjet versionit SPSS.

Rezultatet: Në studim 84% e pjesëmarrësve në pyetësor ishin të gjinisë femërore dhe 37% të gjinisë mashkullore. 54 % e të anketuarve pranojnë që gjatë ushtrimit të detyrës janë përballur me fenomenin e dhunës. Janë referuar si efekte afatshkurtëra: 17.8% axhitim/dridhje. 21.5% frikë, 11.1% të qetë, 4.0% kurajoz. Kampioni ka referuar për efekte afatgjata si: mungesë e kënaqësisë profesionale (12.9%), pasiguri gjatë ushtrimit të detyrës (16.9%), demotivim (7.7%) stres (17.5%).

Përfundime dhe Rekomandime: Personeli infermieror është i prirur për të përjetuar dhunë gjatë ushtrimit të detyrës. Fenomene të tilla kanë një ndikim të fortë psikologjik duke shkaktuar demotivim, pasiguri, frikë, panik të vazhdueshëm deri në humbje të dëshirës për të ushtruar profesionin. Është e një rëndësie të madhe të merren masa parandaluese kundrejt këtij fenomeni.

Fjalë kyçe: dhunë, Elbasan, infermier, qendra shëndetësore, spital.

THE IMPACT OF VIOLENCE AT THE WORKPLACE AGAINST NURSING PERSONNEL IN ELBASAN

Albana SULA¹ Elona DYBELI¹ Ilda TAKA¹ Rajmonda HIDA¹ Shqipe LUTA¹ Elona ZHIVA¹ Jonida BAHJA²

¹Faculty of Technical Medical Sciences, University "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

²RSA CICIGNANO Montemurlo Itali
albana.sula@uniel.edu.al¹

ABSTRACT

The violence in the workplace against the medical personnel can be defined as a global problem nowadays.

Purpose: The identification of the primary characteristics of the violent episodes against the nursing personnel in the prefecture of Elbasan and the analyzing of the short and long term effects.

Methodology: It is a sectional study done through a structured questionnaire, to the nursing personnel in the Regional Hospital, The Polyclinic of Specialties and the Health Centers in Elbasan. The formulation of the questionnaire was done using Google Forms platform. The Period of compilation 18-28 April 2023. The data was analyzed using the SPSS version.

Results: 84% of the participants in the study were females and 37% were males. 54% of the respondents admit that during their work they have faced the phenomenon of violence. Short term effects were considered: 17.8% agitation/ tremors. 21.5% fear. 11.1% calm, 4.0% courageous. the sample has considered as long term: lack of professional gratitude (12.9%), insecurity during working (16.9%), demoralization (7.7%), stress (17.5%).

Conclusions and Recommendations:

The nursing personnel is bound to face violence during work. Such phenomena have a strong psychological impact causing demoralization, insecurity, fear, continuous panic to loss of the will to work. It is of a vital importance that preventive measures should be taken against this phenomenon.

Keywords: violence, Elbasan, nurse, health centers, hospital.

NJË KRAHASIM MIDIS SHKALLËS SË GLASGOW DHE SHKALLËS FOUR NË VLERËSIMIN E VETËDIJES SË PACIENTËVE KRITIKË

Jasmina Hoxha¹

E-mail: Jasmina.hoxha@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Vlerësimi i vetëdijes për pacientët me sëmundje kritike në njësitë e kujdesit intensiv ka rëndësi të jashtëzakonshme për trajtimin e tyre. Shkalla e komës së Glasgow (GCS) ka qenë për një kohë të gjatë një metodë standarte për vlerësimin e vetëdijes, por shkalla e "Përshkrimit të Plotë të Pavetëdijes" (FOUR) është një metodë e re e vlerësimit që mund të ofrojë avantazhe të mëdha në këtë fushë.

Objektivat: Kjo studim synon të krahasojë efikasitetin e shkallës GCS dhe shkallës FOUR në parashikimin e rezultateve për pacientët me sëmundje kritike në njësitë e kujdesit intensiv. Synohet të rishikohet literatura ekzistuese për të analizuar përparësitë dhe mangësitë e secilës shkallë dhe për të promovuar kërkimet e mëtejshme në këtë fushë në Shqipëri.

Metodologjia: Për të arritur qëllimin, është kryer një rishikim i literaturës për të mbledhur informacionin më të fundit dhe më të rëndësishëm lidhur me shkallën GCS dhe shkallën FOUR. Janë përdorur baza të të dhënave të specializuara mjekësore për të identifikuar studime relevante dhe analiza të ndryshme që i krahasojnë këto dy metoda.

Rezultatet: Studimet kanë treguar se shkalla FOUR ka disa avantazhe në krahasim me shkallën GCS në vlerësimin e vetëdijes së pacientëve me sëmundje kritike në njësitë e kujdesit intensiv. FOUR analizon katër parametra të dallueshëm dhe ofron një gamë më të gjerë të rezultateve, duke mundësuar një vlerësim më të hollësishëm. Kjo shkallë gjithashtu ka treguar potencial të lartë në parashikimin e rezultateve për pacientët e intubuar.

Konkluzionet: Bazuar në shqyrtimin e literaturës, duket se shkalla FOUR ka avantazhe në krahasim me shkallën GCS për vlerësimin e vetëdijes në njësitë e kujdesit intensiv për pacientët me sëmundje kritike. Megjithatë, është e rëndësishme të vazhdojnë kërkimet për të kuptuar më mirë se cila prej këtyre metodave është më e përshtatshme për grupet e ndryshme të pacientëve dhe për situatat klinike të ndryshme. Kjo studim synon të rrisë ndërgjegjësimin rreth rëndësisë së vlerësimit të vetëdijes në kujdesin intensiv dhe të inkurajojë përpjekjet për të zhvilluar më tej këtë fushë të kërkimit në Shqipëri.

Fjalët kyçe: Kujdesi Intensiv, Shkalla e Komës së Glasgow, Shkalla FOUR.

COMPARISON OF GLASGOW COMA SCALE AND FOUR SCORE IN THE EVALUATION OF CRITICALLY ILL PATIENTS' CONSCIOUSNESS

Jasmina Hoxha¹

E-mail: Jasmina.hoxha@hotmail.com

ABSTRACT

Introduction: Assessing consciousness in critically ill patients in intensive care units plays a crucial role in comprehensive evaluation. It is essential for the medical staff to accurately monitor the neurological status of the patient, make appropriate treatment decisions, and predict potential outcomes. The Glasgow Coma Scale (GCS) has long been considered the gold standard for consciousness assessment in intensive care due to its simplicity and ease of use. However, recent developments have introduced the Full Outline of Unresponsiveness Score (FOUR), a newly designed consciousness assessment scale that may offer several advantages compared to the Glasgow Coma Scale.

Objectives: This study aims to compare the effectiveness of the GCS and FOUR scales in predicting outcomes for critically ill patients in intensive care. We intend to review the existing literature to analyze the strengths and limitations of each scale and promote further research in this field within Albania.

Methodology: To achieve this goal, a literature review to gather the most up-to-date and relevant information regarding the GCS and FOUR scales was conducted. Specialized medical databases were utilized to identify relevant studies and various analyses that compare these two methods.

Results: Studies have shown that the FOUR scale has several advantages over the GCS in assessing consciousness in critically ill patients in intensive care units. FOUR analyzes four distinct parameters and offers a wider range of outcomes, enabling a more detailed assessment. This scale has also demonstrated high potential in predicting outcomes for intubated patients.

Conclusions: Based on the literature review, it appears that the FOUR scale has advantages over the GCS in assessing consciousness in intensive care units for critically ill patients. However, continued research is important to better understand which of these methods is more suitable for different patient populations and various clinical scenarios. This study aims to raise awareness about the importance of consciousness assessment in intensive care and encourage efforts to further develop this research field in Albania.

Keywords: ICU, Glasgow Coma Scale, FOUR score.

REANIMIMI POSTOPERATOR NË PROCEDURËN WHIPPLE*Mirva Hoxha¹, Geisi Belishta²**Universiteti ALDENT¹***ABSTRAKT**

Hyrja: Kanceri i pankreasit është një sëmundje debilituese dhe që zakonisht shoqërohet me një prognozë të dobët. Përgjatë këtij prezantimi do të përshkruaj mënyrën se si kanceri i pankreasit afekton në tërësi të gjitha sistemet e organizmit, bazën gjenetike të tij, faktorët predispozues dhe komplikacionet me të cilat shoqërohet. Do të njihemi në mënyrë më të zgjeruar me një prej qasjeve të trajtimit, Pankreatoduodenektominë pilor-prezervuese, ose ndryshe Procedura Whipple, e cila edhe pse shoqërohet me mortalitet dhe morbiditet të lartë, është procedurë e cila sjell çlirim simptomatik për pacientët të cilët vuajnë jo vetëm nga neoformacionet malinje por edhe nga traumat pankreatike, lezionet beninje, pankreatit akut, kronik dhe nekroza sapunifinike e pankreasit

Materialet dhe metodat: Qëllimi i kryerjes së këtij studimi është shqyrtimi i mëtejshëm i praktikave të menaxhimit të pacientëve të cilët i nënshtrohen procedurës Whipple, identifikimi i hershëm i komplikacioneve, menaxhimi i tyre, dhe rrjedhimisht ulja e mortalitetit dhe e morbiditetit në fazen e menjëhershme postoperatore. Një grup prej 14 pacientësh janë përzgjedhur në mënyrë cross-sectionale në Reanimacionin Kirurgjikal të QSUNT. Pacientët janë përzgjedhur në një moment të caktuar kohor, bazuar në disa të përbashkëta: Diagnostikuar me neoplazi malinje pankretike, në fazen e menjëhershme postoperatore pas intervenimit për. Të dhënat e mbledhura janë grupuar në formën e variablave dhe janë përpiluar e analizuar në SPSS, në mënyrë që të evidentohen lidhje statistikore ndërmjet tyre.

Rezultatet: Nga studimi dhe shqyrtimi i literaturës u vërtetua hipoteza se ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme midis disa gjetjeve laboratorike dhe mundësisë së shfaqjes së disa komplikacioneve madhore. Gjithashtu u vërtetua se këto gjetje laboratorike, së bashku me faktorë të tjerë shërbejnë si faktorë prognostik postoperator.

Diskutime dhe konkluzione: Nga studimi u evidentua morbiditet dhe mortalitet tepër i lartë, i cili i atribuohet jo vetëm gjendjes klinike të sëmundjes por dhe modalitetit kirurgjikal të zgjedhur dhe mënyrës se si menaxhohen në njësinë e terapisë intensive. Nga rezultatet e mbledhura është i diskutueshëm qëllimi trajtues i kryerjes së procedurës, dhe ky intervent mund të rezultojë të jetë thjesht paliativ, e cila bie ndesh me qëlimin real të procedurës.

Fjalë Kyçe: Pankreatoduodenektomi, Reanimim, Komplikacione, Mortalitet, Morbiditet.

POST OPERATION REANIMATION IN WHIPPLE PROCEDURE

Mirva Hoxha, Geisi Belishta

ABSTRACT

Introduction: Pancreatic cancer is a debilitating disease that is usually associated with a poor prognosis. Throughout this dissertation, I will describe how pancreatic cancer affects all the body's systems, its genetic basis, predisposing factors and complications with which it is associated. We will be extensively acquainted with one of the treatment approaches, the pyloric-preserving pancreatoduodenectomy, or otherwise the Whipple Procedure, which, although associated with high mortality and morbidity, is a procedure that brings symptomatic relief to patients who suffer not only from malignant neoplasms but also from pancreatic trauma, benign lesions, acute and chronic pancreatitis and soap-film necrosis of the pancreas

Materials and methods: The purpose of conducting this study is to further examine the management practices of patients who undergo the Whipple procedure, the early identification of complications, their management, and consequently the reduction of mortality and morbidity in the immediate postoperative phase. . A group of 14 patients were selected cross-sectionally in the Surgical Resuscitation of QSUNT. The patients were selected at a certain point in time, based on some commonalities: Diagnosed with malignant pancreatic neoplasia, in the immediate postoperative phase after intervention for. The collected data are grouped in the form of variables and compiled and analyzed in SPSS, in order to identify statistical relationships between them.

Results: The study and review of the literature confirmed the hypothesis that there is a statistically significant relationship between some laboratory findings and the possibility of some major complications. It was also proven that these laboratory findings, together with other factors, serve as post-operative prognostic factors.

Discussions and conclusions: The study revealed high morbidity and mortality, which is attributed not only to the clinical condition of the disease but also to the surgical modality chosen and the way they are managed in the intensive care unit. From the collected results, the therapeutic purpose of performing the procedure is debatable, and this intervention may turn out to be simply palliative, which contradicts the real purpose of the procedure.

Keywords: Pancreatoduodenectomy, Resuscitation, Complications, Mortality, Morbidity.

INFERMIERI DHE ASPEKTET SHËNDETËSORE VLERAT ETIKE NË SPITALIN E PËRGJITHSHËM, PRIZREN

Esat Qovanaj¹, Edin Ajradini²

ABSTRAKT

Hyrje: Ky abstrakt shkencor eksploron rolin vendimtar të infermierëve në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në sistemin sekondar dhe shqyrton aspektet etike që lidhen me ndërveprimet e tyre me pacientët në një mjedis spitalor. Infermierët mjekësorë luajnë një rol themelor në ofrimin e kujdesit të dhembshur, duke mbrojtur të drejtat e pacientëve dhe duke mbështetur parimet etike gjatë gjithë praktikës së tyre profesionale.

Qëllimi i punimit: Njohja dhe rishikimi i nivelit të besueshmërsë e aspekteve etike në mes të infermiereve dhe pacientëve në kujdesin sekondar në Prizren. Krahas saj kemi qëllimin sekondar që të njohim lidhjet mes tyre dhe variablave të tjerë si mosha, gjinia, prezenca e sëmundjeve kronike.

Materialet dhe metodologjia: Në këtë hulumtim janë përfshirë të gjithë pacientët që kanë vizituar spitalin në priudhen kohore 5 ditore duke përfshirë edhe evidentimin e të gjitha konsultave tek pacientët në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren. Si instrument kryesor i hulumtimit është përdorur pyetësor (Pyetësi i anketës: Infermieri dhe aspektet Shëndetësore /Vlerat Etike në Spitalin e Prizrenit). Përpunimi i rezultateve është bërë me SPSS 26 dhe Microsoft Excel 2016.

Rezultatet: Në një mostër kros-seksionale prej 76 pacientësh (51.3 % meshkuj dhe 48.7% femra, M mosha =46.63, DS=15.19); të vizituar në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren janë aplikuar pyetësorët.

Konkludim: Kemi kryesisht besim të lartë e pacientëve në të gjitha repartet e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit.

Fjalët kyçe: Infermierë, normat etike, crregullimet, simptomatologji, hospitalizimi, diagnoza, hulumtimi.

NURSING AND HEALTH ASPECTS; ETHICAL VALUES IN THE REGIONAL HOSPITAL OF PRIZREN

Esat Qovanaj¹, Edin Ajradini²

ABSTRACT

Introduction: This scientific abstract explores the crucial role of nurses in the provision of health care services in the secondary system and examines the ethical aspects related to their interactions with patients in a hospital setting. Nurses play a fundamental role in providing compassionate care, protecting patients' rights and upholding ethical principles throughout their professional practice.

The aim of the paper: Recognition and review of the level of trustworthiness of ethical aspects between nurses and patients in secondary care in Prizren. In addition, we have the secondary goal of knowing the connections between them and other variables such as age, gender, the presence of chronic diseases.

Materials and methodology: In this research, all the patients who visited the hospital in a 5-day period are included, including the recording of all patient consultations at the General Hospital in Prizren. A questionnaire was used as the main research instrument (Survey Questionnaire: Nursing and Health Aspects / Ethical Values in Prizren Hospital). Data processing of the results was done with SPSS 26 and Microsoft Excel 2016.

Results: The questionnaires were applied in a cross-sectional sample of 76 patients (51.3% male and 48.7% female, M age =46.63, DS=15.19); which have visited the General Hospital in Prizren, the questionnaires were applied.

Conclusions: We mainly have high trust of patients in all wards of the General Hospital of Prizren.

Keywords: Nurses, ethical normatives, disorders, symptomatology, hospitalization, diagnosis, research.

KUJDESI I PERSONELIT INFERMIEROR NË PACIENTËT ME COVID- 19

Eugen Ismulli¹

Kryeinfermier në Repartin e Terapisë Intensive, Spitali Amerikan³

eismolli@spitaliamerikan.com

ABSTRAKT

Covid-19 paraqet një sërë problemesh të rëndësishme për implikimin e shumë organeve edhe pse me focus mushkëritë. Për këtë arsye një pjesë e pacientëve shtrihen në terapi intensive, në të cilën roli infermieror është mjaft i rëndësishëm dhe thelbësor.

Metoda:

Si çdo pacient tjetër në terapi intensive, trajtimi infermieror mbështetet në të njëjtat parime duke shtuar në këtë rast edhe protokollet e mbrojtjes së personelit si edhe parandalimin e përhapjes mes tyre.

Diskutimi: Siç dihet virusi përhapet nëpërmjet sperklave respiratore gjatë kollitjes dhe/ose asistencës respiratore tek keta pacientë. Repartet e urgjencës dhe të terapisë intensive janë mjaft të rrezikuara. Prezantimet klinike janë mjaft të ndryshme dhe përfshijnë që nga simptomat respiratore (kollë, rrufë, vështirësi në frymemarrje), dhimbje fyti, mialgji, simptoma gastrointestinale (diarre, nausea, te vjella, dhimbje barku).

Përgjegjësia kryesore infermiere është të mbrojnë vetveten dhe të minimizojnë trasmetimin. Për këtë arsye shërbejnë trajnimi dhe përvetësimi i protokolleve të përdorimit të PPE, si edhe organizimi në Terapi intensive të ambienteve të veçanta ku do trajtohen këto pacientë. Përdorimi jo adekuat i PPE, cilësia jo e përshtashme e tyre, apo edhe tendencat për risterilizim, janë faktorë për të rritur trasmetimin dhe ankthin ndërmjet personelit infermieror. Numri i personeli në dhomat ku trajtohen pacientët me Covid-19, duhet të jetë i kufizuar dhe i justifikuar. Nga ana tjetër ka rëndësi komunikimi midis stafit që pret pacientin dhe stafin që bie në spital, me qëllim marrjen e masave paraprake mjekësore dhe të sigurisë. Kur pacienti paraqitet në terapi intensive, atëherë infermierja e monitoron dhe krijon një pershtypje të përgjithshme mbi shenjat vitale të pacientit dhe situatën klinike. Pas monitorimit dhe oksigjenoterapisë në varësi të gravitetit të situatës, realizohet marrja e analizave që përfshijnë gjak komplet, d-dimer, ferritinemi, fibrinogjen, crp, prokalcitonine, si edhe egzaminimet e tjera që kërkon mjeku.

Konkluzioni: Trajtimi i këtyre pacientëve përveç asistencës respiratore përfshin edhe kujdesin për organet vitale, nutricionin, parandalimin e dekubituseve, fizioterapinë, dhe kujdes për suportin psikologjik sipas rastit.

Fjalet kyçe: *Covid-19, ARDS, Kujdes infermieror.*

CARE OF NURSING STAFF IN PATIENTS WITH COVID-19

Eugen Ismolli¹

Head nurse in the Intensive Care Department, American Hospital 3¹

eismolli@spitalamerikan.com

ABSTRACT

Covid-19 presents a series of important problems for the involvement of many organs, although with a focus on the lungs. For this reason, some patients are placed in intensive care, in which the nursing role is very important and fundamental.

Materials and Method: Like any other patient in intensive therapy, nursing treatment is based on the same principles, adding in this case the protocols of personnel protection as well as the prevention of the spread between them.

Discussion: As is known, the virus spreads through respiratory droplets during coughing and/or respiratory assistance in these patients. The emergency and intensive care departments are very vulnerable. Clinical presentations are quite different and include respiratory symptoms (cough, wheezing, difficulty breathing), sore throat, myalgia, gastrointestinal symptoms (diarrhea, nausea, vomiting, abdominal pain).

The main nursing responsibility is to protect oneself and minimize transmission. For this reason, training and acquisition of PPE use protocols are useful, as well as the organization of special rooms in intensive therapy where these patients will be treated. Inadequate use of PPE, their inappropriate quality, or even tendencies to resterilize, are factors to increase transmission and anxiety among nursing staff. The number of personnel in the rooms where patients with Covid-19 are treated must be limited and justified. On the other hand, communication is important between the staff waiting for the patient and the staff entering the hospital, in order to take medical and safety precautions. When the patient appears in intensive therapy, the nurse monitors him and creates a general impression on the patient's vital signs and the clinical situation. After monitoring and oxygen therapy, depending on the gravity of the situation, the analysis is carried out including complete blood, dimer, ferritinemia, fibrinogen, crp, procalcitonin, as well as other examinations required by the doctor.

Conclusion: In addition to respiratory assistance, the treatment of these patients also includes care for vital organs, nutrition, prevention of decubitus, physiotherapy, and care for psychological support as appropriate.

Keywords: *Covid-19, ARDS, Nursing care*

“KUJDESJET E HUMBURA INFERMIERORE”, NJË STUDIM DESKRIPTIV PËR LLOJET DHE IDENTIFIKIMIN E SHKAQEVE

Phd.cand Ilda Taka¹, Doc Elona Hasalla¹, Phd.cand Albana Sula¹, Phd.cand Elona Zhiva¹, Phd.cand Rajmonda Hida¹

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan

ilda.taka@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Koncepti “kujdes i humbur” në infermieri është përdorur për të pëshkruar situata ku aktivitete të kujdesit shëndetësor të cilat janë vlerësuar si të rëndësishme ose të nevojshme për pacientët nuk plotësohen ose janë shtyrë për një arsye ose tjetër.

Objektivi

Ky studim kishte si objektiv vlerësimin e aktiviteteve që humbin më shpesh gjatë kujdesit të përditshëm infermior dhe identifikimin e shkaqeve që mund të ndikojnë për praninë e tyre sipas infermierëve.

Metoda

Ky është një studim deskriptiv kross-seksional i cili u krye duke bërë shpërndarjen pyetësorit nëpërmjet aplikacionit “google form”. Pyetësi përbëhej nga 3 sesione: sesioni i parë me të dhëna socio-demografike dhe profesionale, sesioni i dytë me 12 pyetje për vlerësimin e frekuencës së kujdesjeve të humbura ose të shtyrë në punën e tyre dhe sesioni i tretë me 15 pyetje për matjen e perceptimit të infermierëve rreth arsyeve të “kujdesit të humbur”.

Rezultate

Formulari u plotësua nga 48 infermierë nga të cilët 42 ishin femra dhe 6 meshkuj me një moshë mesatare 30+_2.5. Rreth 87,5% e infermiereve iu përgjigjën të gjitha pikave të pyetësorit ku u pa se mobilizimi pasiv i pacientit çdo 2 orë (31,8%) dhe dhënia e ndihmës në ushqyerje (27,2%) ishin dy nga kujdesjet e humbura më të shpeshta. Ndërsa si shkaqe për humbjen e kujdesjeve infermierore u referuan: prania e rasteve urgjente (56,5%), numri i madh i pacienteve për 1 infermier (56,5%) dhe rritja e numrit të të shtruarve në spital (60,8%).

Konkluzione

Zvogëlimi i humbjes së kujdesit infermior është një sfidë komplekse. Identifikimi i shkaqeve thelbësore thekson nevojën për rritjen e numrit të personelit infermior, balancimi e shpërndarjes së infermierëve për pacient dhe zbatimi i strategjive për një komunikim efektiv ndërmjet anëtarëve të kujdesit shëndetësor. Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së kujdesit për pacientët, reduktimin e kostove për sistemin shëndetësor dhe në rritjen e kënaqësisë së punës për infermierët.

Fjalë kyçe: kujdes i humbur infermior, infermier, shkak, cilësi, pacient.

"MISSED NURSING CARE": A DESCRIPTIVE STUDY ON TYPES AND IDENTIFICATION OF CAUSES"

PhD Candidate Ilda Taka¹, Dr. Elona Hasalla¹, PhD Candidate Albana Sula¹, PhD Candidate Elona Zhiva¹, PhD Candidate Rajmonda Hida¹

¹Faculty of Technical Medical Sciences, Elbasan

email: ilda.taka@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction:

The concept of 'missed care' within nursing is utilized to describe situations where essential healthcare activities for patients are either not delivered or delayed due to various reasons.

Objective:

This study aims to evaluate the most frequently missed nursing care tasks during daily routines and to pinpoint factors that contribute to these occurrences as perceived by nurses.

Method:

This descriptive cross-sectional study employed a questionnaire distributed through the "Google Form" application. The questionnaire consisted of three sections: the first section gathered socio-demographic and professional data, the second section contained 12 questions assessing the frequency of missed or postponed nursing tasks, and the third section included 15 questions gauging nurses' perceptions regarding the reasons behind 'missed care'.

Results:

The survey was completed by 48 nurses, comprising 42 females and 6 males, with an average age of 30+_2.5. A notable 87.5% of nurses responded to all questionnaire items. Findings revealed that activities like passive patient mobilization every 2 hours (31.8%) and aiding with feeding (27.2%) were the most commonly missed care tasks. Key causes reported for missed nursing care included the presence of urgent cases (56.5%), high patient-to-nurse ratios (56.5%), and an upsurge in hospital admissions (60.8%).

Conclusion:

Mitigating missed nursing care presents a multifaceted challenge. Identifying primary causes underscores the necessity for augmenting nursing personnel, rebalancing nurse-patient ratios, and implementing strategies that promote effective communication among healthcare team members. Such measures hold promise in elevating patient care quality, curtailing healthcare system expenditures, and enhancing nurse job satisfaction.

Keywords: missed nursing care, nurse, causality, quality, patient.

VLERËSIMI I KENAQËSISË DHE STRESIT TEK INFERMIERËT E SHËRBIMIT TË HEMODIALIZËS NË QENDRËN SPITALORE “XHAFERR KONGOLI”

Ilma Toçi¹, Xhoana Lazellari², Rajmonda Hida¹, Venemin Gega¹, Gjergji Doka¹, Arkida Skenderi¹, Behije Golloberda

¹As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit

“Aleksandër Xhuvani”

² Infermiere, Qendra spitalore” Xhaferr Kongoli” Elbasan

ABSTRAKT

Hyrje: Kujdesi infermior në shërbimin e hemodializës, një mjedis relativisht i kompleksuar nga pikëpamja teknologjike, karakterizohet nga kontakti i shpeshtë dhe intensiv me pacientin. Studime të shumta evidentojnë faktin se infermierët e hemodializës përballen me stresorë që lidhen me natyrën dhe mjedisin e punës së tyre që çon në nivele të ulëta të kënaqësisë në punë dhe nivelit të lartë të stresit (burnout).

Qëllimi: Vlerësimi i nivelit të kënaqësisë dhe stresit në punë tek Infermierët e shërbimit të hemodializës në Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” në qytetin e Elbasanit.

Metodologjia: Të dhënat u mblodhën nga një pyetësor i vetëstrukturuar nga rishikimi i literaturës dhe DASS21. Pjesa e parë e pyetësorit përbëhej nga pyetje sociodemografike dhe karakteristikat e punës. Faza e dytë konsistoi në shpërndarjen e pyetësorit dhe intervista të drejtpërdrejta me personelin infermior. Pyetësori iu shpërnda 15 infermiereve nëpërmjet platformës digjitale Google forms, të cilët gjithashtu iu nënshtruan edhe intervistimit.

Rezultatet: Infermierët e hemodializës raportuan një nivel të pranueshëm të kënaqësisë në punë dhe të perceptuar mjedisi i tyre i punës pozitivisht, megjithëse u konstatuan simptoma ankthi dhe depresioni tek disa prej tyre duke rritur kështu nivelin e stresit. Infermieret ishin të një moshe relativisht të re, dhe kishin punuar jo më gjatë se 1 vit në hemodializë.

Konkluzione: Infermierët e hemodializës përjetonin nivel jo të lartë të stresit edhe ishin të kënaqur nga mjedisi i tyre i punës i cili ishte i favorshëm. Kryeinfermierët dhe drejtuesit e shërbimeve duhet të marrin parasysh këto rezultate për hartimin e strategjive për të mbajtur dhe shmangur stresin në infermierët më të rinj dhe me më pak përvojë në këtë fushë specifike të kujdesit infermior.

Fjalët kyçe: infermier, hemodializë, kënaqësi, stres, punë

ASSESSMENT OF SATISFACTION AND STRESS AMONG THE NURSES OF THE HEMODIALYSIS SERVICE AT THE "XHAFFERR KONGOLI" HOSPITAL CENTER

Ilma Toçi¹, Xhoana Lazellari², Rajmonda Hida¹, Venemin Gega¹, Gjergji Doka¹, Arkida Skenderi¹, Behije Gollobërda

¹Associate/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan

"Aleksander Xhuvani"

² Nurse, Hospital Center "Xhaferr Kongoli" Elbasan

ABSTRACT

Introduction: Nursing care in the hemodialysis service, a relatively complex environment from a technological point of view, is characterized by frequent and intensive contact with the patient. Numerous studies highlight the fact that hemodialysis nurses face stressors related to the nature and environment of their work, which leads to low levels of job satisfaction and high levels of stress (burnout).

Purpose: Assessment of the level of satisfaction and stress at work among the nurses of the hemodialysis service at the Xhaferr Kongoli Hospital Center in the city of Elbasan.

Methodology: Data were collected by a self-structured questionnaire from the literature review and DASS21. The first part of the questionnaire consisted of sociodemographic questions and work characteristics. The second phase consisted of distributing the questionnaire and direct interviews with the nursing staff. The questionnaire was distributed to 15 nurses through the digital platform Google forms, who were also interviewed.

Results: Hemodialysis nurses reported an acceptable level of job satisfaction and perceived their work environment positively, although symptoms of anxiety and depression were found in some of them, thus increasing the level of stress. The nurses were of a relatively young age, and had worked no longer than 1 year in hemodialysis.

Conclusions: Hemodialysis nurses experienced a low level of stress and were satisfied with their work environment which was favorable. Chief nurses and service managers should take these results into account when designing strategies to maintain and avoid stress in younger and less experienced nurses in this specific area of nursing care.

Keywords: nurse, hemodialysis, satisfaction, stress, work.

MENAXHIMI I PACIENTIT TË IMOBILIZUAR ME GIPS

*PhD.cand Elona Prifti Zhiva¹, Dr.Denisa Naqellari², PhD.cand. Ilda Taka², PhD.Dr. Albana Sula²
Msc. Jonila Cela.*

Universiteti "Aleksander Xhuvani", FSHMT Elbasan.

e-mail: elonazhiva@yahoo.com

ABSTRAKT

Hyrje: Imobilizimin me gips, mund ta konsiderojmë si fiksimin e tij në një aparat apo mjet të jashtëm rigid të modeluar rreth trupit apo anësisë së dëmtuar. Qëllimi i kësaj mënyre është imobilizimi i një pjese të dëmtuar, në pozicion anatomo-fiziologjik deri në arrijtjen e ngjijtes apo shërimitin e dëmtimit.

Qëllimi i studimit: Ky studim ka për qëllim të përcaktojë rëndësinë e kujdesjeve infermierore në pacientët me gips. Kujdesi infermior, lidhet me parandalimin e ndërlikimeve nga gipsi, presionet në indet e buta dhe në proeminencat kockore, evitimin e pengesave të qarkullimit të gjakut dhe atij limfatik, etj.

Metoda dhe materiali: Ky studim është kuantitativ, analitik, 1 vjeçar. U morën të dhëna nga kartelat mjekësore dhe infermierore për një periudhë 1 vjeçare, 2022 – 2023, në shërbimin e spitalit të Traumës dhe Ortopedisë, Tiranë, për të përcaktuar rëndësinë që ka kujdesi infermior në parandalimin e komplikacioneve dhe ecurinë e rehabilitimit të pacientëve me fraktura dhe luksacione.

Rezultatet: Në studim u morën 50 pacientë me gips. Nga studimi i këtyre rasteve rezultoi se: Me rritjen e njohurive të stafit infermior në ndihmën që iu ofrohej pacientëve me gips, 30 nga këta pacientë që u morën në studim, e toleruan mirë gipsin dhe nuk kishin pësuar asnjë komplikacion nga vendosja e gipsit. 15 nga pacientët që u morën në studim referuan se në fillim nuk e toleruan mirë gipsin, duke referuar edemë, por për të kontrolluar edemën infermieri e ndihmon pacientin, duke ngritur krahun, (në rastet e imobilizimit të gjymtyrëve të sipërme) e imobilizuar në mënyrë të tillë që bërryli të jetë më lart se shpatulla, dhe dora më lart se bërryli. Në rastin e gjymtyrëve të poshtme, kujdesjet infermierore konsistojnë në vendosjen e këmbës së pacientit mbi disa jastekë deri sa të arrihet niveli i zemrës për të kontrolluar edemën dhe vendos akull mbi vendin e frakturës për 1 deri në 2 ditë. 5 nga pacientët, nuk e toleruan mirë gipsin dhe patën komplikacione, si dhimbje e vazhdueshme dhe sindromën e kompartmentit.

Konkluzione: Detyrat kryesore të stafit infermior në pacientët me gips përfshijnë: Reduktimin e ankthit, përsosjen e komfortit, rritjen e aftësive për vetëkujdesje dhe shmangien e komplikacioneve si: sindroma e kompartmentit, ulçerat e lëkurës nga presioni dhe sindroma e mospërdorimit. Pacienti duhet të kuptojë në mënyrë të saktë qëllimin e përdorimit të gipsit. Pacientët janë më aktivë në kujdesin e shëndetit të tyre, kur ata e kanë kuptuar plotësisht rëndësinë e mbajtjes së gipsit.

Fjalët kyçe: Gips, sindroma e kompartmentit, imobilizim, vetëkujdesje.

NURSING MANAGEMENT OF PATIENTS WHO ARE IMMOBILIZED IN GYPSUM

*PhD.cand Elona Prifti Zhiva¹, Dr.Denisa Naqellari², PhD.cand. Ilda Taka², PhD.Dr. Albana Sula²
Msc. Jonila Cela.*

University of Elbasan, "Aleksander Xhuvani", FSHMT Elbasan.

e-mail: elonazhiva@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: Gypsum can be considered as fixing it to a rigid external device or tool modeled around the body or damaged part. The purpose of this method is the immobilization of a damaged part, in the anatomy-physiological position until reaching the adhesion or healing of the injury.

Scope and Purpose: This study aims to determine the importance of nursing care in patients who are been used the gypsum. Nursing care is related to the prevention of complications from the use of gypsum, pressures in soft tissues and bone marrow, avoiding blood circulation and lymphatic obstruction, etc.

Material and Methods: This is a quantitative and analytical study. Information was taken from medical and nursing cards, for a period of 1 year, 2022-2023, in the service of the Trauma and Orthopedic Hospital in Tirana, to determine the importance of nursing care in preventing complications and the progress of rehabilitation of patients with fractures and luxationes.

Results: In the study, were included 80 patients, who had used the gypsum. From the study of these cases it resulted that: With the increase of nursing staff knowledge in the assistance provided to traumatized patients, 80 of these patients tolerated well the gypsum and referred that had not suffered any complications from the laying of gypsum. 15 of the patients said they did not tolerate the gypsum at first, they referred that they had edema, but to control the edema the nurse raises the arm, (in cases of immobilization of the upper limbs), immobilized in such a way that the elbow is higher than the shoulder, and the arm above the elbow. In the case of the lower limbs, the nursing care consists in placing the patient's leg over some cushions until the heart rate is reached to control the edema and puts ice over the fracture site for 1 to 2 days. 5 of the patients did not tolerate good gypsum and had complications, such as constant pain and compartment syndrome.

Conclusions: The main tasks of nursing staff in patients who use the traction are the following: Reducing anxiety, providing comfort, increasing self-care skills and avoiding complications such as: compartment syndrome, skin ulcers from the pressure and non-use syndrome. The patient must correctly understand the purpose of using the gypsum. The information needs to be repeated frequently. Patients are more active in their health care when they have fully understood the therapy.

Keywords: Gypsum, compartment syndrome, immobilization, self-care.

MËNYRAT E VENDOSJES DHE MIRËMBAJTJA E KATETERIT PERIFERIK VENOZ (KPV)

Klajdi Belishta¹

¹ *Koordinator i KSHI, pedagog i jashtëm në Fakultetin e Infermierisë, Universiteti Fan.S.Noli, Infermier në pavionin e Neurologjisë, Spitali Rajonal Korçë,*

klajdibelishta@kshi.al

ABSTRAKT

Kateteri periferik venoz (KPV), është një procedurë, që realizohet gjërësisht në çdo pavion apo qendër trajtimi, por një rëndësi akoma më të madhe merr në sallat operatore. Në varësi të gjendjes dhe stadiit të pacientit, personelit infermior i duhet të njoh procedurën në tërësi dhe elementet që ndikojnë në jetëgjatësinë dhe komplikacionet e KPV. Ky punim është përqëndruar më shumë tek materialet, procedura, mitet, komplikacionet dhe mënyrën e zgjedhjes së KPV.

OBJEKTIVA: Objektivi i studimit ishte rëndësia e njohjes së procedurës, komplikacioneve dhe roli i infermierit në kujdesin ndaj pacientit.

METODOLOGJIA: Janë vëzhguar pacientët dhe infermierët gjatë trajtimit të pacientëve në ndërhyrjet kirurgjikale të kryera në Spitalin Rajonal të Korçës, në periudhën Qershor 2021 deri Maj 2022. Në total janë vëzhguar 78 pacientë që ju nënshtruan ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara.

REZULTATET: KPV është një paisje intravaskulare, që qëndron e fiksuar për një periudhë kohore, sipas protokollit 48-72 orë. Gjatë këtij intervali kohor, nga mënyra e vendosjes, antiseptikut të zgjedhur, fiksusit të përdorur, rregullat e asepsisë, përdorimi ose jo i tre-rrugëshit, mund të shfaqen komplikacione si hematoma, dhimbja, djegja, flebiti, infiltrimi, ekstravazioni dhe trombo-flebiti. Bazuar në rezultatet e studimit 3 pacientë u identifikuan me flebit, 4 pacientë me hematoma, 2 pacientë me infiltrim, 2 pacientë me ekstravazion, 5 pacientë referuan për dhimbje, dhe 2 pacientë për djegie.

KONKLuzionet: Insetimi i KPV është dhe do të mbetet një nga procedurat bazë të profesionit infermior. Për të shmangur komplikacione të lidhura me procedurën rekomandohet njohja e mirë nga ana e stafit infermior të diametrit, gjatësisë, ngjyrat, numrat, dhe njësitë matëse të KPV. Rekomandohen trajnime të vazhdueshme për përvetësimin sa më të mirë të procedurës nga stafi infermior.

FJALË KYÇE: KPV, Gauge, inch, trombo-flebit, infiltrim, hematoma, ekstravazion.

METHODS OF PLACEMENT AND MAINTENANCE OF THE PERIPHERAL VENOUS CATHETER (PVC)

Klajdi Belishta¹

¹ *KSHI coordinator, external academic staff e at the Fan.S.Noli University, Faculty of Nursing, Nurse at the Neurology ward, Korca Regional Hospital, Albania,*

klajdibelishta@kshi.al

ABSTRACT

INTRODUCTION; Peripheral venous catheterization (PVC) is a procedure that is widely performed in every ward or treatment center, but it takes on even greater importance in operating rooms. Depending on the condition and stage of the patient, the nursing staff should know the procedure as a whole and the elements that affect the life expectancy and complications of the PVC. This paper is more focused on materials, procedures, myths, complications, and the process of choosing PVC.

OBJECTIVES; The objective of the study was to determine the importance of knowing the procedure, its complications, and the nurse's role in patient care.

METHODOLOGY; Patients and nurses were observed during the treatment of patients in surgical interventions performed at the Regional Hospital of Korça in the period from June 2021 to May 2022. In total, 78 patients who underwent planned surgical interventions were observed.

RESULTS; The PVC is an intravascular device that remains fixed for a period of time, according to the 48–72-hour protocol. During this time interval, complications such as hematoma, pain, burning, phlebitis, infiltration, extravasation, and thrombo-phlebitis may appear due to the method of placement, the antiseptic chosen, the fixation used, the rules of asepsis, and the use or not of the three-way. Based on the results of the study, 3 patients were identified with phlebitis, 4 patients with hematoma, 2 patients with infiltration, 2 patients with exvasation, 5 patients referred for pain, and 2 patients for burns.

CONCLUSIONS; The insertion of the PVC is and will remain one of the basic procedures of the nursing profession. To avoid complications related to the procedure, it is recommended that the nursing staff be familiar with the diameter, length, colors, numbers, and measurement units of the PVC. Continuous training is recommended for the best acquisition of the procedure by the nursing staff.

KEYWORDS; PVC, inch, thrombophlebitis, infiltration, hematoma, extravasation.

MENAXHIMI I KONVULSIONEVE FEBRILE TEK PACIENTËT PEDIATRIK*Elona Areza**Kryeinfermiere ne Repartin e Urgjences, Spitali Amerikan 3*elona.areza@spitaliamerikan.com**ABSTRAKT**

Konvulsionet febrile janë ngjarje të lidhura me temperaturën e lartë që ndodhin tek infantët ose fëmijët midis moshës 6 muaj deri 6 vjeç. 2-5 % e fëmijëve në Evropë kalojnë një konvulsion febril nga të cilët vetëm 20% kalojnë konvulsion febril kompleks, 5% status febril epileptik dhe 75% konvulsione febrile të thjeshta.

Materiali dhe Metoda: Vetëm 1/3 e fëmijëve që kanë kaluar një episod febril mund të kalojnë një të dytë; ku më të predispozuar janë: fëmijet me histori familjare, që kanë një episod të parë përpara 18 muajsh, me temperaturë mbi 38 gradë celcius dhe kur njëri nga pjesëtarët vuan nga epilepsia. Etiologjia e saktë e konvulsioneve febrile është e panjohur, por konsiderohet të jetë rezultat i ndërveprimit të faktorëve gjenetikë me faktorët ambiental. Duhet të dyshojmë për KF në raste me temperaturë më të lartë se 38 gradë, moshë më e vogël se 5-6 vjeç, kryesisht 1-3 vjeç, seksi femër prioritar, histori familjare pozitive. Temperatura në konvulsionin febril është e lidhur kryesisht me: Infeksionet virale, Otit media, Tonsilit etj.

Diskutimi: Konvulsionet febrile i klasifikojmë në të thjeshta dhe komplekse. Konvulsione febrile të thjeshta: 95% e konvulsioneve lidhen me ngritjen e menjëhershme të temperatures. Konvulsione febrile komplekse: 5% e konvulsioneve kanë origjinë intrakraniale. K.F të thjeshta: Shfaqen nga 9 muaj deri 5 vjeç, zgjasin më pak se 1 min, kriza ndalon spontanisht dhe nuk kemi përsëritje brenda 24 orëve, shfaqen në fëmijë pa vonesë psiko motore dhe pa anomali neurologjike. Kf komplekse: zgjasin më shumë se 10 minuta me përsëritje brenda 24 orëve, kemi dridhje fokale, psh konvulsioni ndodh vetëm nga njëra anë e trupit, ndërjegjija e plotë rikthehet vonë (pas një ore) dhe kem anomali neurologjike. Fëmija mund të kalojë deri në status epileptik. Vendosja e diagnozës konsiston në një anamnezë të hollësishme dhe të kujdeshme natyra kohëzgjatja e konvulsionit, sëmundjet e kaluara dhe temperatura, përdorimi i antibiotikëve etj.

Shenjat klinike të K.F janë: temperaturë mbi 38 gradë celcius, e qarë që nuk qetësohet me asgjë, fiksion të syve, humbje të ndërjegjjes, ngërç focal ose i përgjithshëm, lëvizje të pakordinuara të këmbëve dhe duarve, vështirësi në frymëmarrje, shkurmb nga goja, zbehje ose një ngjyrë të lëkurës si blu, dhe fiksion të syve. Pas konvulsionit fëmijët janë të përgjumur dhe ndonjëherë konfuz, dhe ju duhen mbi 30 minuta të zgjohen plotësisht. Monitorimi i kujdesshëm neurologjik ka rëndësinë e vetë-reagimi pupilar (niveli i ndërjegjjes), rigiditeti i qafës (meningit apo encefalit) si dhe kryerja e punkcionit lumbar nëse dyshohet për infeksione të kokës. Diagnoza diferenciale, trajtimi dhe menaxhimi i Kf në urgjencëka rëndësinë e vet gjithashtu dhe edukimi dhe suporti i familjarëve si një pikë kryesore për trajtim në këtë temë.

Konkluzioni: Diagnoza është klinike dhe është shumë e rëndësishme të kuptohet nëse kemi të bëjmë me konvulsione febrile të thjeshta apo komplekse. Menaxhimi konsiston në kontrollin e simptomave dhe trajtimin e shkakut të temperaturës. Personeli infermior dhe shëndetësorë kanë për detyrë të mbështesin familjarët, të cilët janë shumë të stresuar, të frikësuar dhe ankthioz. Është shumë e rëndësishme të qetësohen dhe të mësohen familjarët si të menaxhojnë këtë situatë në kushte shtëpie.

Fjalet kyçe: *Konvulsione febrile të thjeshta, konvulsione febrile të përbëra, temperaturë, fëmijë, eplepsi, kriza.*

MANAGEMENT OF FEBRILE SEIZURES IN PEDIATRIC PATIENTS*Elona Areza¹**Head nurse in the Emergency Department, American Hospital 3¹**elona.areza@spitalamerikan.com***ABSTRACT**

Febrile convulsions are events associated with high fever that occur in infants or children between the ages of 6 months and 6 years. 2-5% of children in Europe experience a febrile seizure of which only 20% experience complex febrile seizures, 5% febrile status epilepticus and 75% simple febrile seizures.

Materials and Methods: Only 1/3 of children who have experienced a febrile episode may experience a second one; where the most predisposed are: children with a family history, who have a first episode before 18 months, with a temperature above 38 degrees Celsius and when one of the members suffers from epilepsy. The exact etiology of febrile convulsions is unknown, but it is considered to be the result of the interaction of genetic factors with environmental factors. We should suspect CF in cases with a temperature higher than 38 degrees, age less than 5-6 years, mostly 1-3 years, priority female sex, positive family history. The temperature in the febrile convulsion is mainly related to: Viral infections, Otitis media, Tonsillitis, etc

Discussion: We classify febrile convulsions into simple and complex KF. Simple febrile seizures: 95% of seizures are associated with a sudden rise in temperature. Complex febrile seizures: 5% of seizures have an intracranial origin. Simple seizures: They appear between 9 months and 5 years, they last less than 1 minute, the seizure stops spontaneously and there are no recurrences within 24 hours, they appear in children without psycho motor delay and without neurological abnormalities. Complex seizures: last more than 10 minutes with recurrence within 24 hours, we have focal tremors, for example, the convulsion occurs only on one side of the body, full consciousness is restored late (after an hour) and I have a neurological anomaly. The child can go to status epilepticus.

Establishing the diagnosis consists of a detailed and careful anamnesis, the nature and duration of the convulsion, past illnesses and temperature, the use of antibiotics, etc. The clinical signs of KF are: temperature over 38 degrees Celsius, crying that does not calm down with anything, eye fixation, loss of consciousness, focal or general numbness, uncoordinated movements of the legs and hands, breathing difficulties, foaming at the mouth, paleness or a blue-like skin color, and staring. After a seizure, children are drowsy and sometimes confused, and it takes over 30 minutes for them to fully wake up. Careful neurological monitoring is important - pupillary reaction (level of consciousness), neck stiffness (meningitis or encephalitis) and lumbar puncture if head infections are suspected.

Differential diagnosis, treatment and management of CF in the emergency has its own importance as well as the education and support of family members as a main point for treatment in this matter.

Conclusion: The diagnosis is clinical and it is very important to understand whether we are dealing with simple or complex febrile convulsions. Management consists of controlling the symptoms and treating the cause of the fever. Nursing and health personnel have the duty to support family members, who are very stressed, scared and anxious. It is very important to calm down and teach family members how to manage this situation at home.

Keywords: simple febrile convulsions, combined febrile convulsions, temperature, children, epilepsy, crisis

RRUGËT EFIKASE TË ADMINISTRIMIT TË MEDIKAMENTEVE NË URGJENCËN SPITALORE

Skënder Brataj

Indrit Jaupaj

The National Medical Emergency Center

ABSTRAKT

Arresti kardial është një urgjencë mjekësore kritike që kërkon ndërhyrje të shpejt dhe efektive për të përmirësuar rezultatet e pacientit. Ndër këto ndërhyrje, administrimi i adrenalinës (epinefrina) është një komponent vendimtar, i cili shërben për të rritur prodhimin kardial dhe perfuzionin sistematik. Ky rishikim sistematik dhe meta-analizë synojnë të ofrojnë një krahasim të efikasitetit dhe sigurisë së dy rrugëve kryesore të administrimit të adrenalinës: Intravenoze (IV) dhe Intraosseous (IO) në kontekstin e arrestit kardial. Ne analizuam me përpikëri një përzgjedhje gjithëpërfshirëse të studimeve të publikuara deri në shtator 2021 për të vlerësuar rezultatet që lidhen me administrimin IV dhe IO të adrenalinës. Rishikimi ynë përfshiu të dhëna në lidhje me kohën e përgjigjes, shpërndarjen e suksesshme të drogës, kthimin e qarkullimit spontan (ROSC), shkallët e mbijetesës dhe rezultatet neurologjike. Gjetjet e këtij rishikimi do të kontribuojnë me njohuri të vlefshme në procesin e vendimmarrjes klinike, duke ofruar udhëzime mbi rrugën optimale të administrimit të adrenalinës në skenarët e arrestit kardial, veçanërisht në situatat kur vendosja e aksesit IV mund të jetë sfiduese ose e ndjeshme ndaj kohës. Kjo analizë synon të lehtësojë praktikën e bazuar në prova dhe të përmirësojë kujdesin ndaj pacientit në mjedisin kritik të menaxhimit të arrestit kardial. Udhëzimet aktuale të reanimimit kardio-pulmonar sugjerojnë përdorimin e rrugës intravenoze për administrimin e barnave në arrest kardial jashtë spitalit, ose rrugën intra-kockore në rastet në të cilët aksesit intravenoz nuk mund të aplikohet menjëherë. Studimet vëzhguese që krahasojnë efektin e administrimit **intravenoz** dhe **intra-kockor** të barnave në rezultatet e pacientit janë të vështira për t'u interpretuar për shkak të paragjykimimit të kohës së ringjalljes dhe faktorëve të tjerë konfuzë. Deri më sot, asnjë provë e kontrolluar e rastësishme nuk ka krahasuar drejtpërdrejt efektin në rezultatet e pacientit të administrimit intrakockor kundrejt administrimit intravenoz të barnave në arrest kardial. Rëndësia e rrugës së administrimit të barnave të përdorura në rast të **arrestit kardial jashtë spitalit** bazohet në konceptin se barnat kanë rezultuar efektive). Trajtimi me medikamente në arrest kardial është një ndërhyrje kritike për kohën, me të dhëna vëzhguese që tregojnë lidhjen midis administrimit më të shpejtë të barit dhe rezultateve më të mira të pacientit, megjithëse këto studime mund të jenë të njëanshme nga koha e ringjalljes. Një studim vëzhgues i 32,101 pacientëve me arrest kardial jashtë spitalit zbuloi se çdo minutë vonesë në administrimin e adrenalinës shoqërohej me një probabilitet të zvogëluar të mbijetesës në spital (OR 0,96, 95% CI 0,95 - 0,98). Këto të dhëna pasqyrojnë të dhëna nga provat e kontrolluara të rastësishme se medikamentet e arrestit kardial janë efektive në arritjen e ROSC dhe një lidhje të fortë me kohën e fillimit të aplikimit. Qasja intravenoze është shpesh e vështirë për t'u siguruar në arrest kardial jashtë spitalit, megjithëse normat e suksesit janë raportuar deri në 50% në disa sisteme urgjence. Kjo si pasojë e disa faktorëve që lidhen me e pacientin, të tilla si venat e kolabuara ,

periferitë e ftohta, dhe faktorët mjedisorë, të tillë si ndriçimi i dobët dhe pozicionimi i vështirë i pacientit. Në përgjithësi, 98% e pacientëve morën këtë lloj akses, nga të cilët 86% e kanulave u inseruan në humerusin proksimal. Në këtë sistem me ekspozim të lartë paramedik në rrugën intrakockore, administrimi i barit nëpërmjet kësaj rruge krahasuar me administrimin intravenoz të barit u shoqërua me një kohë dukshëm më të shkurtër (5.0 min, 95% CI 4.7-5.4 vs 8.8 min, 95% CI 6.6- 10.9, $p < 0,001$). Rruga optimale për shpërndarjen e drogës në arrest kardiak jashtë spitalit **është e pasigurt**. Rruga më efektive e barit duhet të lehtësojë marrjen, administrimin dhe transportin e shpejtë të barit në qarkullimin qendror, si dhe të shoqërohet me një rezultat klinik të përmirësuar. Ka avantazhe të mundshme për qasjen intrakockore, duke përfshirë shpejtësinë dhe suksesin e inserimit, megjithëse kjo mund të ndikohet nga vendi anatomik. Në mënyrë të ngjashme, ka avantazhe të mundshme për rrugën intravenoze, të tilla si një rrezik më i ulët i dislokimit dhe një profil farmakokinetik potencialisht më i favorshëm.

Fjalë Kyçe: Intra kockor, ROSC, PARAMEDIC2, Para-Spitalor.intra-venoz, medikamente.

EFFICIENT WAYS OF ADMINISTERING MEDICATIONS IN THE PRE HOSPITAL EMERGENCY

Skënder Brataj

Indrit Jaupaj

The National Medical Emergency Center

ABSTRACT

Current cardiopulmonary resuscitation guidelines suggest the use of the intravenous route for the administration of drugs in out-of-hospital cardiac arrest, or the intraosseous route in cases in which intravenous access cannot be applied immediately. Observational studies comparing the effect of intravenous and intraosseous drug administration on patient outcomes are difficult to interpret because of resuscitation time bias and other confounding factors. To date, no randomized controlled trials have directly compared the effect on patient outcomes of intraosseous versus intravenous administration of drugs in cardiac arrest. The importance of the route of administration of drugs used in out-of-hospital cardiac arrest is based on the concept that the drugs have been effective. Recent larger randomized controlled trials have provided evidence supporting the use of epinephrine and antiarrhythmics during out-of-hospital cardiac arrest. The ALPS placebo-controlled study showed no differences in ROSC, survival to discharge, or neurologic outcomes in patients treated with amiodarone or lidocaine and placebo. However, in the subgroup of patients with evidence of cardiac arrest there was evidence of improved survival to hospital discharge with amiodarone (difference 5.0%, CI 0.3% - 9.7%) and lidocaine (difference 5.0%, CI 0.3% - 9.7%) 5.2%, 95% CI 0.5% - 9.9%). Drug treatment in cardiac arrest is a time-critical intervention, with observational data showing an association between faster drug administration and better patient outcomes, although these studies may be biased by the timing of resuscitation. An observational study of 32,101 patients with out-of-hospital cardiac arrest found that each minute of delay in adrenaline administration was associated with a decreased probability of in-hospital survival (OR 0.96, 95% CI 0.95 - 0.98). These data reflect evidence from randomized controlled trials that cardiac arrest medications are effective in achieving ROSC and a strong correlation with the time of initiation of application.

Intravenous access is often difficult to obtain in out-of-hospital cardiac arrest, although success rates as high as 50% have been reported in some emergency systems. This is a consequence of several factors related to the patient, such as collapsed veins, cold peripheries, and environmental factors, such as poor lighting and difficult positioning of the patient.

Overall, 98% of patients received this type of access, of which 86% of cannulas were inserted into the proximal humerus. In this system with high paramedic exposure to the intraosseous route, drug administration via this route compared with intravenous drug administration was associated with a significantly shorter time (5.0 min, 95% CI 4.7-5.4 vs 8.8 min, 95% CI 6.6-10.9, $p < 0.001$). The optimal route for drug delivery in out-of-hospital cardiac arrest is uncertain. The most effective drug route should facilitate rapid uptake, administration, and transport of the drug into the central circulation, and be associated with an improved clinical outcome. There are potential advantages to the intraosseous approach, including speed and success of insertion, although this may be affected by anatomical site. Similarly, there are potential advantages to the intravenous route, such as a lower risk of dislocation and a potentially more favorable pharmacokinetic profile.

Keywords: Intra-osseous, ROSC, PARAMEDIC 2, Pre -Hospital. Intra-venous, drugs

ASTUPOGRAMA ARTERIALE DHE DOMOSDOSHMERIA E TESTIT ALLEN PER TË PARANDALUAR TROMBOZËN PERIFERIKE TË DORËS

Msc Erald Cocka¹, Msc Enkeleda Hajdini², PhD Anila Dine³, Msc Raimonda Lalaj⁴; PhD Cand. Muhamet Kadrija⁵

*¹Drejtuesi i KSHI, Pedagog FSHMT, Infermier ICU Stroke Unit,
eraldcocka@kshi.al*

ABSTRAKT

HYRJA; Testi ALLEN është një test i cili përgjithësisht përdoret për të përcaktuar kalueshmërinë e gjakut arterial në periferinë e dorës (secilës). Zakonisht vërtetimi i kalueshmërisë normale të gjakut arterial bëhet dhe DUHET të bëhet edhe në rastin e Astrupogramës arteriale (marrjes së monstrës së gjakut arterial për ekzaminim laboratorik). Në këtë rast sigurimi i një aksesit të mirë të gjakut në arterien ulnare e bën të indikueshme punktimin e arteries radiale kurse e kundërta sjell kundëringdikacion për punktimin e arteries radiale.

OBJEKTIVA; Objektivi i këtij punimi shkencor është transmetimi i evidencave sa i përket eksperiencës personale prej gati 2 viteve në ICU me pacientët Covid 19 si edhe shfletimi i shumë literaturave ndërkombëtare sa i përket çështjes. Janë të regjistruara nga shënimet që kam mbajtur 4 raste të zhvillimit të trombozës periferiketë dorës.

METODOLOGJIA; Regjistrimi i rasteve të dyshuara me mungesë perfuzionimi mbas testit allen, apo me perfuzionim të dëmtuar. Mbajtja shënim e manipulimeve të astrupogramës arteriale radiale pa bërë testin Allen si edhe korelacioni me kërkimet shkencore në literatura që kam bërë. Kam realizuar edhe një pyetësor tek kolegët në lidhje me njohuritë rreth Testit ALLEN.

REZULTATET; 4 raste të evidentuara me trombozë periferike të dorës. Të 4-ta rastet kanë përfunduar në kirurgjinë vazale.

Gjithashtu sipas infermierëve të intervistuar, në njësinë e ICU, Astrupograma në arterien radiale ka qënë nga më të zakonshmet. Ajo që u vu re nga praktika ishte mungesa e realizimit të testit ALLEN. 95% e infermierëve të përfshirë në intervistim nuk e njihnin ose kishin dëgjuar për testin ALLEN, ndërsa 5 % e kishin të njohur por nuk e realizonin gjithsesi. 100% te personelit infermior në studim nuk e realizonin testin ALLEN përpara procedurës së Artupogramës arteriale në arterien radiale. Ishemia e ekstremitetit periferik (dorës) u vu re në tre pacientë, ku e vetmja zgjidhje e aplikuar ishte amputim.

KONKLuzionET; Për të promovuar sigurinë e dhënies së kujdesit ndaj pacientit dhe përdorimin në praktikë të teknikës së artupogramës në arterien radiale bazuar në rezultatet e studimit sugjerohet shtimi i kësaj teknike në protokollet e kujdesit infermior dhe trajnimi i stafit infermior specifikisht për këtë teknikë.

FJALË KYÇE; Testi ALLEN, Astrupograma arteriale, staf infermior, amputim, arteria radiale, ulnare.

ALEN TEST AND THE EFFECTS OF NOT DOING IT BEFORE THE ARTERIAL ASTUPOGRAM PROCEDURE IN COVID 19 PATIENTS

Msc Erald Cocka¹ ; Msc Enkeleda Hajdini²; PhD Anila Dine³ ; Msc Raimonda Lalaj⁴; PhD Cand. Muhamet Kadrija⁵

*¹Drejtuesi i KSHI, Pedagog FSHMT, Infermier ICU Stroke Unit,
eraldcocka@kshi.al*

ABSTRACT

Introduction The ALLEN test is a test that is generally used to determine the patency of arterial blood in the periphery of the hand (each one). Usually, the confirmation of normal patency of arterial blood is done and MUST be done in the case of the arterial Astrupogram (taking the blood sample arterial for laboratory examination). In this case, ensuring a good access of blood to the ulnar artery makes puncturing the radial artery indicated, while the opposite brings a contraindication for puncturing the radial artery.

Purpose

- to place the appropriate importance on performing the Allen Test before the procedure.
- to add this to the protocol of the radial artery artifact technique (if it is not).
- to increase the safety of providing care to the patient.

Targets

- to practically clarify the technique of performing the Allen test.
- to determine the main arteries anatomically.
- to clarify the possible complications that the Allen Test avoids.

Results

100 professionals (Nurses) who worked in the intensive care unit with positive Covid 19 patients were studied. In the ICU unit Astrupograma in the radial artery has been one of the most common. What was observed from practice was the lack of realization of the Allen test. This was confirmed by the questionnaire that was given to each professional where 95% did not know it or had heard of it, while 5% knew it but did not implement it anyway. 100% of the health personnel did not perform the Allen test before the arterial Artupogram procedure in the radial artery.

Ischemia of the peripheral limb (hand) from March 2020 to December 2022 was observed in 3 patients, where the only solution remained amputation.

Key words: Allen's test, arterial Astrupogram, necrosis, amputation, radial, ulnar artery

INCIDENCA E FLEBITIT TEK PACIENTËT ME KATETER IV PERIFERIK TË HOSPITALIZUAR NË SPITALIN RAJONAL TË KORÇËS DHE FAKTORËT QË LIDHEN ME TË

Emisa Velo¹, Elena Drenesku², Paola Saro³, Jorgen Kasmollari⁴

¹ *Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, Cel: 0684048799, emisavelo@yahoo.com*

² *Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, Cel: 0676094211, elenadrenesku@yahoo.com*

³ *Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, 0676317053, p_saro@live.com*

⁴ *Infermier praktikant, Spitali Rajonal Korçë, Cel: 0672416092, j.kasmollari@gmail.com*

ABSTRAKT

Flebity është një nga problemet më të zakonshme që lidhet me vendosjen e një kateteri venoz periferik. Flebit është termi mjekësor që përdoret për inflamacionin e një vene. Ai i referohet manifestimeve klinike të individit në pozicionin e inserimit të kateterit intravenoz dhe që shfaqet me dy ose më shumë simptoma, të tilla si eritema, dhimbja, kordoni venoz i prekshëm, edema lokale, etj. Vlerësimi efektiv dhe objektiv i fillimit të flebitit, është i rëndësishëm për të ndërhyrë në kohë dhe për të shmangur pasoja më të rënda për pacientin.

Qëllimi i studimit është evidentimi i rasteve me flebit tek pacientët e hospitalizuar pranë pavioneve të Patologjisë, Kardiologjisë, Kirurgjisë, Pneumologjisë dhe Neurologjisë të Spitalit Rajonal Korçë, për periudhën Prill - Maj 2023 dhe studimi i faktorëve predispozues që çojnë në shfaqjen e tij.

Ky është një studim kohort retrospektiv dhe përshkruar eksplorativ, ku janë studiuar gjithsej 645 raste të hospitalizuara. Nëpërmjet studimit janë vlerësuar dhe përshkruar karakteristikat e flebitit dhe raportet e tij në lidhje me moshën, gjininë, llojin e kateterit intravenoz, sëmundshmërinë, ditët e qëndrimit në spital, kohëzgjatjen mesatare të mbajtjes së kateterit dhe numrin e manipulimeve që kryhen me këtë kateter. Të dhënat u mbledhën nga regjistrat e shtrimeve në pavionet përkatëse, kartelat e shtrimit të pacientëve në çdo pavion, gjithashtu, duke u vëzhguar çdo rast ditë pas dite dhe duke u konsultuar me stafin infermieror dhe mjekësor të pavionit.

Për të gjitha këto, është marrë leje në rrugë zyrtare nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave të pacientit dhe duke mos keqpërdorur këto të dhëna për përfitime personale apo për të dëmtuar persona të tretë. Flebitet si pasojë e inflamacionit lokal të venës ku është inseruar kateteri intravenoz, përbëjnë një nga shqetësimet e shpeshta që has infermieri në punën e përditshme. Evidentimi i të dhënave epidemiologjike dhe faktorëve predispozues, përbën një ndihmesë të madhe në identifikimin, diagnostikimin dhe trajtimin në kohë të flebitit dhe pasojave të tij. Kjo hedh baza të fuqishme në parandalimin e flebiteve, jep rezultat të kënaqshëm të punës së infermierit dhe mundëson cilësi dhe siguri mbi shëndetin e pacientit.

FJALËT KYÇE: *Flebit, Kateter intravenoz, Incidencë, Faktorë predispozues, Parandalim.*

INCIDENCE OF PHLEBITIS IN PATIENTS WITH IV PERIPHERAL CATHETERS HOSPITALIZED IN THE KORCA REGIONAL HOSPITAL AND FACTORS ASSOCIATED WITH IT

Emisa Velo¹, Elena Drenesku², Paola Saro³, Jorgen Kasmollari⁴

¹ *Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, Cel: 0684048799, emisavelo@yahoo.com*

² *Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, Cel:0676094211, elenadrenesku@yahoo.com*

³ *Pedagoge, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, 0676317053, p_saro@live.com*

⁴ *Infermier praktikant, Spitali Rajonal Korçë, Cel: 0672416092, j.kasmollari@gmail.com*

ABSTRACT

Phlebitis is one of the most common problems associated with the placement of a peripheral venous catheter. Phlebitis is the medical term used for inflammation of a vein. It refers to the clinical manifestations of the individual in the position of insertion of the intravenous catheter and appearing with two or more symptoms, such as erythema, pain, palpable venous cord, local edema, etc. Effective and objective assessment of the onset of phlebitis is important to intervene in time and avoid more serious consequences for the patient.

The purpose of the study is to identify cases of phlebitis in patients hospitalized near the wards of Pathology, Cardiology, Surgery, Pneumology and Neurology of the Korca Regional Hospital, for the period April - May 2023, and to study the predisposing factors that lead to its occurrence.

This is a retrospective and descriptive exploratory cohort study, where a total of 645 hospitalized cases were studied. The study evaluated and described the characteristics of phlebitis and its reports in relation to age, gender, type of intravenous catheter, morbidity, days of hospital stay, average duration of catheter retention and the number of manipulations performed with this intravenous catheter. The data were collected from the admission registers in the respective wards, the admission cards of the patients in each ward, also observing each case day by day and consulting the nursing and medical staff of the ward.

For all of this, permission was obtained in an official way from the Korca Hospital Service Directorate, respecting the confidentiality of the patient's data and not misusing these data for personal gain or to harm third parties.

Phlebitis as a result of local inflammation of the vein where the intravenous catheter has been inserted is one of the frequent concerns that nurses encounter in their daily work. Evidence of epidemiological data and predisposing factors is a great help in the identification, diagnosis and timely treatment of phlebitis and its consequences. This lays strong foundations in the prevention of phlebitis, gives a satisfactory result of the nurse's work and enables quality and safety of the patient's health.

KEYWORDS: *Phlebitis, Intravenous catheter, Incidence, Predisposing factors, Prevention.*

TRAUMA LOKOMOTORE DHE RENDESIA E MENAXHIMIT TE SAJ

Doc.Elona HASALLA, PHD.Cand .Ilda Taka, Msc.Elona Dybeli, Msc.Blerta Hasalla, Doc. Shqipe Luta, Phd. cand. Albana Sula. Phd.Cand.Rajmonda Hida,Msc. Marsida Duci, Msc. Bena Marra, Dr. Sulejman Baha, Brandi Fahriu

*Universiteti "Aleksandër XHUVANI" Elbasan;Fakulteti i Shkencave Mjeksore Teknike ,
Departamenti i Lëndëve Paraklinike; Qendra Kërkimore Mjedisore dhe Diagnostike; Departamenti i Lëndëve
Klinike; Departamenti i Infermieristikes;
Qendra Spitalore " Xhaferr Kongoli" Elbasan; Universiteti i Firences Itali*

ABSTRAKT

Hyrje: Traummat janë bashkëudhëtarë të shoqërisë njerzore. Ato ka e kanë shoqëruar njerëzimin gjatë gjithë etapve të zhvillimit të tij; duke filluar nga fatkeqësitë natyrore, luftrat për ekzitencë ,pushtimin e tokave ,në gjuetinë e kafshëve të egra,në përleshjet ndërmjet fiseve të ndryshme, në lufterat botërore pushtuese e shfarosëse etj.

Traummat lokomotorore shpesh bëhen shkaktarë të paaftësive të përhershme, që vijnë si pasojë e mos menaxhimit të saj në kohën dhe mënyrën e duhur.Duke e parë në këtë këndvështrim trajtimi dhe menaxhimi i saj sa më shpejt e mirë që të jetë e mundshme ka një rëndësi të veçantë.

Qëllimi : Qëllimi i punimit tonë modest është:

Të evidentojë tërësinë e dëmtimeve traumatike.

Të paraqesë , ndërlikimet e ndeshura gjatë trajtimit dhe të prezantojë edhe rrugët e zgjidhjes së tyre.

Të nxisë e të apeloje opinionin mbarë shoqëror, për rëndësinë e ndihmës në vënd ngjarje nga individë me njohuri paramjeksore .

Të nxjerë përfundime të drejta me karakter teorik e praktik lidhur me trajtimin e dëmtimeve traumatike në nivelin infermieristik .

Materiali dhe metoda e studimit: Ne morëm në studim në mënyre retrospektive kartelat klinike të 128 pacienteve që kishin pësuar trauma lokomotorore,për periudhen kohore janar 2021 deri në janar 2023. Nga këta 27 paciente ishin femra dhe 101 meshkuj.Raporti meshkuj (m)/ femra (f) ishte 3.74:1.Mosha më e madhe 83 vjeç ,mosha mesatare 31 vjeç, mosha më e vogël 4 vjeç. Pjesën më të madhe të traumave lokomotorore të marra në studim në serinë tonë e zinin aksidentet automobilistike ,78 pacientë (61%) dhe rrëzimet nga lartësitë ,36 pacientë (28%).Vetëm 14 pacientë kishin pësuar trauma lokomotorore si pasojë e dëmtimeve me armë zgjarri ,armë të ftohta ose dëmtime të tjera aksidentale.

Konkluzione:

Pas trajtimit të duhur të pacientëve që ne morëm në studim vumë re keto përfundime:

Pac. ende në trajtimin . . . 10 7.8 %

Pac.të dalë nga spitali . . 118 92.2 %

a-Njëlloj 11 8.59 %

b-Përmirësuar 29 22.65 %

c- Shëruar 62 48.43 %

d-Të vdekur. 16 12.53 %

Gjithsej 128 100 %

Rekomandime:

a-Njohja me problemet e traumës ka rëndësi diagnostikuese , mjekuese dhe është kusht i mjekimit të suksesëshëm i kësaj epidemie madhore, bashkëudhëtare e kohës moderne në të cilën jetojmë.

b-Edukimi i nxënësve nëpër shkolla, policëve rrugorë, shoferëve të makinave, banorëve përgjatë autostradave për mënyrën e dhënies së ndihmes së parë ka rëndësi të madhe pasi, lehtëson punën e personelit mjekësor dhe i mundëson të dëmtuarit të marrin ndihmën e parë sa më shpejt të jetë e mundur.

Fjale kyçe: trauma lokomotorë, pacienti i politraumatizuar, ndihma e parë, menaxhimi i traumës lokomotorë.

LOKOMOTOR TRAUMA AND ITS MANAGEMENT IMPORTANCE

Doc.Elona HASALLA,PHD.Cand .Ilda Taka, Msc.Elona Dybeli, Msc.Blerta Hasalla, Doc. Shqipe Luta, Phd. cand. Albana Sula. Phd.Cand.Rajmonda Hida,Msc. Marsida Duci, Msc. Bena Marra, Dr. Sulejman Baha, Brandi Fahriu

University of Aleksander Xhuvani; ElbasanFaculty of Medical Tech Science

QKZHMD; Department of Preclinical Sciences;

Department of Nursing; Departament of Clinical Sciences;

Hospital Center "Xhaferr Kongoli" ElbasanUniversity of Florence Italy

ABSTRACT

Introduction Traumas are co-travelers of the human society. They have accompanied mankind throughout all the steps of its development; ranging from natural disasters, struggles for existence, invasion of lands, wildlife hunting, clashes between different tribes, invading and exterminating world wars, etc.

Locomotor traumas are often the cause of permanent disabilities, which come as a consequence of not managing it in the right time and manner. By looking at this approach, handling and managing it as soon as possible is of special importance.

Purpose of the work: The purpose of our modest work is to:

- Identify the extent of traumatic injuries.
- Present, the complications encountered during the treatment and to present the ways of their solution.
- Urge and appeal to the social community for the importance of helping during trauma cases, from individuals with paramount knowledge.
- Draw the right conclusions with a theoretical and practical character related to the treatment of traumatic injuries at the nursing level.

Material and study methods: We retrospectively studied the clinical files of 128 patients with locomotor trauma, for the period January 2021 to January 2023. Out of these, 27 patients were female and 101 males. The rate male (m) / female (f) was 3.74. The highest age was 83 years old, the average age was 31 years old, and the youngest age was less than 4 years old.

Most of the locomotor trauma cases taken in the study in our series were caused by automobile accidents, 78 patients (61%) and falling from the height incidents, 36 patients (28%). Only 14 patients suffered locomotor trauma due to damage from the weapon incidents, cold weapons or other accidental damages.

Conclusions: After the proper treatment of the patients taken into consideration in this study, the following conclusions were noted:

Pac. still in the treatment . . . 10 7.8%

Pac. left out of the hospital. . 118 92.2%

a- Same.	11	8.59%
b- Improved.	29	22.65%
c- Cured.	62	48.43%
d- Dead.	16	12.53%
Total.	128	100%

Recommendations

- a- Knowing traumatic problems is for diagnostic importance, therapeutic importance and is a condition of successful treatment of this major epidemic, a co-worker of the modern era in which we live.
- b- Education of pupils in schools, road police, car drivers, residents along the highways for providing the first aid is of great importance because it facilitates the work of medical staff and enables to the injured persons to receive the first aid as soon as possible.

Key words: locomotor trauma, politraumatized patient, first aid, locomotive trauma management.

RËNDESIDIA E TRIAZHIMIT DHE MBIPOPULLIMI NË URGJENCË

Adrian BETI¹, Alion SEJDINI²,

¹ Urdhri i Infermierit të Shqipërisë, Qarku Elbasan.

² President i Urdhërit të Infermierit të Shqipërisë, Qarku Elbasan.

a_beti@hotmail.com

ABSTRAKT

Urgjenca është kontakti i parë i pacientit me personelin shëndetësor, ku këta të fundit duhet të ofrojnë kujdes shëndetësor për të gjithë personat që paraqiten në këtë sektor të kujdesit. Për të patur një performancë sa më të mirë dhe një trajtim në kohë rekord për të gjithë, triazhimi i pacientëve që paraqiteshin në urgjencë u kthye në një element shumë të rëndësishëm.

Qëllimi i këtij studimi është rëndësia e triazhimit dhe menaxhimi në repartin e urgjencës, si një komponent i rëndësishëm në shërbim.

Metodologjia: Studimi është i tipit deskriptiv, analitik. Përfshin periudhën 4 vjeçare 2018-2021 dhe u realizua në Shërbimin e urgjencës në Spitalin Rajonal të Elbasanit. Për studimin janë përdorur pasqyrat e aktivitetit mjekësor të Repartit Urgjencës në Spitalin Rajonal Elbasan.

Rezultatet: Gjetjet treguan se % më e madhe e pacientëve nuk përbënin një urgjencë madhore edhe pse janë paraqitur për të tillë, pasi pjesa më e madhe e pacientëve veprojnë me shpejtësi kur paraqiten në urgjencë.

Konkluzionet: Mungesa e njohurisë mbi triazhimin dhe etapat e tij, kanë përbërë pengesë përgjatë procesit. Triazhimi është një element shumë i rëndësishëm në urgjencën mjekësore për të ulur kohën e ndërhyrjes për pacientët të cilët përbëjnë një urgjencë, si dhe për të pasur efikasitet në shërbimin shëndetësor.

Rekomandimet: Si një nga proceset më të rëndësishme në mjedisin e urgjencës, ky element shërbimi duhet të jetë pjesë praktike thelbësore, në mënyrë që ti jepet përparësi një shërbimi cilësor bazuar në standarde bashkëkohore.

Fjalet kyçe: monitorim, mbipopullim, urgjencë, triazhimi, cilësi.

THE IMPORTANCE OF TRIANGE AND OVERCROWDING IN EMERGENCY

Adrian BETI¹, Alion SEJDINI²,

¹ Order of the Nurse of Albania, Elbasan Region.

² President of the Order of Nurses of Albania, Elbasan Region.

a_beti@hotmail.com

ABSTRACT

Aim: Emergency is the patient's first contact with health personnel, where the latter must provide health care to all persons present in this care sector. In order to have the best possible performance and a treatment in record time for everyone, the triage of patients presenting in the emergency room becomes a very important element.

The purpose of this study is the importance of triage and management in the emergency department, as an important component in service.

Methodology: The study is a descriptive, analytical research. It includes a 4-year period, from 2018 to 2021 and provides the performance of the Emergency Service at the Regional Hospital of Elbasan. Statements of the medical activity of the Emergency Department at the Elbasan Regional Hospital were used for the study.

Results: The findings showed that the majority of patients did not constitute a major emergency case even though they were presented for such, most patients act quickly when they are faced with an emergency.

Conclusions: The lack of knowledge for triage and its stages, have become a barrier during the process. Triage is a crucial element for the emergency service, to help reduce the time needed to intervene in patients who constitute emergency, and also to have efficiency in the offered service.

Recommendations: Considered one of the most important elements in the emergency service, triage should be part of the medical practice, in order to give priority to a quality service based on modern standards.

Keywords: monitoring, overcrowding, urgency, triage, quality.

Sesioni 2

IDENTIFIKIMI I PARASHIKUESVE EFEKTIVE TË ORGANIZIMIT TË PUNËS MBI PERCEPTIMIN E NGARKESËS SË PUNËS INFERMIERORE

Federica Maria Pia Ferramosca (autore korresponduese) Studente PHD, Departamenti i Biomjekësisë dhe Parandalimit, Universiteti Tor Vergata, Romë, Itali, Numri i telefonit: 3270146888, E-mail: federica_ferramosc@hotmail.it

Dhurata Ivziku, PhD, RN, Departamenti i Inovacionit dhe Zhvillimit të Infermierisë, Campus Bio-Medico i Spitalit Universitar të Romës

Maddalena De Maria PhD, RN, Departamenti i Biomjekësisë dhe Parandalimit, Universiteti Tor Vergata, Romë, Itali

Raffaella Gualandi, PhD, Zëvendës Drejtoreshë e Profesioneve Shëndetësore, Departamenti i Profesioneve Shëndetësore, Campus Bio-Medico i Spitalit Universitar të Romës

Daniela Tartaglino, Profesoreshë, Drejtoreshë e Profesioneve Shëndetësore, Departamenti i Profesioneve Shëndetësore, Campus Bio-Medico i Spitalit Universitar të Romës

ABSTRAKT

Hyrje: Evidencat që përshkruajnë efektet e organizimit të punës në ngarkesën e punës së infermierisë janë në rritje. Disa aspekte të mundshme që mund të komprometojnë rrjedhën e punës së infermierëve janë masat paraprake të transmetimit të aplikuara në përgjigje të një ekspozimi ndaj agjentëve infektivë, ngjarjeve të paplanifikuara ose kujdesit për pacientë të specialiteteve të ndryshme nga ato të asistuar zakonisht. Këto aspekte, nëse janë të shumta, mund të çojnë në rritjen e vëllimit ose ritmit të punës infermierore dhe stresit më të madh.

Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë efektet e izolimit të pacientit, specialitetet e pacientit dhe aktivitetet e papritura në ritmin dhe vëllimin e punës infermierore.

Metodat: U zhvillua një studim vëzhgues prospektiv. Infermierët që punojnë në 5 pavijone mjeko-kirurgjikale të një spitali në Itali, të cilët janë përgjigjur një sondazhi online. Ngarkesa e punës u mat me shkallën e ritmit dhe sasisë së punës të pyetësorit QEEW 2.0 © SKB, ndërsa aktivitetet e papritura, izolimi i pacientit dhe specialitetet e pacientit u raportuan nga infermierët. Është kryer analiza e regresioneve lineare.

Rezultatet: U morën 205 pyetësorë të plotësuar. Efekte të rëndësishme të parashikimit në ngarkesën e punës u identifikuan për aktivitetet e papritura ($\beta=0,295$), izolimin e pacientit ($\beta=0,231$) dhe specialitetet e pacientit ($\beta=0,201$). Ky model shpjegoi 23% të variancës në ngarkesën e punës së infermierisë.

Konkluzioni: Rezultatet tregojnë se ngarkesa e punës së infermierëve rritet kur infermierët kujdesen për pacientët në izolim, kur pacientët i përkasin disa specialiteteve dhe sa herë që kërkohet një aktivitet i papritur. Optimizimi i kohës së infermierisë dhe organizimit të punës është thelbësor për menaxherët e repartëve dhe organizatat e kujdesit shëndetësor. Prandaj, rezultatet tona mund të bëhen një pikënisje për ndërhyrjet e ardhshme për përmirësimin e organizimit të punës së infermierëve për t'i lejuar infermierët të kenë më shumë kohë në kujdesin për pacientët dhe për të reduktuar ngarkesën e perceptuar të punës.

Fjalë kyçe: Infermiere; Ngarkesa e punës; Organizimi i punës; Parashikuesit.

IDENTIFICATION OF THE EFFECTIVE PREDICTORS OF THE WORKFLOW ON THE PERCEPTION OF THE NURSING WORKLOAD

Federica Maria Pia Ferramosca (corresponding author) PHD Student, Department of Biomedicine and Prevention, University Tor Vergata, Rome, Italy

Dhurata Ivziku, PhD, RN, Department of Nursing Innovation and Development, Campus Bio-Medico of Rome University Hospital

Maddalena De Maria PhD, RN, Department of Biomedicine and Prevention, University Tor Vergata, Rome, Italy

Raffaella Gualandi, PhD, Vice Director of Health Professions, Department of Health Professions, Campus Bio-Medico of Rome University Hospital

Daniela Tartaglioni, Full Professor, Director of Health Professions, Department of Health Professions, Campus Bio-Medico of Rome University Hospital

ABSTRACT

Dhuna ndaj infermierëve është konsideruar si një pandemi. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), 8 - 38% e infermierëve përjetojnë një episod dhune gjatë karrierës së tyre në kujdesin shëndetësor. Administrata e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (OSHA) e përkufizon më tej dhunën në vendin e punës si çdo veprim ose kërcënim dhune fizike, ngacmimi, frikësimi ose sjellje tjetër kërcënuese dhe shqetësuese që ndodh në vendin e punës. Ajo varion nga kërcënimet dhe abuzimet verbale deri te ngacmimet seksuale, sulmet fizike dhe madje edhe në vrasje. Qëllimi i rishikimit të literaturës është të evidentojë pasojat e dhunës mbi infermierët dhe sistemin e kujdesit shëndetësor dhe të identifikojë masat dhe ndërhyrjet parandaluese për të adresuar këtë çështje në mënyrë efektive. Metodologjia e përdorur konsiston në rishikimin e artikujve të botuar në PubMed, Scopus, EBSCO, Elsevier, PsycINFO dhe CINAHL duke përdorur fjalë kyçe si "dhuna", "agresioni", "infermierët", "personeli mjekësor", "dhuna ndaj infermierëve". Rezultatet e raporteve ndërkombëtare tregojnë se dhuna dhe agresioni kanë një ndikim negativ në performancën e punës së infermierëve, duke shkaktuar ulje të produktivitetit në kujdesin shëndetësor, ulje të nivelit të kënaqësisë në punë dhe angazhim organizativ, dëshirën për të lënë vendin e punës dhe një rritje e nivelit të stresit që ndikon negativisht në cilësinë e kujdesit ndaj pacientit. Një nivel i lartë i ekspozimit ndaj dhunës në vendin e punës do të shoqërohet me rritje të frikës, ankthit dhe stresit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së infermierit, duke rezultuar në pasoja fizike ose psikologjike. Infermierët duhet të edukohen rreth politikave spitalore dhe të inkurajohen të raportojnë çdo situatë dhune.

Fjalët kyçe: dhunë, agresion, infermiere, personel mjekësor, performance

A REVIEW OF VIOLENCE AMONG NURSES AND ITS CONSEQUENCES

Phd. Entela Drizaj¹, Behije Gollobërda¹, Rajmonda Hida (Oboni)¹, Venemin Gega¹

A. Xhuvani University, Faculty of Medical and Technical Sciences¹

ABSTRACT

Violence against nurses has been considered a pandemic. According to the World Health Organization (WHO), 8 - 38% of nurses experience an episode of violence in health care during their career. The Occupational Safety and Health Administration (OSHA) further defines workplace violence as any act or threat of physical violence, harassment, intimidation, or other threatening and disturbing behavior that occurs in the workplace. It ranges from threats and verbal abuse to sexual harassment, physical assault and even murder. The purpose of the literature review is to identify the consequences of violence on nurses and the health care system and to identify preventive measures and interventions to address this issue effectively. The methodology used consists of reviewing articles published in PubMed, Scopus, EBSCO, Elsevier, PsycINFO and CINAHL using keywords such as "violence", "aggression", "nurses", "medical staff", "violence against nurses". The results of international reports show that violence and aggression have a negative impact on the work performance of nurses, causing a decrease in productivity in health care, a decrease in the level of job satisfaction and organizational commitment, the desire to leave the workplace and an increase of the level of stress that negatively affects the quality of patient care. A high level of exposure to workplace violence will be associated with increased fear, anxiety and stress, which directly affect the nurse's quality of life, resulting in physical or psychological consequences. Nurses should be educated about hospital policies and encouraged to report any situations of violence.

Keywords: violence, aggression, nurses, medical personnel, performance.

SA KOHË SHPENZOJNË INFERMIERËT PËR KUJDESIN NDAJ PACIENTIT? NJË RISHIKIM SISTEMATIK

Abdullah Gruda

Ligjërues, Kolegji UBT, Fakulteti i Infermierisë.

Infermier, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Neurologjisë.

Korrespondenca: abdullahgruda@hotmail.com, +38344787664, 10000 Prishtinë, Kosovë.

ABSTRAKT

Hyrja: Infermierët si fuqia punëtore më e madhe profesionale në spitale janë përgjegjës për menaxhimin dhe ofrimin e kujdesit për pacientët dhe familjet. Kujdesi infermior nënkupton kujdesin direkt dhe indirekt ndaj pacientit. Arritja e standardeve kërkon ofrimin e kujdesit me cilësi të lartë, të sigurt dhe përdorimin efikas të kohës së punës në mënyrë që të përfiton pacienti.

Objektivat: Objektiv i këtij rishikimi sistematik ishte të sintetizoj dëshmitë aktuale në lidhje me sasinë e kohës që e shpenzojnë infermierët për kryerjen e detyrave ose aktiviteteve të kujdesit ndaj pacientit në mjedisin spitalor.

Metodologjia: Kërkimi i studimeve është bërë me fjalë kyçe në gjuhën angleze, në bazat e të dhënave PubMed dhe Google scholar në bazë të kriterëve të përfshirjes: studime sasiore ose cilësore, studime të kryera në spitale, të botuara në anglisht, brenda periudhës kohore 2000-2023. Janë identifikuar gjithsej 1457 tituj. Pas leximit të titujve, largimit të duplikimeve, vlerësimit të abstrakteve dhe artikujve me tekst të plotë, vetëm 13 studime janë konsideruar të rëndësishme për këtë rishikim. Për vlerësimin e cilësisë metodologjike të studimeve është përdorur instrumenti i Institutit Joanna Briggs për studime sasiore dhe cilësore.

Rezultatet: Shpenzimi i kohës së infermierëve në kujdesin ndaj pacientit u shqyrtua përmes kategorive. Kështu për kategorinë e kujdesit direkt infermierët shpenzojnë mesatarisht prej 20.4%-24.8%, për kujdesin indirekt 13%-29.08%, detyra të mjekimit 19%, komunikim profesional 19.2%-24%, aktivitetet jo klinike 11.12%, administrimin e medikamenteve 13.9%, vlerësimin e pacientëve 12.92%, planifikimin e kujdesit 23.7%, dokumentim 17.6%-25%, monitorim dhe matje 12.5%, detyra joinfermiore 1.89% dhe për edukimin e pacientit 3.6%.

Konkluzionet: Infermierët shpenzojnë shumë pak nga koha e tyre në ofrimin e kujdesit ndaj pacientit. Rezultatet e këtij rishikimi do të jenë të dobishme për politikbërësit dhe menaxherët të cilët duhet të zhvillojnë strategji që infermierët të kenë në dispozicion kohë të mjaftueshme për kujdesin ndaj pacientit.

Fjalët kyçe: infermior spitalor, koha e shpenzuar, detyra, aktivitete, kujdesi ndaj pacientit.

HOW MUCH TIME DO NURSES SPEND ON PATIENT CARE? A SYSTEMATIC REVIEW

Abdullah Gruda

Lecturer, UBT College, Faculty of Nursing.

Nurse, University Clinical Center of Kosovo, Clinic of Neurology.

Correspondence: abdullahgruda@hotmail.com, +38344787664, 10000 Pristina, Kosovo.

ABSTRACT

Introduction: Nurses as the largest professional workforce in hospitals are responsible for managing and providing care to patients and families. Nursing care means direct and indirect care to the patient. Achieving the standards requires providing high quality, safe care and efficient use of working time to benefit the patient.

Objectives: The objective of this systematic review was to synthesize current evidence regarding the amount of time nurses spend performing patient care tasks or activities in the hospital setting.

Methodology: Studies were searched with keywords in the English language, in the PubMed and Google scholar databases based on the inclusion criteria: quantitative or qualitative studies, studies conducted in hospitals, published in English, within the time period 2000 -2023. A total of 1457 titles have been identified. After reading titles, removing duplicates, evaluating abstracts and full-text articles, only 13 studies were considered relevant for this review. The Joanna Briggs Institute instrument for quantitative and qualitative studies was used to assess the methodological quality of the studies.

Results: Nurses' time spent on patient care was examined across categories. Thus, for the category of direct care, nurses spend an average of 20.4%-24.8%, for indirect care 13%-29.08%, medication tasks 19%, professional communication 19.2%-24%, non-clinical activities 11.12%, medication administration 13.9%, patient assessment 12.92%, care planning 23.7%, documentation 17.6%-25%, monitoring and measurement 12.5%, non-nursing tasks 1.89% and patient education 3.6%.

Conclusions: Nurses spend very little of their time providing patient care. The results of this review will be useful for policy makers and managers who need to develop strategies for nurses to have sufficient time available for patient care.

Keywords: hospital nurse, time spent, tasks, activities, patient care.

VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE PRAKTIKAVE INFERMIERORE TË KËMBËS DIABETIKE

Rajmonda OBONI¹, Elona GAXHJA¹, Rajna ANGJELI², Marsida DUCI¹, Ilma SHOLLA¹, Arkida SKENDERI¹, Albana SULA¹, Venemin GEGA¹, Gjergji DOKO¹

¹Fakulteti I Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti I Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

²Infermiere e përgjithëshme, Spitali Rajonal Elbasan

Email: mondahida86@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Diabeti është një ndër shkaktarët kryesor të sëmundjeve dhe vdekshmërisë. Këmba diabetike është një komplikacion që mund të parandalohet nëse kapet dhe kurohet në kohë. Infermierët kane një rol të rëndësishëm në parandalimi e këmbës diabetike, edukimit, kujdesit dhe trajtimin tek pacientët në rrezik për këmbën diabetike. Niveli i lartë i njohurive dhe praktikave infermierore bën të mundur parandalimin dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje

Qëllimi: Vlerësimi i njohurive dhe praktikave infermierore në menaxhimin e këmbës diabetik tek infermierët e Spitalit Rajonal Elbasan, me qëllim që të evidentohen problematikat që hasin infermierët me këtë patologji.

Metodologjia: Ky është studim cross-sectional. Pyetësori iu shpërnda 16 infermierëve të cilët punojnë në repartet e kirurgjisë, ortopedisë dhe sëmundjeve të brëndshme të Spitalit Rajonal "Xhaferr Kongoli" Elbasan, nëpërmjet platformës Google Forms.

Rezultate: Duke u bazuar në rezultatet e studimit tonë rezultoi që 50% e infermierëve janë trajnuar më parë për menaxhimin e këmbës diabetike, 100% e infermierëve i edukojnë pacientët në lidhje me këmbën diabetike dhe 37.5% e infermierëve e vlerësojnë veten me njohuri shumë të mira mbi menaxhimin e këmbës diabetike.

Konkluzione: Rezultatet e njohurive të infermierëve në lidhje me menaxhimin e praktikave të këmbës diabetike janë në një nivel mesatar. Që infermierët të kenë nivel njohurish dhe praktikash më të mira duhen bërë aktivitete trajnuese edukative të ndryshme mbi menaxhimin e këmbës diabetike dhe të inkurajohet pjesmarrja e infermierëve në to.

Fjale kyçe: këmbë diabetike, ulçera diabetike, infermier, njohuri, praktika.

ASSESSMENT OF DIABETIC FOOT NURSING KNOWLEDGE AND PRACTICES

Rajmonda OBONI¹, Elona GAXHJA¹, Rajna ANGJELI², Marsida DUCI¹, Ilma SHOLLA¹, Arkida SKENDERI¹, Albana SULA¹, Venemin GEGA¹, Gjergji DOKO¹

¹Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandr Xhuvani"

²General nurse, Elbasan Regional Hospital

Email: mondahida86@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Diabetes is one of the main causes of disease and mortality. Diabetic foot is a complication that can be prevented if caught and treated in time. Nurses have an important role in diabetic foot prevention, education, care and treatment in patients at risk for diabetic foot. The high level of nursing knowledge and practices makes it possible to prevent and treat this disease

Purpose: Evaluation of nursing knowledge and practices in the management of diabetic foot among nurses of the Elbasan Regional Hospital, in order to highlight the problems encountered by nurses with this pathology.

Methodology: This is a cross-sectional study. The questionnaire was distributed to 16 nurses who work in the departments of surgery, orthopedics and internal diseases of the Regional Hospital "Xhaferr Kongoli" Elbasan, through the Google Forms platform.

Results: Based on the results of our study, it was found that 50% of nurses have previously been trained in the management of diabetic foot, 100% of nurses educate patients about diabetic foot and 37.5% of nurses rate themselves as knowledgeable. very good on diabetic foot management.

Conclusions: The results of nurses' knowledge regarding the management of diabetic foot practices are at an average level. In order for nurses to have a level of knowledge and better practices, different educational training activities on the management of the diabetic foot should be done and the participation of nurses in them should be encouraged.

Keywords: diabetic foot, diabetic ulcer, nurse, knowledge, practice.

VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE NIVELIT TË NDËRGJEGJËSIMIT TË PROFESIONISTËVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR TË SHËRBIMIT PARËSOR TË TIRANËS MBI NDIKIMIN E MJEDISIT NË SHËNDETIN E FËMIJËVE

MSc. Anduela VASO¹, Prof. Asc. Jolanda HYSKA², MSc. Ediona KOLA³
Urdhëri i Infermierit Qarku Tiranë, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.
Instituti i Shëndetit Publik
Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
anduelavaso@oshksh.gov.al

ABSTRAKT

Stafet shëndetësore që ofrojnë shërbim shëndetësor në qendrat shëndetësore janë hallka e parë e dhënies së shërbimit shëndetësor dhe kanë rëndësi kyçe për të parandaluar, diagnostikuar dhe trajtuar në kohë sëmundjet dhe gjendjet shëndetësore të lidhura me mjedisin. Sipas OBSH reduktimi i rreziqeve mjedisore mund të parandalojë 1 në 4 vdekje të fëmijëve. Për të ndërmarrë masat e duhura në këtë fushë është e rëndësishme vlerësimi i njohurive dhe nivelit të ndërgjegjësimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor mbi ndikimin e mjedisit në shëndetin e fëmijëve.

Metodologjia: U përdor një pyetësor, i vetë-administruar nga subjektet pjesëmarrëse, mjekë dhe infermierë, duke mbuluar sistemit publik të kujdesit shëndetësor parësor në Tiranë. Në total janë plotësuar 209 formularë nga profesionistë shëndetësor të qendrave shëndetësore të rrethit të Tiranës, të cilat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se pjesa më e madhe 64.1% e të anketuarve kanë disa informata dhe 15.7% e tyre kanë pak ose aspak informacion për çështjet e shëndetit mjedisor. Rezultatet na tregojnë që stafet shëndetësore kanë marrë më shumë informacione rreth risqeve mjedisore si cilësia e ajrit të jashtëm 86.3%, ndotjen e ajrit të brendshëm 77.2%, ndotjen e ushqimit me 75.1% dhe ndotja e ujit me 72.1%. Stafet shëndetësore i pyesin më shpesh pacientët gjatë marrjes së anamnezës klinike për ndotjen e ushqimit 51.9%, ndotjen e ajrit të jashtëm 50.3%, zhurmat 48.5% dhe i pyesin më pak për risqet mjedisore që kanë më pak informacion si për merkurin, plumbin, kimikate të tjera.

Në përfundim të studimit u pa se në mënyrë që profesionistët shëndetësorë të ofrojnë shërbime shëndetësore efektive në mbrojtje të shëndetit të fëmijëve nga kërcënimet mjedisore janë të nevojshme trajnime të specializuara por dhe studime të mëtejshme të cilat ndihmojnë në krijimin e një panorame mbi grupet më të riskuara dhe faktorët e riskut mjedisor në vendin tonë. Gjithashtu nga ana e stafeve shëndetësore të përfshirë në studim fushatat parandaluese dhe edukative dhe trajnimet shikohen si ndërhyrje që i nevojiten vendit tonë për përmirësimin në fushën e shëndetit mjedisor të fëmijëve.

Fjalë kyçe: *shëndet mjedisor, fëmijë, faktor risku, fushata parandaluese, trajnime profesionale*

**TOPIC: EVALUATION OF PRIMARY HEALTH CARE PROFESSIONALS
KNOWLEDGE AND AWARENES OF THE IMPACT OF THE ENVIRONMENT ON
CHILDREN'S HEALTH IN TIRANA**

*MSc. Anduela VASO¹ Prof. Asc. Jolanda HYSKA², MSc. Ediona KOLA³
Nurse's Order Tirana District, Regional Operator of Tirana Health Care Services
Institute of Public Health
Regional Operator of Tirana Health Care Services
anduelavaso@oshksh.gov.al*

ABSTRACT

The first line of defense in delivering health services is the medical professionals that work in primary health facilities. They are crucial in preventing, diagnosing, and promptly treating environmental illnesses and other health disorders. The WHO claims that lowering environmental dangers can stop 1 in 4 child fatalities. It is crucial to evaluate the knowledge and awareness of health care professionals on the effects of the environment on children's health in order to take the right action in this regard.

To accomplish this, a questionnaire covering the public primary health care system in Tirana was devised and self-administered by the study's subjects, doctors and nurses. Health experts from randomly chosen health centers in the Tirana district filled out a total of 209 forms.

The study's findings indicate that 64.1% of respondents have some knowledge of environmental health issues, while 15.7% have none at all. The findings indicate that health professionals have more knowledge of environmental dangers, such as poor outdoor air quality (86.3%), poor indoor air quality (77.2%), poor food and water quality (75.1%). During the clinical history-taking process, health professionals question patients more frequently about noise (48.5%), outdoor air pollution (50.3%), and food pollution (51.9%) than they do about other environmental dangers, such as mercury, lead, and other chemicals.

Specialized training and further research that helps paint a picture of the nation's most vulnerable populations and environmental risk factors are required for health professionals to deliver effective health services to safeguard children's health from environmental risks. Additionally, the health professionals who participated in the survey saw trainings and campaigns for prevention and education as interventions our nation needs to improve the environmental health of children.

Keywords: *environmental health, children, risk factors, preventive campaign, professional training*

DETERMINANTËT E SHËNDETTIT DHE SHËNDETI NË POPULLATËN TONË

¹PhD Juljana Xhindoli,²PhD(c) Vasilika Prifti, ¹PhD(c) Emirjona Kiçaj, ¹PhD(c) Rudina Cercizaj
¹PhD(c) Saemira Durmishi, ¹Dr. Rezarta Lalo, ¹Msc. Stiliana Brokaj,²Dr. Evis Allushi,

¹Departamenti i Kujdesit, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

²Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

E-mail: juljana.xhindoli@univlora.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Shëndeti është një e drejtë individuale dhe një çështje e drejtësisë sociale. Është gjithashtu një e mirë publike. Kujdesi klinik spitalor është më pak i rëndësishëm nga sa mendojnë shumë njerëz, ndërsa faktorët socio-ekonomik dhe mjedisi fizik janë mjaft ndikues në shëndetin dhe mirëqenien e individëve. Qëllimi i këtij studimi është risjellja në vëmendjen e personelit shëndetësor mbi faktorët socio-ekonomik, biologjik dhe të sjelljes që ndikojnë në shëndetin. Cilët janë përcaktuesit social të shëndetit dhe ku duhet të fokusohet kujdesi shëndetësor për mirëqenien e popullatës?

Metodologjia: Studimi është trajtuar në formën e një përshkrimi të udhëzuesve mbi faktorët determinant të shëndetit sipas OBSH, nëse shëndeti i popullatës përcaktohet nga rrethanat dhe mjedisi i tyre – kushtet sociale, ekonomike dhe mjedisore që ndikojnë në shëndetin e popullatës. Janë marrë në konsideratë disa modele të cilat edhe pse janë të viteve të hershme, i kanë rezistuar koheve duke u bërë bazë për modelet e reja pasardhëse.

Rezultate: Studimi i literaturës zbuloi disa modele që përshkruajnë determinantët e shëndetit si Dahlgren dhe Whitehead (1991), Global Commission on SDH (2008), PAHO Equity Commission (2019), ku shihet se shumë faktorë kombinohen duke ndikuar në shëndetin e individëve dhe komuniteteve. Shëndeti i njerëzve ndikohet nga kushtet e tyre të jetesës dhe jo vetëm nga gjenetika apo të sjellja. Faktorët më të shpeshtë determinantë janë vendi ku jetojmë, gjendja e mjedisit, gjenetika, të ardhurat, niveli arsimor, marrëdhëniet tona me miqtë dhe familjen, me ndikime të konsiderueshme në shëndet, ndërsa faktorët më të konsideruar si aksesit dhe përdorimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor shpesh kanë më pak ndikim. Modeli Dahlgren dhe Whitehead (1991) vazhdon të jetë më i rëndësishmi në përshkrimin e përcaktuesve social të shëndetit – mënyrat në të cilat elementët e mjedisit social, ekonomik dhe fizik ndërveprojnë me faktorët dhe sjelljet biologjike individuale dhe formësojnë gjendjen shëndetësore.

Konkluzione. Njohja e mirë, zbatimi dhe kujdesi ndaj elementëve të përcaktuesve social të shëndetit kanë rëndësi sepse vendosin kushtet për shëndetin e individëve, komuniteteve dhe popullatave, dhe nëse përcaktuesit social të shëndetit nuk shpërndahen në mënyrë të drejtë, ato mund të çojnë në pabarazi shëndetësore.

Fjalë kyce: determinant shëndeti, shëndet, modele, popullatë, kujdes shëndetësor.

HEALTH DETERMINANTS AND THE HEALTH OF OUR POPULATION

¹PhD Juljana Xhindoli,²PhD(c) Vasilika Prifti, ¹PhD(c) Emirjona Kiçaj, ¹PhD(c) Rudina Cercizaj
¹PhD(c) Saemira Durmishi, ¹Dr. Rezarta Lalo, ¹Msc. Stiliana Brokaj,²Dr. Evis Allushi,

¹Department of Health Care, Faculty of Health, University Ismail Qemali, Vlore

²Department of Nursing, Faculty of Health, University Ismail Qemali, Vlore

*E-mail correspondent author: juljana.xhindoli@univlora.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Health is an individual right and a matter of social justice. It is also a public good. Hospital clinical care is less important than many people think, while socio-economic factors and the physical environment are quite influential in the health and well-being of individuals. The purpose of this study is to bring to the attention of health personnel the socio-economic, biological and behavioral factors that affect health. What are the social determinants of health and where should health care focus for the well-being of the population?

Methodology: The study is treated in the form of a description of the guidelines on the determinants of health according to the WHO, if the health of the population is determined by their circumstances and environment - social, economic and environmental conditions that affect the health of the population. Several models have been taken into consideration which, although they are from the early years, have stood the test of time, becoming the basis for the new successor models.

Results: The literature study revealed several models that describe the determinants of health such as Dahlgren and Whitehead (1991), Global Commission on SDH (2008), PAHO Equity Commission (2019), where it is seen that many factors combine to affect the health of individuals and communities. People's health is affected by their living conditions and not just genetics or behavior. The most frequent determining factors are the place where we live, the state of the environment, genetics, income, education level, our relationships with friends and family, with significant impacts on health, while the most considered factors are access to and use of health care services often have less impact. The Dahlgren and Whitehead (1991) model continues to be the most important in describing the social determinants of health—the ways in which elements of the social, economic, and physical environment interact with individual biological factors and behaviors and shape health status.

Conclusions. Good recognition, implementation and care of the elements of social determinants of health are important because they set the conditions for the health of individuals, communities and populations, and if the social determinants of health are not equitably distributed, they can lead to health inequalities.

Keywords: health determinants, health, models, population, health care.

SI NDIKON REHABILITIMI FIZIK NË LEHTËSIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË NDJESHMËRISË NË PACIENTËT ME SKLEROZË MULTIPLE

Dr. Evis Allushi, PhD. Juljana Xhindoli, Phd. c. Vasilika Prifti, Phd. c. Sonila Nika
evis.allushi@univlora.edu.al

ABSTRAKT

Çrregullimet e ndjeshmërisë përbëjnë simptomat më të zakonshme fillestare në pacientët me Sklerozë Multiple. Referuar “Fatigue National Multiple Sclerosis Society”, mpirja është një nga shenjat më të hershme dhe më të shpeshta në pacientët me SM.

Shpesh shfaqet në formën e mpirjes ose ndjesi shpimi në pjesë të ndryshme të trupit, të tilla si krahët, këmbët ose trangu, e cila zakonisht përhapet brenda disa ditësh. Kjo gjë interferon në jetën e pacientëve si në shtëpi ashtu edhe në punë, dhe është një nga shkaktarët e largimit të pacientëve nga jeta e tyre aktive.

Objektivi i këtij artikulli është shqyrtimi i literaturës për të parë lidhjen midis ndjesive jonormale dhe rehabilitimit fizik, në pacientët me SM, dhe ndikimit të tyre tek njëri-tjetri. Kërkimi përfshiu të dhënat bazë elektronike të: Ovid PubMed, Cochrane Library, NLM Tools. Më shumë se 40 artikuj potencialë u identifikuan, por në shqyrtim u përfshin rezultatet origjinale të shtatë studimeve që kishin lidhje me tematikën e interesit përfshirë dhe rishikime të literaturës. Studimet e analizuara theksuan se rehabilitimi është një terapi mjaft e rëndësishme në menaxhimin e mpirjes, përmirësoi gjendjen e pacientëve me SM, pavarësisht gjendjes së tyre, edhe pse përmirësimi mund të jetë i shkurtër në kohë, ç’ka kërkon përfshirjen e një rehabilitimi gjithëpërfshirës për të gjithë pacientët me MS.

U identifikuan gjetje kontradiktore në literaturën e botuar në lidhje me ndikimin e ndjesive jonormale në aftësinë e pacientëve për të realizuar rehabilitimin.

Është e nevojshme të bëhen studime me metodologji më të rreptë, për të sqaruar se cila formë e rehabilitimit mund të çojë në mirëmenaxhimin e këtyre ndjesive jonormale.

Fjalë kyçe: *Sklerozë Multiple, ndjesi jonormale, mpirje, rehabilitim fizik.*

HOW PHYSICAL REHABILITATION AFFECTS THE RELIEF OF ABNORMAL SENSATIONS IN PATIENTS WITH MULTIPLE SCLEROSIS

Dr. Evis Allushi
Phd. candidate Vasilika Prifti
Phd. candidate Sonila Nika
evis.allushi@univlora.edu.al

ABSTRACT

Abnormal sensations are the most common initial symptoms in patients with Multiple Sclerosis. According to Fatigue National Multiple Sclerosis Society, numbness is one of the earliest and most common signs in MS patients.

It often appears in the form of numbness or tingling in various parts of the body, such as the arms, legs or trunk, which usually spreads within a few days. This interferes with patients' lives both at home and at work, and is one of the causes of patients leaving their active lives.

The objective of this article is to review the literature to see the relationship between abnormal sensations and physical rehabilitation, in patients with MS, and their influence on each other. The search included the basic electronic databases of: Ovid PubMed, Cochrane Library, NLM Tools. More than 40 potential articles were identified, but the review included the original results of seven studies related to the topic of interest including literature reviews. The analyzed studies pointed out that rehabilitation is a very important therapy in the management of numbness, improved the condition of patients with MS, regardless of their condition, although the improvement may be short in time, which requires the inclusion of a comprehensive rehabilitation for all MS patients.

Contradictory findings were identified in the published literature regarding the impact of abnormal sensations on patients' ability to perform rehabilitation.

It is necessary to conduct studies with stricter methodology, to clarify which form of rehabilitation can lead to the better management of these abnormal sensations.

Keywords: *Multiple Sclerosis, abnormal sensations, numbness, physical rehabilitation.*

MENAXHIMI I NDRYSHIMIT TEK PUNONJËSIT EKUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR

MP. Babeta Rexhepi
Kryeinfermiere në Kujdesin Parësor Shëndetësor Nikel
Babeta.rexhepi@yahoo.com/0696777521

ABSTRAKTI

Organizatat e kujdesit shëndetësor vazhdimisht ndryshojnë si rezultat i përparimeve teknologjike, plakjes së popullatave, ndryshimit të modeleve të sëmundjeve, zbulimeve të reja për trajtimin e sëmundjeve, reformave politike dhe iniciativave të politikave. Ndryshimet mund të jenë sfiduese sepse ato kundërshtojnë nevojën themelore të njerëzve për një mjedis të qëndrueshëm.

Qëllimi i punimit është që të njihemi dhe kuptojmë procesin e ndryshimit në një organizatë shëndetësore, si reagojnë punonjësit shëndetësorë ndaj ndryshimit dhe çfarë i karakterizon ndryshimet e suksesshme organizative në kujdesin shëndetësor.

Duke ditur që ndryshimet e vazhdueshme që ndodhin në organizatë ndikojnë në performancën e punonjësit do të analizojmë mënyrat se si një punonjës mund të reagojë përballë ndryshimeve dhe sesi të ndihet më i përfshirë me punën e tij duke menaxhuar me sukses ndryshimin dhe njëkohësisht organizata të përfitojë maksimumin e efikasitetit dhe efikasitetit nga puna e punonjësit gjatë ndryshimeve.

Metodologjia – Për hartimin e këtij punimi është përdorur metodologjia e studimit dytësor dhe parësor. Metodologjia e studimit dytësor është përdorur për të studiuar së pari, konceptet teorike të procesit të ndryshimit në Kujdesin parësor shëndetësor me fokus në efektin që shkaktojnë këto ndryshime tek punonjësit shëndetësorë. Së dyti, dytë është hulumtuar për gjetjen e strategjive për menaxhimin e ndryshimeve me qëllim një qasje më pozitive nga ana e punonjësve shëndetësorë

Për këtë është përdorur një literaturë e gjerë e cila konsiston në materiale dhe punime të autorëve të huaj, në studime me karakter ndërkombëtar dhe në përdorimin e një numri të madh burimesh informacioni nga faqet të ndryshme dhe të rëndësishme që merren me çështjen dhe temat e shtjelluara në këtë punim të diplomës.

Për të realizuar këtë punim është përdorur gjithashtu edhe shqyrtim i literaturës (secondary research) – i për të studiuar konceptet teorike në përgjithësi. Për këtë janë përdorur artikuj të shumtë studimorë, libra nga botimet më të ndryshme nga botues të famshëm botërorë. Bashkëbisedimi me stafin shëndetësor në Qendrën Shëndetësore Nikel, dhe marrja e shumë mendimeve të tyre. Pyetësorët janë përdorur për të nxjerrë statistika për të përmbushur hulumtimin rreth punëtorëve shëndetësorë në Qendrën shëndetësore Nikel.

Rezultatet – Në kuadër të hulumtimit të parë janë përfshirë stafi shëndetësor, të cilët kryesisht vinin nga Qendra Shëndetësore Nikel dhe nëntë ambulancat e saj. Në bazë të këtij hulumtimi, shohim stafin shëndetësor nga afër se si ato reagojnë ndaj ndryshimeve, janë të lumtur me

punën e tyre të përditshme që po e bëjnë në përditshmëri. A e kanë të lehtë apo jo të kryejnë këtë punë, cilat janë sfidat me të cilën ato përballen, a kanë kohë të mjaftueshme t'iu përkushtohen familjeve të tyre, me cilat ndryshime në punën e tyre shfaqin më shumë rezistence, dhe në cilat prej tyre kanë marrë kënaqësi apo kanë lulëzuar gjatë procesit të punës

Konkluzione- Në këtë kapitull janë përmbledhur pikat kryesore nga i gjithë punimi për të shpjeguar më mirë pyetjen hulumtuese. Nga sondazhet e bëra deri më tani në rajonin tone dhe më gjerë mund të konkludojmë se ndryshimet organizative në kujdesin shëndetësor kanë më shumë të ngjarë të kenë sukses kur profesionistët e kujdesit shëndetësor të kenë mundësinë të ndikojnë në ndryshim, të ndjehen të përgatitur për ndryshimin dhe të njohin vlerën e ndryshimit, duke përfshirë perceptimin e përfitimit të ndryshimit për pacientët

Rezultatet

Të intervistuarit theksuan rëndësinë e të paturit mundësi për të ndikuar në ndryshimet organizative që janë zbatuar. Ndryshimet që u nisën nga vetë profesionistët u konsideruan më të lehtë dhe rrallë u rezistuan. Ndryshimet që u komunikuan qartë për të lejuar përgatitjen rritën shanset për sukses. Të intervistuarit nuk mbështesnin ndryshimet organizative që u perceptuan të zbatoheshin papritur dhe / ose pa komunikim paraprak. Ata përcollën se ishte e rëndësishme për ta të kuptonin nevojën dhe përfitimet e ndryshimeve organizative. Ata veçanërisht vlerësuan dhe perceptuan si ndryshime të suksesshme organizative me fokus pacientin, me përfitime të qarta për pacientët.

Fjalë kyçe: kënaqësia në punë, punonjësit, kënaqësia e pacientëve, shërbimet

CHANGE MANAGEMENT IN THE PRIMARY HEALTH CARE WORKFORCE

MP. Babeta Rexhepi

Head Nurse at Nickel Primary Health Care

Babeta.rexhepi@yahoo.com/0696777521

ABSTRACT

Health care organizations are constantly changing as a result of technological advances, aging populations, changing disease patterns, new discoveries about disease treatments, policy reforms, and policy initiatives. Changes can be challenging because they contradict people's basic need for a stable environment.

The purpose of the paper is to get to know and understand the process of change in a health organization, how health workers react to change and what characterizes successful organizational changes in health care.

Knowing that the constant changes that occur in the organization affect the employee's performance, we will analyze the ways in which an employee can react to the changes and how to feel more involved with his work by successfully managing the change and at the same time the organization benefits the most of the efficiency and effectiveness of the employee's work during the changes.

Methodology – The methodology of the secondary and primary study was used for the drafting of this paper. The secondary research methodology was used to study first, the theoretical concepts of the process of change in Primary Health Care with a focus on the effect these changes cause on health workers. Secondly, it was researched to find strategies for managing changes in order to have a more positive approach on the part of health workers.

For this, a wide literature was used, which consists of materials and works of foreign authors, in studies of an international character and in the use of a large number of information sources from various and important sites that deal with the issue and elaborated topics. in this thesis.

To carry out this work, literature review (secondary research) was also used - to study theoretical concepts in general. For this, numerous study articles, books from various editions by famous world publishers were used. Talking to the health staff at the Nikël Health Center, and getting a lot of their opinions. Questionnaires were used to extract statistics to fulfill the research about the health workers at the Nickel Health Center.

Results - In the framework of the first research, the health staff were included, who mainly came from the Nikël Health Center and its nine ambulances. Based on this research, we see the health staff closely, how they react to changes, are they happy with their daily work that they are doing on a daily basis. Is

it easy or not for them to do this work, what are the challenges they face, do they have enough time to devote to their families, with which changes in their work do they show more resistance, and in which of they have enjoyed or flourished during the work process

Conclusions- This chapter summarizes the main points from the entire paper to better explain the research question. From surveys conducted so far in our region and beyond, we can conclude that organizational changes in health care are more likely to succeed when health care professionals have the opportunity to influence change, feel prepared for change, and recognize the value of change, including the perceived benefit of change to patients

Results

The interviewees emphasized the importance of having the opportunity to influence the organizational changes that have been implemented. The changes that were initiated by the professionals themselves were considered the easiest and were rarely resisted. Changes that were clearly communicated to allow for preparation increased the chances of success. Interviewees did not support organizational changes that were perceived to be implemented suddenly and/or without prior communication. They conveyed that it was important for them to understand the need and benefits of organizational change. They particularly valued and perceived as successful patient-focused organizational changes with clear benefits for patients.

Keywords: job satisfaction, employees, patient satisfaction, services

SHTATËZANIA DHE USHQIMI, NJË RAPORT I VËSHITIRË*Msc. Saemira Durmishi¹**Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë¹*saemira.durmishi@univlora.edu.al**ABSTRAKT**

Ushqyerja e një gruaje duhet të karakterizohet nga një dietë e shëndetshme, sidomos gjatë periudhës së shtatëzimit pasi të ushqehesh mire dhe mjaftueshëm gjatë shtatëzimit është vendimtare për rritjen dhe zhvillimin e mbarë të embrionit. Gjatë periudhës së shtatëzimit, të gjitha gratë bëhen shumë më të ndërgjegjshme për mënyrën e të ushqyerit, se çfarë duhet të hanë e çfarë jo. Megjithatë, jo gjithmonë është e lehtë t'i kategorizosh ushqimet dhe pijet në çfarë DUHET dhe çfarë NUK DUHET. Kequshqyerja është një nga burimet më të mëdhatë komplikacioneve të shtatëzimit. Për shkak të kequshqyerjes, në trupin e gruas ndodhin një sërë ndryshimesh, çrregullimesh apo sëmundjesh.

Qellimi: Të vlerësojmë mënyrën e ushqyerjes së gruas shtatëzënë dhe problematikat që sjell kequshqyerja.

Objektivi: Të vlerësojmë këshillimin dhe kujdesin e infermierëve për ushqyerjen e grave shtatëzëna, duke pasur si objektivi kryesor që foshnja të zhvillohet, të përparojë, të rritet dhe të kemi një mëmësi të sigurtë.

Metodologjia e studimit: Ky është një studim deskriptiv i kryer në qytetin Vlorë për një periudhë kohore 1 vjeçare (Janar 2022 - Janar 2023). Ky studim u krye në 2 qendra shëndetsore duke u bazuar në pyetesoret dhe intervistat me gratë shtatëzëna lidhur me mënyrën e ushqyerjes.

Rezultatet: U morën në studim 210 gra shtatëzëna të cilat ju nënshtruan një pyetësori. Sipas rezultateve të studimit 71 % kishin informacion lidhur me mënyrën e ushqyerjes. 46% kishin shtesë të tepërt në peshë (referuar moshës së barrës). Vetëm 63% kishin marrë acidin folik. 32% ishin konsumatorë të cigares para shtatëzimit dhe vetëm 4% vazhdonin ta konsumonin edhe gjatë shtatëzimit. Rezulton se 44% konsumon sasi të vogla alkoli gjatë festave familjare, dhe 58% pëlqejnë të konsumojnë çokollata dhe ëmbëlsira. 91% përdorin vajin e ullirit, 62% mishin dhe peshkun. Vetëm 27% kishin informacione që lidheshin me komplikacionet dhe problemet që sjell kequshqyerja në shtatëzani.

Konkluzione: Në këtë studim u pa se personeli shëndetësor ka një rol kyç në dhënien e informacioneve lidhur me dietën e gruas shtatëzënë por duhet të krijohen kushte të përshtatshme dhe klasa antenatale për përcaktimin e dietës sipas moshës gestacionale. Ekzistojnë shumë dyshime në lidhje me ushqimin gjatë shtatëzimit, si dhe me pijet që duhen konsumuar. Konsumi i frutave gjatë shtatëzimit është thelbësor për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Fjalë kyçe: Dietë, mosha gestacionale.

PREGNANCY AND FOOD, A DIFFICULT RELATIONSHIP

MSc. Saemira Durmishi¹

Department of Health Care, Faculty of Health, University "Ismail Qemali" Vlorë¹

saemira.durmishi@univlora.edu.al

ABSTRACT

A woman's nutrition should be characterized by a healthy diet, especially during pregnancy, since eating well and enough during pregnancy is crucial for the growth and development of the embryo. During the period of pregnancy, all women become much more conscious about the way they eat, what they should eat and what they shouldn't. However, it is not always easy to categorize foods and drinks into what you SHOULD and what you SHOULD NOT. Malnutrition is one of the biggest sources of pregnancy complications. Due to malnutrition, a number of changes, disorders or diseases occur in the woman's body.

Aim: To evaluate the way in which pregnant women are fed and the problems caused by malnutrition.

Objective: To evaluate the advice and care of nurses for the nutrition of pregnant women, with the main objective being that the baby develops, progresses, grows and has a motherhood. sure.

Methodology: This is a descriptive study conducted in the city of Vlorë during a one year period (January 2022 - January 2023). This study was conducted in 2 health centers based on questionnaires and interviews with pregnant women regarding the way of nutrition.

Results: 210 pregnant women who submitted a questionnaire were taken into the study. According to the results of the study, 71% had information about the way of nutrition. 46% had excessive weight gain (referred to gestational age). Only 63% had received folic acid. 32% were cigarette consumers before pregnancy and only 4% continued to smoke during pregnancy. It turns out that 44% consume small amounts of alcohol during family holidays, and 58% like to consume chocolates and sweets. 91% use olive oil, 62% meat and fish. Only 27% had information related to complications and problems caused by malnutrition during pregnancy.

Conclusions: In this study, it was seen that health personnel have a key role in providing information about the diet of pregnant women, but suitable conditions and antenatal classes should be created to determine the diet according to gestational age. There are many doubts about food during pregnancy, as well as the drinks that should be consumed. Fruit consumption during pregnancy is essential for the health of the mother and the child.

Keywords: Diet, gestational age.

RËNDËSIA E TË MENDUARIT KRITIK NË INFERMIERI*Silvana Gripshi, Anila Cake***ABSTRAKT**

Aftësitë e të menduarit kritik janë thelbësore për të funksionuar në mjedisin e sotëm kompleks të kujdesit shëndetësor, ku kërkohet që infermierët të angazhohen gjithnjë e më shumë në zgjidhjen e problemeve e situatave të ndërlikuara si dhe të bashkëpunojnë me një sërë aktorësh të disiplinave të ndryshme gjatë ofrimit të kujdesit për pacientët dhe gjatë marrjes së vendimeve. Për këtë arsye infermierët duhet të zhvillojnë të menduarit kritik si një instrument i dobishëm për të lehtësuar në mënyrë efektive zgjidhjen e problemeve, procesin e vendimmarrjes dhe gjykimin klinik në mjediset e kujdesit shëndetësor.

Qëllimi i këtij punimi është të rishikojë literaturën që shqyrton konceptin e të menduarit kritik dhe marrëdhënien e tij me infermierinë si profesion dhe me arsimin infermior.

Për këtë punim u shqyrtuan artikuj të cilët u gjetën duke kërkuar në bazat elektronike të të dhënave PubMed, CINAHL Plus, Elsevier dhe BMJ Open. Studimet shqyrtonin përkufizimet e të menduarit kritik dhe rëndësinë e tij në mjedisin klinik dhe në programet e arsimit infermior.

Rezultatet e studimeve të shumta sugjerojnë se të menduarit kritik ka një rëndësi të madhe për edukimin infermior dhe infermierët që praktikojnë çdo ditë në institucionet shëndetësore në zgjidhjen e problemeve shëndetësore të pacientëve dhe në marrjen e vendimeve të rëndësishme lidhur me kujdesin ndaj tyre, e si rrjedhojë kjo rezulton në përmirësimin e kujdesit për pacientët. Të menduarit kritik është një aftësi që kultivohet, prandaj integrimi në kurrikul dhe zbatimi në auditore i metodave dhe strategjive novatore që zhvillojnë të menduarit kritik do të ndryshojë praktikën e tanishme të mësimdhënies në dobi të përgatitjes e aftësimin të profesionistëve të ardhshëm.

Fjalë kyçe: mendim kritik, arsim infermior, mjedis klinik, praktikë infermierore

THE IMPORTANCE OF CRITICAL THINKING IN NURSING

Silvana Gripshi, Anila Cake

ABSTRACT

Critical thinking skills are essential to function in today's complex healthcare environment, where nurses are increasingly required to engage in problem solving in complex situations and to collaborate with a range of multidisciplinary actors in the delivery of patient care and decision-making. For this reason, nurses must develop critical thinking as a useful tool to effectively facilitate problem solving, decision making, and clinical judgment in health care settings.

The purpose of this paper is to review the literature that examines the concept of critical thinking and its relationship to nursing as a profession and to nursing education.

Articles from the electronic databases PubMed, CINAHL Plus, Elsevier and BMJ Open were reviewed for this paper. The studies examined definitions of critical thinking and its importance in the clinical setting and in nursing education programs.

The results of numerous studies suggested that critical thinking is very important for nursing education and nurses who practice every day in health institutions in solving health problems of patients and in making important decisions regarding their care, and consequently this results in improved patient care. Critical thinking is a skill that is cultivated, therefore the integration in the curriculum and the implementation in the classrooms of innovative methods and strategies that develop critical thinking will change the current teaching practice for the benefit of the preparation and training of future professionals.

Keywords: critical thinking, nursing education, clinical environment, nursing practice.

RËNDËSIA E PËRMIRËSIMIT TË KUJDESIT INFERMIEROR PËR RIKUPERIMIN E HERSHËM NË PACIENTËT ME STROKË

Arjona Rakipi

Urdhri Infermierit të Shqipërisë

ABSTRAKT

Hyrja: Aksidenti vaskular cerebral(Stroke) ishemic dhe hemoragjik është shkaku i dytë kryesor global i vdekjeve pas sëmundjeve kardiake dhe përbën rreth 12% të vdekshmëris totale në mbarë botën.Një insult cerebral ndodh kur furnizimi me gjak i një pjese të trurit ndërpritet duke çuar në nekrozë (vdekje qelizore)të pjesës së prekur.

Qëllimi: Diagnostikimi i hershëm i rasteve që në orët e para (4-6 orë)të shfaqjes së simptomave, shmang mortalitetin dhe ul shkallën e invaliditetit.Transport i menjëhershëm i rasteve të dyshuara dhe ato të konfirmuara drejt qendrave stroke për trajtim dhe rehabilitim.Zbulimi i faktorëve të riskut dhe menaxhimi në mënyrë që të zvogëlohet numri i rasteve të përsëritura.

Metodologjia: Ky material është bazuar në të dhënat e fundit të literaturës dhe udhëzuesit e ndryshëm mbarë botëror .Materiali nxjerr në pah kujdesin infermieror në stroke, duke përfshirë rëndësinë e vlerësimit,diagnostikimit të shpejtë,dhe edukimin e pacientit.

Rezultatet: Stroke është një aksident vascular cerebral i cili rreth 2/3 prek më tepër moshën mbi 60 vjeç .Meshkujt kanë 25% më shumë rrisht se femrat.Rreth 85% e rasteve janë ishemicke (të shkaktuara nga trombet) dhe 15 % hemoragjike (të shkaktuara nga ruptura-shkëputja e një ene gjaku).Faktorët e riskut janë:presioni i lartë i gjakut,diabeti,obeziteti,pirja e duhanit,dieta,inaktiviteti fizik,fibrilacioni atrial,kolesteroli,përdorimi i drogës,alkoolit,sëmundja e arteries karotide,anemia drepanocitare etj.Është e rëndësishme të evidentohen shenjat klinike si humbja e vetëdijes,errësimi i shikimit,paraliza faciale,hemipareza,vështiësia në artikulum,dhe të veprohet shpejt dhe në kohë për rikuperimin dhe trajtimin e menjëhershëm pasi cdo sekond është vendimtare.Kujdesi infermieror kryesor është të ndjek udhëzimet mjeksore,të monitorojë parametrat jetësore ,të marrë analizat e duhura laboratorike të shoqërojë pacientin në ekzaminimet imazherike të cilat ndihmojnë në diagnostikimin e duhur të sëmundjes.

Konkluzioni: Informimi i personelit shëndetësor.Aftësimi mbi të dhënat e fundit të kërkimeve shkencore dhe OBSH .Kujdesi dhe menaxhimi infermieror bazohet në monitorimin, trajtimin medikamentoz ,ushqyerjen enterale dhe parenterale të pacientit,parandalimin dhe trajtimin e dekubituseve në qëndrimet afatgjata dhe suportin emocional dhe psikologjik në përmirësimin e jetës së pacientit të prekur nga Stroke.

Fjalë kyçe: Stroke, ishemic stroke, hemorragjik stroke, AVC,kujdes infermieror, menaxhim infermieror.

THE IMPORTANCE OF IMPROVING NURSING CARE FOR EARLY RECOVERY IN STROKE PATIENTS

Arjona Rakipi

Albanian Order of Nurses

ABSTRACT

Introduction: Cerebral vascular insult(Stroke) Ischemic and Hemorrhagic Stroke is the second leading cause globally deaths after cardiac diseases and accounts for about 12% of total mortality in worldwide. A cerebral stroke occurs when the blood supply to a part of the brain, is interrupted leading to necrosis (cell death) of the affected part. Insults are ischemic (caused by blood clots) and hemorrhagic (by rupture of a blood vessel).

Purpose: Diagnosing early morning sickness in the early hours (4-6 hours) of the appearance of symptoms, avoids mortality and lowers the rate of disability. Immediate transport of cases suspected and those confirmed to the stroke centers for treatment and rehabilitation. Discovery of risk factors and management in order to reduce the number of repeated cases.

Methodology: This material is based on the latest literature data and various worldwide guidelines. The material highlights nursing care in stroke, including the importance of rapid assessment and diagnosis, and patient education.

Results: There has been an increase in physician mobility in OECD countries, but data on the mobility of nurses are incomplete. The OECD reported that between 2006 and 2016, there was a 50 % increase in the number of foreign physicians working in OECD countries. The number of nurses increased by 20 % over the five years prior to 2016. Most of these foreign health professionals worked in the United States, the United Kingdom, and Germany. The total number of foreign medical doctors (MDs) in Germany increased from 22,000 in 2008 to over 58,000 in 2019, amounting to 14.5 % of all Germany’s physicians in 2019, up from 4.2 % in 2008. Most of these physicians came from new EU states, mainly Romania, Hungary, and Bulgaria. Another 6 % came from the countries of the WB. The number of doctors per capita has grown much more slowly or remained stable since 2000 in Belgium, France, Poland and the Slovak Republic. For nurses, the growth in the number per capita has been particularly rapid in countries that already had a relatively high number of nurses in 2000 such as Norway, Switzerland and Finland. Albania, Romania, Bulgaria, and all the western Balkans have the higher numbers of migrating health care professionals.

Conclusions: The trends in health care workers has changed in variation to certain country’s characteristics and features. Albanian trend has changed from Italy and Greece migration to Germany, USA and Canada migration. The trend is reversing in Poland and Romania in slow rates. EU-countries and non-EU countries have started to work seriously on reversing the brain drain to brain gain and circulation by improving work conditions, increasing wages, developing talent programs, reducing taxes for returnees, offering better job positions, remaining in close relations with the diaspora and developing better programs for third cycle of education and research. There is much work to be done, especially in Albania, as the data on migration, pull and push factors and brain gain rates are scarce, and more researches are needed in this area.

Keywords: *brain drain, brain gain, migration, health care personnel*

**PROTOKOLL KËRKIMOR MBI TRAJTIMIN FARMAKOLOGJIK TË
ENDOMETRIOZËS PËR NJË CILËSI MË TË MIRË TË JETËS PËR GRATË DHE
PARANDALIMIN E INFERTILITETIT
STUDIM PËR TË ARDHMEN**

MSc. Lejdi Fetahu¹, PhD candidate Brunilda Subashi,

MSc. Erlini Kokalla, MSc. Marjola Muhaj

¹Lejdi Fetahu, Farmaciste, Vlorë

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë

e-mail: lejdifetahu@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Protokoll i kërkimit demonstroi udhëzimet për kryerjen e studimit. Ai ilustron se çfarë do të bëhet në studim duke shpjeguar çdo pjesë thelbësore të tij dhe si do të kryhet. Ai gjithashtu përshkruan përzgjedhjen e pjesëmarrësve, kohëzgjatjen e studimit, medikamentet dhe testet përkatëse. Endometrioza është një çrregullim gjinekologjik që prek deri në 10% të grave gjatë viteve të tyre riprodhuese dhe shpesh dëmton mirëqenien mendore, fizike, sociale dhe psikoseksuale të grave dhe zakonisht ka një efekt negativ në cilësinë e jetës së lidhur me shëndetin.

Objektivat: Ky protokoll kërkimor synon vlerësimin e trajtimit farmakologjik tek gratë me endometrioze, vlerësimin e dhimbjes, kontrollit dhe pafuqisë, mirëqenies emocionale, mbështetjes sociale dhe vetë-imazhit përmes instrumenteve ENDOPAIN-4D dhe EHP-30, si dhe edukimin e grave mbi trajtimin farmakologjik të endometrioze dhe simptomave të saj.

Metodologjia: Studimi do të kryhet në një popullatë të përfaqësuar nga gra adulte të moshës 18-50 vjeç në qytetin e Vlorës, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024. Kriteret për përfshirje në studim janë: (1) të jesh femër e rritur. (18-50 vjeç), (2) diagnostikimi i endometrioze, (3) pjesëmarrja vullnetare në studim, (4) plotësimi i pyetësorëve nga gratë me Endometrioze deri në 90%.

Protokoll i kërkimit do të realizohet nëpërmjet ekzekutimit në faza të ndryshme si: rishikimi i literaturës dhe instrumenti i anketimit, përkthimi i instrumentit të anketimit dhe përshtatja e pyetësorit, aplikimi formal për autorizim për të kryer kërkime në një kampion studimor, kryerja e anketimit, periudha e saktë kohore për shpërndarjen e pyetësorit dhe mbledhja e të dhënave, prezantimi i të dhënave duke krijuar një bazë të dhënash në excel, analiza e të dhënave, përpunimi dhe interpretimi i të dhënave, shkrimi i konkluzioneve, plotësimi i draftit të parë, trajtimi i reagimeve, përfundimi i studimit, publikimi dhe prezantimi në kongrese dhe seminare të ndryshme.

Rezultatet e pritshme: Njohja e grave të diagnostikuara me endometrioze me metodat e trajtimit farmakologjik për një cilësi më të mirë të jetës, menaxhimin e dhimbjes dhe pafuqisë, mirëqenies emocionale dhe sociale, përmirësimin e imazhit për veten dhe përshtatjen e një stili jetese të shëndetshëm.

Fjalë kyçe: protokoll kërkimor, trajtim farmakologjik, endometrioze, cilësia e jetës lidhur me shëndetin, infertiliteti.

RESEARCH PROTOCOL ON PHARMACOLOGICAL TREATMENT OF ENDOMETRIOSIS FOR A BETTER QUALITY OF LIFE FOR WOMEN AND PREVENTION OF INFERTILITY FUTURE STUDY

MSc. Lejdi Fetahu¹, PhD candidate Brunilda Subashi,

MSc. Erlini Kokalla, MSc. Marjola Muhaj

¹Contact person: Lejdi Fetahu, Pharmacist, Vlorë

University of Vlora 'Ismail Qemali'

e-mail.: lejdifetahu@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: The research protocol demonstrates the guidelines for conducting the trial. It illustrates what will be done in the study by explaining each essential part of it and how it is carried out. It also describes the eligibility of the participants, the length of the study, the medications and the related tests. Endometriosis is a gynecological disorder that affects up to 10% of women during their reproductive years, and often impairs women's mental, physical, social and psychosexual well-being and usually has a negative effect on health-related quality of life.

Objectives: This study protocol aims the assessment of pharmacological treatment in women with endometriosis, assessment of pain, control and impotence, emotional well-being, social support, and self-image through the ENDOPAIN-4D and EHP-30 instruments, as well as educating women on the pharmacological treatment of endometriosis and its symptoms.

Methodology: The research will be carried out in a population represented by adult women aged 18-50 years in the city of Vlora, during the period January-December 2024. The criteria for inclusion in the study are: (1) being an adult female (18-50 years old), (2) diagnosis of endometriosis, (3) voluntary participation in the study, (4) completion of questionnaires by women with Endometriosis until 90%.

The research protocol will be carried out through execution in different stages such as: literature review and survey tool, translation of the survey instrument and adaptation of the questionnaire, formal application for authorization to conduct research on a study sample, conducting the survey, exact time period for questionnaire distribution and data collection, presentation of data by creating a database in excel, data analysis, data processing and interpretation, writing conclusions, completion of the first draft, dealing with feedback, completion of the study, publication and presentation at various congresses and seminars.

Expected results: Acquaintance of women diagnosed with Endometriosis with pharmacological treatment methods for a better quality of life, management of pain and helplessness, emotional and social well-being, improvement of self-image and adaptation of a healthy lifestyle.

Keywords: research proposal, pharmacological treatment, endometriosis, HRQOL, infertility

“FRIKA DHE ANKTHI TEK PACIENTËT PARA OPERACIONIT, ROLI I INFERMIERIT”

Msc Elvira Qosja

Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, Universiteti i Elbasanit

ABSTRAKT

Hyrje: Në ditët e sotme kirurgjia paraqitet një nga mjetet më efikase në mjekimin e shumë sëmundjeve, por pothuaj dhe çdo pacient që ka nevojë për ndërhyrje kirurgjikale provon ndjenjën e frikës dhe të ankthit para operacionit. Spitali, si një institucion që ofron shërbims hëndetësor cilësor, kujdeset që të vendosë besimin dhe komunikimin e hapur me pacientët si edhe të kuptojë dhe mbrojë vlerat psikologjike dhe shpirtërore të çdo pacienti. Një marrëdhënie e plotë besueshmërie midis pacientit dhe stafit mjekësor ka rëndësi thelbësore për një trajtim shëndetësor të suksesshëm.

Qellimi: Të vlerësohet gjendja emocionale dhe psikologjike e pacientit, dhe menaxhimi infermieror ne periudhen preoperatore.

Objektivat: Rritja e njohurive për ankthin dhe frikën, për ti paraprirë qetësisë psikologjike të pacientit preoperatory si dhe zgjerimi i njohurive për rëndësinë e gjendjes shpirtërore dhe psikologjike të pacientit.

Metodologjia: është një studim deskriptiv i kryer ne Spitalin e qytetit te Elbasanit i shtrire ne afatin kohor Janar 2022- janar 2023 duke ju referuar pyetesoreve te bere te pacientet para nderhyrjes kirurgjikale

Rezultatet: Jane perdorur pyetesoret te 145 paciente te shtruar ne spital pergjate vitit 2022. Nga keta 87 meshkuj dhe 58 femra. 95 paciente shprehin gjendje ankthi dhe frike kurse 50 te tjere jane te qete. nga te cilet 45 jane meshkuj dhe 50 femra. Pas bisedes dhe informimit 101 kane siguri te nderhyrja kirurgjikale kurse 44 shprehin friken per periudhen post operatore. Frike nga dhimbjet dhe diskomforti, është pothuajse ndjenje universale dhe ka te beje me friken ndaj dhimbjes para dhe pas operacionit.

Konkluzione : Si konkluzion themi se roli i infermierit në qetësimin e pacientit nga frika dhe ankthi preoperator, varet nga njohuritë që ka ai në lidhje me frikën dhe ankthin, detyrat dhe rolin si infermier, pasi Kujdesi infermieror është pasqyrë e kujdesit shëndetësor. Ne jemi të parët që përballemi me pacientin dhe familjarët.

Fjale kyçe: Ndërhyrje, Post-Operatore, Gjendja Pasikologjike, Ankthi.

"FEAR AND ANXIETY IN PATIENTS BEFORE OPERATION, THE ROLE OF THE NURSE"

MSc Elvira Qosja

Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan

ABSTRACT

Introduction: Nowadays, surgery is one of the most efficient tools in the treatment of many diseases, but almost every patient who needs surgical intervention experiences the feeling of fear and anxiety before the operation. The hospital, as an institution that offers quality health care, takes care to establish trust and open communication with patients, as well as to understand and protect the psychological and spiritual values of each patient. A full relationship of trust between the patient and the medical staff is of fundamental importance for a successful health treatment.

Purpose: To evaluate the emotional and psychological state of the patient, and nursing management in the preoperative period.

Objectives: Increasing knowledge about anxiety and fear, to advance the psychological calm of the preoperative patient as well as expanding knowledge about the importance of the spiritual and psychological state of the patient.

Methodology: A descriptive study carried out in the Hospital of the city of Elbasan in the period January 2022-January 2023 referring to the questionnaires made to the patients before the surgical intervention.

Results: The questionnaires of 145 patients admitted to the hospital during the year 2022 were used. Of these, 87 men and 58 women. 95 patients express a state of anxiety and fear, while the other 50 are calm. of which 45 are men and 50 are women. After the conversation and information,

101 are confident about the surgical intervention, while 44 express fear for the post-operative period. Fear of pain and discomfort is almost a universal feeling and it has to do with the fear of pain before and after surgery.

Conclusions: As a conclusion, we say that the nurse's role in calming the patient from preoperative fear and anxiety depends on the knowledge he has about fear and anxiety, the tasks and the role as a nurse, since nursing care is a reflection of health care. We are the first to face the patient and family members.

Keywords: Intervention, Post-Operative, Psychological State, Anxiety.

VLERËSIMI I STILEVE ‘LEADERSHIP’ NË INFERMIERINË SHQIPTARE*Eriola Grosha¹**“Zoja e Keshillit të Mirë”¹**e.grosha29@gmail.com***ABSTRAKT**

Koncepti i lidërshiptit i aplikuar në menaxhimin infermieror është një temë e re në literaturën shqiptare të infermierisë, por me interes të madh ndërkombëtar. Udhëheqja brenda një fuqie të madhe punëtore siç është infermiera kërkon që drejtuesi i infermierisë të ketë përvojë në profesionin e infermierisë së bashku me aftësi drejtuese për të ruajtur konkurrencën në industrinë komplekse të kujdesit shëndetësor.

Obiektivat

Ky studim hulumton stilin e lidërshiptit në rolet menaxheriale të infermierisë. Objektivi i këtij studimi është të marrë të dhëna mbi karakteristikat specifike të stilit të lidërshiptit të përdorur në Shqipëri. Pyetësi “Blake and Mouton” na inkurajon të mendojmë për stilin e udhëheqjes dhe efektet e tij në produktivitetin dhe motivimin e kampionit tonë.

Metodologjia

Sondazhi u krye duke përdorur pyetësin “Blake and Mouton” tek 407 drejtues dhe koordinatorë të infermierisë në territorin e Shqipërisë gjatë periudhës Qershor-Shtator 2022.

Rezultatet

Bazuar në rezultatet e studimit kampioni i marrë në konsideratë i përket stilit 9.9. Team leader

(9.9) - ka një ndjeshmëri të lartë për personat dhe për arritjen e qëllimeve organizative.

Shumica e pjesëmarrësve të studimit konfirmojnë se vetëm integrimi i shqetësimit për prodhimin dhe njerëzit mund të japë rezultate pozitive dhe të arrijë vizionin e tyre të lidërshiptit. Drejtuesit komunikojnë me punonjësit, ndajnë idetë dhe u japin atyre lirinë e veprimit. Problemet zgjidhen në një konfrontim të drejtpërdrejtë të grupeve të ndryshme dhe ofrojnë zgjidhje të drejta të pranueshme, marrëveshje dhe negociata menjëherë për të gjithë.

Konkluzionet

Ky është një nga studimet e para shqiptare mbi rëndësinë e stilit të lidërshiptit për përmirësimin e cilesisë në punë. Transformimi i sistemit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe sfidat nënvizojnë rëndësinë e sigurimit që infermierët të jenë drejtues efektivë në nevojat organizative për të ardhmen. Vlefshmëria e studimit duhet të vërtetohet nga studime të mëtejshme. Kompetencat e stilit mund të përmiresohen në programet e edukimit të infermierisë dhe të përdoren si parametër vlerësimi gjatë përzgjedhjes së menaxherëve të infermierisë.

Fjalë kyçe: lidërshipt infermieror, vetëvlerësim, stile lidërshipti, infermiere, vlerësim, vizion,

THE EVALUATION OF THE LEADERSHIP STYLE OF ALBANIAN NURSES

Eriola Grosha¹

Nurse at Lady of the Good Counsel

e.grosha29@gmail.com

ABSTRACT

The concept of leadership applied to nursing management is a new topic in Albanian nursing literature, but of great international interest. Leadership within a large workforce such as nursing requires the nurse manager to have experience in the nursing profession along with leadership skills to remain competitive in the complex healthcare industry.

Objectives

This study investigates leadership style in nursing managerial roles. The objective of this study is to obtain data on the specific characteristics of the leadership style used in Albania. The Blake Mouton Questionnaire encourages us to think about leadership style and its effects on the productivity and motivation of our sample.

METHODOLOGY

The survey was conducted using the Blake and Mouton questionnaire among 407 managers and nursing coordinators in the territory of Albania during the period June-September 2022.

Findings

Based on the results of the study, the sample considered belongs to style 9.9. Team leader

(9.9) - has a high sensitivity for people and for the achievement of organizational goals.

Most of the study participants confirm that only the integration of concern for production and people, can give positive results and achieve their leadership vision. Leaders communicate with employees, share ideas and give them freedom of action. Problems are solved in a direct confrontation of different groups and offer just acceptable solutions, agreements and negotiations immediately for all.

CONCLUSIONS

This is one of the first Albanian studies on the importance of leadership style for improving quality at work. The transformation of the health care system in Albania and the challenges underline the importance of ensuring that nurses are effective leaders in organizational needs for the future. The validity of the study needs to be verified by further studies. Style competencies can be improved in nursing education programs and used as an evaluation parameter during the selection of nursing managers.

Keywords: nursing leadership, self-esteem, leadership styles, nurse, assessment, vision

SINDROMI I BURNOUT-IT AKADEMIK TEK STUDENTËT E FAKULTETIT TË SHËNDETIT, VLORË

Msc. Erlini Kokalla¹, Ph.Dc. Brunilda Subashi, Msc. Lejdi Fetahu, Msc. Marjola Muhaj

¹ *Personi i kontaktit: Erlini Kokalla, Specialist i Shëndetit Publik, Vlorë
Universiteti "I.Qemali", Vlorë
Cel. 0694782283
e-mail: erlinikokalla@gmail.com*

ABSTRAKT

Hyrje: Burnout-i, edhe pse i cilësuar si një 'fenomen okupacional', duket se po merr një vëmendje të rëndësishme jo vetëm në mjedisin e punës, por edhe atë akademik, duke i bërë kështu studentët, target të të ashtuquajturit burnout-i akademik. Ky fenomen përkufizohet si një reagim negativ emocional, fizik dhe mendor, për shkak të studimit të zgjatur që rezulton në rraskapitje, zhgënjim, mungesë motivimi dhe reduktim të aftësive të studentëve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i sindromit të burnout-it akademik tek studentët e fakultetit të Shëndetit (infirmieri dhe infermieri-mami), në qytetin e Vlorës.

Metodologjia: Studimi është kros-seksional dhe përfshin 258 studentë të anketuar gjatë muajve mars-qershor 2023. Të dhënat janë grumbulluar duke përdorur një pyetësor dy-pjesësh;

Informacioni i përgjithshëm për përcaktimin e karakteristikave socio-demografike, profilin akademik dhe aspekte interpersonale;

Shkalla e burnout-it akademik të Bresos për matjen e nivelit të burnout-it akademik, përmes 3 dimensioneve të tij (rraskapitja emocionale, cinizmi dhe efikasiteti akademik). Normaliteti i shpërndarjes së të dhënave është vlerësuar përmes testit Kolmogorov-Smirnov. Testet jo-parametrike Mann-Whitney U dhe Kruskal-Wallis janë aplikuar për vlerësimin e dimensioneve të burnout-it sipas karakteristikave të përgjithshme. Në të gjitha rastet u konsiderua statistikisht sinjifikative një vlerë e $p \leq 0.05$.

Rezultate: Sindromi i burnout-it akademik u evidentua në 22.1% të studentëve të përfshirë në studim. Përsa i përket 3 dimensioneve të burnout-it, 32.6 % e studentëve rezultuan me nivele të larta të rraskapitjes emocionale, 62.8% me nivele të larta të cinizmit dhe 53.9% e studentëve me nivele të ulëta të efikasitetit akademik. Studentët që kanë shprehur një interes të lartë për degën e studimit, rezultojnë të kenë nivele më të larta të efikasitetit akademik. ($p=0.002$)

Konkluzione: Dimensionet e sindromit të burnout-it akademik evidentohen ndjeshëm tek studentët e infermierisë dhe infermieri-mamisë në Fakultetin e Shëndetit, prandaj është i rëndësishëm krijimi i një sistemi universitar bashkëpunues për të nxitur motivimin dhe reduktuar faktorët e mundshëm të burnout-it.

Fjalë kyçe: Burnout-i akademik, studentët e infermierisë, studentët e mamisë, rraskapitje, cinizëm, efikasiteti akademik.

ACADEMIC BURNOUT SYNDROME AMONG NURSING AND MIDWIFERY STUDENTS AT THE FACULTY OF HEALTH

Msc. Erlini Kokalla¹, Ph.Dc. Brunilda Subashi, Msc. Lejdi Fetahu, Msc. Marjola Muhaj

*¹Contact person: Erlini Kokalla, Public Health Specialist, Vlore
University of Vlora "Ismail Qemali"
Cel. 0694782283
e-mail: erlinikokalla@gmail.com*

ABSTRACT

Background: Burnout, although described as an 'occupational phenomenon', seems to be receiving significant attention not only in the work but also in the academic environment, thus making students the target of so-called academic burnout. This phenomenon can be defined as a negative emotional, physical and mental reaction to prolonged study that results in exhaustion, frustration, lack of motivation and reduced of students' abilities.

Purpose: The purpose of this study is to assess the academic burnout syndrome in nursing and midwifery students at the Faculty of Health.

Methodology: The study is cross-sectional and includes 258 students surveyed during March-June 2023. The data were collected using a two-parts questionnaire; 1.General Information Form to determine the socio-demographic characteristics, academic profile and interpersonal aspects; and 2. Bresso's academic burnout scale for measuring the level of academic burnout, through its 3 dimensions (emotional exhaustion, cynicism and academic efficacy). The normality of the data was assessed through the Kolmogorov-Smirnov test. The non-parametric Mann-Whitney U and Kruskal-Wallis tests were used for the assessment of burnout dimensions according to general characteristics. In all cases, a value of $p \leq 0.05$ was considered statistically significant

Results: The results showed that the prevalence of academic burnout syndrome was 22.1% among the surveyed. Regarding the 3 dimensions of burnout, about 32.6% of students had high level of emotional exhaustion, 62.8% of students had high level of cynicism, and 53.9% of students suffered from low levels of academic efficacy. Students with high interest in the study field, turn out to have higher levels of academic efficiency($p=0.002$).

Conclusions: Considering that the presence of the academic burnout dimensions is significantly encountered among nursing and midwifery students in the Faculty of Health, the university should establish a cooperative system to motivate students and to reduce the factors of burnout.

Key words: Academic Burnout, nursing students, midwifery students, exhaustion, cynicism, academic efficacy, score.

“PËRDITËSIMI I PROTOKOLLIT INFERMIEROR NË ONKOLOGJI”

Msc Raimonda Lalaj¹; Msc Erald Cocka²; Prof.Dr. Pirro Prifti

*¹Kryeinfermiere Sherbimi Onkologjik QSUNT, Anëtare e BSH KSHI, Pedagoge M.Barleti
mondalalaj@gmail.com*

*²Drejtuësi i KSHI, Pedagog FSHMT, Infermier ICU Stroke Unite,
eraldcocka@kshi.al*

ABSTRAKT

HYRJE: Onkologjia është një shërbim sa sfidues aq edhe interesant,sa i mbushur me shumë sfida të vështira aq edhe dinamik dhe i shumëllojshëm sidomos në aspektin e veprimtarisë profesionale të personelit infermieror.E në fakt tërësia e këtyre manipulimeve e bën komplekse dhënien e kujdesit infermieror në këtë specialitet.Që të realizohet një shërbim sa më adekuat,patjetër që duhet domosdoshmërisht krijimi i disa standarteve (protokolleve) dhe zbatimi i tyre.

OBJEKTIVA: Standartizimi i serisë së manipulimeve infermiere,përshtatja e protokolleve ndërkombëtare dhe homogjenizimi i tyre me standartet e kërkuara edhe për në sistemin tonë shëndetësor. Nëpërmjet këtij punimi shkencor është në objektivat tona edhe nxitja e kolegëve që punojnë në onkologji për përditësim të vazhdueshëm të standarteve,sepse edhe shkenca mjekësore në vazhdim hera herës sjell vërtetime shkencore që mund të bien ndesh me ato ‘te parat’.Rëndesi ka sensibilizimi,parandalimi ne perditsimin e protokollit.

METODOLOGJIA: Eksperienca mbi 40 vjecare si Infermiere dhe Kryeinfermiere në këtë shërbim më jep një qasje reale dhe konstruktive sa i përket protokolleve infermiere në onkologji.Në këtë material shkencor janë të përmbledhura edhe të gjitha shënimet e mia që kam mbajtur me shkrim për thujse 40 vjet.

KONKLuzionet: Në disa periudha kohore është parë e nevojshme përditësimi i protokolleve të veprimtarisë infermiere si një domosdoshmëri për të qënë koherent me zhvillimet shkencore në mjekësi.Vlen shumë për tu theksuar gjithashtu, që materialet e reja janë përvetësuar mirë nga personeli , gjë që është reflektuar në një shërbim shumë më cilësor dhe adekuat,në një feedback pozitiv karshi pacientit.

Fjalë kyce: Onkologji, Infermier,protokolle, edukim, standarte, sensibilizim, parandalim.

"UPDATING THE NURSING PROTOCOL IN ONCOLOGY"

MSc Raimonda Lalaj¹; Msc Erald Cocka²; Prof.Dr.Pirro Prifti.

*¹Chief Nurse of the QSUNT Oncology Service, Member of the BSH KSHI, Lecturer M.Barleti
mondalalaj@gmail.com*

²Head of KSHI, FSHMT Lecturer, ICU Stroke Unit Nurse, eraldcocka@kshi.al

ABSTRACT

INTRODUCTION: Oncology is a service as challenging as it is interesting, as full of many difficult challenges as it is dynamic and diverse, especially in terms of the professional activity of the nursing staff. In fact, the entirety of these manipulations makes the delivery of nursing care complex in this specialty. In order to provide the most adequate service, it is definitely necessary to create some standards (protocols) and implement them.

OBJECTIVE: Standardization of the series of nursing manipulations, adaptation of international protocols and their homogenization with the standards required for our health system. Through this scientific paper, one of our objectives is also to encourage colleagues who work in oncology to continuously update standards, because even ongoing medical science sometimes brings scientific proofs that may conflict with the 'first' ones. The importance is awareness, preventing the protocol from being updated.

METHODOLOGY: Over 40 years of experience as a Nurse and Head Nurse in this service gives me a real and constructive approach regarding nursing protocols in oncology. All my written notes that I have kept for almost 40 years are summarized in this scientific material. .

CONCLUSIONS: In some periods of time, it has been deemed necessary to update nursing activity protocols as a necessity to be coherent with scientific developments in medicine. It is also worth noting that the new materials have been well acquired by the staff, which has been reflected in a much better quality and adequate service, in a positive feedback towards the patient.

Keywords: Oncology, Nursing, Protocols, Education, Standards, Awareness, Prevention.

“ROLI I INFERMIERIT GJATË PANDEMIVE, INCIDENTEVE DHE FATKEQËSIVE NATYRORE DHE SISTEMI I TRIAZHIMIT”

Albert Husha, Alma Gjylaci.

ABSTRAKT

Hyrje: Në dekadën e fundit, 2.6 miliardë njerëz në mbarë botën janë prekur nga tërmetet, përmytjet, uraganet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Për më tepër, Shqipëria është gjithashtu e ndjeshme ndaj emergjencave kimike, biologjike, radiologjike dhe fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga njeriu. Rreziqet e fatkeqësive në Shqipëri komplikohen më tej dhe lidhen me ndryshimin e kushteve demografike dhe socio-ekonomike, urbanizimin e paplanifikuar dhe zhvillimin brenda zonave me rrezik të lartë, degradimin e mjedisit, ndryshimet klimatike, rreziqet gjeologjike, epidemitë dhe pandemitë. Është e qartë se të gjitha këto kontribuojnë në një situatë ku fatkeqësitë kërcënojnë seriozisht ekonominë e Shqipërisë, popullsinë e saj dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Metodologjia: 1-Cikli i menaxhimit të fatkeqësive, 2-Rolet e infermierit në pandemi dhe sëmundje të tjera infektive; 3- Triazhi në raste fatkeqësie.

Zbutja e fatkeqësive fillon me identifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin e fatkeqësive të mundshme. Për shembull, vendet e sheshta gjeografike janë të prirura për përmytje kur reshjet janë të mëdha. Ndërtimi i strukturave të tilla si kanalet kulluese, urat apo një diga mund të ndihmojë në uljen e ndikimit të një fatkeqësie. Përpara se të ndodhë një fatkeqësi, në fazën e parapregatitjes, infermieri mund të ndihmojë në zhvillimin e planeve të reagimit dhe pergjigjes se pare ne momentin qe do te ndodhe fatkeqesia dhe të merrni pjesë në praktika, drille, trajnime që ndihmojnë në testimin e planeve dhe simulimin e fatkeqësive reale.

Resultatet: Një faktor i rëndësishëm në reagimin ndaj fatkeqësive janë operacionet e kërkim-shpëtimit. Për shembull, një shpërthim zjarri zakonisht shkakton dëme të pronës. Përveç shuarjes së zjarrit, është e nevojshme edhe ndërtimi i strehimoreve për personat e zhvendosur. Duke qene se prioriteti i kujdesit ndryshon nga pacienti në pacient në varësi të ashpërsisë së gjendjes. Vendimmarrja e saktë është kritike në këtë fazë të menaxhimit të fatkeqësive, duke e bërë të menduarit kritik një aftësi thelbësore për infermierët.

Konkluzionet: Duhet të bëjmë të mirën më të madhe për shumicën e pacienteve, pra të shpëtojmë numrin më të lartë të të mbijetuarve në një incident. Trajtimi i fatkeqësive nuk është një triazhim rutinë i përditshëm ku cdo dite infermieri bën më të mirën për çdo individ.

Fjalë kyçe: Infermier, Pandemi, Fatkeqësi Natyrore, Emergjencia kimike, Sistemet e Triazhit.

"THE ROLE OF THE NURSE DURING PANDEMICS, INCIDENTS AND NATURAL DISASTERS AND THE TRIAGE SYSTEM"

Albert Husha, Alma Gjylaci.

ABSTRACT

Introduction: In the last decade, 2.6 billion people worldwide have been affected by earthquakes, floods, hurricanes and other natural disasters. In addition, Albania is also vulnerable to chemical, biological, radiological and other man-made disasters. Disaster risks in Albania are further complicated and related to changing demographic and socio-economic conditions, unplanned urbanization and development within high-risk areas, environmental degradation, climate change, geological hazards, epidemics and pandemics. It is clear that all these contribute to a situation where disasters seriously threaten Albania's economy, its population and sustainable development.

Methodology: 1-Disaster management cycle, 2-Nurse roles in pandemics and other infectious diseases; 3- Triage in cases of disaster. Disaster mitigation begins with hazard identification and assessment of potential disasters. For example, geographically flat countries are prone to flooding when rainfall is heavy. Building structures such as drainage channels, bridges or a dam can help reduce the impact of a disaster. Before a disaster occurs, in the preparedness phase, the nurse can help develop response and first response plans when the disaster occurs and participate in practices, drills, training that help test the plans and simulation of real disasters.

Results: An important factor in disaster response is search and rescue operations. For example, a fire outbreak usually causes property damage. In addition to extinguishing the fire, it is also necessary to build shelters for the displaced persons. Since the priority of care varies from patient to patient depending on the severity of the condition. Accurate decision making is critical at this stage of disaster management, making critical thinking an essential skill for nurses.

Conclusions: We must do the greatest good for the most patients, save the highest number of survivors in an incident. Disaster management is not a routine daily triage that the nurse does every day the good for each individual.

Keywords: Nurse, Pandemic, Natural Disaster, Chemical Emergency, Triage Systems.

“NDËRLIKIMET E HERSHME NË PERIUDHËN POST-OPERATORE”

*K. Vakefliu MSc^{*1,2}, B. Kaleci PhD¹, M. Prapa PhD¹, E. Vakefliu³ M. Agolli MD/PhD⁴*

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri.

² Blloku Operator Sherbimi Kirurgji e Përgjithshme dhe Digjesticive III, QSUT, Tiranë, Shqipëri.

³ Shërbimi Pneumologjisë, Spitali Rajonal Durrës, Durrës, Shqipëri.

⁴ Shërbimi Kirurgji e Përgjithshme I, QSUT, Tiranë, Shqipëri.

ABSTRAKT

Hyrje: Ndërlikimet e hershme postoperatore përbëjnë moment tepër delikat për sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë pas ndërhyrjes. Aftësia për të minimizuar, njohur dhe trajtuar në mënyrë efektive këto probleme është thelbësore për rezultate positive postoperatore. Qëllimi i studimit është evidentimi i faktorëve kryesorë shkaktar për ndërlikime të hershme postoperatore dhe korrelacioni i komplikacioneve me diagnozën kirurgjikale.

Metodologjia: Në këtë studim janë analizuar të dhënat në dhomën e zgjimit për 40 raste të shtruar dhe operuar në Sherbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme dhe Digjesticive III (QSUT). Pacientet janë pëfshirë në studim në mënyrë rastësore. U analizuan të dhëna kuantitative dhe semikuantitative të SNQ, sistemin kardiovaskular, respirator dhe sistemi renal.

Instrumentat: Monitor pacienti Mindray e PM, dhe ekzaminimi, vlersimi/ opinion i ekspertit.

Rezultatet: Në rastet me zgjim të vonuar u evidentua kohë e zgjatur e ndërhyrjes kirurgjikale. Nga të dhënat e sistemit kardiovaskular 12% të rasteve manifestojnë çrregullime si rritje të tensionit arterial, çrregullime të rritmit, frekuencës me fibrilacion arterial dhe ekstrasistola ventrikulare. Përsa i përket aktivitetit respirator dhe renal u paraqit në gjëndje normale. Në vlerësimin postoperator të plagës u evidentuan vetëm 5% e rasteve me hemoragji.

Diskutime: Ndërlikimet respiratore lidhen me ventilacionin mekanik, esencialisht me deficitin e dy funksioneve kryesore që sigurohen nga pulmoni eliminimi i CO₂ dhe oksigjenimi. Rëdësi të veçant mbart lloji i anestesizë dhe thellësia e anestesizës. Prgatitja preoperatore dhe menaxhimi medikamentoz në varësi të sëmundjeve shoqëruese ul riskun për komplikacione respiratore postoperatore.

Konkluzione: Ndërlikimet postoperatore lidhen me moshën, kohëzgjatjen e operacionit, llojin e anestesizës, veçoritë anatomike të sistemit vaskular, teknikën e hemostazës, patologjitë malinje dhe sëmundjet shoqëruese. Sidomos pacientët me patologji kardiovaskulare, pulmonare apo sistemike janë më të predispozuar për ndërlikime postoperatore. Monitorimi i parametrave jetik dhe bashkëpunimi reanimator infermier si dhe komunikimi me pacientin duhet të jetë i vazhdueshëm për të evidentuar në kohë komplikacionet.

Fjalë kyçe: Komplikacione Post-Operatore, Reintervent, Sero-Hemoragji, Hemoragji Post-Operatore, Apnoea.

“EARLY INTERACTIONS IN THE POST-OPERATIVE PERIOD”

K. Vakefliu MSc^{1,2}, B. Kaleci PhD¹, M. Prapa PhD¹, E. Vakëfliu³ M. Agolli MD/PhD⁴*

¹Faculty of Medical Sciences, Barleti University, Tirana, Albania.

²General and Digestive Surgery Service Operator Block III, QSUT, Tirana, Albania.

³Pneumology Service, Durrës Regional Hospital, Durrës, Albania.

⁴General Surgery Service I, QSUT, Tirana, Albania.

ABSTRACT

Introduction: Early postoperative complications constitute a very delicate moment for morbidity and mortality after the intervention. The ability to minimize, recognize and effectively treat these problems is essential for positive postoperative results. The purpose of the study is to identify the main causative factors for early postoperative complications and the correlation of complications with surgical diagnosis.

Methodology: In this study, the data in the recovery room for 40 cases admitted and operated on in the General and Digestive Surgery Service III (QSUT) were analyzed. The patients were included in the study in a random way. Quantitative and semiquantitative data of the CNS, the cardiovascular system, the respiratory system and the renal system were analyzed.

Instruments: Mindray ePM patient monitor, and examination, assessment/expert opinion.

Results: In cases with delayed awakening, prolonged time of surgical intervention was evident. From the data of the cardiovascular system, 12% of cases manifest disorders such as increased arterial pressure, growth disorders, frequency with arterial fibrillation and ventricular extrasystole. In terms of respiratory and renal activity, he was presented in a normal state. In the postoperative evaluation of the wound, only 5% of cases with hemorrhage were identified.

Discussions: Respiratory complications are related to mechanical ventilation, essentially to the deficit of the two main functions provided by the lungs, CO₂ elimination and oxygenation. The type of anesthesia and the depth of anesthesia are of particular importance. Preoperative preparation and drug management depending on the associated diseases reduces the risk of postoperative respiratory complications.

Conclusions: Postoperative complications are related to age, duration of surgery, type of anesthesia, anatomical features of the vascular system, hemostasis technique, malignant pathologies and associated diseases. Especially patients with cardiovascular, pulmonary or systemic pathologies are more predisposed to postoperative complications. The monitoring of vital parameters and the cooperation of resuscitators and nurses, as well as communication with the patient, must be continuous in order to identify complications in time.

Keywords: Post-Operative Complications, Reintervention, Sero-Hemorrhage, Post-Operative Hemorrhage, Apnea.

ROLI I INFERMIERIT NË SHËNDETIN PUBLIK¹,Msc. Kaltrina Buzhala¹Departamenti i Menaxhiment Shëndetësor, Fakulteti i Infermierisë Universiteti “AAB” Prishtinë

* buzhalakaltrina@outlook.com

ABSTRAKT

Roli i infermierit si rol kyç në shërbimin dhe promovimin shëndetësor sidomos përgjatë dhe pas pandemisë COVID-19 përbën një ndër temat më aktuale në suazat e shkencave infermiore. Cilat janë politikat e duhura në promovimi dhe dukimin shëndetësor dhe si qëndrojnë në këtë aspekt organizata botërore përbën po ashtu një çështje me rëndësi thelbësore.

Për një kohë të gjatë termi “promovim shëndetësor” është përfshirë në kuadër të praktikave të përbashkëta të mjekësisë parandaluese kurse sot ky term ka një përdorim më të gjerë, si një shtesë në kuadër të shumëneve.

Qëllimi: A ekziston një ndarje konkrete mes asaj që ne njohim si edukim dhe promovim dhe cila është më e efikase, njëra apo tjetra? Përmes këtij hulumtimi synohet që të vihet në pah se:

- Cili është nënkuptimi i termit ‘promovim shëndetësor’ ?
- Si arrihet edukimi përmes promovimit shëndetësor në suaza të shëndetit publik dhe jo vetëm ?
- Cila është mbivendosja ndërmjet dy linjave edukim-promovim shëndetësor?
- Sa e efikase janë politikat e organizatave si OBSH në promovime ?

Metodologjia: Përmes këtij punimi përveç të tjerash synohet që me metodologjinë e hulumtimit, krahasimit të të dhënave, metodologjia e statistikave dhe krahasimit statistikor duke u bazuar edhe kronologjikisht të jepen disa definime dhe konkluzione të cilat bëjnë të njohur rezultatet e promovimit dhe edukimit shëndetësor.

Rezultate: OBSH liston pesë parime kryesorë në këtë drejtim ndër të cilat përfshin popullatën si një tërësi, në të cilën publiku ka një pjesëmarrje efektive. Po e njëjta ka zhvendosur definimin e ‘promovim’-it larg nga termi fillestar i viteve të 80-ta, duke e specifikuar si : Parandalim i sëmundjeve specifike dhe zbulimin e grupeve të rrezikuara. (Shih. Turjaka A. Kujdesi parësor shëndetësor dhe komuniteti 2011, fq.17-19.)

Konkluzion: Duke nisur nga hulumtimet e terminologjisë së viteve 80-të e deri tek problemet moderne që hasen në promovim dhe edukim shëndetësor publik, duke u bazuar edhe në vetë pandeminë dhe çasjen publike kundrejt pandemisë COVID-19, arrijmë në konkluzionin se promovimi dhe edukimi shëndetësor publik luajnë një rol shumë të madh fillimisht në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive apo edhe kronike e po aq me rëndësi ky promovim theksohet edhe tek shërimi dhe mirëqenia e përgjithshme e popullatës si tërësi. Përmes zbatimit të politikave shtetërore të promovimit arrihet qëllimi I edukimit shëndetësor publik, kur politikat janë hartuar bazuar në eksperiencat e popullit përballë pandeimeve dhe sëmundjeve kronike.

Fjalët kyçe: Shëndeti Publik, Promovim, Edukim shëndetësor, Politikat shëndetësore.

THE ROLE OF THE NURSE IN PUBLIC HEALTH

*I, MSc. Kaltrina Buzhala**

1 Department of Health Management, Faculty of Nursing, University "AAB" Prishtina

buzhalakaltrina@outlook.com

ABSTRACT

The role of the nurse as a key role in health service and promotion, especially during and after the COVID-19 pandemic, is one of the most current topics in nursing sciences. What are the appropriate policies in health promotion and appearance and how do organizations stand in this regard? world is also a matter of fundamental importance.

For a long time, the term "health promotion" has been included within the common practices of preventive medicine, while today this term has a wider use, as an addition within many professions.

Purpose: Is there a concrete division between what we know as education and promotion and which is more efficient, one or the other? Through this research, it is intended to highlight that:

- What is the meaning of the term 'health promotion'?
- How is education achieved through health promotion in terms of public health and not only?
- What is the overlap between the two health education-promotion lines?
- How efficient are the policies of organizations like WHO in promotions?

Methodology: Through this paper, among others, it is intended that with the methodology of research, data comparison, the methodology of statistics and statistical comparison, based also chronologically, some definitions and conclusions are given which make known the results of health promotion and education.

Results: The WHO lists five main principles in this regard, including the population as a whole, in which the public has an effective participation. This has also shifted the definition of 'promotion' away from the original term of the 80s. , specifying it as: Prevention of specific diseases and detection of vulnerable groups. (See Turjaka A. Primary health care and community 2011, pp. 17-19.)

Conclusion: Starting from the terminology research of the 80s to the modern problems encountered in public health promotion and education, based on the pandemic itself and the public response to the COVID-19 pandemic, we come to the conclusion that promotion and education public health plays a very large role initially in preventing the spread of infectious or even chronic diseases, and this promotion is equally important in the recovery and general well-being of the population as a whole. Through the implementation of state promotion policies, the goal of education is achieved public health, when the policies are designed based on the people's experiences in the face of chronic illnesses and diseases.

Keywords: Public Health, Promotion, Health Education, Health Policies.

USHQYERJA PARENTERALE TEK TË LINDURIT NË PRETERM

Joniada Kalthi

Kryeinfirmiere, Spitali Amerikan 3

ABSTRAKT

HYRJE: Ushqyerja parenterale totale eshte nje nder terapite me efektive e cila ka gjetur zhvillim qe prej vitit 1960. Ushqyerja parenterale perdoret ne rastin e pacienteve te cilet nuk mund te ushqehen nga trakti gastrointestinal, si pasoje e patologjive infantile apo prematuritetit.

Objektivat: Te arrijme te evidentojme komplikacionet dhe te kujdesemi per linjen venoze.

Materiali dhe Metodikat: Ne kete studim ne morem rastet e bebeve te lindur nga periudha qershor 2011-qershor 2015, te cilet gjate diteve te para te jetes kishin nevojte per UP per me shume se 3 dite. Bebet u ndane ne 3 grupe: ELBW; VLBW; LBW. Per secilin grup ne analizuam humbjen mesatare te peshes ne dite, mesataren e dites se jetes kur rifituan peshen e lindjes, mesataren e diteve total me UP dhe mesataren e dites se jetes kur u fillua ushqyerja enterale(UE).

Rezultatet: Ne total u perfshine 29 femije te cilet gjate diteve te para te jetes u vendos kateteri umbilikal dhe moren UP. Per bebet ELBW (gjithseje 2) humbja mesatare ne peshe ishte 16 g/dite; numri mesatar i diteve me UP ishte 9.5 dite , ata rifituan peshen e lindjes pas 10.5 ditesh. Te dy rifilluan UE ne ditin e 3-te te jetes. Per grupin VLBW (total 9 raste) humbja mesatare ne peshe ishte 9.6g/dite, numri mesatar i diteve ne UP ishte 6.5 dite, rifitimi i peshes se lindjes mesatarisht ishte pas 8 ditesh; UE u nis mesatarisht ne ditin e 1.4 te jetes. Per bebet LBW (total 18 raste) humbja mesatare ne peshe ishte 8.2 g/dite; numri mesatar i diteve ne UP ishte 4.5 dite; rifitimi i peshes se lindjes pas mesatarisht 6.2 ditesh; fillimi i UE ne ditin pare te jetes.

Konkluzion: Duke u bazuar ne eksperiencen nder vite ne spitalin tone UP ka rezultuar pothuajse gjithmone efektive dhe komplikacionet kane qene te pakta dhe pa rrezikshmeri.

Fjalë kyçe : ushqyerja parenterale, prematuriteti, kateteri umbilikal.

AN OVERVIEW OF OUR EXPERIENCE IN PARENTERAL NUTRITION OF THE PRETERM NEWBORN

Joniada Kalthi

Head Nurse, American Hospital 3

ABSTRACT

Background: PN is one of the most effective therapies since 1960. PN is used in babies who cannot be enterally fed because of prematurity or different pathologies.

Aim of study: effectiveness of parenteral nutrition in premature babies born in our hospital during June 2011- June 2015

Methods: we included in this study babies born from June 2011- June 2015 that during the first days of life needed PN for more than 3 days. We divided them in three groups ELBW; VLBL; and LBW . For each group we analyzed the mean daily weight loss, the mean day of regaining of the birthweight; the mean number of days that they took any parenteral nutrition and the mean day of starting the enteral feeding.

Results: A total of 29 infants which during the first hours of life needed umbilical catheterisation and took total or partial PN were enrolled. For babies ELBW (total of 2 cases) the mean daily weight loss was 16 g/day; the mean number of days on PN was 9.5 days. They regained birth-weight after 10.5 days. Both of them were started trophic feeds on day 3 of life. On their follow up we noticed that they doubled their birth-weight after 2.8 months. For VLBW group (a total of 9 cases) the mean daily weight loss was 9.6 g/day; the mean number of days on parenteral nutrition was 6.5 days; they regained birth weight after 8 days ; enteral feeds were introduced on 1.4 days of life; For babies LBW (a total of 18 cases) the mean daily weight loss was 8.2 g/day; the mean number of days in PN was 4.5 days; enteral feeding was introduced on day 1 of life; they regained birth weight after 6.2 days.

Conclusions: in our experience, short term administration of PN (less than 2 weeks) was found to be safe.

Keywords: *parenteral nutrition, preterm newborn, umbilical catheterisation.*

TERAPIA VAC NË TRAJTIMIN DHE MENAXHIMIN E TRAJTIMIN E PLAGËVE*M.Sc. Lutfi Lami k/inf SRD, Lector UAMD, Medical Care Lami Director**Msc Blerim Maloku K/inf Medical Care Lami***ABSTRAKT**

Evolucioni i shkencës nga pikëpamja diagnostike dhe terapeutike, përvoja në terren, kontaktet e vazhdueshme në trajtimin e plagëve ecuria dhe evidentimi i faktoreve negative dhe pozitiv në trajtimin dhe vlerësimin e plagëve krahasimisht me metodat e tjera alternative ka klasifikuar terapinë VAC si një nga mekanizmat më të mirë në shërimin e plagëve e cila do të jete një nga prioritetet e zhvillimit si një nga modalitetet më të avancuara të trajtimit të plagëve kronike dhe akute shërimi i vonuar i plagëve veçanërisht në plagët e veshitura, kronike dhe akute të shoqeruara edhe me mbivendosje të diagnozave dytesore çon në rritjen e intesitetit të dhimbjeve, rritje të riskut dhe të komplikacioneve, trajtim të zgjatur dhe rritje të kërkesave për kirurgji të mëdha rindërtuese që imponojnë një barrë të madhe sociale dhe financiare.

Mbyllja me vakum (VAC) është një metodë alternative e menaxhimit të plagës, e cila përdor presionin negativ për të përgatitur plagën për shërim spontan ose me opsione më të vogla rindërtuese. Metoda e aplikimit të VAC përfshin komprimim të plotë, hemostazë adekuate dhe aplikim të veshjes me shkume sterile. Një tub i mbështjellë është futur në shkumë dhe plaga mbyllet me shirit ngjitës për ta bërë atë të ajrosur. Tubi bashkues është i lidhur me një pompë vakum me enë grumbullimi të lëngjeve. Makina jep thithje të vazhdueshme ose me ndërprerje, që varion nga 50 në 125 mmHg. Veshjet VAC ndërrohen në ditën e tretë. Terapia me presion negativ stabilizon mjedisin e plagës, zvogëlon edemën e plagës/ngarkesën bakteriale, përmirëson perfuzionin e indeve dhe stimulon indin e granulimit dhe angiogjenezën. Terapia VAC duket të jetë një e thjeshtë dhe më efektive sesa veshjet konvencionale për menaxhimin e plagëve të veshitura për sa i përket reduktimit të vëllimit të plagës, thellësisë, kohëzgjatjes së trajtimit dhe koston.

Objektivat: Për të vlerësuar efektet e NPWT në plagët kirurgjikale (mbyllja primare, transplantimi i lëkurës ose mbyllja me flap) që pritet të shërohen nga qëllimi parësor. Njohja me sistemin vac, menaxhimi dhe përdorimi i kesaj terapie inovative, avantazhet dhe disavantazhet e terapise vac.

Konkluzione: Përfitimet klinike të V.A.C. ATS trajton të gjitha përmasat e mundshme të plagëve, teknologjia T.R.A.C. dhe alarmet inteligjente ndihmojnë në garantimin e sigurisë së pacientit, Ekranin i madh I aparatit vac me prekje me udhëzuesin e përdoruesit në ekran, jastëku T.R.A.C. e bën të lehtë ndryshimin e veshjes, Kapaciteti i kontejnerit të madh 500 deri 1000ml minimizon numrin e ndryshimeve të kontejnerit. jetëgjatësia e baterisë me orë e bën transportin më të lehtë. Rehati më e madhe e pacientit, Sistemi special i filtrit minimizon erën e plagës. Zgjedhja e nivelit të intensitetit të kompresimit të veshjes Stimulon rrjedhjen e lokalizuar të gjakut dhe redukton kolonizimin bakterial duke ofruar mjedis të lagësht shërues të plagëve. Redukton edemën e lokalizuar dhe përmirëson migrimin e epitelit. Ushtron presion negativ për të tërhequr në mënyrë uniforme plagën e mbyllur (tkurrje plaje). Ofron terapi më efektive sepse presioni nën-atmosferik i synuar monitorohet dhe mbahet në saktësinë dhe efektivitetin e terapisë V.A.C. Nderhyrje me te pakte në lidhje trajtimet standarte. Numri i reduktuar i qelizave bakteriale. Ambienti i mbyllur dhe të lagësht kontrollon në mënyrë perfekte aromën dhe eksudatin. Reduktimi i nderhyrjeve kirurgjikale.

Fjalë kyçe: (NPWT); (VAC); Plagë të veshitura; Terapia e plagës me presion negativ; Veshje me presion nën-atmosferik; Mbyllje me vakum.

WOUND MANAGEMENT USING INNOVATIVE METHODS: VAC THERAPY*M.Sc. Lutfi Lami k/inf SRD, UAMD Lecturer, Medical Care Lami director***ABSTRACT**

The evolution of science from a diagnostic and therapeutic point of view, experience in the field, continuous contacts in the treatment of wounds, progress and evidence of negative and positive factors in the treatment and evaluation of wounds compared to other alternative methods has classified VAC therapy as one of the most effective mechanisms. well in wound healing, which will be one of the development priorities as one of the most advanced modalities for treating chronic and acute wounds, delayed wound healing, especially in difficult, chronic and acute wounds accompanied by overlapping diagnoses secondary leads to increased pain intensity, increased risk and complications, prolonged treatment and increased requirements for major reconstructive surgery that imposes a large social and financial burden.

Vacuum closure (VAC) is an alternative method of wound management that uses negative pressure to prepare the wound for spontaneous healing or with lesser reconstructive options. The method of VAC application includes full compression, adequate hemostasis, and application of a sterile foam dressing. A coiled tube is inserted into the foam and the wound is sealed with duct tape to make it ventilated. The coupling tube is connected to a vacuum pump with a liquid collection vessel. The machine delivers continuous or intermittent suction, ranging from 50 to 125 mmHg. VAC dressings are changed on the third day. Negative pressure therapy stabilizes the wound environment, reduces wound edema/bacterial burden, improves tissue perfusion, and stimulates granulation tissue and angiogenesis. VAC therapy appears to be a simple and more effective than conventional dressings for the management of difficult wounds. in terms of reduction in wound volume, depth, treatment duration and cost.

Objectives: To assess the effects of NPWT on surgical wounds (primary closure, skin graft or flap closure) expected to heal by primary intent. Familiarity with the vac system, management and use of this innovative therapy, advantages and disadvantages of vac therapy.

Conclusions: The clinical benefits of V.A.C. ATS treats all possible wound sizes, T.R.A.C. technology. and smart alarms help ensure patient safety, Large touchscreen vac display with on-screen user guide, T.R.A.C. makes dressing changes easy, Large container capacity of 500 to 1000ml minimizes the number of container changes. hours of battery life make portability easier. Greater patient comfort Special filter system minimizes wound odor Choice of compression intensity level Stimulates localized blood flow and reduces bacterial colonization by providing moist wound healing environment. Reduces localized edema.and improves epithelial migration.Exerts negative pressure to uniformly pull the wound closed (wound contraction).Provides more effective therapy because target subatmospheric pressure is monitored and maintained for the accuracy and effectiveness of V.A.C therapy..Intervention with few in relation to standard treatments. Reduced number of bacterial cells. The closed and humid environment perfectly controls the aroma and the exudate. Reduction of surgical interventions.

Keywords: (NPWT); (VAC); Difficult wounds; Negative pressure wound therapy; Sub-atmospheric pressure coating; Vacuum sealing.

ROLI I MAMIVE DHE KUJDESI QË OFROHET PËR ABORTIN NË MATERNITETIN E KORÇËS

Delantina Mulla

Presidente e Urdhërit të Infermierit, Qarku Korçë

ABSTRAKT

Në ditët e sotme advokacia, përgjegjshmëria, bashkëpunimi dhe kujdesi janë koncepte që mamitë po ofrojnë gjithnjë e më shumë për gratë dhe vajzat për të përmirësuar aksesin e tyre në shëndetin seksual, riprodhues dhe për një abort të sigurt. Gjithashtu mamitë kanë qënë në ballë të ndryshimeve individuale dhe sociale duke dhënë një kujdes, përfshirë edhe kujdesin për abortin për vajzat adoleshente, gratë të cilat kanë të drejtë të lindin në çdo fazë të jetës së tyre. Duhet theksuar se legjislacioni i përshtatshëm është një masë paraprake e rëndësishme për të pasur një abort të përhershëm dhe të sigurt nga pikëpamja mjekësore sidomos për një kategori që jetojnë në varfëri, me identitete të marginalizuara racore dhe etnike, adoleshentet dhe ato që jetojnë në zona rurale.

Mamitë në Maternitetin e Korçës janë të arsimuara dhe me standarte në edukimin në vazhdimësi për të kryer shërbime kompetente, gjithëpërfshirëse dhe të sigurt në lidhje me abortin.

Dhënia dhe marrja e informacionit është parandalimi i vetëm i komplikacioneve. Informacionet e dhëna mbi planifikimin familjar, rëndësinë e tij dhe përdorimi i masave kontraceptive shmangin një shtatzëni të padëshiruar dhe për pasojë abortin.

Qëllimi i studimit është marrja e informacionit dhe paraqitja e të dhënave rreth abortit, llojeve të tij dhe pasojave. Duke parë ndikimin e faktorëve si niveli i arsimimit, moshë e madhe në martesën e parë dhe moshë në shtatzëninë e parë çojnë në rritjen e mundësisë për abort spontan duhen marrë gjithmonë masa për kujdes më të madh, ndërgjegjësim dhe edukim për vajzat dhe gratë. Planifikimi familjar, ekzaminimet dhe konsultat e here pas hershme me mjekun gjinekolog, shmangin dështimin e shtatzënisë, komplikacionet e saj dhe infertilitetin e vajzës apo gruas.

Ky studim u krye për periudhën janar 2019 deri në muajin dhjetor të vitit 2022 në Maternitetin e Korçës. Të dhënat e paraqitura u morrën nga dokumentacioni i pavionit të gjinekologjisë dhe kartotekës së Maternitetit. Ndërtimi i grafikëve është bërë sipas llojeve të aborteve, grup moshave, vendbanimit, nivelit arsimor dhe nëse lishin pasur aborte të mëparshme.

FJALË KYÇE: *abort, shtatzëni e padëshiruar, planifikim familjar, konsent, infertilitet*

THE ROLE OF MIDWIVES AND THE CARE OFFERED FOR ABORTATION IN KORÇA MATERNITY

Delantina Mulla

Presidente e Urdhërit të Infermierit, Qarku Korçë

ABSTRACT

Nowadays advocacy, accountability, collaboration and care are concepts that midwives are increasingly offering to women and girls to improve their access to sexual, reproductive health and safe abortion. Midwives have also been at the forefront of individual and social change by providing care, including abortion care for teenage girls, women who have the right to give birth at any stage of their lives. It should be emphasized that appropriate legislation is an important precautionary measure to have a permanent and safe abortion from a medical point of view, especially for a category that lives in poverty, with marginalized racial and ethnic identities, adolescents and those living in rural areas.

The midwives in Korça Maternity are educated and have standards in continuing education to perform competent, comprehensive and safe services related to abortion.

Giving and receiving information is the only prevention of complications. The information given on family planning, its importance and the use of contraceptive measures avoid an unwanted pregnancy and consequently abortion.

The purpose of the study is to obtain information and present data about abortion, its types and consequences. Seeing the influence of factors such as the level of education, older age at first marriage and age at first pregnancy lead to an increase in the possibility of spontaneous abortion, measures should always be taken for greater care, awareness and education for girls and women. Family planning, examinations and frequent consultations with the gynecologist avoid pregnancy failure, its complications and infertility of the girl or woman.

This study was conducted for the period January 2019 to December 2022 in the Maternity Hospital of Korça. The presented data were obtained from the documentation of the gynecology ward and the Maternity card file. The construction of the graphs was done according to the types of abortions, age group, place of residence, educational level and if they had previous abortions.

KEYWORDS: *abortion, unwanted pregnancy, family planning, consent, infertility*

KOMUNIKIMI I DIAGNOZËS TEK PACIENTËT ME KANCER TË AVANCUAR*Elena Drenesku¹, Emisa Velo², Paola Saro³*¹ *Pedagoge, Universiteti Fan S. Noli*” Cel: 0676094211 elenadrenesku@yahoo.com² *Pedagoge, Universiteti Fan S. Noli*” Cel: 0684048799 emisavelo@yahoo.com³ *Pedagoge, Universiteti Fan S. Noli*” Cel: 0676317053 p_saro@live.com**ABSTRAKT**

Ky punim lidhet me komunikimin e diagnozës tek një pacient me kancer të avancuar e cila nënkupton një pritshmëri të ulët jetese afërsisht më pak se një vit ose më pak se 6 muaj.

Të komunikosh diagnozën në rastin e një kanceri të avancuar është një ngjarje stresuese, e vështirë dhe që ndryshon jetën e individit. Dhënia e lajmit të keq është shqetësues për pacientët, familjarët dhe shpesh është i pakëndshëm edhe për stafin mjekesor që e jep atë. Komunikimi i një diagnoze të tillë kërkon durim, aftësi shumë të mira komunikuese dhe duhet trajtuar me ndjeshmëri për të gjitha palët e përfshira. Ka disa mënyra për t'u dhënë pacientëve lajmin e keq duke përdorur teknikat dhe metodat e komunikimit ku në qendër është pacienti duke mbajtur një perspektive realiste, me një qasje fleksibël e cila është thelbësore për të plotësuar nevojat e pacientëve dhe familjarëve.

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një përmbledhje mbi dobinë e modeleve të komunikimit të lajmit të keq nga ana e infermierëve dhe se si është realisht situata në rrethin e Korçës me pacientë që vuajnë nga sëmundje terminale nëpërmjet analizimit të eksperiencës së tyre mbi mënyrën e komunikimit të diagnozës. Ka ende shumë për të bërë në praktikën infermirore për mënyrën sesi duhet t'i komunikojmë një pacienti diagnozën, stadin e sëmundjes së tij, mënyrën e trajtimit gjë që i bën këta pacientë një grup nga më të vështirët për t'u kujdesur prandaj edhe komunikimi merr vlerën e tij më të mëdhe.

Kërkimi është bazuar në hulumtim dhe është realizuar nëpërmjet intervistës me anë të pyetësorit të përgatitur e të përdorur në rrethin e Korçës. Për anketimin e pacientëve është marrë konsenti i secilit pacient apo familjar të përfshirë në studim. Pacientëve dhe familjarëve i u është dhënë informacion në lidhje me qëllimin e këtij studimi dhe secili prej tyre ka shprehur gatishëri të plotë për të qënë pjesë e tij.

Infermierët mund të mbështesin shpërndarjen e lajmit të keq duke përdorur strategjitë e komunikimit dhe për rrjedhojë të mbajnë komunikimin me pacientët dhe familjarët e tyre në mënyrë efektive dhe produktive.

FJALË KYÇE: *komunikim, lajmi i keq, kancer i avancuar, mbeshtetje psikologjike, cilësi e jetës.*

COMMUNICATION OF THE DIAGNOSIS IN PATIENTS WITH ADVANCED CANCER

Elena Drenesku¹, Emisa Velo², Paola Saro³

¹ *Pedagoge, Universiteti Fan S. Noli'' Cel: 0676094211 elenadrenesku@yahoo.com*

² *Pedagoge, Universiteti Fan S. Noli'' Cel: 0684048799 emisavelo@yahoo.com*

³ *Pedagoge, Universiteti Fan S. Noli'' Cel: 0676317053 p_saro@live.com*

ABSTRACT

This paper is related to communicating the diagnosis to a patient with advanced cancer which means a low life expectancy of approximately less than a year or less than 6 months.

Communicating the diagnosis of advanced cancer is a stressful, difficult and life-changing event for the individual. Giving bad news is distressing for patients, families, and often uncomfortable for the medical staff who deliver it. Communicating such a diagnosis requires patience, very good communication skills and must be handled with sensitivity for all parties involved. There are several ways to break the bad news to patients using patient-centered communication techniques and methods while maintaining a realistic perspective, with a flexible approach that is essential to meet the needs of patients and families.

The purpose of this paper is to provide a summary on the usefulness of the models of communication of bad news by nurses and how the situation is really in the district of Korça with patients suffering from terminal diseases by analyzing their experience on the way of communication of the diagnosis. There is still a lot to be done in nursing practice about how we should communicate to a patient the diagnosis, the stage of his disease, the way of treatment, which makes these patients one of the most difficult groups to care for, therefore communication takes its greatest value.

The research is based on research and was carried out through an interview using a questionnaire prepared and used in the district of Korça. For the patient survey, the consent of each patient or family member included in the study was obtained. Patients and family members have been given information about the purpose of this study and each of them has expressed full willingness to be part of it.

Nurses can support the delivery of bad news by using communication strategies and therefore keep communication with patients and their families effective and productive.

KEY WORDS: *communication, bad news, advanced cancer, psychological support, quality of life.*

RISHIKIMI I KURRIKULËS MAMI NË FSHMT DHE PËRSHTATJA SIPAS DIREKTIVAVE TË BE

Albana Poloska¹, Risida Gjonej¹, Blerina Duka², Erisa Grabocka³

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

²Presidente e Urdhrit Infermierit

³Universiteti Korçë “Fan.S Noli”

albana.poloska@yahoo.com

ABSTRACT

Hyrje: Misioni i kurrikulës “Mami” është të diplomojë student që kanë përvetësuar njohuri dhe aftësi profesionale në fushën e Obstetrikë -Gjinekologji, dhe do të jenë të aftë për të menaxhuar ose adresuar problematikat në sistemin shëndetësor. OBSH raporton për rritje të sëmundshmërisë, rritje e moshës amtare të lindjes së fëmijës së parë dhe mungesa e stafit bën që sistemi shëndetësor të jetë i mbingarkuar kjo sjell rritje të kostos dhe rënie të cilësisë së shërbimit. UNFPA ka si prioritet forcimin e kapaciteteve institucionale të fuqisë punëtore të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues (SHSR), si dhe forcimin e rrjeteve profesionale dhe akademike ndërmjet institucioneve dhe shoqërive rajonale dhe globale, përfshirë mamitë, në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (EECA).

Qëllimi: është rishikimi i kurrikulës dhe qasja e një programi bashkëkohor “Mami” duke e përshtatur sipas nevojave të vendit me fokus studentin për të patur personel kompetent dhe me standarte të larta profesionale në shëndetësi.

Metodologjia: Rishikimi i literaturave të huaja dhe programi në FSHMT për identifikimin e mangësive dhe implementimin e një kurrikule sa më afër direktivave të BE.

Rezultatet: Shyrtimi i literaturave të huaja të bazuara sipas direktivave të BE dhe standarteve të OBSH vendos theksin në një student të aftë të përqafoj praktikën e bazuar në evidenca, të ofroj kujdes me cilësi të lartë bazuar në të dhënat më të mira të disponueshme dhe të vlerësoj gjykimin klinik dhe preferencën e pacientit. Një vlerësim i detajuar i kurrikulës “Mami” në vendet dhe territoret e EECA lidhur me kompetencat e nevojshme për ofrimin e shërbimit (SHSR) në përputhje me udhëzimet më të fundit të UNFPA dhe OBSH është kryer në qershor – korrik 2023. Gjetjet kryesore të këtij vlerësimi nxjerrin në pah mangësitë e kompetencave të studentit dhe ulje te krediteve të lëndëve të kujdesit infermieror.

Konkluzione: Harmonizimi i kurrikulës nga vendet e ngjashme me sistemin tonë shëndetësor dhe arsimor do të sjellë një një mami kompetente që jep një qasje holistike të kujdesit.

Rekomandimet: politikat duhet të fokusohen në rritjen e përpjekjeve të avokimit kombëtar dhe rajonal për avancimin e arsimit të mamisë. Rritja e krediteve të kujdesit infermieror sjell një Mami që jep kujdes kosto-efektiv, përmirësim të cilësisë së shërbimit, pacientë të kënaqur. Për rishikimin dhe riformatimin e një kurrikule adekuate nevojitet krijimi i një grupi pune për hartimin e kurrikulave, identifikimin e nevojave të vendit dhe përshtatshërinë e një kurrikule bashkëkohore.

Fjalë kyç: kurrikul, student, Mami, aftësi,qasje,cilësi,sistem shëndetësor

REVIEW OF THE MIDWIFE CURRICULUM IN FSHMT AND ADAPTATION ACCORDING TO EU DIRECTIVES

Albana Poloska¹, Risida Gjonej¹, Blerina Duka², Erisa Grabocka³

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

²Presidente e Urdhrit Infermierit

³Universiteti Korçë "Fan.S Noli"

albana.poloska@yahoo.com

ABSTRACT

Introduction: The mission of the "Midwife" curriculum is to graduate students who have acquired knowledge and professional skills in Obstetrics-Gynecology, field and will be able to manage or address problems in the health system. According to the WHO, we have an increase in morbidity, an increase in the age of mothers giving birth to their first child, the lack of staff causes the health system to be overloaded, this leads to an increase in cost and a decrease in the quality of service. UNFPA prioritizes strengthening the institutional capacity of the Sexual and Reproductive Health (SRH) workforce, as well as strengthening professional and academic networks between regional and global institutions and societies, including midwives, in Eastern Europe and Central Asia (EECA).

The goal is the revision of the curriculum and the approach of a contemporary "Midwife" program by adapting it according to the needs of the country with a focus on the student to have competent personnel with high professional standards in the health system.

Methodology: Review of foreign literature and program at FSHMT to identify deficiencies and implement a curriculum as close as possible to EU directives.

Results: The introduction of foreign literature based on EU directives and WHO standards puts the emphasis on the student who must be able to embrace evidence-based practice, provide high-quality care based on the best data available and evaluate clinical judgment and patient preference. A detailed evaluation of the "Midwives" curriculum in EECA countries and territories related to competences needed for service delivery (SHSR) in accordance with the latest UNFPA and WHO guidelines was carried out in June - July 2023. The main findings of this evaluation highlight the deficiencies of the student's competencies and the decrease in the credits of the nursing care courses.

Conclusions: Harmonizing the curriculum from similar countries with our health and education system will lead to a competent midwife who provides a holistic approach to care.

Recommendations: policies should focus on increasing national and regional advocacy efforts to advance midwifery education. Increasing nursing care credits brings a Midwife who provides cost-effective care, improved service quality, satisfied patients. For the review and reformatting of an adequate curriculum, it is necessary to create a working group for the design of curricula, the identification of the country's needs and the suitability of a contemporary curriculum.

Key words: curriculum, student, midwife, skills, access, quality, health system

LLOJET E KUJDESIT DIADIK TË PACIENTËVE ME MULTIMORBIDITET DHE KUJDESTARËT E TYRE JOFORMALË, NJË ANALIZË PARAPRAKE

Federico Ferro¹ | Ilaria Erba^{1,4} | Manuela Saurini¹ | Alta Arapi¹ | Sajmira Aderaj¹ | Gennaro Rocco^{2,3} | Ercole Vellone^{1,5} | Maddalena De Maria^{1,2}

¹ Universiteti Tor Vergata i Romës, Romë, Itali

² Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Albani

³ Qendra e Ekselencës për Bursën e Infermierisë, Romë, Itali

⁴ Universiteti Ndërkombëtar Saint Camillus i Romës dhe Shkencat Mjekësore (UniCamillus), Roma, Itali

⁵ Universiteti Mjekësor Wroclaw, Poloni

ABSTRAKT

Hyrje

Për të ruajtur stabilitetin e multimorbiditetit, vetëkujdesi është thelbësor. Ai përfshin sjelljet e ruajtjes së shëndetit, monitorimin dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike (mirëmbajtjen e kujdesit për veten, monitorimin e vetë-kujdesit dhe menaxhimin e vetë-kujdesit). Pavarësisht përfitimeve të vetë-kujdesit, është e vështirë të kryhet. Pra, kujdestarët joformalë mund të kontribuojnë dhe mbështesin pacientin për të kryer sjellje adekuate të vetë-kujdesit. Pacienti dhe kujdestari, krijojnë një diadë dhe ndikojnë njëri-tjetrin. Dallimet në kryerjen e vetë-kujdesit dhe kontributit të kujdestarit në kujdesin ndaj vetes në menaxhimin e sëmundjeve kronike, përcaktojnë lloje të ndryshme të diadave (të orientuara nga pacienti, të orientuar nga kujdestari, të orientuar drejt bashkëpunimit, jo kongruente). Njohja se si diadat kryejnë vetë-kujdes dhe CC ndaj vetëkujdesit në diada MCC do të jetë e dobishme për infermierinë për përshtatjen e ndërhyrjeve për përmirësimin e vetë-kujdesit dhe kontributet e kujdestarëve (CC) në sjelljet e vetë-kujdesit.

Qellimi: Për të ekzaminuar sjelljet e vetë-kujdesit dhe CC për vetë-kujdes në diada të ndryshme dhe për të identifikuar karakteristikat e pacientit dhe kujdestarit që lidhen me çdo lloj kujdesi diadik.

Metodat: Analiza paraprake e një studimi ndërsektorial. Për të matur vetëkujdesin dhe CC me vetëkujdesin, janë përdorur përkatësisht Inventari i Vetëkujdesit të Sëmundjeve Kronike dhe Indeksi i Kontributit të Kujdestarit në Vetëkujdesin e Sëmundjeve Kronike. Shkalla e tipit të menaxhimit të simptomave dyadike u përdor për të identifikuar llojet e kujdesit diadik.

Rezultatet: U regjistrua një kampion prej 541 diadash pacient-kujdestar. Pacientët ishin kryesisht femra (55.8%), me një moshë mesatare 76.54 (± 7.23) vjeç. Kujdestarët ishin kryesisht femra (71.3%) me një moshë mesatare 52.71 (15.06) vjeç. Në diadat e orientuara nga pacienti, pacientët treguan rezultate të larta të mirëmbajtjes, monitorimit dhe menaxhimit të vetë-kujdesit. Në diadat e orientuara nga kujdestari dhe bashkëpunuese, kujdestarët treguan CC të lartë ndaj mirëmbajtjes, monitorimit dhe menaxhimit të vetëkujdesit të pacientëve. Përndryshe, në diada të papajtueshme, pacientët dhe kujdestarët raportuan nivele të ngjashme të vetë-kujdesit dhe CC me vetëkujdesin e pacientit, përveç rasteve kur në CC me menaxhimin e vetë-kujdesit të pacientit që ishte dukshëm më i lartë se menaxhimi i vetë-kujdesit të pacientëve. Në diadat e orientuara nga pacienti, pacientët ishin më të rinjtë me statusin më të lartë njohës, numrin më të vogël të sëmundjeve shoqëruese dhe shtrimin në spital. Në diadat e orientuara nga kujdestari, pacientët ishin më të moshuarit me statusin më

të keq njohës. Pacientët e këtyre diadave kishin një numër më të lartë të shtrimeve në spital krahasuar me diadat e orientuara nga pacienti dhe ato bashkëpunuese dhe kishin një numër më të lartë të komorbiditeteve krahasuar me diadat e orientuara nga pacienti. Kujdestarët e diadave të orientuara nga kujdestari paraqitën numrin më të madh të kujdesit. Në diadat e orientuara nga bashkëpunimi, pacientët ishin më të moshuar dhe më pak të arsimuar me më shumë sëmundje shoqëruese dhe shtrime në spital, status më të ulët njohës krahasuar me diadat e orientuara nga pacienti. Kujdestarët e këtyre diadave ishin kryesisht femra, duke siguruar një numër më të madh orësh për kujdesjeje krahasuar me diadat e orientuara nga pacienti. Në diadat e papajtueshme, pacientët ishin më të moshuar, kishin nivele më të ulëta të edukimit dhe statusit njohës, një numër më të madh të sëmundjeve shoqëruese, krahasuar me diadat e orientuara nga pacienti. Kujdestarët perceptuan mbështetje më të ulët sociale dhe varësi më të madhe kohore dhe ngarkesë fizike në krahasim me diadat bashkëpunuese.

Diskutim: Ne zbuluam se shumica e diadave ishin të orientuara drejt bashkëpunimit. Kjo do të thotë që menaxhimi i MCC-ve përfshin si pacientët ashtu edhe anëtarët e familjes. Disa karakteristika sociodemografike dhe klinike të pacientit dhe kujdestarit janë të lidhura me lloje të ndryshme të kujdesit diadik. Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të vlerësojnë dhe identifikojnë llojin e diadave për të krijuar ndërhyrje edukative të përshtatura për çdo lloj kujdesi diadik dhe për të promovuar menaxhimin efektiv të sëmundjes.

DYADIC CARE TYPES OF PATIENTS WITH MULTIMORBIDITY AND THEIR INFORMAL CAREGIVERS, A PRELIMINARY ANALYSIS

Federico Ferro¹ | Ilaria Erba^{1,4} | Manuela Saurini¹ | Alta Arapi¹ | Sajmira Aderaj¹ | Gennaro Rocco^{2,3} | Ercole Vellone^{1,5} | Maddalena De Maria^{1,2}

¹ Tor Vergata University of Rome, Rome, Italy

² Catholic University "Our Lady of Good Counsel", Tirana, Albany

³ Centre of Excellence for Nursing Scholarship, Rome, Italy

⁴ Saint Camillus International University of Rome and Medical Sciences (UniCamillus), Roma, Italia

⁵ Wroclaw Medical University, Poland

ABSTRACT

Introduction: To maintain the stability of multimorbidity self-care is essential. It includes behaviours of maintaining health, monitor and manage chronic illnesses (self-care maintenance, self-care monitoring and self-care management). Despite the benefits of self-care, it is difficult to perform. So, informal caregivers can contribute and support patient to perform adequate self-care behaviours. Patient and caregiver, compose a dyad, and influence each other. The differences in performing self-care and caregiver contribution to self-care in the managing of chronic illnesses, define different types of dyads (patient-oriented, caregiver-oriented, collaborative-oriented, incongruent). Knowing how dyads perform self-care and CC to self-care in MCC dyads will be useful for nursing for tailoring interventions for improving self-care and caregiver contributions (CC) to self-care behaviours.

Aim: To examine self-care behaviours and CC to self-care in different dyads, and identify patient and caregiver characteristics associated with each dyadic care type.

Methods: Preliminary analysis of a cross-sectional study. To measure self-care and CC to self-care, the Self-Care of Chronic Illness Inventory and The Caregiver Contribution to Self-Care of Chronic Illness Index, respectively were used. The Dyadic Symptom Management Type Scale was used to identify dyadic care types.

Results: A sample of 541 patient-caregiver dyads was enrolled. Patients were mostly female (55.8%), with a mean age of 76.54 (± 7.23) years. Caregiver were mostly female (71.3%) with a mean age of 52.71 (15.06) years. In the patient-oriented dyads, patients showed high scores self-care maintenance, monitoring and management. In caregiver-oriented and collaborative dyads, caregivers showed high CC to patients' self-care maintenance, monitoring, management. Otherwise, in incongruent dyads, patients and caregivers reported similar levels of self-care and CC to patient self-care unless in CC to patient self-care management that was significantly higher than patients' self-care management. In the patient-oriented dyads, patients were the youngest with highest cognitive status, fewest number of comorbidities and hospital admissions. In caregiver-oriented dyads, patients were the oldest with the worst cognitive status. Patients of these dyads had a higher number of hospital admissions compared with the patient-oriented and collaborative dyads and had a higher number of comorbidities compared with the patient-oriented dyads. Caregivers of the caregiver-oriented dyads presented the greatest number of caregiving. In the collaborative-oriented dyads, patients were older and less educated with more comorbidities and hospital admissions, lower cognitive status compared with the patient-oriented dyads. Caregivers of these dyads were mainly female, providing a greater number of caregiving hours compared with the patient-oriented dyads. In the incongruent dyads, patients were older, had lower levels of education and cognitive status, a greater number of comorbidities, compared with the patient-oriented dyads. Caregivers perceived lower social support, and higher time-dependence and physical burden compared with the collaborative dyads.

Discussion

We found that the majority of dyads were collaborative-oriented. This means that the management of MCCs involve both patients and family members. Several sociodemographic and clinical characteristics

of patient and caregiver are associated with different dyadic care types. Healthcare professionals should assess and identify the type of dyads to create tailored educational interventions to each dyadic care type and to promote effective disease management.

POSTERA INFERMIERI

FOKUS GRUP ANALIZË E STUDENTËVE MASTER TË INFERMIERISË LIDHUR ME MODELET E KUJDESIT KRONIK

Msc. Luljeta Habilaj¹, Assoc. Prof. Fatjona Kamberi²

¹Studente, Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" Albania. luljetahabilaj123@gmail.com

²Profesore, Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" Albania. fatjona.kamberi@univlora.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Kujdesi kronik është një qasje e fokusuar te pacienti për t'u ofruar pacientëve me sëmundje kronike njohuri dhe aftësi për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë gjendjen e tyre shëndetësore dhe të respektojnë trajtimin për rezultate më të mira në shëndet.

Qëllimi: Të vlerësojë njohuritë e studentëve të infermierisë në programet master në Fakultetin e Shëndetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në lidhje me modelet e kujdesit kronik gjatë periudhës së studimit, si dhe të evidentoj qëndrimet e tyre.

Metodologjia: Ky është një studim përshkrues transversal me fokus metodën e fokus grupit për kujdesin kronik dhe integrimin e tij në kurrikulat e infermierisë. Fokus grupi u zhvillua në Qershor 2023 dhe përfshinte 12 pjesëmarrës: 10 studente femra dhe 2 studentë meshkuj. Për të mbledhur të dhënat u përdor një listë pyetjesh të drejtuara bazuar në literaturën mbi modelet e kujdesit kronik. Pjesëmarrësit shprehën vullnetin e tyre për të qenë pjesë e studimit duke nënshkruar pëlqimin e informuar. Diskutimi zgjati 90 minuta.

Rezultatet: Gjatë diskutimit në fokus grup, pjesëmarrësit deklaruan se nuk kishin njohuri për modelet e kujdesit kronik; disa prej tyre deklaruan se në Shqipëri janë zbatuar modele të kujdesit kronik dhe disa të tjerë jo. Përsa i përket qëndrimit të tyre ndaj modeleve të kujdesit kronik, ata kishin një qëndrim pozitiv, duke i konsideruar të nevojshme për të ndihmuar pacientët me sëmundje kronike.

Konkluzione: Bazuar në diskutime, njohuritë e studentëve ishin shumë të kufizuara për modelet e kujdesit kronik si rezultat i përfshirjes së pakët ose aspak të modeleve të kujdesit kronik në kurrikulat e infermierisë të programeve në të cilat ata studionin.

Fjalë kyçe: Studentët e infermierisë, modelet e kujdesit kronik, njohuritë, qëndrimet, integrimi, fokus grupi.

A FOCUS GROUP ANALYSIS OF MASTER DEGREE NURSING STUDENTS REGARDING MODELS OF CHRONIC CARE

Msc. Luljeta Habilaj¹, Assoc. Prof. Fatjona Kamberi²

¹Student, Department of Nursing, Faculty of Health, University of Vlora "Ismail Qemali" Albania.
luljetahabilaj123@gmail.com

²Professor, Scientific Research Centre for Public Health, Faculty of Health, University of Vlora "Ismail Qemali" Albania. fatjona.kamberi@univlora.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Chronic care is a patient-centered approach to providing chronically ill patients with knowledge and resources to help them better understand their conditions and pursue treatment for better outcomes.

Purpose: To evaluate the knowledge of nursing students in master's programs at the Faculty of Health of "Ismail Qemali" University of Vlora regarding chronic care models during the study period, as well as to find out their attitudes.

Methodology: This is a descriptive cross-sectional study using the focus group method about chronic care and its integration into nursing curricula. The focus group took place in June 2023 and included 12 participants: 10 female students and 2 male students. A list of guided questions based on the literature on chronic care models was used to collect the data. The participants expressed their willingness to be part of the study by signing the informed consent. The discussion lasted 90 minutes.

Results: During the focus group discussion, the participants stated that they had no knowledge of chronic care models; some of them stated that chronic care models were implemented in Albania, and some others did not. Regarding their attitude towards chronic care models, they had a positive attitude, considering them necessary to help patients with chronic diseases.

Conclusions: Based on the discussion, the knowledge of students was very limited on chronic care models as a result of little or no inclusion of chronic care models in the nursing curricula of the programs in which they studied.

Keywords: Nursing students, chronic care models, knowledge, attitudes, integration, focus group.

PARANDALIMI I ZHVILLIMIT TË KANCEREVE TË LIDHURA ME DIETËN PËRMES ZAKONEVE TË TË USHQYERIT SHËNDETSHËM

Xhesika Dine

Master Shkencor në Shkenca Infermierore

e-mail: xhesikadine@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Kanceri parashikohet të jetë shkaku kryesor i vdekjeve në çdo vend të botës deri në fund të këtij shekulli. Si infermierë të ardhshëm dhe anëtarë të besuar të ekipit shëndetësor, studentët e infermierisë kanë rol unik pasi duhet të jenë këshillues dhe propagandues të fortë të adaptimit të sjelljeve të shëndetshme te pacientët apo tek çdo person tjetër që riskon mirëqenien e tij për shkak të ushqyerjes jo të shëndetshme. Njohuritë mbi ushqyerjen përbëjnë një faktor kritik që i motivon individët të shmangin sjellje jo të shëndetshme.

Qëllimi: Vlerësimi i nivelit të njohurive të studentëve, në lidhje me ushqyerjen e shëndetshme për parandalimin e kancereve të lidhura me dietën

Metoda: Ky studim u zhvillua në një mostër prej 202 studentësh të Fakultetit të Shëndetit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë. Ata aprovuan pjesëmarrjen, me ruajtjen e anonimitetit të të dhënave të tyre. Studentët i përkisnin cikleve të studimit Bachelor, Master dhe çdo viti të studimit, sipas ciklit përkatës.

Rezultatet: Studentët pjesëmarrës ishin të moshës 19-45 vjeç. 25,2% i takonin moshës 20 vjeç, ndërsa një pakicë prej 1,5% dhe 1% i takojnë moshave 42;45 vjeç. Nga këta studentë 70.3% ishin femra dhe 29.7% meshkuj. 65% e studentëve u përgjigjën saktë pyetjeve të pyetësorit. Po ashtu u konstatua një lidhje mes gjinisë dhe disa prej variablave matëse të njohurive që ata kishin në lidhje me temën e studimit ($p < 0.05$).

Konkluzione: Njohuritë e studentëve të Fakultetit të Shëndetit ishin përgjithësisht të mira përsa i përket ushqyerjes së shëndetshme dhe rolit të saj në parandalimin e kancereve të lidhura me dietën. Ekziston një lidhje sinjifikative mes gjinisë dhe njohurive që studentët zotërojnë, ku në bazë të rezultateve u arrit në përfundimin se studentet femra kishin më tepër njohuri sesa meshkujt.

Fjalë kyç: *ushqyerje e shëndetshme, njohuri, parandalimi i kancerit, studentë.*

PREVENTION OF THE DEVELOPMENT OF DIET RELATED CANCERS THROUGH HEALTHY EATING HABITS

Xhesika Dine

Master Shkencor në Shkenca Infermierore

e-mail: xhesikadine@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Cancer is predicted to be the leading cause of death in every country in the world by the end of this century. As future nurses and trusted members of the healthcare team, nursing students have a unique role as they must be strong advisors and advocates for the adaptation of healthy behaviors to patients or any other person who risks their well-being due to poor nutrition. Nutrition knowledge is a critical factor that motivates individuals to avoid unhealthy behaviors.

Purpose: To assess the level of knowledge of students, regarding healthy nutrition for the prevention of diet-related cancers

Method: This study was conducted in a sample of 202 students of the Faculty of Health at "Ismail Qemali" University, Vlora. They agreed to participate, with the anonymity of their data preserved. The students belonged to the study cycles of Bachelor, Master and each year of study, according to the relevant cycle.

Results: Participating students were aged 19-45 years. 25.2% belonged to the age of 20, while a minority of 1.5% and 1% belong to the ages of 42; 45 years. Of these students, 70.3% were female and 29.7% male. 65% of students answered the questionnaire questions correctly. A relationship was also found between gender and some of the variables measuring the knowledge they had about the subject of the study ($p < 0.05$).

Conclusions: Faculty of Health students' knowledge was generally good regarding healthy nutrition and its role in the prevention of diet-related cancers. There is a significant relationship between gender and the knowledge that students possess, where based on the results it was concluded that female students had more knowledge than males.

Keywords: *healthy eating, knowledge, cancer prevention, students.*

KUJDESI PALIATIV DHE NEVOJAT E TË SËMURËVE TERMINAL

¹PhD Juljana Xhindoli, Msc. Erisilda Tare, ¹PhD(c) Emirjona Kiçaj, ¹PhD(c) Rudina Cercizaj
¹PhD(c) Saemira Durmishi, ¹Dr. Rezarta Lalo, ¹Msc. Stiliana Brokaj, Dr. Evis Allushi, ¹PhD(c)
 Vasilika Prifti

¹Departamenti i Kujdesit, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
 E-mail: juljana.xhindoli@univlora.edu.al

ABSTRAKT

Shumë të sëmurë tumoral vuajnë pasojat e sëmundjes dhe pamundësinë e lehtësimit të tyre. Studime të shumta tregojnë se kujdesi paliativ përmirëson ndjeshëm cilësinë e jetës së pacientit dhe ul ndjeshëm gravitetin e simptomave. Një nga të drejtat kryesore të shtetasve e sanksionuar në Kushtetutë dhe në konventa ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë është e drejta për të gëzuar nga shteti, në mënyrë të barabartë, të drejtën për kujdes shëndetësor, si dhe sigurim shëndetësor, sipas procedurës së caktuar në ligj.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i nevojave të pacientëve terminal dhe familjarëve të tyre, në drejtim të kujdesjeve shëndetësore.

Metodologjia: Ky studim është i tipit cross-seksional, i realizuar me anën e një interviste drejtuar familjarëve të pacientëve terminal, pranë Qendrës Shëndetësore Velabisht në qytetin e Beratit mbi nevojat që kanë këta pacientë dhe familjarët e tyre. U intervistuan 4 familjarë të pacientëve terminal gjatë vitit 2022.

Rezultatet: Sipas të dhënave nga intervistat e familjarëve, asnjëri prej pacientëve nuk kishte dijeni për sëmundjen e tij, sepse “nuk donim të rëndojmë gjendjen e tyre psikologjike apo ta dëmtonim emocionalisht”. Familjarët referojnë se kanë vendosur ti trajtojnë në shtëpi, as ata dhe as i sëmurit nuk kanë marrë support psikologjik nga profesionistët përkatës. Pengesa që kanë hasur në trajtimin e të sëmurit ka qenë mungesa e medikamenteve, përkujdesja në shtëpi, procedurat infermiere, menaxhimin e dhimbjes dhe refuzimi i trajtimit nga vet i sëmurit. Familjarët kanë patur nevojën e një ndjekjeje të vazhduar nga infermierët në shtëpi pasi kanë referuar se “Vinin me shumë insistim nga ana jonë dhe me vështirësi sepse nuk gjendeshin shpesh pranë nesh”, “Vinin shumë rrallë. Të gjendeshin më shpesh pranë të sëmurit”. Personeli nuk e ka përkrahur përdorimin e morfinës sepse “krijon varësi”, “duhet përdorur më vonë”, “na sugjeruan të përdorim fentanyl në vend të morfinës, por më vonë përdorëm morfinë”. Procedurat infermiere janë asistuar pjesërisht nga infermieri, ndërkohë referohet se “vendosjen e vëgonit me serum, kateterin urinar. Kemi marrë infermier privat”. 3 pacientë kanë marrë oksigjen shtesë në shtëpi dhe është siguruar privatisht. Familjarët kanë referuar se përkujdesja ndaj të sëmurit i ka rënduar ata shumë psikologjikisht dhe financiarisht.

Konkluzione: Nga referimet e familjarëve shihet një cilësi të ulët e jetës tek pacientët paliativ tumoral, në aspektin fizik, psikologjik, social dhe aksesibilitetin e strukturave shëndetësore. Bazuar në nevojat dhe problemet del i nevojshëm ofrimi dhe funksionimi i kujdesit paliativ në banesë, bazuar kjo edhe në ligjin Nr. 138/2014 “Për Kujdesin Paliativ në Republikën e Shqipërisë” për të mbrojtur të drejtën e qytetarëve për të përfituar kujdes paliativ, të asistuar nga një ekip multidisiplinar, i orientuar drejt nevojave të pacientit dhe familjarëve të tij.

Fjalët kyçe: pacient terminal, opioid; menaxhim i dhimbjes; kujdes paliativ, shërbim shëndetësor, infermier.

PALLIATIVE CARE AND THE NEEDS OF TERMINAL PATIENTS

¹PhD Juljana Xhindoli, Msc. Erisilda Tare, ¹PhD(c) Emirjona Kiqaj, ¹PhD(c) Rudina Cercizaj,
¹PhD(c) Saemira Durmishi, ¹Dr. Rezarta Lalo,, ¹Msc. Stiliana Brokaj, Dr. Evis Allushi, ¹PhD(c)
 Vasilika Prifti

¹Department of Health Care, Faculty of Health, University Ismail Qemali, Vlore

*E-mail correspondent author: juljana.xhindoli@univlora.edu.al

ABSTRACT

Numerous tumoral patients suffer the consequences of the diseases and the burden of inefficiency of care. Various studies show that palliative care greatly improves patient's quality of life and reduces significantly the gravity of symptoms. One of the main rights of the patients sanctioned in the Constitution and international Convents implemented in the Republic of Albania is the right of equal health care and health insurance according to the procedures sanctioned by law.

The aim of this study is to assess the needs of terminal patients and their families according to their health care services.

Methodology: This is a cross sectional study conducted with an interview of the family members of terminal patients. The study took place in the health care center of the Velabisht, in the city of Berat, Albania. We interviewed four family members during 2022.

Results: The interview revealed that none of the patients were aware of their terminal disease as the family members "did not want to cause deterioration of the psychological condition or to cause more emotional damage". The family members stated that they reached the decision to treat the patients at home, and neither the patients nor the family received any psychological support from the health care professionals of the area. The challenges encountered during the care of the patients were the lack of medications, no nursing care, inability to reduce pain, and refusal of the treatment from the patient. Family members needed continuous nursing care, as they stated that "the nurses came only when we insisted, they were not close to the family, meanwhile they were needed to be closer to the patient". The health care personnel did not use morphine shots as they thought about "the dependence", "will be used later in the course of the disease", suggested the use of fentanyl, and later the morphine" etc. Nursing procedures were somewhat performed, and the family was obligated to hire private nurses to insert a foley, a perfusion etc. Three patients used oxygen at home, which was bought privately. The family members stated that the chronic care provided drained them emotionally and financially.

Conclusions: The quality of life of terminal patients is really low, physically, psychologically, and the accessibility of health care structures. Based on the needs of the patients it is necessary to offer palliative care at home settings, based on the law No. 138/2014 "On palliative care in the Republic of Albania" to protect the rights of citizens to have palliative care, assisted by a multidisciplinary health care professionals aiming to improve the care of family and patient needs.

Keywords: terminal patient, opioid; pain management, palliative care, health care, nurse

MENAXHIMI INFERMIEROR TEK PACIENTET ME PNEUMONI*Denis Sylta***ABSTRAKT****Hyrje:**

Pneumonia në mjeksi njihet si inflamacion i parenkimës të mushkërirëve e shprehur ndryshe në gjuhën popullore, ndezje e mushkërive. Pneumonia është një infeksion në njëren apo në të dy mushkëritë , është një problem i madh shëndetësor dhe i shoqëruar me sëmundshmëri të lartë dhe vdekshmëri afatshkurtër dhe afatgjatë në të gjitha grupmoshat në mbarë botën. Mund të shkaktohet nga bakteret, viruset ose kërpudhat .

Metodologjia:

Ky hulumtim është një hulumtim deskriptiv, retrospektiv dhe statistikor i realizuar në periudhën kohore 12 mujore, respektivisht nga muaji janar të vitit 2022 deri në muajin dhjetor të vitit 2022. Janë analizuar të dhënat e 93 pacientëve me Pneumoni nga Sherbimi i Pneumologjisë të “Spitalit Rajonal të Shkodrës”. Analiza përfshiu të gjithë pacientët e diagnostifikuar me pneumoni sipas moshës , gjinisë , vendbanimit , shkaktarëve të pneumonisë , periudhës kohore/stinore , dhe sipas njohurive që kishin pacientët për sëmundjen e pneumonisë dhe trajtimin e saj .

Rezultatet:

Në bazë të të dhënave dhe rezultateve të hulumtimit kemi arritur në përfundim se sëmundja e pneumonisë më shumë i atakon personat e moshuar. Ku nga 93 persona të diagnostifikuar me sëmundjen e pneumonisë 59 % e pacientëve ishin mbi moshën 55 vjeqare . Sa i përket gjinisë së pacientëve të diagnostifikuar me pneumoni, nga rezultatet e fituara mund të konstatohet se pacientët e gjinisë mashkullore janë më të prekur nga pneumonia.

Konkluzionet:

Ne si infermierë për këtë sëmundje duhet që në mënyrë të vazhdueshme ta bëjmë edukimin e popullatës dhe të rekomandojmë tek ata: Të ndalojnë konsumimin e duhanit, të ndalojnë konsumimin e alkoolit, të mbajnë sistemin imunitar të fortë.(Bëni gjumë të mjaftueshëm, ushtroni rregullisht dhe hani një dietë të shëndetshme),të marrin vaksinat për të ndaluar pneumoninë, të marrin medikamentet e caktuara nga mjeku.

Fjalë kyçe : Pneumonia , mushkëritë, sëmundje , sistem imunitar , infermierë

NURSING MANAGEMENT IN PATIENTS WITH PNEUMONIA

Denis Syla

ABSTRACT

Introduction:

Pneumonia in medicine is known as inflammation of the lung parenchyma, expressed differently in the vernacular, inflammation of the lungs. Pneumonia is an infection in one or both lungs, is a major health problem and is associated with high morbidity and mortality in the short and long term in all age groups worldwide. It can be caused by bacteria, viruses or fungi.

Methodology:

This research is a descriptive, retrospective and statistical research carried out in a 12-month period, respectively from January 2022 to December 2022. The data of 93 patients with Pneumonia from the Pneumology Service of "Shkodra Regional Hospital". The analysis included all patients diagnosed with pneumonia according to age, sex, place of residence, causes of pneumonia, time period/season, and according to the knowledge the patients had about the disease of pneumonia and its treatment.

Results:

Based on the data and research results, we have come to the conclusion that the pneumonia disease attacks older people more. Of the 93 persons diagnosed with pneumonia, 59% of the patients were over the age of 55. Regarding the gender of the patients diagnosed with pneumonia, from the obtained results it can be concluded that male patients are more affected by pneumonia.

Conclusions:

We as nurses for this disease must continuously educate the population and recommend to them: Stop smoking, stop drinking alcohol, keep the immune system strong. (Get enough sleep, exercise regularly and eat a healthy diet), get vaccines to prevent pneumonia, take medications prescribed by your doctor.

Keywords:

Pneumonia, lungs, disease, immune system, nurses.

KANCERI I PROSTATES DHE MENAXHIMI INFERMIEROR*Revelino Tali***ABSTRAKT**

Ky punim është me qëllim studimi, jo vetëm për faktin se është një patologji kronike apo se është kanceri i dytë më i shpeshtë pas atij pulmonar, por është bërë mbi të gjitha për nevojën e ndergjegjesimit të të semuarve për mbajtjen të kesaj sëmundje nën kontroll, pasi kjo sëmundje mund të sjellë një përfundim letal për pacientin pasi krijon metastaza në organe vitale si truri, pulmonet, kockat etj. Behet fjalë për një patologji të traktit genito-urinar, pra për kancerin e prostatës.

Kanceri i prostatës është një patologji e traktit genito-urinar ku qelizat tumorale arrijnë të shumohen dhe të zmadhohen në mënyrë të pakontrolluar duke prekur një pjesë të gjendres në fillimet e hershme dhe më pas në avancim prek gjithë gjendren e prostatës, më pas prek dhe organet përreth si vezika urinare, uretra, testikujt ose ureteri, ku në rast të diagnostikimit të vonuar kanceri ka krijuar metastaza në organe vitale si truri, pulmonet ose dhe në organe si veshkat, kockat, hepari. Kanceri i prostatës është një patologji që prek moshat e mesme në kufijtë e moshave geriatrike domethënë moshat nga 50-70 vjeç me një diagnozë mesatarisht në moshën 66 vjeçare. Në etiopatologji ndikojnë direkt faktorët e moshës, më pas vijnë dhe faktorët tjerë si ato familjare, dietike (vitamina E në sasi të larta që shton me 17% rrishtjen e shfaqjes së kancerit), më pas kemi diabetin ku si shkak është përdorimi i metforminës.

Karakterizohet nga simptoma si dizuri, hematuria, shtim i frekuencës së urinimit, disfunksion erektil dhe në stadi të avancuar shfaqen limfedema në zonën pelvike, dhimbje kockash, mpirje etj. Diagnoza vendoset nëpërmjet: 1- Vlerë e lartë e Antigjenit Specifik të Prostatës (PSA) kur është më e lartë se 4 ng/ml me 20% probabilitet dhe në rast kur kjo vlerë arrin shifrën mbi 10 ng/ml atëherë një nga dy burra është me kancer prostate ku në këtë rast rekomandohet kryerja e biopsisë. Përdoret aparatul ultrasonografik, ekzaminimi dixhital rektal (DRE).

Fjalë kyçe: Kancer, kanceri i prostatës, metastaza, trakti genito-urinar, moshë geriatrike, faktor dietik, PSA (antigjen specifik i prostatës), biopsi, dizuri, hematouria, limfedemë, aparat ultrasonografik, DRE (ekzaminim dixhital rektal).

PROSTATE CANCER AND NURSING MANAGEMENT*Revelino Tali***ABSTRACT**

This work has been done for the purpose of the study, not only for the fact that it is a chronic pathology or that it is the second most common cancer after lung cancer, but it is done above all for the need to raise the awareness of patients to keep this disease under control. As we know this kind of disease can bring a lethal end to the patient because it creates metastases to vital organs like the brain, lung or to other organs for example kidney, liver or bone. It is a pathology of the genito-urinary tract, it is about prostate cancer.

Prostate cancer is a pathology of the genito-urinary tract where tumor cells manage to multiply and enlarge in an irregularly and uncontrollably, affecting first part of the prostate gland and then the entire prostate gland. In case of progression it extends to the surrounding organs near prostate such as urinary bladder, urethra, testicles, ureters. But in extreme cases of a very late diagnosis of cancer it has created metastases to vital organs like the brain, lungs, or other organs like kidney, liver or bone.

Prostate cancer is a pathology that affects middle age nearly with geriatric age, exactly from the age to 50 years to 70 years with an average age of 66 years. In etiopathology the age factor directly affects, then come other factors such as family, dietary (vitamin E in high amounts that increases by 17% the risk of cancer), another reason is using of metformine a hypoglycemic agent used to treat diabetes mellitus type 2.

It is characterized by symptoms such as dysuria, hematuria, increased frequency of urination, erectile dysfunction and in advanced stages lymphedema appears in the pelvic area or legs, numbness, bone pain. The diagnosis is made through: 1- the high value of the specific prostate antigen if it is higher than 4ng/ml has a probability of touch and in cases when this value reaches the figure above 10ng/ml then one of the two men has prostate cancer. In this case a biopsy is recommended. Other diagnostic way used ultrasonographic machinery, digital rectal examination (DRE).

KEYWORDS: cancer, prostate cancer, metastases, genito-urinary tract, dysuria, hematuria, lymphedema, geriatric age, dietary factor, PSA (prostate specific antigen), biopsy, ultrasonographic machinery, DRE (digital rectal examination).

**“VLERËSIMI I PËRDORIMIT TË DUHANIT DHE ALKOLIT TEK STUDENTËT
E INFERMIERISË NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS,
MAJ 2023”**

MSc.Enxhi Hasani

ABSTRAKT

Hyrje: Vendi ynë ka implementuar një sërë politikash për reduktimin e duhanpirjes dhe alkoolitmes të rinjve. Krahas edukimit shëndetësor, ka dhe masa si ndalimi i duhanit në ambjente tëmbyllura, moslejimi i reklamimit të produkteve të duhanit, apo moslejimi i shitjes së produktevetë duhanit dhe alkoolit në moshën nën 18 vjeç. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi iduhanpirjesdhekonsumit tëalkoolit tek studentët einfermierisënëqytetineDurrësit.

Metodologjia: Për marrjen e informacionit është përdorur një formular i vetëadmitsitruar. Pjesae parë lidhet me pyetje socio – demografike, e dyta ka pyetje lidhur me duhanpirjen dhe e tretaka pyetje lidhur me konsumin e alkoolit. Mostra është zgjedhur në mënyrë rastësore. Të dhënatjanë përpunuar duke përdorur paketën statistikore SPSS dhe Excel. Është zhvilluar një analizëdeskriptiveetëdhënave.

Rezultatet dhe Diskutime: U intervistuan 45 studentë (45% meshkuj dhe 56% femra). 100% etyre kanë patur të lehtë blerjen e cigares dhe të alkoolit para moshës 18 vjeçare. 40% nuk pijnëcigare, ndonëse 9% e tyre e kanë provuar atë, pjesa tjetër pijnë rregullisht. Konsumi i cigares kafilluar që në moshën 12 vjeçare për disa, dhe vetëm 2% e kanë provuar në moshën 18 vjeçare.Pjesa më e madhe, 23% e ka vazhduar konsumin e rregullt që 15 vjeç. 39% konsumon 20 – 39cigarenëditë(njënivelilartëkonsumi). Aksesi ndajalkoolit ështëdhënë i lehtë(nën moshën 9vjeçare për 4%). 16% konsumon të paktën një pije alkoolike në ditë. 51% kanë filluar cigarendhe38%alkoolin si pasojë epresionit tëbashkëmoshatarëve.

Konkluzionet: Ligjet që janë në fuqi aktualisht të cilat synojnë të reduktojnë konsumin eprodukteve të duhanit dhe pijeve alkoolike duke ulur aksesin ndaj moshën nën 18 vjeçare duketse, bazuar në këto rezultate, nuk janë efikase. Pavarësisht ndalimeve ligjore, të rinjtë vazhdojnë të kenë akses ndaj tyre dhe të fillojnë konsumin hershëm. Më shumë duhet bërë dhe në drejtim tëimpaktitqë kashoqëriadhebashkëmoshatarët.

Fjalë kyçe: Duhanpirje,alkool,produktduhani,student,infermieri

"ASSESSMENT OF TOBACCO AND ALCOHOL USE AMONG NURSING STUDENTS AT "ALEKSANDR MOISIU" UNIVERSITY, DURRËS, MAY 2023"

MSc. Enxhi Hasani

ABSTRACT

Introduction: Our country has implemented a number of policies to reduce smoking and alcohol among young people. In addition to health education, there are also measures such as banning smoking in public places closed, not allowing the advertising of tobacco products, or not allowing the sale of products of tobacco and alcohol under the age of 18. The purpose of this study is to evaluate smoking and alcohol consumption among nursing students in the city of Durrës.

Methodology: A self-administered form was used to obtain information. The first part is related to socio-demographic questions, the second has questions related to smoking and the third there are questions about alcohol consumption. The sample is randomly selected. Data were processed using the statistical package SPSS and Excel. An analysis has been developed descriptive data.

Results and Discussion: 45 students (45% male and 56% female) were interviewed. 100% of them found it easy to buy cigarettes and alcohol before the age of 18. 40% do not smoke cigarettes, although 9% of them have tried it, the rest smoke regularly. Cigarette consumption has started as early as age 12 for some, and only 2% tried it at age 18. The largest part, 23%, has continued regular consumption since the age of 15. 39% consume 20 – 39 cigarettes per day (a high level of consumption). Access to alcohol is also easier (under the age of 9 per year for 4%). 16% consume at least one alcoholic drink per day. 51% have started smoking and 38% alcohol as a result of peer pressure.

Conclusions: The laws currently in force which aim to reduce the consumption of tobacco products and alcoholic beverages by reducing access to the under 18 age group appears that, based on these results, they are not efficient. Despite legal prohibitions, young people continue have access to them and start consumption early. More should be done in the direction of the impact that society and peers have.

Keywords: Smoking, Alcohol, Tobacco Product, Student, Nursing.

ROLI I INFERMIERIT NË MENAXHIMIN E SËMUNDJEVE RESPIRATORE KRONIKE NË SPITAL DHE NË BANESËN E PACIENTIT

Kejsid Mala

Infermier, Diplomuar pranë Universitetit Katolik "Zoja e Keshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri, e-mail: kejsidmala108@gmail.com

ABSTRAKT

Sëmundjet respiratore kronike (SRK) përbëjnë një sfidë të madhe shëndetësore në nivel global, duke ndikuar negativisht në cilësinë e jetës dhe kostot shëndetësore të pacientëve. Infermierët luajnë një rol kyç në menaxhimin e këtyre pacientëve, të cilët shpesh kanë nevojë për kujdes multidisiplinar në mjekësi spitalore dhe asistencë në shtëpi.

Qëllimi: Ky studim synon të analizojë rolin e infermierit në menaxhimin e SRK në mjekësi spitalore dhe kujdesin në shtëpi, duke identifikuar strategjitë dhe praktikatat më efektive të ofruara nga infermierët për të përmirësuar cilësinë e kujdesit dhe rezultatet shëndetësore të pacientëve.

Metoda: Studimi është realizuar përmes një analize të literaturës dhe analizës së praktikave të infermierisë në menaxhimin e SRK. Përdorimi i burimeve bibliografike dhe intervistat me infermierë të spitalit janë përdorur për të mbështetur këtë analizë.

Rezultate: Infermierët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin, edukimin, dhe ndihmën për pacientët me SRK në mjekësi spitalore dhe në kujdesin e shtëpisë. Përdorimi i protokolleve të standardizuara dhe ndërhyrjet e personalizuara janë një pjesë e rëndësishme e praktikave të tyre. Ky ndihmës i kujdesit shëndetësor ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe redukton kostot e trajtimit.

Përfundime: Infermierët luajnë një rol kyç në menaxhimin e SRK duke përdorur njohuritë e tyre të specializuara dhe praktikatat e kujdesit, ata ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe reduktojnë përdorimin e burimeve shëndetësore. Përmirësimi i edukimit dhe bashkëpunimi multidisiplinar janë thelbësorë për të përballuar sfidat e SRK me sukses.

Fjalë kyçe: Sëmundje respiratore kronike, Infermier, Mjekësi spitalore, Kujdes në shtëpi, Menaxhimi shëndetësor, Cilësia e jetës.

THE ROLE OF NURSES IN MANAGEMENT OF CHRONIC RESPIRATORY DISEASES IN HOSPITAL SETTING AND IN THE PATIENT'S HOUSE

Kejsid Mala

Infermier, Diplomuar pranë Universitetit Katolik "Zoja e Keshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri, e-mail: kejsidmala108@gmail.com

ABSTRACT

Background: Chronic respiratory diseases (CRDs) constitute a major health challenge globally, negatively affecting the quality of life and health costs of patients. Nurses play a key role in the management of these patients, who often require multidisciplinary care in hospital medicine and home care.

Aim: This study aims to analyze the role of the nurse in the management of CKD in hospital medicine and home care, identifying the most effective strategies and practices provided by nurses to improve the quality of care and health outcomes of patients.

Methods: The study was carried out through an analysis of the literature and the analysis of nursing practices in the management of SRK. The use of bibliographic sources and interviews with hospital nurses were used to support this analysis.

Results: Nurses play an important role in the evaluation, education, and assistance of patients with CKD in hospital medicine and in home care. The use of standardized protocols and personalized interventions are an important part of their practices. This health care aid improves quality of life and reduces treatment costs.

Conclusion: Nurses play a key role in the management of CKD using their specialized knowledge and care practices, they help improve the quality of life and reduce the use of health resources. Improving education and multidisciplinary collaboration are essential to meet the challenges of SRK successfully.

Keywords: Chronic respiratory disease, Nurse, Hospital medicine, Home care, Health management, Quality of life.

ABSTRAKTE TEKNIK LABORATORI

CIKLI I TESTIMIT LABORATORIK. GABIMET LABORATORIKE QË LINDIN GJATË TIJ

Emirela Cenomeri¹, Prof. Dr. Anyla Bulo²

*¹ Kryelaborante, Shërbimi i Labororit Klinik-Biokimik, Qendra Spitalore
Universitare “Nënë Tereza” Tirane*

*² Shefe e Shërbimit të Labororit Klinik-Biokimik, Qendra Spitalore Universitare
“Nënë Tereza” Tirane*

Email: emirelacenomeri@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Testet laboratorike janë një komponent thelbësor i kujdesit shëndetësor, luajnë një rol kyç si në shëndetin e individit ashtu edhe në shëndetin publik të popullatës. Këto teste ndihmojnë në diagnostikimin, monitorimin, depistimin, parandalimin dhe parashikimin e sëmundjeve. Ky abstrakt eksploron ciklin e testimit laboratorik dhe gabimet që mund të lindin gjatë këtij procesi.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësoje burimet e ndryshme të gabimeve laboratorike dhe qasjet praktike për ti minimizuar ato, duke përmirësuar përfundimisht cilësinë e rezultateve laboratorike.

Metodologjia: U krye një rishikim i literaturës në Pubmed për të kuptuar përditësimet dhe rekomandimet në lidhje me llojet dhe frekuencat e gabimeve laboratorike që lindin gjatë ciklit të testimit laboratorik.

Rezultatet: Cikli i testimit laboratorik është një proces kompleks i ndjeshëm ndaj gabimeve në fazat pre-analitike, analitike dhe post-analitike. Këto gabime mund të kenë implikime të thella për kujdesin ndaj pacientit, rezultatet e testeve laboratorike dhe cilësinë e përgjithshme të kujdesit shëndetësor.

Konkluzione: Programet e edukimit dhe trajnimit për personelin shëndetësor konsiderohen si masat më domethënëse dhe të nevojshme për të reduktuar gabimet laboratorike. Duke përdorur protokollet e standardizuara, duke përdorur teknologji të avancuara institucionet e kujdesit shëndetësor mund të rrisin ndjeshëm saktësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të testeve laboratorike, duke avancuar në këtë mënyrë kujdesin ndaj pacientit dhe saktësinë diagnostike.

Fjalëkyç: gabimet laboratorike, testimi laboratorik, personel shendetësor, pacient

CYCLE OF LABORATORY TESTING. LABORATORY ERRORS ARISING DURING IT

Emirela Cenameri¹, Prof. Dr. Anyla Bulo²

¹ Head Laboratory Technician, Clinical-Biochemical Laboratory Service, University Hospital Center "Mother Teresa" Tirana

² Head of the Clinical-Biochemical Laboratory Service, University Hospital Center

"Mother Teresa" Tirana

Email: emirelacenomeri@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Laboratory tests are an essential component of health care, playing a key role in both the health of the individual and the public health of the population. These tests help in the diagnosis, monitoring, screening, prevention and prediction of diseases. This abstract explores the laboratory testing cycle and the errors that can arise during this process.

Purpose: The purpose of this study is to evaluate the various sources of laboratory errors and practical approaches to minimize them, ultimately improving the quality of laboratory results.

Methodology: A Pubmed literature review was conducted to understand updates and recommendations regarding the types and frequencies of laboratory errors that arise during the laboratory testing cycle.

Results: The laboratory testing cycle is a complex process susceptible to errors in the pre-analytical, analytical and post-analytical phases. These errors can have profound implications for patient care, laboratory test results, and the overall quality of health care.

Conclusions: Education and training programs for health personnel are considered the most significant and necessary measures to reduce laboratory errors. By using standardized protocols, using advanced technologies healthcare institutions can significantly increase the accuracy and reliability of laboratory test results, thus advancing patient care and diagnostic accuracy.

Keywords: laboratory errors, laboratory testing, health personnel, patient

FLEBOTOMIA

Rejdi Zaimi¹, Suela Gjeci², Prof. Dr. Anyla Bulo³

*¹ Teknik Laboratori, Shërbimi i Laboratorit Klinik-Biokimik, Qendra Spitalore
Universitare "Nënë Tereza" Tirane*

² Kryeinfermiere, Spitali Universitar i Traumës, Tirane

*³ Shefe e Shërbimit të Laboratorit Klinik-Biokimik, Qendra Spitalore Universitare
"Nënë Tereza" Tirane*

Email: rejdi_zaimi@hotmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Flebotomia, praktika e marrjes së gjakut nga venat e një pacienti me qëllim kryerjen e testimeve laboratorike, luan një rol kryesor në kujdesin shëndetësor. Një profesionist i kujdesit shëndetësor i specializuar në flebotominë njihet si flebotomist. Ky rishikim i literaturës synon të ofrojë një përmbledhje të praktikave të flebotomisë, perspektivat historike, përparimet e fundit dhe rëndësinë e saj në kujdesin shëndetësor.

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të shqyrtojë kontekstin historik të flebotomisë, duke gjurmuar origjinën e saj në praktikat e lashta dhe evolucionin e saj deri tek zhvillimi i teknikave moderne të flebotomisë.

Metodologjia: U krye një rishikim i literaturës në Pubmed në lidhje me praktikat bashkëkohore të flebotomisë duke theksuar rëndësinë e sigurisë së pacientit, kontrollin e infeksionit dhe rolin e flebotomistëve në ofrimin e kujdesit shëndetësor cilësor.

Rezultatet: Ky punim trajton sfidat dhe konsideratat që lidhen me flebotominë, të tilla si sigurimi i rehatisë së pacientit, minimizimi i komplikimeve dhe rëndësia e etiketimit, trajtimit dhe transportit të duhur të mostrave të gjakut. Theksohet rëndësia e kontrollit të cilësisë dhe edukimit të vazhdueshëm për flebotomistët për të qëndruar të përditësuar mbi praktikat më të mira laboratorike.

Konkluzione: Përdorimi i protokolleve të standardizuara dhe teknikave moderne të flebotomisë rrit kujdesin, sigurinë dhe saktësinë diagnostike për pacientin. Një personel mjekësor i trajnuar mirë për flebotominë është pjesë përbërëse e funksionimit të suksesshëm të institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe ofrimit të kujdesit cilësor për pacientët.

Fjalëkyç: flebotomia, testime laboratorike, personel mjekësor, protokolle

PHLEBOTOMY

Rejdi Zaimi¹, Suela Gjeci², Prof. Dr. Anyla Bulo³

¹ Laboratory Technician, Clinical-Biochemical Laboratory Service, University Hospital Center

"Mother Teresa" Tirana

² Head Nurse, Trauma University Hospital, Tirana

² Head of the Clinical-Biochemical Laboratory Service, University Hospital Center

"Mother Teresa" Tirana

Email: *rejdi_zaimi@hotmail.com*

ABSTRACT

Introduction: Phlebotomy, the practice of drawing blood from a patient's veins for the purpose of performing laboratory tests, plays a major role in health care. A health care professional who specializes in phlebotomy is known as a phlebotomist. This literature review aims to provide an overview of phlebotomy practices, historical perspectives, recent advances and its importance in healthcare.

Purpose: The purpose of this presentation is to examine the historical context of phlebotomy, tracing its origins to ancient practices and its evolution to the development of modern phlebotomy techniques.

Methodology: A Pubmed literature review was conducted regarding contemporary phlebotomy practices highlighting the importance of patient safety, infection control, and the role of phlebotomists in providing quality health care.

Results: This paper addresses the challenges and considerations associated with phlebotomy, such as ensuring patient comfort, minimizing complications, and the importance of proper labeling, handling, and transportation of blood samples. Emphasizes the importance of quality control and continuing education for phlebotomists to stay current on best laboratory practices.

Conclusions: The use of standardized protocols and modern phlebotomy techniques increases care, safety and diagnostic accuracy for the patient. A well-trained phlebotomy medical staff is integral to the successful operation of health care facilities and the provision of quality patient care.

Keywords: phlebotomy, laboratory tests, medical personnel, protocols

“VLERËSIMI I VLERËS SË ANTI-TPO-SË TE PACIENTËT ME HIPOTIREOZË”

Afërdita Xhelili-Dervisha¹, Vlora Ejupi²

ABSTRAKT

Hyrje: Gjëndra e tiroides është pjesë e sistemit endokrin, e cila prodhon hormone që kordinojnë funksionet e trupit. Të vlerësohen vlerat e anti-TPO-së tek pacientët me hipotireozë në Shërbimin e Mjekësisë Nukleare– QKUK.

Qellimi: Sa ndikojnë vlerat e anti-TPO-së në terapinë e hershme në sëmundjet e gjëndrës tiroide? A ka raste kur përkundër terapisë adekuate gjatë hipotireozës vlerat e anti-TPO-së nuk ulen? A ka specifitet dhe sensitivitet më të lartë në përcaktimin e vlerave të anti-TPO-së metoda me radioimmunoassay (RIA) në krahasim me metodat e tjera?

Metodologjia: Janë përdorur dy metoda për matjen e Anti-TPO. Metoda e pare Radioimmunoassay (RIA) e cila është analizë sasiore, përpërcaktimi ne Anti-thyroid peroxidase (anti-TPO), autoantitrupe në serum dhe në urinë. Metoda tjetër alternative e përdorur për matjen e Anti-TPO ishte metoda ELISA. Në hulumtimin tone janë analizuar gjithsej 100 pacientë, në periudhën kohore dy vjeçare, 16 meshkuj ose 16%, dhe 84 femra ose 84%, me moshë mesatare 46.53 vjeç. 96 prej 100 pacientëve kishin shenja të tiroidit kronik Hashimoto. 18 prej 100 pacientëve kanë bërë kontrolle rutinore për sëmundje të gjëndrës tiroide, për shkak të ankesave dhe faktorëve potencial të shfaqjes së hipotiroidizmit dhe kanë rezultuar me vlera normale të hormoneve të gjëndrës tiroide, respektivisht me TSH lehtë të ngritur, por me vlera të larta të anti-TPO-se. 86 nga 100 pacientë kishin anti-TPO të lartë. 14 nga 100 pacientë kishin nivele normale të anti-TPO.

Rezultatet: 82 pacientë me Tiroidit Hashimoto, u trajtuan me L-thyroxin medozatë ndryshme për sëmundje hipotiroidizëm primar klinik dhe subklinik, tiroiditis kronik Hashimoto. Në 22 raste u evidentua zvogëlim i nivelit të anti-TPO pas terapisë, kryesisht të trajtuar me L-thyroxine dhe me terapi suplementare me përmbajtje të SE, Jodit.

Diskutimi: Shënuesi më i mirë i progresionit në hipotiroidizëm është një kombinim i një niveli të lartë TSH me praninë e autoantitropave antitiroide, domethënë antitrupe anti-TPO dhe anti-Tg. Pacientët me autoantitrupe pozitive kundër tiroides, por një nivel normal të TSH duhet të kontrollohen periodikisht- për të monitoruar simptomat e hipotiroidizmit dhe për të zbuluar çdo rritje të niveleve të tyre të TSH. Kontrollat zakonisht mund të kryhen çdo 6-12 muaj. Këta pacientë duhet të trajtohen nëse niveli i TSH vazhdon të rritet, edhe nëse niveli është në kufirin e sipërm të intervalit të referencës. Edhe pse teknika RIA është jashtëzakonisht e ndjeshme dhe jashtëzakonisht specifike, ajo kërkon pajisje të specializuara dhe kërkon masa paraprake të veçantë dhe liçensim, pasi përdoren substanca radioaktive.

Fjalë kyçe: anti-TPO, pacient, hipotireozë, RIA, Elisa

"ASSESSMENT OF THE VALUE OF ANTI-TPO IN PATIENTS WITH HYPOTHYROIDISM"

Aphrodita Xhelili-Dervisha¹, Vlora Ejupi²

ABSTRACT

Introduction: The thyroid gland is part of the endocrine system, which produces hormones that coordinate body functions. To evaluate anti-TPO values in patients with hypothyroidism in the Nuclear Medicine Service - KKUK.

Purpose: How much do anti-TPO values affect early therapy in thyroid gland diseases? Are there cases when, despite adequate therapy during hypothyroidism, anti-TPO values do not decrease? Does the radioimmunoassay (RIA) method have higher specificity and sensitivity in determining anti-TPO values compared to other methods?

Methodology: Two methods were used to measure Anti-TPO. The first Radioimmunoassay (RIA) method, which is a quantitative analysis, for the determination of Anti-thyroid peroxidase (anti-TPO), autoantibodies in human serum. Another alternative method used to measure Anti-TPO was the ELISA method. In our research, a total of 100 patients were analyzed in the two-year period, 16 males or 16%, and 84 females or 84%, with an average age of 46.53 years. 96 out of 100 patients had signs of Hashimoto's chronic thyroiditis. 18 out of 100 patients had routine check-ups for thyroid disease, due to complaints and potential factors of hypothyroidism and resulted in normal values of thyroid hormones, respectively with slightly elevated TSH, but with high values of anti-TPO. 86 of 100 patients had high anti-TPO. 14 of 100 patients had normal anti-TPO levels.

Results: 82 patients with Hashimoto's Thyroiditis were treated with L-thyroxin at different doses for primary clinical and subclinical hypothyroidism, chronic Hashimoto's thyroiditis. In 22 cases, a decrease in the level of anti-TPO was evident after therapy, mainly treated with L-thyroxine and with supplementary therapy containing SE, Iodine.

Discussion: The best marker of progression to hypothyroidism is a combination of a high TSH level with the presence of antithyroid autoantibodies, namely anti-TPO and anti-Tg antibodies. Patients with positive anti-thyroid autoantibodies but a normal TSH level should be checked periodically to monitor for symptoms of hypothyroidism and to detect any increase in their TSH levels. Checkups can usually be done every 6-12 months. These patients should be treated if the TSH level continues to rise, even if the level is at the upper limit of the reference range. Although the RIA technique is extremely sensitive and extremely specific, it requires specialized equipment and requires special precautions and licensing, as radioactive substances are used.

Keywords: anti-TPO, patient, hypothyroidism, RIA, Elisa

“RËNDËSIA E VLERËSIMIT TË SASISË SË MIKROELEMENTËVE NË GJAKUN E NJERIUT DHE NDIKIMI I PATOLOGJIVE TË CAKTUARA NË NIVELIN E TYRE”

PhD. Anila Jançe¹, Prof. Assoc. Lila Shundi¹, Prof. Dr. Eleni Nastas¹

¹Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri

ABSTRAKT

Hyrje: Elementët gjurmë/ mikroelementët janë të rëndësishëm për një sërë funksionesh jetësore në trupin e njeriut, kështu që studimi i përqendrimit të tyre në gjak është një temë që është trajtuar gjerësisht për një kohë të gjatë.

Elementet gjurmë dhe përqendrimi i tyre në gjakun e njeriut janë të një rëndësie të madhe sidomos gjatë shtatzënisë. Për këtë arsye është e përshtatshme të nënvizohet rëndësia e veçantë e monitorimit të niveleve të përqendrimit të këtyre elementeve tek gratë shtatzëna.

Për shkak të ndryshimeve hormonale dhe rritjes së nivelit të progesteronit në gjak, problemeve në sistemin tretës, rritjes së fetusit dhe placentës, një dietë të varfër në mikroelemente, janë vërejtur përqendrime elektrolite më të ulëta se vlerat e lejuara, faktorë që çojnë në hiponatremi, hipokalemi, anemi, hipokalcemi.

Ndër funksionet më të rëndësishme të mikroelementeve në trupin e njeriut, ne rendisim: aktivizimi i proceseve të ndryshme enzimatiske, transmetimi i impulseve nervore, pjesëmarrja në procesin e koagulimit të gjakut dhe rritjes së qelizave, ndikimi në mekanizmin e transportit të membranës, transporti i oksigjenit, ruajtja e ngjyrës së kuqe të gjakut, sinteza e proteinave etj.

Ndikimi i patologjive të caktuara në nivelin e mikroelementëve, në trupin e njeriut është një element që duhet konsideruar, duke parë dhe rëndësinë që këta komponentë kanë për proceset biokimike të organizmit të njeriut.

Patologji të caktuara si: humbje gastro-intestinale, diarre, drenimi i fistulave, pamjaftueshmëria kortikosteroide, djersitja profuze, hipertermia, sindroma Cushing, hipotiroidizmi, hiperparatiroidizmi, rakitizmi, osteomalacia, karcinoma prostatike, mieloma multiplex, leucemia dhe limoma, koliti ulçeroz, diabeti, etj janë disa prej patologjive që ndikojnë në nivelin e mikroelementëve të caktuar në organizëm.

Metodologjia:

Përcaktimi dhe vlerësimi i përqendrimit të mikroelementeve dhe elektroliteve, në laboratorët biokimik realizohet me materiale të ndryshme biologjike të marra nga organizmi i njeriut, si:

- Serumi dhe plazma e gjakut
- Gjaku integral
- Urina
- Lëngu cerebrospinal etj.

Procedura e marrjes së kampionit të materialit biologjik, për të nënshtruar analizave biokimike, në evidentimin e përqendrimit të metaleve gjurmë, është një nga elementet kryesorë preanalitik sepse është e lidhur ngushtë saktësinë e rezultatit përfundimtar. (Ising *et al.*, 1995)

Instrumentet: Serumi i gjakut është materiali më i përshtatshëm biologjik për të realizuar analizat biokimike dhe hormonale dhe përcaktimin e nivelit të mikroelementëve në organizëm sepse mund të ruhet për një periudhë të caktuar duke respektuar kushtet optimale (errësirë, temp -20°C, tuba hermetik)

pa humbur vlerat jetësore, mund të ruhet në tuba bosh pa pasur nevojë për lëndë shtesë si dhe niveli i mikroelementeve i matur në serum dhe gjakut është përfaqësues i gjendjes së këtij elementi në të gjithë organizmin.

Metodat analitike për të matur nivelin e mikroelementeve në mostrat e serumit të gjakut janë kryesisht: Spektroskopia e Absorbimit Atomik (SAA) me flakë acetilen-ajër për matjen e absorbancës së : Mg, Ca , Zn, Fe, Spektroskopia e Absorbimit Atomik (SAA) me atomizues elektrotermik me furrë grafiti për matjen e absorbancës së: Pb, Cu, Cr, Ni, Mn, Spektroskopia e Emisionit Atomik (SEA) me flakë acetilen-ajër për matjen e emisionit të: Na, K and Li. Kontrolli i cilësisë së analizës në të gjithë metodat e përdorura për analizën e kampioneve realizohet në përputhje të plotë me kriteret e propozuara nga Organizata Botërore e Shëndetit për testimin esigurisë kimike në rastin e materialeve biologjike në mungesë të mostrave të çertifikuara CRM (WHO, 1992).

Diskutime dhe Konkluzionet:

Përbajtja e mikroelementeve: Ca, Mg, Zn, K, Na, Li, Pb, Fe, Cu, Cr, Ni, Mn në serum dhe gjakut të meshkujve dhe femrave në pjesën më të madhe rezultojnë të jetë e ndryshme. Referuar literaturave të shumta, rezultojnë se nga krahasimi i rezultateve të përftuara për meshkujt dhe për femrat, u evidentua që tek meshkujt ndeshen më tepër rastet me përbajtje të mikroelementeve Fe, Ca, Mg, Na, K mbi normën të lejuar. Ekziston mundësia e një korrelacioni midis dietës ushqimore të pasur me këto elemente dhe kushteve fiziologjike dhe anatomike që e favorizon këtë gjini.

Për të gjithë gjininë femërore, mbi moshën 45 vjeç, janë evidentuar rastet me vlera më të ulta ose afër kufirit minimal të elementeve Ca, Mg, Na, K, lidhur kjo me periudhën e menopauzës, ku për shkak të ndryshimeve në sistemin hormonal, pjesa më e madhe e këtyre elementeve (veçanërisht Mg) ekstrahohet në mënyrë të pashfrytëzuar nëpërmjet veshkave dhe për rrjedhojë kemi shfaqjen e sëmundjeve kardiovaskulare, osteoporozës, etj. Një kategori tepër e rëndësishme e cila është konsideruar subjekt i mirëfilltë studimi janë dhe femrat shtatzana. Nga studimet e kryera është evidentuar që nuk ka patur ndryshime të konsiderueshme të mikroelementeve midis vlerave të përftuara nga femrat shtatzana dhe ato jo shtatzana. Kjo lidhet më së miri me efikasitetin e suplementeve të elementeve esenciale me të cilat trajtohen femrat shtatzana për ruajtjen e përqendrimeve të këtyre elementeve brenda normave të lejuara. Problemet infertilitetit, referuar studimeve të shumta janë vërejtur tek meshkujt në rastet me mungesë të theksuar hekurit. Infertiliteti mashkullor dhe mungesa e hekurit mbetet ende një diskutim i hapur për studime të thelluara në të ardhmen. Vlen për tu theksuar që përbajtja e mikroelementeve në meshkujt dhe femrat e marra në studimet e shumta është e lidhur me faktorët kryesisht si dieta ushqimore, faktorët antropogjen si kimikatet ushqimore, lëndët djegëse fosile, ndotja mjedisore nga automjetet etj.

Fjalë kyçe: mikroelemente, mostra gjaku, spektroskopia e absorbimit atomik, dieta ushqimore, ndotja mjedisore, patologji.

THE IMPORTANCE OF ASSESSING THE QUANTITY OF MICROELEMENTS IN HUMAN BLOOD AND THE INFLUENCE OF CERTAIN PATHOLOGIES ON THEIR LEVEL

PhD. Anila Jançe¹, Prof. Assoc. Lila Shundi¹, Prof. Dr. Eleni Nastas¹

¹Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri

ABSTRACT

Introduction: Trace elements/microelements are important for a number of vital functions in the human body, so the study of their concentration in the blood is a topic that has been widely addressed for a long time.

Trace elements and their concentration in human blood are of great importance especially during pregnancy. For this reason, it is appropriate to underline the special importance of monitoring the concentration levels of these elements in pregnant women.

Due to hormonal changes and an increase in the level of progesterone in the blood, problems in the digestive system, the growth of the fetus and placenta, a diet poor in microelements, electrolyte concentrations lower than the permissible values have been observed, factors that lead to hyponatremia, hypokalemia, anemia, hypocalcemia.

Certain pathologies such as: gastro-intestinal loss, diarrhea, drainage of fistulas, adrenal insufficiency, profuse sweating, hyperthermia, Cushing's syndrome, hypothyroidism, hyperparathyroidism, rickets, osteomalacia, prostatic carcinoma, myeloma multiplex, leukemia and lymphoma, ulcerative colitis, diabetes, etc. are some of the pathologies that affect the level of certain microelements in the body.

Methodology: Determination and evaluation of the concentration of microelements and electrolytes in biochemical laboratories is carried out with various biological materials taken from the human body, such as:

- Blood serum and plasma
- Whole blood
- Urine
- Cerebrospinal fluid, etc.

The procedure of taking a sample of biological material, to undergo biochemical analysis, in the evidence of the concentration of trace metals, is one of the main elements preanalytical because it is closely related to the accuracy of the final result. (Ising et al., 1995)

Instruments: Blood serum is the most suitable biological material to carry out biochemical and hormonal analyzes and determine the level of microelements in the body because it can be stored for a certain period respecting the optimal conditions (darkness, temperature -20°C, hermetic tubes) without losing vital values, can be stored in empty tubes without the need for additional substances, and the level of microelements measured in the blood serum is representative of the state of this element in the whole organism.

Analytical methods to measure the level of trace elements in blood serum samples are mainly: Atomic Absorption Spectroscopy (AAA) with acetylene-air flame for measuring absorbance of: Mg, Ca, Zn, Fe, Atomic Absorption Spectroscopy (SAA) with electro-thermal atomizer with graphite furnace for measuring the absorbance of: Pb, Cu, Cr, Ni, Mn, Atomic Emission Spectroscopy (SEA) with

acetylene-air flame for measuring the emission of: Na, K and Li. The control of the quality of the analysis in all the methods used for the analysis of the samples is carried out in full accordance with the criteria proposed by the World Health Organization for the testing of chemical safety in the case of biological materials in the absence of samples of certified CRM (WHO, 1992).

Discussions and Conclusions:

Maintenance of trace elements: Ca, Mg, Zn, K, Na, Li, Pb, Fe, Cu, Cr, Ni, Mn in blood serum of men and women for the most part turns out to be different. Referring to numerous literatures, it results that from the comparison of the results obtained for men and women, it was evident that in men there are more cases with content of microelements Fe, Ca, Mg, Na, K above the allowed rate. There is a possibility of a correlation between the food diet rich in these elements and physiological conditions and anatomical that favors this gender.

For all females, over the age of 45, cases with higher values have been identified low or close to the minimum limit of elements Ca, Mg, Na, K, related to the menopause period, where due to changes in the hormonal system, most much of these elements (especially Mg) is extracted in an unused way through the kidneys and therefore we have the appearance of cardiovascular diseases, osteoporosis, etc. A very important category which has been considered a real subject of study are pregnant women. From the conducted studies, it has been evidenced that there were no significant changes in microelements between the values obtained by pregnant and non-pregnant women, pregnant woman. This is best related to the efficacy of essential element supplements with which pregnant women are treated to maintain the concentrations of these elements within the allowed rates.

Infertility problems, referring to numerous studies, have been observed in men in cases with marked iron deficiency. Male infertility and iron deficiency still remains an open discussion for future in-depth studies. It is worth noting that the content of microelements in men and women taken in numerous studies are related to factors mainly such as food diet, anthropogenic factors such as food chemicals, fossil fuels, environmental pollution from vehicles, etc.

Key words: trace elements, blood samples, atomic absorption spectroscopy, food diet, environmental pollution, pathology.

ASPEKTE LABORATORIKO-KLINIKE NË PACIENTË AMBULATORË ME ARTRIT REUMATOID

Aleksandra Lamthi¹, Prof. Asoc. Dr. Admir Nake²

¹Msc Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,
Universiteti i Mjekësisë Tiranë

²Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Email: aleksandralamthi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrja: Artriti Reumatoid (AR) është sëmundje autoimune që parapëlqen prekjen e artikulacioneve të vogla, që mund të evoluojë me prekje ekstrartikulare dhe përbën edhe një nga patologjitë më serioze e cila kërkon një vëmendje të veçantë nga ekipet multidisiplare mjekësore, sidomos reumatologut. Duke marrë në shqyrtim aspektin laboratorik do evidetohen cilat teste laboratorike janë më të përshtatshme për diagnostikimin dhe monitorimin e mëtejshëm të Artritit Reumatoid.

Qëllimi: Vlerësimi i testeve laboratorike, specifike ose jo specifike, me peshë diagnostike ose orientuese diagnostike në pacientë me Artritit Reumatoid.

Metodologjia: Në këtë studim u morën në shqyrtim 100 pacientë me AR të cilët kanë kryer teste laboratorike siç janë Antitruapat Anti-Nuklear (ANA), PCR, Eritrosedimenti(ERS), Fibrinogjeni, Faktori Reumatoid (RF), Peptidi Anti-Ciklike të Citrulluar (Anti-CCP). Ekzaminimet janë kryer me metoda referente standarte.

Rezultati: Gjinia më e prekur janë femrat, 77%. Prevalenca e personave me ANA të lartë është 81%, me Anti-CCP të lartë është 69%, me FR pozitiv është 67%, me PCR të lartë është 74%, me fibrinogjen të rritur është 96%, me ERS të lartë është 98%.

Konkluzione: Ky studim vuri në dukje rëndësinë e testeve laboratorike në vendosjen e diagnozës së AR, dhe monitorimin e mëtejshëm të tij.

Fjalë kyçe : Artrit Juvenil Idiopatik (JIA), Antitruapat Anti-Nuklear (ANA), Peptidet Anti-Ciklike të Citrulluar (Anti-CCP), Faktori Reumatoid (RF), Eritrosedimenti (ERS).

LABORATORY-CLINICAL ASPECTS IN OUTPATIENTS WITH RHEUMATOID ARTHRITIS

Aleksandra Lamthi¹, Prof. Asoc. Dr. Admir Nake²

¹ Msc, Laboratory Technician, Faculty of Medical Technical Sciences, University of Medicine, Tirana

² Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana

Email: aleksandralamthi@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Considering the laboratory aspect, it will be noted which laboratory tests are most suitable for the diagnosis and further monitoring of Rheumatoid Arthritis. Rheumatoid arthritis (RA) is an autoimmune disease that precedes the involvement of small joints, that can evolve with extraarticular involvement and is one of the most serious pathologies that requires special attention from multidisciplinary medical teams, especially rheumatologists.

Purpose: Evaluation of laboratory tests, specific or non-specific, with diagnostic weight or diagnostic orientation in patients with Rheumatoid Arthritis.

Methodology: In this study, 100 patients with RA were examined, who underwent laboratory tests such as Anti-Nuclear Antibodies (ANA), PCR, Erythrocyte Sedimentation Rate (ERS), Fibrinogen, Rheumatoid Factor (RF), Anti-Citrullinated Cyclic Peptide (Anti-CCP).

Result: The most affected gender are women, 77%. Prevalence of people with high ANA is 81%, prevalence of people with high Anti-CCP is 69%, prevalence of people with positive RF is 67%, prevalence of people with high PCR is 74%, prevalence of people with high fibrinogen is 96%, prevalence with high ERS is 98%.

Conclusions: This study highlighted the importance of laboratory tests in establishing the diagnosis of RA, and its further monitoring.

Keywords: Juvenile Idiopathic Arthritis (JIA), Anti-Nuclear Antibodies (ANA), Anti-Cyclic Citrullinated Peptides (Anti-CCP), Rheumatoid Factor (RF), Erythrocyte Sedimentation Rate (ERS).

CANABIS SATIVA DHE SHËNDETI RIPRODHUES MASHKULLORGriselda Korcari ¹, Kleo Plaka², Jona Kerri³¹Departamenti i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë² Laborant, Laborator Mjekësor Medline³ Qendra Kerkimore Farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë,Email: Griselda.zacaj@ual.edu.al**ABSTRAKT**

Hyrje: Cannabis sativa është një bimë e njohur që nga kohërat e lashta për përfitimet e saj të ndryshme shëndetësore. Gjatë dekadës së fundit, konsumi i marihuanës ose i çdo forme tjetër të kanabisit, qoftë mjekësor, rekreativ apo ilegal, është përshkallëzuar në mbarë botën. Studime të ndryshme aktuale tregojnë se kanabisi ka të ngjarë të ketë ndikime negative në fertilitetin mashkullor kryesisht në kategorinë e parametrave të spermës. Gjithashtu ka studime që tregojnë efekte të cannabis në nivelet e hormoneve të testosteronit, hormonit luteinizues (LH) dhe hormonit folikolo-stimulues (FSH).

Metodologjia: Në këtë studim morën pjesë rreth 40 vullnetarë të qytetit të Elbasanit, të cilët iu nënshtruan një pyetësori anonim lidhur me konsumimin e kanabisit, numrin e cigareve që konsumonin, kohëzgjatjen e përdorimit, problematikat në lidhje me performancën seksuale. Pjesëmarrësit në studim ishin meshkuj të moshës nga 15-44 vjeç. Vullnetarëve iu morën kampionet gjaku venoze 5ml me sistem me vakum (21GX3/) me tubat me xhel (Lot AG2502) që u përdoren për matjen e hormoneve Testosteron, LH dhe FSH. Kampionët u analizuan në laboratorin mjekësor MedLine Lab në aparatit ADVIA Centaur CP Immunoassay system me metodën analitike të Kimilumineshencë direkte.

Rezultate: Nga pyetësoret rezultoi se 20 vullnetarë ishin përdorues të cannabis sativa. Kohëzgjatja e përdorimit të lëndës narkotike ishte nga 1-10 vjet. Moshë mesatare e vullnetarëve ishte përkatësisht 24.55 vjeç për përdoruesit dhe 23.7 vjeç për jopërdoruesit. Grupmosha më e prekur nga përdorimi i kanabis sativa ishte 16-21 vjeçe (8 vullnetarë). Nga krahasimi i të dhënave laboratorike të vlerave të hormoneve midis grupit të kontrollit dhe atij përdorues të lëndëve narkotike rezultoi se:

- Mesatarja e vlerave të hormonit LH të përdoruesit 4,88 mIU/ml krahasuar me 7,42 mIU /ml të grupit të kontrollit. Lidhje statistikore negative $p=0.086$.
- Mesatarja e vlerave të hormonit FSH të përdoruesit 4,24 mIU /ml krahasuar me 6,20 mIU /ml të grupit të kontrollit. Lidhje statistikisht e rëndësishme $p=0.027$.
- Mesatarja e vlerave të hormonit Testosteron të përdoruesit 391,31ng/ml krahasuar me 522,17ng/ml të grupit të kontrollit. Lidhje statistikisht e rëndësishme $p=0.029$

Konkluzione: Është e rëndësishme që individët të jenë të vetëdijshëm për mundësitë e efekteve të mundshme negative që sjell përdorimi i cannabis dhe të marrin vendime të kujdesshme lidhur me përdorimin e tij. Gjithashtu është e rëndësishme të kryhen studime të tjera për të kuptuar më tej mekanizmin e veprimit të kanabis në sistemin Hipotalomo-hipofizë si edhe masën e ndikimit të tij në këtë bilanc hormonal

Fjalë kyçe: Testosteron, LH, FSH, Kimilumineshencë direkte.

CANNABIS SATIVA AND MALE REPRODUCTIVE HEALTH*Griselda Korcari¹, Kleo Plaka², Jona Kerri³**¹Department of Medical Laboratory and Imaging Technology, Faculty of Medical Technical Sciences, Aldent University, Tirana**²Laboratory technician, Medline Medical Laboratory**³Pharmacotherapeutic Research Center, Faculty of Medical Sciences, Aldent University, Tirana**Email: Griselda.zacaj@ual.edu.al***ABSTRACT**

Introduction: Cannabis sativa is a plant known since ancient times for its various health benefits. Over the last decade, the consumption of marijuana or any other form of cannabis, whether medical, recreational or illegal, has escalated worldwide. Various current studies show that cannabis is likely to have negative impacts on male fertility mainly in the category of sperm parameters. There are also studies showing effects of cannabis on the levels of the hormones testosterone, luteinizing hormone and follicle stimulating hormone.

Methodology: About 40 volunteers from the city of Elbasan participated in this study, who were submitted to an anonymous questionnaire regarding the consumption of cannabis, the number of cigarettes they consumed, the duration of use, problems related to sexual performance. The participants in the study were men aged 15-44. 5ml venous blood samples were taken from the volunteers with a vacuum system (21GX3/) with gel tubes (Lot AG2502) that was used to measure the hormones Testosterone, LH and FSH. The samples were analyzed in the medical laboratory MedLine Lab on the ADVIA Centaur CP Immunoassay system with the analytical method of Direct Chemiluminescence.

Results: From the questionnaires it was found that 20 volunteers were users of cannabis sativa. The duration of the use of the narcotic substance was from 1-10 years. The average age of the volunteers was respectively 24.55 years for users and 23.7 years for non-users. The age group most affected by the use of cannabis sativa was 16-21 years (8 volunteers). From the comparison of the laboratory data of the hormone values between the control group and that user of the narcotic substance, it results that:

- Average values of the LH hormone in users 4.88 mIU/ml compared to 7.42 mIU/ml of the control group. There is no statistically significant relationship $p=0.086$.
- The average value of the FSH hormone in users 4.24 mIU /ml compared to 6.20 mIU /ml of the control group. Statistically significant relationship $p=0.027$.
- The average values of the hormone Testosterone in users 391.31ng/ml compared to 522.17ng/ml of the control group. Statistically significant relationship $p=0.029$

Conclusions: It is important for individuals to be aware of the potential negative effects of cannabis use and to make careful decisions about its use. It is also important to carry out other studies to further understand the mechanism of action of cannabis in the hypothalamo-pituitary system as well as the extent of its influence on this hormonal balance.

Keywords: Testosterone, LH, FSH, Direct chemiluminescence.

ROLI I TESTEVE LABORATORIKE TEK PACIENTET ME COVID-19

Brandi Fahriu¹, Doc. Elona Hasalla², Phd. Cand. Ilda Taka², Klajdi Tarko¹

*¹ Studentë Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit
“Aleksandër Xhuvani”*

*² Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit
Email:brandifahriu@gmail.com*

ABSTRAKT

Hyrje: Sëmundja koronavirus 2019 ose ndryshe njihet COVID-19 është një sëmundje infektive e shkaktuar nga sindromi i rëndë akut i frymëmarrjes SARS-COV-2. Sëmundja është përhapur globalisht që nga viti 2019, duke rezultuar në pandemi globale. Simptomat përfshijnë simptomat e aparatit të frymëmarrjes: ethe, kollë, marje fryme dhe vështirësi në frymëmarrje. Në raste më të rënda, infeksioni mund të shkaktojë pneumoni, sindromë të rëndë respiratore akute, insuficencë multi-organore, madje edhe vdekje. Laboratori luan një rol të rëndësishëm në diagnostikimin dhe monitorimin e pacienteve me COVID-19. Metoda standarde e diagnozës është me anë të teknikës RT-PCR nga një tampon nazofaringeal. Testet laboratorike rutinë janë përdorur për të vlerësuar ecurinë dhe gjendjen klinike të pacientit.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të hetojë dhe të analizojë shpeshtësinë e rasteve të diagnostikuara me COVID-19. Të kuptojmë rëndësinë e ekzaminimeve laboratorike në sëmundjen e COVID-19.

Metodologjia: Në këtë studim, u mbledhën të dhëna për pacientë të konfirmuar me Covid-19 gjatë periudhës Prill 2020 - Shkurt 2021. Të dhënat janë mbledhur në disa laboratore privatë në qytetin e Elbasanit. Për çdo pacient u analizuan të dhënat klinike dhe laboratorike.

Rezultate dhe konkluzione: Njohja me popullatën dhe grupmoshat me të prekura nga kjo sëmundje. Ky studim evidentoi rëndësinë e ekzaminimeve laboratorike në vendosjen e diagnozës dhe prognozës së pacientëve me Covid-19. Njohja me ekzaminimet e ndryshme laboratorike që kryhen në rastet kur dyshohet për preken e pacientëve me COVID-19.

Fjalë kyçe: COVID-19, ekzaminim laboratorik, PCR, tampon nazofaringeal.

ESCHERICHIA COLI AS THE PRIMARY CAUSE OF URINARY INFECTIONS

Aida Toli¹, Jona Berdufi¹, Kostandina Tila¹, Venemin Gega²

¹Msc, Laboratory Technician, Faculty of Medical Technical Sciences, University of Medicine, Tirana

²As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

Email:aidatoliii@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Urinary tract infections are one of the most common infections after respiratory infections. In most cases these infections do not cause complications and are easily treated, but in some cases the infection reaches the kidneys causing damage to them. To consider a urinary infection in addition to the clinic, the laboratory is the one that helps and establishes the final diagnosis through laboratory parameters. Studies conducted around the world show that Escherichia coli is the primary cause of urinary infections.

Purpose: The purpose of this study is to identify the bacterium that causes the most urinary infections.

Methodology: This study is a retrospective study in which 210 male and female patients were studied. These individuals were presented to a non-public laboratory in the city of Elbasan to perform laboratory examinations, such as complete urine and urine culture, which are important tests to assess the presence of urinary infection and the bacteria that cause it. For each study subject, the bacteria responsible for the infection was discovered, and sociodemographic data such as: age, gender, place of residence, and the antibiotic used were recorded. The data were collected during the period January-June 2023.

Results: Out of 210 positive urine cultures taken in the study, it was found that 180 of them have Escherichia coli bacteria present, the most affected gender is the female gender and the most predisposed age group was the 40-49 age group.

Conclusions: Laboratory tests together with clinical signs should be carefully evaluated in determining the diagnosis of ITU. This study highlighted the importance of clinical examination of urine and urine culture in establishing the diagnosis of ITU, and the causes of ITU.

Keywords: escherichia coli, urinary infection, urine culture, laboratory

INFEKSIONET VAGINALE

Klara Hysenaj¹, Rezarta Stena¹, Elona Dybeli¹, Blerina Bani¹

¹ Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Klara.hysenaj@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Infeksionet vaginale përfaqësojnë një nga problemet më të mëdha të shëndetit tek femrat. Këto infeksione mund të shkaktohen nga baktere, viruse apo kërpudha. Ato mund të shkaktojnë diskonfort në zonat intime, prurit, djegie, sekrecione jo normale vaginale, dhimbje gjatë urinimit, dhimbje gjatë mardhenieve seksuale etj.

Infeksionet vaginale ndahen në disa grupe kryesore :

- Infeksionet bakteriale të shkaktuara nga;Gonorrhea, klamidia, sifilizi, klebsiellagranumolatis
- Infeksionet virale të shkaktuara nga;HIV, herpes genitalis, lythet genitale, citomegalovirusi
- Infeksionet mykotike të shkaktuara nga; candida albicans, trichomonas vaginalis

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i shpeshtësisë së këtyre infeksioneve në një periudhë 2 mujore (shkurt-mars) dhe identifikimi i problemeve që ato sjellin në shëndetin riprodhues dhe jo vetëm. Në këtë studim jemi munduar të hedhim dritë mbi shkaktarët kryesorë të këtyre infeksioneve kryesisht atyre që njihen deri tani dhe faktorëve idiopatik.

Metodologjia: Ky studim u mbështet tek të dhënat demografike(të marra nga administrata e qëndrave shëndetësore) dhe laboratorike (të mbledhura nga laboratorë të ndryshëm në zonën që kemi marrë në studim). Ekzaminimet më të shpeshta të përdorura tek këta pacient janë kryesisht strishot vaginale, analizat e urinës, PAP test(të marra nga qëndrat shëndetësore) etj.

Rezultatet: Në studim u përfshin 928 femra të grupmoshave nga 19-70 vjeç, konkretisht 139 femra të grupmoshës 19-25 vjeç, 205 femra të grupmoshës 26-34 vjeç dhe 584 femra të grupmoshës 35-70 vjeç. Nga rezultatet u vu re se infeksionet më të përhapura ishin ato mykotike me 41 raste konkretisht 8 raste në grupmoshën 19-25 vjeç 20 raste në grupmoshën 26-34 vjeç dhe 13 raste në grupmoshën 36-70 vjeç. Me lythe genitale ishin 13 raste , me sifiliz 1 rast .

Konkluzioni: Në përfundim u vu re që shkaktarët kryesorë të infeksioneve vaginale ishin; marrëdhëniet seksuale të pambojtura, higjiena e ulët personale, përdorimi në masë i antibiotikëve. Nga rezultatet dolëm në përfundim që femrat e çdo grupmoshe preken më tepër nga infeksionet mykotike në krahasim me infeksionet nga lythet genitale, apo nga sifilizi që kishin një probabilitet më të ulët.

Fjalet kyçe: Infeksione, IST, Laborator, Mykotik, Strisho.

VAGINAL INFECTIONS

Klara Hysenaj¹, Rezarta Stena¹, Elona Dybeli¹, Blerina Bani¹

¹ University of Elbasan "Aleksander Xhuvani", Faculty of Technical Medical Sciences

Klara.hysenaj@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Vaginal infections represent one of the biggest health problems in women. These infections can be caused by bacteria, viruses, or fungi. They can cause discomfort in intimate areas, pruritus, burning and abnormal vaginal secretions, pain during urination, pain during sexual intercourse, etc.

Vaginal infections are divided into several main groups:

- Bacterial infections caused by; Gonorrhoea, chlamydia, syphilis, klebsiella granulomatis
- Viral infections caused by; HIV, genital herpes, genital warts, cytomegalovirus
- Fungal infections caused by; candida albicans, trichomonas vaginalis

Purpose: The purpose of this study is to identify the frequency of these infections in 2 months (February-March) and to identify the problems they bring to reproductive health and beyond. In this study, we tried to shed light on the main causes of these infections, mainly those known so far and idiopathic factors.

Methodology: This study was based on demographic data (obtained from the administration of health centers) and laboratory data (collected from different laboratories in the area we studied.). The most frequent examinations used in these patients are mainly vaginal smears, urine tests, PAP tests (obtained from health centers), etc.

Results: The study included 928 women aged 19-70, specifically 139 women aged 19-25, 205 women aged 26-34, and 584 women aged 35-70. From the results, it was observed that the most widespread infections were fungal infections with 41 cases, specifically 8 cases in the age group of 19-25 years, 20 cases in the age group of 26-34 years, and 13 cases in the age group of 36-70 years. Genital warts were 13 cases, syphilis 1 case.

Conclusion: In conclusion, it was observed that the main causes of vaginal infections were; unclean sexual relations, poor personal hygiene, and mass use of antibiotics. From the results, we concluded that women of any age group are more affected by fungal infections compared to infections from genital warts, or from syphilis which had a lower probability.

Keywords: Infections, STI, Laboratory, Mycotic, Strain.

INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR TEK STUDENTËT E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR TEKNIK LABORATORI

Erjolda Rexhep¹, Rafaela Lala¹, Bjanka Bardhi¹, Venemin Gega²

¹Studentë, Dega Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

²As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Email: erjolda.rexhep@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Infeksionet e traktit urinar (ITU), u referohen pranisë së inflamacionit të traktit urinar, si pasojë e prezencës së agjentëve patogjen të ndryshëm. Ato mund të prekin çdo pjesë të aparatit urinar qoftë veshkat, ureterët, uretrën apo vezikën urinare. Ato kanë një përhapje të gjerë të gjithë grupmoshat si dhe në të dyja gjinitë. Simptomat tipike përfshijnë urgjencë për të urinuar, dhimbje gjatë urinimit, poliuri, polidipsi apo dhimbje lumbare.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është që të vlerësojmë njohuritë e studentëve të degës Teknik Laboratori përsa i përket infeksioneve të traktit urinar, mënyrës së identifikimit dhe mënyrës së ekzaminimit të tyre nëpërmjet ekzaminimeve të ndryshme. Të përshkruhen karakteristikat e grup popullatës së marrë në studim si dhe të përcaktohen shkaktarët kryesorë patogjene të infeksioneve të traktit urinar.

Metodologjia: Studimi është realizuar tek studentët e programit të studimit Bachelor Teknik Laboratori, viti i tretë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Elbasanit. Studimi u realizua nëpërmjet një pyetësoi, pjesë e të cilit u bënë studentët e moshës 20-25 vjeç, të cilëve iu morën të dhëna demografike, të dhëna lidhur me manifestimet klinike dhe të dhëna në lidhje me ekzaminimet e ndryshme të kryera.

Rezultatet: Prej 50 studentëve që u përfshinë në studim, 43 studentë janë femra dhe 7 studentë janë meshkuj. Moshë që rezultoi më e prekur nga infeksionet e traktit urinar është moshë 21 vjeç. Në ekzaminimet laboratorike mikrobiologjike rezultoi që E.coli është bakteri përgjegjës për pjesën më të madhe të infeksioneve.

Konkluzione: Nga studimi arritëm në konkluzionin se femrat kanë një rrezik më të lartë për t'u prekur nga infeksionet e traktit urinar krahasuar me meshkujt. Manifestimet klinike dhe ekzaminimet laboratorike duhen parë me kujdes për të përcaktuar diagnozën dhe prognozën e ITU-ve. Ky studim theksoi rëndësinë që ka ekzaminimi klinik dhe ai laboratorik si urokultura, analiza e urines komplet, strishot vaginale për të vendosur diagnozën e ITU-ve tek studentët.

Fjalë kyç: Infeksion, Student, Trakti urinar, Urokulturë.

URINARY TRACT INFECTIONS IN LABORATORY TECHNICIAN BACHELOR STUDY PROGRAM STUDENTS

Erjolda Rexhep¹, Rafaela Lala¹, Bjanka Bardhi¹, Venemin Gega²

¹Students, Study program Laboratory Technician, Faculty of Medical and Technical Sciences, University of Elbasan "Aleksander Xhuvani"

²As/Lecturer, Faculty of Technical and Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksander Xhuvani"

Email: erjolda.rexhep@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Urinary tract infections (UTIs) refer to the presence of inflammation of the urinary tract, as a result of the presence of various pathogenic agents. They can affect any part of the urinary system, the kidneys, ureters, urethra or bladder. They have a wide distribution in all age groups as well as in both sexes. Typical symptoms include urgency to urinate, pain during urination, polyuria, polydipsia or lumbar pain.

Purpose: The purpose of this study is to evaluate the knowledge of Laboratory Technician students regarding urinary tract infections, how to identify them and how to examine them through different examination methods. To describe the characteristics of the population group studied and to determine the main pathogenic causes of urinary tract infections.

Methodology: The study was conducted among the students of the Laboratory Technician Bachelor study program, the third year in the faculty of Technical and Medical Sciences at the University of Elbasan. The study was carried out through a questionnaire, which included students aged 20-25 years, from them were taken demographic data, data related to clinical manifestations, and data related to the various examinations performed.

Results: From 50 students who were included in the study, 43 students are female and 7 students are male. The most affected age by urinary tract infections is the age of 21. Microbiological laboratory examinations showed that E.coli is the bacterium responsible for most of the infections.

Conclusions: From the study we came to the conclusion that women have a higher risk of being affected by urinary tract infections compared to men. Clinical manifestations and laboratory examinations should be carefully considered to determine the diagnosis and prognosis of UTIs. This study emphasized the importance of clinical and laboratory examinations such as uroculture, routine urinalysis test, vaginal swabs to establish the diagnosis of UTIs in students.

Keywords: infection, students, urinary tract, uroculture.

FAKTORËT RISKUES TË SËMUNDJEVE KARDIOVASKULARE NË STUDENTËT E DEGËS TEKNIK LABORATORI

Kristina Olldashi¹, Jorida Cupi¹, Majlinda Manxhuku¹, Evisa Beqiri¹, Venemin Gega²

*¹Studentë, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,
Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”*

*²As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit
“Aleksandër Xhuvani”*

kristinaolldashi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Sëmundjet kardiovaskulare (SKV) janë shkaktari kryesor i vdekjeve të parakohshme si dhe invaliditetit të miliona njerëzve në botë. SKV janë një term i gjerë dhe përfshijnë një sërë sëmundjesh që ndikojnë në zemër, tru dhe në enët e gjakut. Faktorët riskues të SKV përfshijnë përdorimin e duhanit, inaktivitetin fizik, dietën jo të shëndetshme, përdorimin e dëmshëm të alkoolit, hipertensionin arterial, diabetin, dislipideminë, mbipeshën, obezitetin dhe predispozicionin gjenetik.

Qëllimi: Në këtë studim qëllimi kryesor është njohja me faktorët riskues të Sëmundjeve Kardiovaskulare te studentët e degës Teknik Laboratori në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike” në Universitetin e Elbasanit.

Metodologjia: Studimi është realizuar tek studentët e degës Teknik Laboratori, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Elbasanit. Për çdo student që u bë pjesë e studimit, u plotësua një pyetësor ku u regjistruan të dhëna të përgjithshme sociodemografike si: mosha, gjinia, vendbanimi ; të dhëna antropometrike si pesha, gjatësia për përcaktimin e BMI, të dhëna mbi faktorët riskues për sëmundje kardiovaskulare atherosklerotike si hipertensioni, duhanpirja, konsumi i alkoolit, diabeti mellitus, obeziteti, faktorët gjenetike.

Rezultatet: Prej 50 studentëve që u përfshinë në studim, 40 studentë janë femra dhe 10 studentë janë meshkuj. Studentët e përfshirë në studim i përkasin moshës 20-25 vjeç. Në këtë studim faktorët riskues prezente për SKV rezultuan: mbipesha, obeziteti, duhanpirja, konsumi i alkoolit, predispozita gjenetike.

Konkluzione: Faktorët e riskut janë të pranishëm në disa studentë pjesëmarrës në studim. Nevojiten fushata sensibilizuese për njohjen, menaxhimin dhe parandalimin e faktorëve të riskut kardiovaskular.

Fjalë kyçe: faktorë risku, sëmundje kardiovaskulare, studentë, teknik laborator

RISK FACTORS OF CARDIOVASCULAR DISEASES IN LABORATORY TECHNICIAN BRANCH STUDENTS

Kristina Olldashi¹, Jorida Cupi¹, Majlinda Manxhuku¹, Evisa Beqiri¹, Venemin Gega²

¹Students, Laboratory Technician, Faculty of Medical and Technical Sciences,

University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

²As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan

"Aleksander Xhuvani"

kristinaolldashi@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Cardiovascular diseases (CVD) are the main cause of premature death and disability of millions of people in the world. CVD is a broad term and includes a variety of diseases that affect the heart, brain and blood vessels. Risk factors for CVD include tobacco use, physical inactivity, unhealthy diet, harmful use of alcohol, arterial hypertension, diabetes, dyslipidemia, overweight, obesity and genetic predisposition.

Purpose: In this study, the main purpose is to get to know the risk factors of Cardiovascular Diseases among the students of the Laboratory Technician branch at the Faculty of Medical and Technical Sciences at the University of Elbasan.

Methodology: The study was carried out among the students of the Laboratory Technician branch, at the Faculty of Medical and Technical Sciences at the University of Elbasan. For each student who took part in the study, a questionnaire was filled in, where general sociodemographic data such as: age, gender, place of residence were recorded; anthropometric data such as weight, height for determining BMI, data on risk factors for atherosclerotic cardiovascular diseases such as hypertension, smoking, alcohol consumption, diabetes mellitus, obesity, genetic factors.

Results: Of the 50 students who were included in the study, 40 students are female and 10 students are male. The students included in the study belong to the age group of 20-25 years. In this study, the present risk factors for CVD were found to be: overweight, obesity, smoking, alcohol consumption, genetic predisposition.

Conclusions: Risk factors are present in some students participating in the study. Awareness campaigns are needed for the recognition, management and prevention of cardiovascular risk factors.

Keywords: risk factors, cardiovascular disease, students, laboratory technician.

NDRYSHIMET LABORATORIKE TEK PACIENTËT ME MIELOMË MULTIPLE

Ligerta Hasanaj¹, Venemin Gega²

¹MsC,Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

²As/Lektor,Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani"

Email: ligertahasanaj@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Mieloma multiple është një cregullim neoplazik malinj i qelizave plazmatike dhe karakterizohet nga klinika e infeksionit, nefropatisë dhe sëmundjeve kockore. Zbulimi i hershëm i mielomës mund të jetë i vështirë për pacientët të cilët nuk i nënshtrohen ekzaminimeve laboratorike dhe imazherike në mënyrë rutinë dhe kjo bën që mieloma multiple të diagnostifikohet në raste të avancuara me komplikacione renale, hematologjike, të skeletit etj.

Qëllimi: Të paraqiten ndryshimet laboratorike biokimike, imunologjike dhe hematologjike tek pacientët e diagnostikuar me mielomë multiple, duke vlerësuar parametrat që pesojnë më shumë ndryshime.

Metodologjia:Duke u bazuar në një studim transversal dhe deskriptiv, u morën në studim 34 raste të diagnostikuara me mielomë multiple, në periudhën kohore Shkurt 2019 - Prill 2022, në QSUT(Qendra Spitalore Universitare Nënë Teraza) dhe në SRD(Spitalin Rajonal të Durrësit). Pacientet ishin të grupmoshës 24-72 vjeç dhe u vlerësuan bazuar në ndryshimet laboratorike më të shpeshta të pranishme të shfaqura në hemogramë, mielogramë, imunoelktroforezë, bilancin biokimik dhe urinën 24 h.

Rezultatet: Nga një total prej 34 pacientesh, 65% e subjekteve ishin meshkuj dhe vetëm 35% ishin femra, me moshë mesatare 50 vjeç. Ndryshime më të shpeshta u vunë re në hemogramë me një ulje në numrin e eritrociteve dhe hemoglobinës në 91 % të rasteve.Në mielogramë kishte një predominim të plazmociteve mbi 60% në 35% të subjekteve. Në imunoelktroforezë kishim rritje të IgG në 56% të rasteve, krahasuar me Ig e tjera. Azoti dhe kreati ishin të rritura në 59 % të rasteve,proteinat totale ishin rritur në 35% të rasteve dhe kalciumi pa në 24% të rasteve. Ndersaprania e proteinës Bence Jones dhe B-microglobulinës ishte e karakteristike e sëmundjes.

Konkluzioni:Të gjithë pacientet shfaqën ndryshime të theksuara në parametrat laboratorik, kryesisht në mielogramë dhe hemogramë, ndjekur nga testet e tjera imunologjike dhe biokimike, ku rëndësi të vecante duhet ti kushtohet pranisë së proteinave Bence Jones në urinë dhe B-mikroglobulinës pasi janë karakteristike të sëmundjes.

Fjalë kyçe: Mieloma multiple, mielogramë, hemogramë, teste biokimike, proteinat Bence Jones.

LABORATORY CHANGES IN PATIENTS WITH MULTIPLE MYELOMA

Ligerta Hasanaj¹, Venemin Gega²

¹MSc, Laboratory Technician, Faculty of Technical Medical Sciences, Tirana University of Medicine.

²As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksander Xhuvani"

Email: ligertahasanaj@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Multiple myeloma is a malignant neoplastic disorder of plasma cells and is characterized by the clinical features of infection, nephropathy and bone diseases. Early detection of myeloma can be difficult for patients who do not undergo laboratory and imaging examinations routinely, and this causes multiple myeloma to be diagnosed in advanced cases with renal, hematological and skeletal complications, etc.

Purpose: To present biochemical, immunological and hematological laboratory changes in patients diagnosed with multiple myeloma, evaluating the parameters that get effected the most.

Methodology: Based on a transversal and descriptive study, 34 cases diagnosed with multiple myeloma were studied, in the period February 2019 - April 2022, at QSUT (Mother Teraza University Hospital Center) and at SRD (Durrës Regional Hospital). The patients were in the age group of 24-72 years and were evaluated based on the most frequent laboratory changes present in hemogram, myelogram, immunoelectrophoresis, biochemical balance and urine.

Results: From a total of 34 patients, 65% of the subjects were male and only 35% were female, with an average age of 50 years. Most frequent changes were observed in hemogram with a decrease in the number of erythrocytes and hemoglobin in 91% of cases. In myelogram there was a predominance of plasma cells over 60% in 35% of the subjects. We had increased of IgG in 56% of cases in immunoelectrophoresis, compared to other Ig. Urea and creatine were elevated in 59% of cases, total protein was elevated in 35% of cases, and calcium was observed in 24% of cases. While the presence of Bence Jones protein and B-microglobulin was characteristic of the disease.

Conclusion: Laboratory changes was observed, mainly in myelogram and hemogram, followed by other immunological and biochemical tests, where special importance should be given to the presence of Bence Jones proteins in urine and B-microglobulin as they are characteristic of the disease.

Keywords: Multiple myeloma, myelogram, hemogram, biochemical tests, Bence Jones proteins.

RËNDËSIA E TESTIT TË ELEKTROFOREZËS NË DETEKTIMIN E HEMOGLOBINOPATIVE

Rafaëla Lala¹, Klara Hysenaj²

¹MscTeknik Laboratori, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, lalarafaëla30@gmail.com

²As/Lektore, Departamenti i Lëndëve Klinike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Klara.hysenaj@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrja: Të dhënat statistikore të OBSH tregojnë se më shumë se 70 milionë individë janë mbartës të hemoglobinopative në të gjithë botën, prej të cilëve rreth 10 milionë individë jetojnë në zonën e Mesdheut Lindor. Ndërkohë në Shqipëri janë identifikuar aktualisht rreth 530 pacientë të diagnostikuar me hemoglobinopati. Këto shifra sa vijnë e rriten nga viti në vit prandaj është e domosdoshme të merren masa për parandalimin e formave homozigote homogjene apo heterogjene. Një formë parandalimi tepër e rëndësishme konsiderohet elektroforeza, e cila përcakton nivelet e llojeve të ndryshme të hemoglobinës në gjak ose praninë e hemoglobinës anormale.

Qëllimi: Sensibilizimi i popullatës mbi rëndësinë që ka kryerja e testit të elektroforezës për zbulimin e patologjive që shoqërohen me çrregullime të hemoglobinës të tilla si: talasemia, drepanocitoza apo sëmundja e hemoglobinës C, dhe parandalimi i formave major apo intermedia të sindromit talasemik dhe drepanocitës nëpërmjet realizimit të elektroforezës apo testeve të tjera gjenetike.

Materialet dhe Metodadat: Studimi u realizua në sajë të një pyetësori, pjesë e të cilit u bënë pacientë të grupmoshave të ndryshme (18-45 vjeç) si dhe anëtarë të kujdesit shëndetësor. Në studim u përfshinë 55 subjekte dhe u shqyrtuan 15 raste. Rastet e marra i përkasin periudhës kohore Qershor 2023 – Gusht 2023.

Rezultatet: Nga 54 pacientë që u morën në studim 32 ishin femra dhe 22 meshkuj. Mosha mesatare rezultoi 36 vjeç. Sipas pyetësorit 41 pacientë ishin informuar mbi rëndësinë që ka elektroforeza për detektimin e hemoglobinopative, por vetëm 8 prej tyre kanë kryer testin e elektroforezës. Nga ana tjetër nëpërmjet të dhënave të marra nga stafi i kujdesit shëndetësor u arrit në përfundimin se nga muaji Qershor 2023 deri më Gusht 2023 janë kryer 15 teste të elektroforezës. Prej tyre 3 pacientë kanë rezultuar pozitive, përkatësisht një pacient i diagnostikuar me talasemi minor dhe dy pacientë të diagnostikuar me drepanocitozë heterozigotë.

Konkluzionet: Hemoglobinopatitë konsiderohen ndër patologjitë më të përhapura jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën e megjithatë popullata ende nuk ka edukimin e duhur shëndetësor lidhur me to. Ky studim thekson në mënyrë të veçantë rëndësinë që ka elektroforeza në detektimin e hemoglobinopative dhe në parandalimin e shtimit të rasteve pozitive.

Fjalë kyçe: diagnostikim, elektroforeza, hemoglobinopati, mbartës, parandalim.

IMPORTANCE OF THE ELECTROPHORESIS TEST IN THE DETECTION OF HEMOGLOBINOPATHY

Rafaela Lala¹, Klara Hysenaj²

¹ Msc Laboratory Technician University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani”, Faculty of Technical Medical Sciences lalarafaela30@gmail.com

² Ass/lecturer, Department of Clinical Subjects Faculty of Technical Medical Sciences

Klara.hysenaj@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction: The statistical data from WHO show that more than 70 million individuals are carriers of hemoglobinopathies worldwide, of which approximately 10 million individuals live in the Eastern Mediterranean area. Meanwhile, in Albania have been identified about 530 patients diagnosed with hemoglobinopathy. These figures keep increasing from year to year, so it is necessary to take measures to prevent homozygous, homogeneous or heterogeneous forms. An extremely important form of prevention is considered electrophoresis, which determines the levels of different types of hemoglobin in the blood or the presence of abnormal hemoglobin.

Purpose: Awareness of population on the importance of performing the electrophoresis test for the detection of pathologies associated with hemoglobin disorders such as: thalassemia, sickle cell disease or hemoglobin C disease, and the prevention of major or intermediate forms of thalassemic and sickle cell syndrome through performing electrophoresis or other genetic tests.

Materials and Methods: The study was based on a questionnaire, which included patients of different age groups (18-45 years) as well as health care members. 55 subjects were included in the study and 15 cases were examined. The cases received belong to the time period June 2023 - August 2023.

Results: From 54 patients who were included in the study, 32 were women and 22 were men. The average age was 36 years. According to the questionnaire, 41 patients were informed about the importance of electrophoresis for the detection of hemoglobinopathies, but only 8 of them have performed the electrophoresis test. On the other hand, through the data obtained from the health care members, it was concluded that from June 2023 to August 2023, 15 electrophoresis tests were performed. Of them, 3 patients resulted positive, respectively one patient diagnosed with thalassemia minor and two patients diagnosed with heterozygous sickle cell disease.

Conclusions: Hemoglobinopathies are considered among the most widespread pathologies not only in Albania, but throughout the world, and yet the population still does not have the proper health education regarding them. This study particularly emphasizes the importance of electrophoresis in the detection of hemoglobinopathies and in preventing the increase of positive cases.

Keywords: diagnosis, electrophoresis, hemoglobinopathy, carriers, prevention.

RËNDËSIA E EKZAMINIMEVE LABORATORIKE TEK BEBET PREMATURE*Kasandra Allushi¹**¹ Laborante, Laboratori i Maternitetit “Mbreteresha Geraldine”***ABSTRAKT**

Hyrje: Bebet premature janë bebe që lindin para javës së 37. Duke qenë se ato lindin në një kohë ku organet e tyre nuk janë të maturuar mjaftueshëm ato janë të ekspozuar ndaj një sërë komplikacionesh ku më të shpeshta janë: hipoksia, detresi respirator, anemi, ikter, infeksione apo probleme të traktit gastro intestinal dhe sistemit nervor. Mostrat për ekzaminim laboratorik tek bebet premature merren që në minutat e para pas lindjes dhe kanë një rëndësi të veçantë në 72 orët e para të jetës e derisa bebet dalin nga kujdesi i terapisë intensive. Faza preanalitike në marrjen e mostrave në këtë grup pacientësh është shumë e rëndësishme pasi gabimet në këtë fazë bëhen më të dukshme në rezultatin e testeve.

Qellimi: Qëllimi i këtij punimi është të tregojë rëndësinë e ekzaminimeve laboratorike në parandalimin dhe trajtimin e patologjive dhe komplikacioneve tek bebet premature.

Metodologjia: Nga shërbimi i terapisë intensive në repartin e neonatologjisë në maternitetin Mbretëresha Geraldinë u morën në studim 50 raste të bebeve lindur premature. Nëpërmjet sistemit Lis (sistemit të informacionit të laboratorit) u morën të dhënat e të gjitha testeve të kryera për secilin bebe nga momenti i lindjes deri në momentin e ndërprerjes së kujdesit nga reparti i neonatologjisë.

Rezultatet: Nga të dhënat e marra nga shërbimi i terapisë intensive dhe sistemi i informacionit të laboratorit rezultoi që nga 50 bebe premature, 32 janë meshkuj dhe 28 janë femra.

Konkluzione: Ekzaminimet laboratorike kanë një rëndësi të veçantë në identifikimin e patologjive dhe komplikacioneve si edhe monitorimin e bebeve premature. Gjatë gjithë procesit të kujdesit të repartit të neonatologjisë i cili zgjat disa javë apo muaj, testet laboratorike kanë rol kyç në monitorimin dhe mjekimin e këtyre pacientëve.

Fjalë kyç: ekzaminime laboratorike, maternitet, bebe premature, neonatologji, Lis

THE IMPORTANCE OF LABORATORY EXAMINATIONS IN PREMATURE BABIES

Kasandra Allushi¹

¹ Laboratory technician, "Queen Geraldine" Maternity Laboratory

ABSTRACT

Introduction: Premature babies are babies who are born before week 37. Since they are born at a time when their organs are not mature enough, they are exposed to a series of complications, the most common of which are: hypoxia, respiratory distress, anemia, jaundice, infections or problems of the gastro-intestinal tract and the nervous system. Samples for laboratory examination in premature babies are taken in the first minutes after birth and are of particular importance in the first 72 hours of life until the babies leave intensive care. The preanalytical phase in sampling in this group of patients is very important as errors in this phase become more visible in the test results.

Purpose: The purpose of this paper is to show the importance of laboratory examinations in the prevention and treatment of pathologies and complications in premature babies.

Methodology: From the intensive care service in the neonatology department at the Queen Geraldine maternity hospital, 50 cases of babies born prematurely were studied. Through the Lis system (laboratory information system), the data of all tests performed for each baby from the moment of birth to the moment of termination of care from the neonatology department were obtained.

Results: From the data obtained from the intensive care service and the laboratory information system, it was found that out of 50 premature babies, 32 are male and 28 are female.

Conclusions: Laboratory examinations have a special importance in identifying pathologies and complications as well as monitoring premature babies. Throughout the care process of the neonatology department, which lasts several weeks or months, laboratory tests have a key role in the monitoring and treatment of these patients.

Keywords: laboratory examinations, maternity, premature babies, neonatology, Lis

VLERAT E VITAMISËS D NE POPULLATËN ADULTE TË QYTETIT TË ELBASANIT

Sidorela Berati¹, Venemin Gega², Vjola Shkira³

¹ Laborante, Laboratory Network, Elbasan

²As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit

“Aleksandër Xhuvani”

³Laborante, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut

Email: beratisidorela@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Vitamina D, e njohur shpesh si "vitamina e diellit", ka tërhequr vëmendje të konsiderueshme vitet e fundit për shkak të roleve të saj në ruajtjen e shëndetit të njeriut, me fokus kryesor në shëndetin e kockave, funksionin e sistemit imunitar dhe parandalimin e sëmundjeve. Është e rëndësishme që individët të sigurojnë se kanë nivele adekuate të vitaminës D përmes një kombinimi të ekspozimit të ndjeshëm ndaj diellit, burimeve dietike dhe monitorimit të rregullt të vlerës të saj në serum për të promovuar mirëqenien e përgjithshme. Vitet e fundit mungesa e vitaminës D është bërë një problem i madh i shëndetit publik në mbarë botën.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë vlerat në serum të vitaminës D në popullatën adulte të qytetit të Elbasanit.

Metodologjia: Në këtë studim morën pjesë 72 pacientë, të cilët kryen matje të nivelit të vitaminës D në një laborator privat në qytetin e Elbasanit. Të dhënat u mbledhën përgjatë muajve Mars-Qershor 2023.

Rezultatet: Nga 72 pacientë të përfshirë në studim 54 rezultuan femra dhe 18 meshkuj. Nga rezultatet e analizave laboratorike 46 paciente rezultuan me vlera normale të vitaminës D në serum, ndërsa 26 pacientë me pamjaftueshmëri ose mangësi të vitaminës D.

Konkluzione: Në një epokë ku mungesa e vitaminës D mbetet një shqetësim global për shëndetin, kuptimi i rëndësisë së saj dhe zbatimi i strategjive efektive për parandalimin dhe menaxhimin janë të një rëndësie të madhe. Nevojiten kërkime të mëtejshme, iniciativa të shëndetit publik dhe udhëzime klinike për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse mungesën e vitaminës D. Duke vepruar kështu, ne mund të punojmë kolektivisht drejt përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies së individëve dhe komuniteteve në mbarë botën.

Fjalë kyçe: Elbasan, vitaminë D, popullatë, pacientë

VALUES OF VITAMIN D IN THE ADULT POPULATION OF THE CITY OF ELBASAN

Sidorela Berati¹, Venemin Gega², Vjola Shkira³

¹ Laboratory Technician, Laboratory Network, Elbasan

²As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan

"Aleksander Xhuvani"

³Laboratory technician, National Center of Blood Transfusion

Email: beratisidorela@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Vitamin D, often known as the "sunshine vitamin", has attracted considerable attention in recent years due to its roles in maintaining human health, with a primary focus on bone health, immune system function, and prevention of diseases. It is important that individuals ensure they have adequate levels of vitamin D through a combination of sensible sun exposure, dietary sources, and regular monitoring of its serum value to promote overall well-being. In recent years, vitamin D deficiency has become a major public health problem worldwide.

Purpose: The purpose of this study is to evaluate the serum values of vitamin D in the adult population of the city of Elbasan.

Methodology: 72 patients participated in this study, who performed vitamin D level measurements in a private laboratory in the city of Elbasan. The data were collected during the months of March-June 2023.

Results: Of the 72 patients included in the study, 54 were female and 18 were male. From the results of the laboratory tests, 46 patients showed normal levels of vitamin D in the serum, while 26 patients had insufficiency or deficiency of vitamin D.

Conclusions: In an era where vitamin D deficiency remains a global health concern, understanding its importance and implementing effective strategies for prevention and management are of paramount importance. Further research, public health initiatives, and clinical guidelines are needed to comprehensively address vitamin D deficiency. By doing so, we can collectively work toward improving the health and well-being of individuals and communities around the world.

Keywords: Elbasan, vitamin D, population, patients

KOLONIZIMI I TRAKTIT GASTROINTENSTINAL NGA CANDIDA ALBICANS

Venemin Gega¹, Gjergji Doka¹, Arkida Skenderi¹, Ilma Toçi¹, Rajmonda Hida¹,

Prof. Asoc. Dr Admir Nake²

¹As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit

“Aleksandër Xhuvani”

² Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

ABSTRAKT

Hyrje: Candida Albicans nuk është vetëm një përbërës i zakonshëm i traktit gastrointestinal të njerëzve, por gjithashtu një shkaktar i rëndësishëm i infeksioneve fungale në mbarë botën dhe për këtë arsye konsiderohet një patogjen oportunist. Në rrethana të caktuara, si përdorimi i antibiotikëve, kur mikrobiota dhe mbrojtja imune janë të dëmtuara, rritja e tepërt e Candida mund të çojë në infeksione të lokalizuara ose sistemike, duke shkaktuar simptoma klinike si pasojë e dëmtimit të mukozës, inflamacionit ose infeksioneve sistemike, shpeshhere kërcënuese për jetën.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i ngarkesës së Candida Albicans në grupin e pacientëve të marrë në studim. Të përshkruhen karakteristikat e grup popullatës së marrë në studim.

Metodologjia: Studimi është realizuar në periudhën kohore Mars - Korrik 2023 në qytetin e Elbasanit. Janë mbledhur të dhënat demografike dhe laboratorike të pacienteve që kryenin analizën e feçes përgjatë kësaj periudhe kohore. Metoda diagnostike përfshiu kulturën mikrobiologjike të feçes.

Rezultatet: Nga studimi arritëm në konkluzionin se Candida Albicans është prezente në grupin e pacientëve të marrë në studim. Nga 100 pacientë që u përfshinë në studim, 66 ishin femra dhe 34 meshkuj. Në ekzaminimet laboratorike mikrobiologjike 78 pacientë rezultuan pozitive me Candida Albicans në traktin gastrointestinal.

Konkluzione: Ky studim theksoi rëndësinë që ka ekzaminimi laboratorik në vendosjen e diagnozës për praninë e Candida Albicans në traktin gastrointestinal. Rekomandohen fushata sensibilizuese për të përmirësuar strategjitë për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e kandidozës.

Fjalë kyçe: candida albicans, ekzaminimi laboratorik, pacientë, trakti gastrointestinal

COLONIZATION OF THE GASTROINTENSTINAL TRACT BY CANDIDA ALBICANS

Venemin Gega¹, Gjergji Doka¹, Arkida Skenderi¹, Ilma Toçi¹, Rajmonda Hida¹,

Prof. Asoc. Dr Admir Nake²

¹As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit

“Aleksandër Xhuvani”

² Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

ABSTRACT

Introduction: Candida Albicans is not only a common component of the gastrointestinal tract of humans, but also an important cause of fungal infections worldwide and is therefore considered an opportunistic pathogen. Under certain circumstances, such as the use of antibiotics, when the microbiota and immune defenses are impaired, Candida overgrowth can lead to localized or systemic infections, causing clinical symptoms as a result of mucosal damage, inflammation or systemic infections, often life-threatening.

Purpose: The purpose of this study is to determine the load of Candida Albicans in the group of patients included in the study. To describe the characteristics of the population group taken in the study.

Methodology: The study was carried out in the period March - July 2023 in the city of Elbasan. The demographic and laboratory data of the patients who performed the fecal analysis were collected during this time period. The diagnostic method included the microbiological culture of feces.

Results: From the study we came to the conclusion that Candida Albicans is present in the group of patients taken in the study. Of the 100 patients who were included in the study, 66 were women and 34 were men. In microbiological laboratory examinations, 78 patients tested positive for Candida Albicans in the gastrointestinal tract.

Conclusions: This study highlighted the importance of laboratory examination in establishing the diagnosis for the presence of Candida Albicans in the gastrointestinal tract. Awareness campaigns are recommended to improve strategies for the prevention, diagnosis and treatment of Candidiasis.

Keywords: candida albicans, laboratory examination, patients, gastrointestinal tract.

RËNDËSIA E EKZAMINIMIT HISTOPATOLOGJIK NË DIAGNOSTIKIMIN E MOLËS HIDATIFORMË

Vjola Shkira¹, Venemin Gega², Edlira Bixhaku³

¹Laborante, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut

²As/Lektor; Fakulteti I Shkencave Mjekësore Teknike; Universiteti I Elbasanit

³Laborante, "Luar Med"

Email: vjolashkira@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Mola hidatiforme totale ose parciale është një komplikacion i rrallë i shtatëzanisë që bën pjesë në një grup gjëndjesh të njohura si tumoret trofoblastike gestacionale, sepse karakterizohet nga një rritje jonormale e trofoblasteve, qelizave që normalisht zhvillohen për të formuar placentën. Ajo ka një paraqitje klinike jo-tipike dhe për këtë arsye diagnoza e saktë nuk mund të vendoset që në momentin e paraqitjes në maternitet.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të zbulojmë rëndësinë e ekzaminimit histopatologjik në diagnostikimin e molës hidatiforme totale ose parciale.

Metodologjia: Në studim morën pjesë 70 paciente ku përqindjen më të lartë të rasteve e kanë pasur femrat 25-34 vjeç dhe ka mbizotërim të pacienteve me vendbanim në zonat rurale. Materiali i marrë përmes kyretazhit ose mbas abortit pastrohet nga mbetjet e gjakut dhe zhytet në ujë. Një pjesë e fragmenteve të indit të përzgjedhura nga mjeku patolog fiksohet në formalinë dhe futet në parafinë, me pas ngjyroset me hematoksilinë-eozinë për një ekzaminim të detajuar mikroskopik. Të dhënat u hodhën për tu analizuar në programin statistikor SPSS 23.

Rezultatet: Diagnoza klinike më e shpeshtë është Missed abort, në javën 10-11 dhe 12-13 të shtatëzanisë. Pra pjesa më e madhe e pacienteve janë diagnostikuar pas abortit përmes ekzaminimit histopatologjik dhe vetëm një përqindje e vogël diagnostikohen paraprakisht. Nga 70 paciente, 2.9 % (n=2) kanë mole totale dhe 97.1% (n=68) kanë mole parciale bazuar në karakteristikat morfologjike të ekzaminimit mikroskopik. Asnjë rast nuk ka përfunduar me vdekjen e pacientes gjatë abortit apo gjatë kyretazhit.

Përfundime: Diagnoza definitive për molën hidatiforme bëhet përmes ekzaminimit histopatologjik të materialit të abortit apo të procedurës së kyretazhit. Ndjekja e protokolleve të shtatëzanisë do të ndihmonte në diagnostikimin e hershëm si dhe menaxhimin e duhur të rasteve duke shmangur riskun për zhvillim të koriokarcinomës. Duhet të bëhet monitorimi i vazhdueshëm përmes testeve laboratorike i pacienteve pas heqjes së masës molare.

Fjalë kyçe: ekzaminimi histopatologjik, mola hidatiforme, pacientë.

THE IMPORTANCE OF HISTOPATHOLOGICAL EXAMINATION IN THE DIAGNOSIS OF HYDATIFORM MOLE

Vjola Shkira¹, Venemin Gega², Edlira Bixhaku³

¹Laboratory technician, National Center of Blood Transfusion

²As/Lecturer Medical Technical Faculty; University of Elbasan

³Laboratory technician "Luar Med"

Email: vjolashkira@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Total or partial hydatidiform mole is a rare complication of pregnancy that is part of a group of conditions known as gestational trophoblastic tumors because it is characterized by an abnormal growth of trophoblasts, the cells that normally develop to form the placenta. It has a non-typical clinical presentation and therefore the correct diagnosis cannot be established at the time of presentation at the maternity hospital.

Purpose: The purpose of this study is to reveal the importance of histopathological examination in the diagnosis of total or partial hydatidiform mole.

Methodology: 70 patients participated in the study where the highest percentage of cases were women aged 25-34 and there is a predominance of patients residing in rural areas. The material obtained through curettage or after abortion is cleaned of blood residues and immersed in water. A portion of the tissue fragments selected by the pathologist is fixed in formalin and embedded in paraffin, then stained with hematoxylin-eosin for detailed microscopic examination. The data were analyzed in the statistical program SPSS 23.

Results: The most frequent clinical diagnosis is Missed abortion, in weeks 10-11 and 12-13 of pregnancy. So most of the patients are diagnosed after abortion through histopathological examination and only a small percentage are diagnosed beforehand. From 70 patients, 2.9% (n=2) have total moles and 97.1% (n=68) have partial moles based on the morphological characteristics of the microscopic examination. No case has ended with the death of the patient during abortion or during curettage.

Conclusions: The definitive diagnosis for the hydatidiform mole is made through histopathological examination of the abortion material or the curettage procedure. Following pregnancy protocols would help in early diagnosis as well as proper management of cases avoiding the risk of developing choriocarcinoma. Patients should be continuously monitored through laboratory tests after removal of the molar mass.

Keyword: histopathological examination, hydatidiform mole, patients

PREVALENCA E DISLIPIDEMISË NË NJË POPULLATË QË KA KRYER KONTROLLIN MJEKËSOR BAZË RUTINË, NË QENDRËN SHËNDETËSORE NUMËR 1 TË TIRANËS, GJATË VITIT 2022

Xhensila Beqari¹, Prof. Asoc. Dr Alma Barbullushi²

1 Msc, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë

Tiranë

2 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

ABSTRAKT

Hyrje: Dislipidemia është një nga faktorët kryesorë të rrezikut për zhvillimin e sëmundjeve kardiovaskulare (SKV). Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) rreth 2.6 milionë vdekje shkaktohen nga dislipidemia çdo vit me një prevalencë prej 37% dhe 40% prespektivisht tek meshkujt dhe femrat dhe pritet të rritet për shkak të zhvillimit social-ekonomik të shoqëruar me ndryshime në stilin e jetesës.

Qëllimi: Ky studim u krye për të vlerësuar prevalencën e dislipidemisë dhe faktorët e rrezikut shoqëruar tek subjektet e marra në studim.

Metodologjia: Ky është një studim transversal dhe deskriptiv, i cili u zhvillua gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor të 2022, në qendrën shëndetësore numër 1 të Tiranës duke përfshirë pjesëmarrës të moshës 35-75 vjeç, meshkuj dhe femra të cilët kishin kryer kontrollin mjekësor bazë rutinë gjatë 1 viti. Subjektet e marra në studim, u paraqitën në qendrën shëndetësore në gjendjen esëll të cilët pasi iu nënshtruan një pyetësori iu bënë matjet antropometrike dhe marrja e gjakut intravenoz. Dislipidemia u identifikua duke përdorur udhëzimet sipas vlerave referente, në bazë të udhëzuesit të Shoqatës Europiane të Kardiologjisë.

Rezultatet: Një total prej 1.036 subjektsh (48,16% meshkuj dhe 51,83% femra) me moshë mesatare 43 vjeç, u morën në studim. Dislipidemia takohet në 43.82% individë, ku 51.32% kishin hiperkolesterolemi, 48.67% kishin hipertrigliceridemi, 43.17% kishin nivele të larta LDL-C ndërsa 32.15% kishin nivele të ulëta HDL. Nivelet më të larta të kolesterolit dhe triglicerideve u paraqiten në grupmoshën 43-54 vjeç, ndërsa LDL e lartë dhe HDL e ulët ishin më të zakonshme në grupmoshën 40-49 vjeç. Diabeti, obeziteti dhe hipertensioni paraqesin faktorë predispozues të rëndësishëm për dislipideminë.

Konkluzioni: Prevalenca e dislipidemisë duket të jetë e lartë në qendrën shëndetësore numër 1, dhe kërkon një nderhyrje të menjëhershme dhe menaxhim efektiv, në rradhë të parë përmes ndryshimit të stilit të jetesës dhe më pas nëpërmjet përdorimit të preparateve antilipidike, për të parandaluar aksidentet kardiovaskulare, për të cilat dislipidemitë përfaqsojnë një faktor rreziku të lartë.

Fjalë kyçe: Dislipidemia, Hiperkolesterolemi, Hipertrigliceridemi, HDL-C, LDL-C, Prevalenca.

THE PREVALENCE OF DYSLIPIDEMIA IN A POPULATION THAT HAS CARRIED OUT A ROUTINE MEDICAL CHECK-UP, AT THE HEALTH CENTER NUMBER 1 OF TIRANA, DURING THE YEAR 2022

Xhensila Beqari¹, Prof. Asoc. Dr Alma Barbullushi²

1 Msc, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë

Tiranë

2 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

ABSTRACT

Introduction: Dyslipidemia is one of the main risk factors for the development of cardiovascular diseases (CVD). According to the World Health Organization (WHO), about 2.6 million deaths are caused by dyslipidemia every year with a prevalence of 37% and 40% respectively in men and women and it is expected to increase due to socio-economic development accompanied by changes in lifestyle.

Purpose: This study was conducted to assess the prevalence of dyslipidemia and associated risk factors in the subjects enrolled in the study.

Methodology: This is a transversal and descriptive study, which took place during the period January-December 2022, in the health center number 1 of Tirana, including participants aged 35-75 years, men and women who had performed the basic medical check-up routine during 1 year. The subjects included in the study, presented to the health center in fasting state and after submitting to a questionnaire, anthropometric measurements and intravenous blood samples were taken. Dyslipidemia was identified using the guidelines according to the reference values, based on the guideline of the European Society of Cardiology.

Results: A total of 1,036 subjects (48.16% males and 51.83% females) with an average age of 43 years, were included in the study. Dyslipidemia is found in 43.82% of individuals, where 51.32% had hypercholesterolemia, 48.67% had hypertriglyceridemia, 43.17% had high LDL-C levels, while 32.15% had low HDL levels. The highest levels of cholesterol and triglycerides were seen in the 43-54 age group, while high LDL and low HDL were more common in the 40-49 age group. Diabetes, obesity and hypertension are important predisposing factors for dyslipidemia.

Conclusion: The prevalence of dyslipidemia appears to be high in health center number 1, and requires an immediate intervention and effective management, first through lifestyle changes and then through the use of antilipemic preparations, to prevent cardiovascular accidents, for which dyslipidemias represent a high risk factor.

Keywords: Dyslipidemia, Hypercholesterolemia, Hypertriglyceridemia, HDL-C, LDL-C, Prevalence.

INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR NË QYTETIN E ELBASANIT, GJATË MUAJVE QERSHOR-KORRIK

Jona Bërdufi¹, Aida Toli¹, Kostandina Tila¹, Venemin Gega²

¹Msc, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

²As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Email: jonnajuna@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Infeksionete traktit urinar (ITU) janë një nga infeksionet më të zakonshme që prekin njerëzit e të gjitha moshave. UTI janë një problem i rëndë i shëndetit publik dhe shkaktohen nga një sërë patogjenësh, por më së shpeshti nga *Escherichia coli*. Infeksionet urinare mund të prekin pjesë të ndryshme të traktit urinar. Ato shkaktojnë një sërë simptomash duke përfshirë djegie gjatë urinimit, dhimbjebarku, poliuri apo polidipsi.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i prevalencës së infeksioneve të traktit urinar në qytetin e Elbasanit në muajt qershor-korrik. Të përshkruhen karakteristikat e grupit popullatës së marrë në studim sidhetë përcaktoshkaktarëtkryesorë patogjenikë në infeksionet e traktit urinar.

Metodologjia: Në këtë studim, u mbledhën të dhëna klinike dhe laboratorike për 114 pacientë që kryen analizë urine komplete dhe urokulture. Të dhënat janë grumbulluar në një laborator jo publik në qytetin e Elbasanit, në muajt qershor-korrik 2023.

Rezultatet: Nga 114 urokultura të kryera, 29 rezultuan negative dhe 85 rezultuan pozitive. Nga 114 paciente që u bënë pjesë e studimit 95 ishin femra dhe 19 ishin meshkuj. Nga rezultatet e ekzaminimeve laboratorike mikrobiologjike rezultoi që *E. Coli* dhe *Proteus Mirabilis* janë bakteret përgjegjëse për pjesën më të madhë të infeksioneve të traktit urinar.

Konkluzione: Nga studimi arrihet në konkluzion që pothuajse të gjitha grupmoshat janë të rrezikuara për të përkur në infeksionet e traktit urinar. Prevalencë më të lartë kanë femrat në krahasim me meshkujt. Analizat laboratorike së bashku me të dhënat klinike luajnë një rol kryesor në diagnozën, prognozën dhe mjekimin e ITU.

Fjalë kyçe: analizat, Elbasan, infeksion, trakti urinar, urokultura.

URINARY TRACT INFECTIONS IN THE CITY OF ELBASAN, DURING THE MONTHS OF JUNE-JULY

Jona Bërdufi¹, Aida Toli¹, Kostandina Tila¹, Venemin Gega²

¹Msc, Laboratory Technician, Faculty of Medical Technical Sciences, University of Medicine, Tirana

²As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

Email: jonnajuna@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Urinary tract infections (UTI) are one of the most common infections affecting people of all ages. UTIs are a serious public health problem and are caused by a variety of pathogens, but most commonly by *Escherichia coli*. Urinary tract infections can affect different parts of the urinary tract. They cause a variety of symptoms including burning during urination, abdominal pain, polyuria or polydipsia.

Purpose: The purpose of this study is to determine the prevalence of urinary tract infections in the city of Elbasan in the months of June-July. To describe the characteristics of the population group studied and to determine the main pathogenic factors in urinary tract infections.

Methodology: In this study, clinical and laboratory data were collected for 114 patients who underwent complete urinalysis and urine culture. The data were collected in a non-public laboratory in the city of Elbasan, in the months of June-July 2023.

Results: Out of 114 urine cultures performed, 29 were negative and 85 were positive. Of the 114 patients who took part in the study, 95 were women and 19 were men. The results of microbiological laboratory examinations showed that *E. Coli* and *Proteus Mirabilis* are the bacteria responsible for most infections in the urinary tract.

Conclusions: From the study we came to the conclusion that almost all age groups are at risk of being affected by urinary tract infections. Women have a higher prevalence compared to men. Laboratory analyzes together with clinical data play a major role in the diagnosis, prognosis and treatment of UTI.

Keywords: tests, Elbasan, infection, urinary tract, urine culture

SËMUNDJET PARAZITARE TË TRAKTIT GASTROINTESTINAL NGA NJË GRUP POPULLATE NË QYTETIN E ELBASANIT

*Venemin Gega¹, Sidorela Berati², Vjola Shkira³, Arkida Skenderi¹, Gjergji Doka¹,
Ilma Toçi¹, Rajmonda Hida¹*

*¹As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit
“Aleksandër Xhuvani”*

²Laborante, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë

³Laborante, Laboratory Network, Elbasan

Email: venemin.gega@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Sëmundjet parazitare të traktit gastro-intestinal përbëjnë një problem madhor për shëndetin publik në botë dhe në vendin tonë. Njerëzit mund të infektohen me parazitë të zorrëve duke ngrënë ushqim, duke pirë ujë të kontaminuar ose duke rënë në kontakt me tokë të kontaminuar. Parazitizat shkaktojnë një sërë problemesh tek njerëzit, ato mund të shkaktojnë një gamë të gjërë simptomash, duke përfshirë diarren, humbjen e oreksit, dhimbjen e barkut, feçe me erë të keqe, të vjella, renie në peshë. Giardia lamblia mbetet shkaku më i zakonshëm i sëmundjeve parazitare gastrointestinale në botë.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i ngarkesës së infeksioneve parazitare nga një grup popullate nga qyteti i Elbasanit. Të përshkruhen karakteristikat e grup popullatës së marrë në studim si dhe të përcaktohen shkaktarët kryesorë patogjenëtë sëmundjeve parazitare të traktit gastro-intestinal.

Metodologjia: Studimi është realizuar në periudhën kohore Maj-Korrik 2023 në një laborator privat në qytetin e Elbasanit. Janë mbledhur të dhënat demografike dhe laboratorike të pacientëve që kryen analizën mikrobiologjike të feçes përgjatë kësaj periudhe kohore.

Rezultatet: Prej 145 pacientëve që u përfshinë në studim, 76 janë femra dhe 69 janë meshkuj. Në ekzaminimet laboratorike mikrobiologjike rezultoi që Giardia lamblia është paraziti më i hasur dhe paraziti përgjegjës për sëmundjet parazitare gastro-intestinale. 38 pacientë rezultuan pozitive me Giardia lamblia.

Konkluzione: Ky studim theksoi rëndësinë që ka ekzaminimi klinik dhe ai laboratorik në vendosjen e diagnozës së sëmundjeve parazitare gastro-intestinale. Infeksionet parazitare gastrointestinale vazhdojnë të mbeten një problem shqetësues për shëndetin publik. Rekomandohen fushata sensibilizuese për njohjen dhe menaxhimin e faktorëve të riskut që ndikojnë në përhapjen e sëmundjeve parazitare.

Fjalë kyçe: giardia lamblia, pacientë, sëmundje parazitare, trakti gastrointestinal

PARASITIC DISEASES OF THE GASTROINTESTINAL TRACT FROM A POPULATION GROUP IN THE CITY OF ELBASAN

Venemin Gega¹, Sidorela Berati², Vjola Shkira³, Arkida Skenderi¹, Gjergji Doka¹,
Ilma Toçi¹, Rajmonda Hida¹

¹As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan
"Aleksander Xhuvani"

²Laboratory technician, National Blood Transfusion Center, Tirana

³Laboratory technician, Laboratory Network, Elbasan

Email: venemin.gega@uniel.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Parasitic diseases of the gastro-intestinal tract constitute a major public health problem in the world and in our country. People can become infected with intestinal parasites by eating food, drinking contaminated water or coming into contact with contaminated soil. Parasites cause a variety of problems in humans, they can cause a wide range of symptoms, including diarrhea, loss of appetite, abdominal pain, foul-smelling stools, vomiting, weight loss. Giardia lamblia remains the most common cause of gastrointestinal parasitic disease in the world.

Purpose: The purpose of this study is to determine the load of parasitic infections from a population group from the city of Elbasan. To describe the characteristics of the population group studied and to determine the main pathogenic causes of parasitic diseases of the gastro-intestinal tract.

Methodology: The study was carried out in the period May-July 2023 in a private laboratory in the city of Elbasan. During this time period were collected demographic and laboratory data of patients who performed the microbiological analysis of feces.

Results: From the 145 patients who were included in the study, 76 are women and 69 are men. Microbiological laboratory examinations showed that Giardia lamblia is the most common parasite and the parasite responsible for gastro-intestinal parasitic diseases. 38 patients tested positive for Giardia lamblia.

Conclusions: This study emphasized the importance of clinical and laboratory examination in establishing the diagnosis of gastro-intestinal parasitic diseases. Gastrointestinal parasitic infections continue to be a worrisome public health problem. Sensitization campaigns are recommended for the recognition and management of risk factors that affect the spread of parasitic diseases.

Keywords: giardia lamblia, patients, parasitic disease, gastrointestinal tract.

NDRYSHIMET HORMONALE NË SINDROMIN E OVARIT POLICISTIK TË NJË POPULLATE QË KA KRYER ANALIZAT HORMONALE NË NJË KLINIKË PRIVATE NË TIRANË GJATË VITIT 2023

Kejsi Çekiçi¹, Emirvina Koliçi²

¹Msc Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti I Mjekësisë Tiranë

²Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Email: kejs.cekici@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Sindroma e ovarit policistik (PCOS) është një gjendje në të cilën ovaret prodhojnë një sasi jonormale të androgjeneve, hormoneve seksuale mashkullore që zakonisht janë të pranishme tek gratë, në sasi të vogla. Emri sindromi i ovarit policistik përshkruan cistet e shumta të vogla (qeset e mbushura me lëngje) që formohen në ovare.

Qëllimi: Vlerësimi i ndryshimeve hormonale që sjell ky sindrom dhe si ndikojnë ato në metabolizmin dhe shëndetin riprodhues të një femre.

Metodologjia: Studimi u bazua në metoda të kërkimit shkencor kuantitativ dhe kualitativ.

U morën në studim 45 raste të diagnostikuara me PCOS gjatë periudhës Janar-Qershor 2023 në një klinikë private në qytetin e Tiranës, bazuar në kriteret e Roterdamit. Në të gjitha rastet u matën nivelet në serum të hormoneve si LH, FSH, Testosteron, Prolaktin, DHEA-s dhe raporti LH/FSH.

Rezultatet: Ngatë dhënat e mbledhura rezultoi se grupmosha më e prekur ishte 14–25 vjeç. Ndryshimet hormonale që u vunë re ishin rritje e androgjeneve si DHEA-s në 46.7 % e pacientëve, rritje e Testosteronit në 53.3 % e pacientëve, FSH e rritur në 11.1 % e pacientëve, e ulur në 11.1 % e pacientëve, LH e lartë në 31.1 % e pacientëve dhe e ulët në 6.7% e tyre, PRL e lartë në 42.2% e pacientëve dhe me një raport LH/FSH të lartë në 35.6% e pacientëve. Fenotipi më i shpeshtë rezultoi Fenotipi A 46.7% i ndjekur nga D me 31.1% , C me 13.3% dhe B me 8.9 %.

Konkluzionet: PCOS është një çrregullim heterogjen me shkak të pasigurt. Në gratë me PCOS, boshti normal gonadotropin-ovarian është i ndryshuar kjo reflektohet nga çrregullimet hormonale. Rezultatet e marra në këtë studim treguan se testosteroni, DHEA-s, PRL, FSH dhe LH ishin të implikuar në subjektet PCOS.

Fjalët kyçe: PCO-s, androgjene, FSH, LH, PRL.

HORMONAL CHANGES IN POLYCYSTIC OVARY SYNDROME OF A POPULATION THAT HAS PERFORMED HORMONAL ANALYZES IN A PRIVATE CLINIC IN TIRANA DURING 2023

Kejsi Çekiçi¹, Emirvina Koliçi²

¹*Msc Laboratory Technician, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine Tirana*

²*Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine Tirana*

Email: kejs.cekici@gmail.com

ABSTRACT

Background: Polycystic ovary syndrome (PCOS) is a condition in which the ovaries produce an abnormal amount of androgens, the male sex hormones normally present in women, in small amounts. The name polycystic ovary syndrome describes the many small cysts (fluid-filled sacs) that form in the ovaries.

Aim: Evaluation of the hormonal changes brought about by this syndrome and how they affect the metabolism and reproductive health of a woman.

Methods: The study was based on quantitative and qualitative scientific research methods. We took 45 cases diagnosed with PCOS during the period January-June 2023 in a private clinic in the city of Tirana based on Rotterdam criteria. In all cases, serum levels of hormones such as LH, FSH, Testosterone, Prolactin and DHEA and the LH/FSH ratio were measured.

Results: From the collected data it was found that the most affected age group was 14-25 years old. Hormonal changes that were observed were increased androgens such as DHEA-s in 46.7% of patients, increased Testosterone in 53.3% of patients, increased FSH in 11.1% of patients, decreased in 11.1% of patients, high LH in 31.1% of patients and low in 6.7% of them, high PRL in 42.2% of patients and with a high LH/FSH ratio in 35.6% of patients. The most frequent phenotype was Phenotype A 46.7% followed by D with 31.1%, C with 13.3% and B with 8.9%.

Conclusion: PCOS is a heterogeneous disorder of uncertain etiology. In women with PCOS, the normal gonadotropin-ovarian axis is altered, this is reflected by hormonal disturbances. The results obtained in this study showed that testosterone, DHEA, PRL, FSH and LH were implicated in PCOS subjects.

Keywords: PCOS, androgens, LH, FSH, PRL

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM LABORATORIK MBI CANDIDA ALBICANS

Kostandina Tila¹, Aida Toli¹, Jona Bërdufi¹, Venemin Gega²

¹Msc, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

²As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Email: kostandina.tila@live.com

ABSTRAKT

Hyrje: E njohur si një ndër shkaktarët kryesorë të infeksioneve të cilat lënë gjurmë me invazivitetin e vetë dhe që ripërsëritet në organizmin human, *Candida albicans* është një mykpatogjen oportunist i cili edhe pse në dukje një fung jo i dëmshëm, falë aftësisë për tu kthyer në patogjen dhe faktorëve të virulencës arrin të shkaktojë infeksione dhe probleme tek qenia humane, duke iniciuar nga infeksionet më banale e deri tek candidiasis invasive e cila është dhe forma më e rëndë e infeksionit të shkaktuar nga *Candida*.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim matjen e ndjeshmërisë së *Candida albicans* ndaj antimykotikëve të përdorur në organet si lëkura, trakti uro-genital, trakti gastro-intestinal, apo në kavitetin oro-faringeal si dhe përcaktimin e prevalencës së grupmoshës dhe gjinisë më të prekur.

Metodologjia: Njëkëtëstudim retrospektiv, janë marrë në studim 110 raste pozitive me *Candida* nga muaji janar-qershor 2023 pranë një laboratorit jopublik në Tiranë. Pasi janë mbledhur të dhënat laboratorike nga fletë-raportet e pacientëve që kanë kryer analiza mikrobiologjike ato janë hedhur në Excel dhe janë përpunuar.

Rezultatet: Nga rastet e marra në studim, 82 pacientë me *Candida* ishin të gjinisë femërore dhe 28 të gjinisë mashkullore. U mat shkalla e ndjeshmërisë së *C.albicans* ndaj klasave të ndryshme të antimykotikëve duke u bazuar tek rastet pozitive dhe rezultoi se më sensitive ishin fluconazole dhe nystatina, kursemërezistentët econazole, ketoconazole, amphotericine B dhe 5-fluorocytosine.

Konkluzione: Rëndësia themelore gjatë analizimit të *Candidas* qëndron tek theksi që duhet ti vendoset rëndësisë që kanë dhe mbartin testet laboratorike dhe se sa hallkë kyçe është një diagnozë preçize laboratorike.

Fjale kyçe: *Candida albicans*, laboratorit, infeksion, testet laboratorike

LABORATORY OVERVIEW OF CANDIDA ALBICANS

Kostandina Tila¹, Aida Toli¹, Jona Bërdufi¹, Venemin Gega²

¹Msc, Laboratory Technician, Faculty of Medical Technical Sciences, University of Medicine, Tirana

²As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

Email:kostandina.tila@live.com

ABSTRACT

Introduction: Known as one of the main causes of infections that leave a mark with its invasiveness and that repeats itself in the human body, *Candida albicans* is an opportunistic pathogenic mold which, although seemingly a harmless fungus, thanks to its ability to return in the pathogen and virulence factors manages to cause infections and problems in the human being, starting from the most banal infections to invasive candidiasis, which is the most severe form of infection caused by *Candida*.

Purpose: This study aims to measure the sensitivity of *Candida albicans* to antifungals used in organs such as the skin, uro-genital tract, gastro-intestinal tract, or in the oropharyngeal cavity, as well as to determine the prevalence of the age group and gender most affected.

Methodology: In this retrospective study, 110 positive cases with candida were studied from January to June 2023 near a non-public laboratory in Tirana. After the laboratory data have been collected from the report sheets of the patients who have performed microbiological analysis, they have been entered into Excel and processed.

Results: From the cases taken in the study, 82 patients with *Candida* were female and 28 were male. The degree of sensitivity of *C.albicans* to different classes of antifungals was measured based on the positive cases and it turned out that the most sensitive were fluconazole and nystatin, while the most resistant were econazole, ketoconazole, amphotericin B and 5-fluorocytosine.

Conclusions: The fundamental importance when analyzing *Candida* lies in the emphasis that must be placed on the importance of laboratory tests and how important a precise laboratory diagnosis is.

Keywords: candida albicans, laboratory, infection, laboratory tests

THE ROLE OF LABORATORY TESTS IN PATIENTS WITH COVID-19

Brandi Fahriu¹, Doc. Elona Hasalla², Phd. Cand. Ilda Taka², Klaydi Tarko¹

*¹ Laboratory Technician Students, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan
"Aleksandër Xhuvani"*

*² Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan
Email:brandifahriu@gmail.com*

ABSTRACT

Introduction: The 2019 coronavirus disease or otherwise known as COVID-19 is an infectious disease caused by the severe acute respiratory syndrome SARS-COV-2. The disease has spread globally since 2019, resulting in a global pandemic. Symptoms include respiratory symptoms: fever, cough, shortness of breath and difficulty breathing. In more severe cases, the infection can cause pneumonia, severe acute respiratory syndrome, multi-organ failure, and even death. The laboratory plays an important role in the diagnosis and monitoring of patients with COVID-19. The standard method of diagnosis is by RT-PCR technique from a nasopharyngeal swab. Routine laboratory tests are used to assess the patient's clinical progress and condition.

Purpose: The purpose of this study is to investigate and analyze the frequency of cases diagnosed with COVID-19. To understand the importance of laboratory examinations in the disease of COVID-19.

Methodology: In this study, data were collected for confirmed patients with Covid-19 during the period April 2020 - February 2021. The data were collected in several private laboratories in the city of Elbasan. Clinical and laboratory data were analyzed for each patient.

Results and conclusions: Getting to know the population and age groups most affected by this disease. This study highlighted the importance of laboratory examinations in establishing the diagnosis and prognosis of patients with Covid-19. Acquaintance with the various laboratory examinations that are performed in cases where it is suspected to affect patients with COVID-19.

Keywords: COVID-19, laboratory examination, PCR, nasopharyngeal swab.

ESCHERICHIA COLI SI SHKAKTAR PRIMAR I INFEKSIONEVE URINARE

Aida Toli¹, Jona Bërdufi¹, Kostandina Tila¹, Venemin Gega²

¹Msc, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

²As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Email: aidatoliii@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Infeksionet e traktit urinar janë një ndër infeksionet më të zakonshme pas infeksioneve respiratore. Në shumicën e rasteve këto infeksione nuk sjellin komplikacione dhe mjekohen lehtësisht, por në disa raste infektimi arrin deri në veshka duke sjellë dëmtim të tyre. Që të konsiderojmë një infeksion urinar përveç klinikës është dhe laboratorit ai i cili ndihmon dhe vendos diagnozën përfundimtare përmes parametrave laboratorik. Studimet e kryera në botë tregojnë që *Escherichia coli* është shkaktari primar i infeksioneve urinare.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i bakterit i cili shkakton më së shumti infeksione urinare.

Metodologjia: Ky studim është një studim retrospektiv në të cilin janë marrë në studim 210 pacientë meshkuj dhe femra. Këta individë janë paraqitur në një laborator jopublik në qytetin e Elbasanit për të kryer ekzaminime laboratorike, si urinë komplet dhe urokulturë, të cilat janë teste të rëndësishme për të vlerësuar praninë e infeksionit urinar dhe bakterit që e shkakton atë. Për çdo subjekt të studimit u zbulua bakteri përgjegjës i infeksionit, gjithashtu u regjistruan të dhëna sociodemografike si: mosha, gjinia, vendbanimi, antibiotiku trajtues. Të dhënat janë mbledhur gjatë periudhës Janar-Qershor 2023.

Rezultatet: Nga 210 urokultura pozitive të marra në studim, ka rezultuar se 180 prej tyre kanë të pranishëm bakterin *Escherichia coli*, gjinia më e prekur është gjinia femërore dhe grupmosha më e predispozuar rezultoi grupmosha 40-49.

Konkluzione: Ekzaminimet laboratorike bashkë me shenjat klinike duhet të vlerësohen me kujdes në përcaktimin e diagnozës së ITU. Ky studim vuri në dukje rëndësinë e ekzaminimit klinik të urinës dhe urokulturës në vendosjen e diagnozës së ITU, dhe shkaktarëve të ITU.

Fjale kyçe: *Escherichia coli*, infeksion urinar, urokultura, laborator

LEUKOCITIZAT DHE LLOJET E SAJ , NGA NJË INFEKSION BAKTERIAL DERI NË MALINJITET

Shqiponja Simitciu¹, Alma Barbullushi²

¹*MsC, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë*

²*As/Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë*

Email: ponja.simitciu@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Leukocitoza perfaqeson rritjen mbi vlerat normale rruazave te bardha te gjakut, më shume se 11,000 /mm³. Ajo eshte nje dukuri e zakonshme laboratorike e cila mund te shkaktohet si nga shkaqe beninje (infeksione ose inflamacion) dhe shkaqe malinje, ku perfshihen hemopatite malinje, duke pasur keshtu nje dignoze te gjere diferenciale. Shqyrtimi kujdesshëm i te dhenave te gjakut komplet (CBC) dhe karakteristikat morfologjike janë hapat kyce të nevojshëm për të eksploruar natyren e leukocitozes. Leukocitoza zbulohet shpesh gjate kontrolleve mjekesore rutine prandaj eshtë e rëndësishme që klinikistët etiologjitë malinje nga jo te leukocitozes. Leukocitoza më e madhe se 100,000/ mm³ shkaktohet pothuajse gjithmonë nga sindromat mieloproliferative ose nga leukozat. Patologjite e palcës kockore dyshohen në kushtet e nje leukocitoze mjaft te shprehur sidomos kur eshte e shoqeruar me trombocitopeni dhe anemi.

Qëlimi studimit tone eshte te vleresojme prevalencen e leukocitozes ne grup popullate qe ka kryer kontrollin mjekesore baze, te percaktojme llojin e saj si dhe prevalencen e leukocitozes malinje si nje ngjarje e mundshme laboratorike sa here qe kemi prezencen e leukocitozes.

Materiali dhe metoda: Ky është një studim transversal deskriptiv, i cili u zhvillua gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor të 2022, në Tiranë duke përfshirë individe 400 individe të moshës 35-70 vjeç, nga te cilet 226(56.5%) ishin femra dhe 174(44.5%) ishin meshkuj, të cilët kishin kryer kontrollin mjekësor bazë rutinë, në Qendrën shëndetësore numër 1 të Tiranës. Për secilin rast u hartua një skedë personale, e cila përmbante, të dhënat e hemogrames dhe formulës leukocitare, si dhe ekzaminimet e tjera laboratorike.

Rezultatet. Ne studimin leukocitoza takohet ne 10% te individeve te perfshire ne studim, ku 65% jane femra me leukocitoze dhe 35% meshkuj me leukocitoze. Veme re se, nga 40 individe me leukocitoze, 29 persona (72.5%) me leukoitoze neutrofilike, 7 persona (17.5%) jane me leukocitoze eozinofilike, 3 persona 7.5 % me LLC, 1 person 2.5 % me sindrome mieloproliferativ. Neutrofilia ishte shkak kryesor i leukocitozes ku 75% jane me leukocitoze neutrofilike. Leukocitoza malinje takohet ne 1% te rasteve te perfshira ne studimin dhe ne 10 % te rasteve me leukocitoze, nga te cilat 3 raste ishin me Sindrome Limfopoliferativ (LLC) dhe 1 rast me Sindrome Mieloproliferativ (Policitemia Vera).

Konkluzione. Leukocitoza eshte nje dukuri e shpeshte laboratorike, e cila ne pjesen me te madhe te rasteve vjen nga shkaqe beninje. Ne asnje rast nuk duhet anash kaluar mundesia se shkak i nje leukocitoze mund te jete nje hemopati malinje.

Fjale kyçe. Leukocitoza, leukocitoza beninje, leukocitoza malinje.

LEUKOCYTOSIS AND ITS TYPES, FROM A BACTERIAL INFECTION TO MALIGNANCY

Shqiponja Simitciu¹, Alma Barbullushi²

¹ *MSc, Laboratory Technician, Faculty of Medical and Technical Sciences, University of Medicine, Tirana*

² *As/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Medicine, Tirana*

Email: ponja.simitciu@gmail.com

ABSTRACT

Introduction: Leukocytosis represents the increase above the normal values of white blood cells, more than 11,000 /mm³. It is a common laboratory phenomenon which can be caused by both benign causes (infection or inflammation) and malignant causes, including malignant hemopathies, thus having a wide differential diagnosis. Careful examination of the complete blood count (CBC) and morphological characteristics are the key steps necessary to explore the nature of leukocytosis. Leukocytosis is often detected during routine medical check-ups, therefore it is important that clinicians distinguish malignant etiologies from non-leukocytosis. Leukocytosis greater than 100,000/mm³ is almost always caused by myeloproliferative syndromes or leukemia. Bone marrow pathologies are suspected in the conditions of a very pronounced leukocytosis, especially when it is accompanied by thrombocytopenia and anemia

Purpose: The aim of our study is to evaluate the prevalence of leukocytosis in the population group that has performed basic medical control, to determine its type as well as the prevalence of malignant leukocytosis as a possible laboratory event whenever we have the presence of leukocytosis.

Material and method: This is a descriptive transversal study, which was conducted during the time period January-December 2022, in Tirana including 400 individuals aged 35-70 years, of which 226 (56.5%) were women and 174 (44.5%) were men, who had performed the basic routine medical check-up at Health Center number 1 of Tirana. For each case, a personal file was drawn up, which contained the hemogram and leukocyte formula data, as well as other laboratory examinations.

Results: In this study, leukocytosis is found in 10% of the individuals included in the study, where 65% are women with leukocytosis and 35% are men with leukocytosis. We noticed that, out of 40 individuals with leukocytosis, 29 people (72.5%) have neutrophilic leukocytosis, 7 people (17.5%) have eosinophilic leukocytosis, 3 people 7.5% with LLC, 1 person 2.5% with myeloproliferative syndrome. Neutrophilia was the main cause of leukocytosis where 75% have neutrophilic leukocytosis. Malignant leukocytosis is found in 1% of cases included in the study and in 10% of cases with leukocytosis, of which 3 cases were with Lymphoproliferative Syndrome (LLC) and 1 case with Myeloproliferative Syndrome (Polycythemia Vera).

Conclusions: Leukocytosis is a frequent laboratory phenomenon, which in most cases comes from benign causes. In no case should the possibility that the cause of a leukocytosis be a malignant hemopathy be overlooked.

Keywords : Leukocytosis, benign leukocytosis, malignant leukocytosis.

ABSTRAKTE LOGOPEDI

ANALIZAT E BASHKËBISEDIMIT TEK FËMIJËT ME DËMTIM TË TË FOLURIT PRAKTIK: NJË MJET EKOLOGJIK NË NJË VLERËSIM FORMAL

*Giovanni Masciarelli, Durrës; Emanuela Leone Sciabolazza, Romë.
giovanni.masciarelli@gmail.com*

ABSTRAKT

Shqetësimet e komunikimit shoqëror (praktik) është një diagnozë e re e DSM-V që karakterizohet nga probleme të dukshme duke përdorur komunikimin verbal dhe jo-verbal për qëllime sociale. Megjithatë, mungesa praktike kryesore ndikon në çrregullimet e ndryshme të zhvillimit nervor. Pavarësisht se ekzistojnë një sërë testesh të duhura praktike, përpjekjet për vlerësim nëpërmjet analizave të bashkëbisedimit janë shumë të rralla.

Qëllimi i këtij punimi është të përshkruajë Analizën e Bashkëbisedimit si një përpunim me Trajnimin e aftësive Praktike të Komunikimit (Leone Sciabolazza E. & Masciarelli G., 2023), i cili lejon të theksojë 32 fenomene komunikimi brenda 9 fushave, nëpërmjet një bashkëbisedimi udhëzues midis një të rrituri dhe një fëmije. Ne do të përdorim një rast të vetëm studimi për të kuptuar se çfarë ndodh pas perdes së sjelljes së çuditshme të pacientit gjatë ndërveprimit social. Kjo zgjedhje metodike do të na ndihmojë të arrijmë një profil më shumë specifik, të aftësive bashkëbiseduese tek një fëmijë me shqetësime të komunikimit social (pragmatik) dhe gjithashtu të përcaktojmë terapi të personalizuar. Së bashku me një listë për vëzhgimin e sjelljes jo-verbale, ky mjet është themelor për strukturimin e një plani terapie që prek fushat e ndryshme të komunikimit social.

Si përfundim, një përjasje e sjelljes përshkruese të fëmijëve me paaftësi praktike është vetëm pika e fillimit. Përndryshe, fenomenet konjitive dhe linguistike që përcaktojnë sjelljen e tyre janë vendimtare për të rritur aftësitë e tyre përshtatëse: analizat tona të bashkëbisedimit duken për ne një mjet shumë i mirë për ta bërë këtë.

Fjalë kyçe: gjuha praktike (pragmatike), analiza e bashkëbisedimit, njohja sociale, përshtatja konjitive, rehabilitimi konjitiv, zhvillimi i komunikimit.

CONVERSATIONAL ANALYSIS IN CHILDREN WITH PRAGMATIC LANGUAGE IMPAIRMENT: AN ECOLOGICAL TOOL INTO A FORMAL ASSESSMENT

*Giovanni Masciarelli, Durres; Emanuela Leone Sciabolazza, Rome.
giovanni.masciarelli@gmail.com*

ABSTRACT

Social (pragmatic) communication disorder is a recent diagnosis of the DSM V characterized by significant problems using verbal and non-verbal communication for social purposes. However, pragmatic competence deficits affect different neurodevelopmental disorders. Despite the presence of various tests to assess pragmatic competence, attempts for assessment through conversational analysis are very rare. The aim of this work is to describe the Conversational Analysis as elaborated within the Communication and Pragmatic skills Training (Leone Sciabolazza E. & Masciarelli G., 2023) which allows to highlight 32 communicative phenomena within 9 domains through a guided conversation between an adult and a child. We will use a single case study for understanding what is happening behind the scenes of the patient's bizarre behavior during social interactions. This methodological choice will enable us to achieve a more specific profile of conversational abilities in a child with social (pragmatic) communication disorder and also to design a personalized therapy. Together with a checklist for observing nonverbal behavior, this tool is essential for structuring a therapy plan that affects the different socio-communicative domains. In conclusion, a descriptive behavioral approach of children with pragmatic impairment is only a starting point. Otherwise, cognitive and linguistic phenomena that determine their conduct is crucial to increase their adaptive competences: our conversational analysis seems to us to be an excellent tool to do this.

Keyword: pragmatic language, conversational analysis, social cognition, cognitive rehabilitation, communication development

REHABILITIMI I FËMIJËS ME HUMBJE DEGJIMI TË IMPLANTUAR, ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Dr. Alessandra Resca, U.O.C. i Audiologjisë dhe Otokirurgjisë, Qendra Referenciale për Implantet Kokleare dhe protezat e implantueshme, Shefi i Dr. Pasquale Marsella, Spitali Pediatrico Bambino Gesù, Romë

ABSTRAKT

Implantet kokleare tek fëmijët janë treguar të jenë kosto-efektive dhe ofrojnë përfitime në perceptimin dëgjimor dhe të të folurit; megjithatë, ka pak studime në lidhje me rezultatet e arritura te fëmijët me nevoja komplekse.

Vështirësia për të përcaktuar se kush ka nevoja komplekse dhe diapazoni i gjerë në ashpërsinë e nevojave shtesë çon në një grup heterogjen fëmijësh. Rezultatet audiologjike të marra tregojnë se të gjithë këta fëmijë janë në gjendje të aksesojnë zërin pas CI; Megjithatë, është më e vështirë të vlerësohet se si e përdorin më pas këtë tingull

Tradicionalisht, rezultatet për fëmijët me CI janë fokusuar në perceptimin e të folurit, aftësitë gjuhësore gojore dhe shkrim-leximin, por këto qëllime nuk janë gjithmonë të arritshme për këta pacientë. Prandaj do të ishte më e dobishme të përdreshin masat e cilësisë së jetës si një tregues më i mirë i rezultateve

REHABILITATION OF THE IMPLANTED DEAF CHILD WITH ASSOCIATED DISABILITIES

Dr. Alessandra Resca, U.O.C. of Audiology and Otosurgery, Reference Center for Cochlear Implants and implantable prostheses, Head of Dr. Pasquale Marsella, Bambino Gesù Pediatric Hospital, Rome

ABSTRACT

Cochlear implants in children have been shown to be cost-effective and to provide benefits in auditory and speech perception; however, there are few studies relating to the outcomes achieved in children with complex needs.

The difficulty in defining who has complex needs and the wide range in the severity of additional needs leads to a heterogeneous group of children. The audiological results obtained indicate that all these children are able to access sound after CI; it is more difficult, however, to evaluate how they then use this sound

Traditionally, outcomes for children with CIs have focused on speech perception, oral language skills, and literacy, but these goals are not always achievable for these patients. It would therefore be more useful to use quality of life measures as a better indicator of outcomes

PROCESIMI GJUHËSOR GESTALT NË FËMIJËT ME ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT TË AUTISMIT

MIGENA KIKA, A. BEDENI, L. KONOMI, M. GUSHO, K. MAHMUTAJ, K. KUKA, E.

BASHALLI, G.KIKA-Kids Health Clinic

ABSTRAKT

HYRJE: Procesimi gjuhësor Gestalt është forma më e zakonshme e zhvillimit gjuhësor në fëmijët me ÇSA. Evidencat raportojnë se një përqindje rreth 75 - 90% e fëmijëve me autism zhvillojnë gjuhën e folur në këtë mënyrë. Kjo formë e zhvillimit gjuhësor mund të vërehet edhe në fëmijët neurotipikë por ata kalojnë fazat e procesimit gjuhësor Gestalt shpejt duke zhvilluar në mënyrë tipike gjuhën ekspresive.

QËLLIMI: Të vlerësojë sa fëmijë verbalë me autism zhvillojnë gjuhën ekspresive në këtë mënyrë procesimi.

METODAT: U vlerësuan gjithsej 30 fëmijë me ÇSA të moshës 4 deri 10 vjeç. Të gjithë fëmijët ishin verbalë. Të gjithë fëmijët u vlerësuan jo vetëm për mënyrën e procesimit gjuhësor por edhe për stadin e procesimit Gestalt në të cilin janë. Testet gjuhësore tipike nuk mund të vlerësojnë fëmijët që procesojnë gjuhën sipas Gestalt. Për këtë qëllim për vlerësimin gjuhësor u përdorën “language samples” duke i vlerësuar në bazë të Natural Language Acquisition framework.

REZULTATET: 28 nga 30 fëmijët me ÇSA procesojnë gjuhën sipas Gestalt. Të gjithë fëmijët janë në stadin e parë dhe të dytë të procesimit Gestalt pra paraqesin ekolali të vonuar me fjalë teke dhe copëza gjuhe (scripting) dhe pjesërisht Gestalt me përzjerje dhe ndarje të bloqeve më të mëdha të gjuhës në copëza më të vogla duke i përzier.

PËRFUNDIME: Një pjesë e madhe e fëmijëve me ÇSA procesojnë gjuhën sipas “Gestalt”. Në pjesën më të madhe të rasteve këta fëmijë paraqesin stadin 1 dhe 2 Gestalt duke rezultuar në cungim e vështirësi në komunikim e në kuptueshmëri të gjuhës. Ndërhyrja terapeutike në këto raste duhet të përqendrohet në elaborimin gjuhësor dhe kalimin në stadin tjetër Gestalt duke rritur kështu cilësinë e komunikimit.

FJALË KYÇE: autism, femije, procesimi gjuhësor gestalt, terapi logopedike

GESTALT LANGUAGE PROCESSING IN CHILDREN WITH AUTISM SPECTRUM DISORDERS

MIGENA KIKA, A. BEDENI, L. KONOMI, M. GUSHO, K. MAHMUTAJ, K. KUKA, E. BASHALLI,
G.KIKA-Kids Health Clinic

ABSTRACT

INTRODUCTION: Gestalt language processing is the most common form of language development in children with ASD. Evidence reports that a percentage of about 75 - 90% of children with autism develop spoken language in this way. This form of language development can also be observed in neurotypical children, but they pass the stages of Gestalt language processing quickly, typically developing expressive language.

AIM OF STUDY: To assess how many verbal children with autism develop expressive language in this processing mode.

METHODS: A total of 30 children with ASD between the ages of 4 and 10 were evaluated. All children were verbal. All children were assessed not only for language processing but also for the stage of Gestalt processing they are in. Typical language tests cannot assess children who process language according to Gestalt. For this purpose, "language samples" were used for language evaluation, evaluating them based on the Natural Language Acquisition framework.

RESULTS: 28 out of 30 children with ASD process language according to Gestalt. All children are in the first and second stages of Gestalt processing, i.e. they present delayed echolalia with single words and pieces of language (scripting) and partially Gestalt with mixing and dividing larger blocks of language into smaller pieces by mixing them .

CONCLUSION: A large part of children with ASD process language according to "Gestalt". In most cases, these children present Gestalt stages 1 and 2, resulting in truncation and difficulties in communication and intelligibility of language. Therapeutic intervention in these cases should be focused on linguistic elaboration and the transition to other Gestalt stages, thus increasing the quality of communication.

KEYWORDS: autism, gestalt language processing, speech therapy, children

MARRËDHËNIA MES LEKSIKUT, SEMANTIKËS DHE PRAGMATIKËS

Dott.ssa Emanuela Leone Sciabolazza

ABSTRAKT

Leksiku, semantika dhe pragmatika janë aspekte ndërvepruese në komunikimin e përditshëm.

Biseda ime do të fokusohet në marrëdhëniet midisleksikut, semantikës dhe pragmatikës, veçanërisht duke analizuar natyrën e tyre, kufijtë e tyre dhe modelet interpretuese të përdorura për të shpjeguar se si ato ndërveprojnë.

Objektivi është përcaktimi i parametrave praktik për të kuptuar vështirësitë e komunikimit në përpunimin e tekstit në një nivel leksikor, semantik dhe pragmatik. Këto vështirësi mund të prekin një nga këto aspekte ose, njëkohësisht, të gjitha.

Prezantimi im do t'ju japë një këndvështrim të ndryshëm se si modelet njohëse e shpjegojnë këtë temë dhe si t'i zbuloni këto vështirësi në praktikën klinike përmes analizës së sjelljes komunikuese në çrregullimet zhvillimore dhe të fituara.

Së fundi, do të përcaktoj parametrat për vlerësimin dhe rehabilitimin kognitiv të këtyre çrregullimeve.

THE RELATIONSHIP BETWEEN LEXICS, SEMANTICS AND PRAGMATICS

Dott.ssa Emanuela Leone Sciabolazza

ABSTRACT

Lexicon, semantics, and pragmatics are interacting aspects in everyday communication.

My talk will focus on the relationship between lexicon, semantics, and pragmatics, particularly analyzing their nature, their boundaries, and the interpretative models used to explain how they interact.

The objective is delineating practical parameters to understanding communication difficulties in word processing at a lexical, semantic, and pragmatic level. These difficulties can affect one of these aspects or simultaneously, all of them.

My presentation will give you a different perspective on how cognitive models explain this topic and how to detect these difficulties in clinical practice through analysis of communicative behavior in developmental and acquired disorders.

Finally, I will define parameters for assessment and cognitive rehabilitation of these disorders

NDIKIMI I TEKNOLOGJISË ELEKTRONIKE NË SHËNDETIN E FËMIJES DHE ADOLESHENTIT

Valentina Demaj¹, Edona Gara²

ABSTRAKT

Hyrje: Ne ditet e sotme eshte e pamundur ti rezistosh ketij trendi dhe duke pare shoqeri me teknologji te reja duke na karakterizuar epoken ne te cilen po jetojm. Me zhvillimin e shpejte te teknologjise softuerike dhe asaj mobile, smartphone jane bere pjese e pandashme e jetes tone e veqanerisht tek femijet.

Qëllimi – I ketij hulumtimi eshte qe te analizohen sfidat ne perdorimine teknologjise digjitale nga ana e femijeve e cila nga ngritur shqetesime nga: prinderit, mesusesit, mjeket, specialistet e sjelljes, komuniteti, adoleshentet dhe vet femijet. Prandaj qellimi kryesor I ketij punimi eshte qe te paraqesim njohurit te cilat femijet dhe adoloshentet rrezikohen nga ndikimi I teknologjive.

Dhe nga kjo lind pyetja: A ndikon perdorimi I teknologjive dhe rrjeteve sociale ne shendetin e femijes?

Objektivat – Te vleresoje efektin e teknologjise elektronike si si ajo ndikon ne mireqenjen e femijes dhe cilesine e jetese se tyre .

Metodat- Ne kete hulumtim jane perdorur metodologji te ndryshme si ajo pershkruese dhe ajo hulumtuse. Perzgjedhja e mostres ka qene e rastesishme. Tipi i studimit eshte kualitativ ku eshte bere mbledhja e te dhenave nga nje moster prej 200 femije. Target grupi jane femije dhe adoleshent te moshave nga 2 -15 vjec te marre ne kopshte dhe shkolla .

Rezultatet: Gjetjet nga analizat e rezultateve tregojne se ekzistojne njohuri mbi pasojat e perdorimit te tepruar te teknologjise nga ana e prindereve, femijeve dhe adoloshenteve. Sa I per kete dallimeve ne mes te grupmoshave femijevt e moshes mbi 12 vjeqare jane perdorues active te teknologjise. Sipas analizave shumica e femijeve dine te perdorin paisjet elektronike, dhe koha e shpenzuar para ekraneve te ndryshme eshte prej 3-5h gjate dites. Dhe vetem nje pjese e tyre deklarohen se e perdorin vetem gjate fundjaves.

Diskutimi: Teknologjia digjitale ka transformuar rrugen e nderveprimit dhe komunikimit edhe tek femijet duke jane mundesuar nje komunikim me te lehte dhe me te shpejte.

Ne anen tjeter te medaljes jane edhe disavantazhet te perdorimit te tepruar te teknologjise nga ana e femijeve. Ne radhe te pare qendrimi per nje kohe te gjate perballe ekranit I sjelle efekte negative ne shendetin fizik dhe mendore tek femijet duke perfshire nje fjalor jo te pasur . Disa autor kane treguar se varesia nga perdorimi I teknologjive nga femijet ka sjelle efekte negative ne personalitetin e femijeve.

Rekomandimet: Per te pasur nje kontrole te plote jane disa rekomandime qe prinderit mund ti perdorin si ta menaxhojne perdorimin racional te teknologjise.

Ata duhet te vendosin kufijet ne shfrytezimin e paisjeve digjitale, duhet te bashkebisedojne per pasojat qe vijen si rezultat i perdorimit te tepruar te ketyre teknologjive.

Fjalalet kyçe: femije , adoleshent, teknologji , shendet , paisje elektronike ,smart phone tablet.

THE IMPACT OF ELECTRONIC TECHNOLOGY ON THE HEALTH OF CHILDREN AND ADOLESCENTS

Valentina Demaj¹, Edona Gara²

ABSTRACT

Introduction: Nowadays it is impossible to resist this trend and seeing society with new technologies characterizing the era we are living in.

With the rapid development of software and mobile technology, smart phones have become an integral part of our lives, especially for children and teenagers.

The purpose of this research is to analyze the challenges in the use of digital technology by children, which has raised concerns on the part of parents, teachers, doctors, behavioral specialists, the community, teenagers and the children themselves.

Therefore, the main purpose of this research is to present the knowledge that children and teenagers are endangered by the influence of technologies.

Objectives: To evaluate the effect of electronic technology, how it affects the child's well-being and the quality of their life.

Methods: In this research, different methodologies were used, both descriptive and research. The selection of the sample was random, the type of study is qualitative, where data was collected from a sample of 200 people. The target was children from the age of 2-15, enrolled in Kindergarten and School.

Results: The findings from the analysis of the results show that there is knowledge about the consequences of the excessive use of electronic technology by both parents and children. Regarding the differences between the age groups, children over 12 years old are active users of technology. According to the analysis, most children know how to use electronic devices such as smart phones, tablets, PCs, and the time spent in front of different screens is from 3h-5h during the day. And only a part of them declare that they use it during the weekend.

Discussio: Digital technology has transformed the way of interaction and communication even among children, enabling easier and faster communication.

Intergenerational trauma can occur in younger family members whose parents or grandparents experienced traumatic events such as war, persecution, sexual abuse, or violence. People who have experienced the initial trauma, if they haven't been able to recover from it, their children and

grandchildren can also feel the effects of the trauma - even if they haven't experienced it first hand. Survivors often pass on trauma to later generations when they fail to diagnose it or have no opportunity to engage in a healing process – or, of course, if the effect of their trauma is simply too difficult to overcome.

Purpose: The main focus of this study is to present the reality of carrying the psychological trauma of the last war in Kosovo and its transmission between generations.

Study: Longitudinal and observational, duration 98-99, 2008-2009, 2018-2020-2023, was conducted in five regions of Kosovo, (Drenica, Podujeve, Rahovec, Gjakove, Vushtri) the study collected data from focus group and case study of 50 age participants

During the year 98-99, the age of the participants was 02-45 years

During the year 2008-2009, the participants were 12-55 years old

During the year 2018-2020, the participants were 22-65 years old

Men and women, Kosovo Albanians, consisting of parents, children and family members directly affected by the trauma. The study used various validated scales and checklists to measure variables such as PTSD symptoms, traumatic life events, and social support.

The result:

The findings showed an interesting generational divide. The younger generation, consisting of those born after the war, show significantly higher levels of perceived PTSD symptoms compared to their parents. Other family members of this study during the first decade were more focused on rebuilding their lives and socio-economic well-being, the level of trauma was lower at that time, but after 20 years of the same, they present major crises of post-traumatic stress and states of heavy psychological. Additionally, they reported lower levels of perceived social support, suggesting a potentially unstable emotional foundation.

Also, this disparity in perceived support was particularly pronounced among those who were parents coping with PTSD.

Discussion:

More importantly, the study revealed a disturbing trend – youth whose parents had experienced PTSD were more susceptible to developing PTSD symptoms themselves. Further analysis revealed that these youth were exposed to a higher frequency of traumatic events, including attempted suicide, domestic violence, and sudden violent death.

The implications of these findings are profound.

The study highlights the urgency of addressing the multigenerational implications of PTSD, emphasizing the importance of understanding not only direct survivors of conflict, but also their descendants. It highlights the need for an overall holistic approach to address the complex web of effects of PTSD on individuals, families and communities, particularly in settings affected by ongoing or recent conflicts.

Conclusion:

My study aims to emphasize the transmission of trauma in general to all family members, with particular emphasis on the next generation, if the trauma caused last year is not treated in a continuous and

professional manner. It is very important to provide ongoing professional support, care and treatment to all who have experienced violence, torture or other traumatic events during war. Likewise, effective interventions that contribute to breaking the chain of intergenerational trauma should be made possible. In this regard, the findings from the study mentioned above, but also from other studies that have been carried out in countries that have experienced war, will serve the state institutions well enough to organize professional interventions for children born to victim mothers. of families that are directly affected by trauma and war. Sensitization and self-awareness campaigns should also be organized so that society has a different perception of victims of violence and their families. Such campaigns would contribute to a lower level of stigma and prejudice in general towards survivors of violence.

It is also essential for Kosovo that the young generation that has been exposed to such trauma receives adequate support during development, so that the intervention and treatment have the appropriate effect.

Keywords: Trauma, psychology, generations

NDËRHYRJA E HERSHME PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA ZHVILLIMORE

Brunilda Elezi¹ Alda Elezi² Tatjana Elezi³ Xhesika Zyko³

¹ *Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike*

² *Shëndet Publik*

³ *Qendër Shendetesore*

brunilda.elezi@uniel.edu.al

ABSTRAKT

Hyrja. Ndërhyrja e hershme për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore përfshin sigurimin në kohë të një mjedisi optimal të edukimit dhe mësimi që synon të maksimizojë rezultatet e zhvillimit dhe shëndetit dhe të reduktojë shkallën e kufizimeve funksionale.

Qëllimi. Sigurimi një sistem shërbimesh të koordinuara që nxit rritjen dhe zhvillimin e fëmijës dhe mbështet familjet gjatë viteve të hershme kritike duke ruajtur dhe maksimizuar zhvillimin e fëmijës nëpërmjet ofrimit të një gamë të gjerë shërbimesh duke përfshirë personel mjekësor kualifikuar, terapi fizike, terapi profesionale dhe këshillimin familjar.

Metodologjia. U rishikua literatura e përzgjedhur nga 34 artikuj duke u identifikuar në bazë të referencave dhe fjalëve kyçe, bazë e të dhënave shërbyen kërkimet në Google scholar, Pubmed, Researchgate. U përfshinë artikuj që ishin të fokusuar në mjediset e edukimit të fëmijërisë së hershme, konceptet e teknikave inovative në lidhje me ndërhyrjet e aftësisë së kufizuar në fëmijëri, praktikat e politikave që promovojnë fëmijën dhe familjen.

Rezultate. Ekziston një konsensus në rritje i bazuar në provat me të mira të disponueshme se ndërhyrjet e hershme mund të ushtrojnë efekte të moderuara pozitive. Megjithatë, kjo literaturë është e kufizuar nga fusha metodologjike në shumicën e studimeve. Prandaj nevojiten studime të mëtejshme klinike të rastësishme për të përcaktuar se cilat programe plotësojnë më mirë nevojat e fëmijëve me ose në rrezik për paaftësi zhvillimore.

Konkluzione. Programet e ndërhyrjes së hershme ofrohen më së miri në një mënyrë të koordinuar, të planifikuar, të përqendruar në familje, që pasqyron një qasje jetësore ndaj rezultateve të shëndetit dhe mirëqenies. Mbështetja e familjes është një komponent thelbësor i programeve të ndërhyrjes së hershme, pasi familja ka një rol kyç në nxitjen e potencialit zhvillimor të fëmijës së tyre dhe mund të përjetojë strese shtesë ndërsa plotësojnë nevojat e veçanta të fëmijës së tyre.

Rekomandime. Një kornizë gjithëpërfshirëse parandaluese për aftësitë e kufizuara zhvillimore mund të kuptohet në termat e qasjes së shëndetit publik për reduktimin e sëmundshmërisë. Megjithatë, ekziston një nevojë e vazhdueshme për kërkime në shumë fusha, duke përfshirë vlerësimin e efekteve afatgjata të shërbimeve për grupe të veçanta, përcaktimin e mjeteve më efektive të ofrimit të shërbimeve dhe vlerësimin e rezultateve të funksionimit të familjes.

Fjalë kyçe: Aftësi e kufizuar zhvillimore, fëmijë, ndërhyrje e hershme.

EARLY INTERBENTION FOR CHILDREN WITH DEVELOPMENTAL DISABILITIES

Brunilda Elezi¹ Alda Elezi² Tatjan Elezi³

¹ University of Elbasan "Aleksander Xhuvani, Albania, Faculty of Technical Medical Sciences

²Public Health

³Health Center

ABSTRACT

Introduction. Early intervention for children with developmental disabilities involves the timely provision of an optimal education and learning environment aimed at maximizing developmental and health outcomes and reducing the degree of functional limitations.

The purpose. Providing a coordinated system of services that promotes child growth and development and supports families during the critical early years by maintaining and maximizing child development through the provision of a wide range of services including qualified medical personnel, physical therapy, occupational therapy and family counseling

Methodology. The literature was reviewed, selected from 34 articles by identifying based on references and keywords, database served searches in Google scholar, Pubmed, Researchgate. Articles were included that focused on early childhood education settings, concepts of innovative techniques related to childhood disability interventions, policy practices that promote the child and the family.

Results. There is a growing consensus based on the best available evidence that early interventions can have moderate positive effects. However, this literature is limited by the methodological area in most studies. Further randomized clinical trials are therefore needed to determine which programs best meet the needs of children with or at risk for developmental disabilities.

Conclusions. Early intervention programs are best delivered in a coordinated, planned, family-centered manner that reflects a lifetime approach to health and well-being outcomes. Family support is an essential component of early intervention programs, as the family has a key role in fostering their child's developmental potential and may experience additional stresses while meeting their child's special needs.

Recommendations. A comprehensive prevention framework for developmental disabilities can be understood in terms of a public health approach to morbidity reduction. However, there is a continuing need for research in many areas, including evaluating the long-term effects of services for specific groups, determining the most effective means of service delivery, and evaluating family

functioning outcomes.

Keywords: Early intervention, children, developmental disabilities.

“TRAJTIMI LOGOPEDIK I INTEGRUAR ME TERAPI ZHVILLIMI NËTRAJTIMIN E PARALIZËS CEREBRALE INFANTILE”

MSc.Dorina HASANLLARI

Psikologe, Klinika Italiane “Umano Felice”, Elbasan, Shqipëri, hasanllari.dorina@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Paraliza cerebrale infantile është një sëmundje e sistemit nervor e cila prek aftësitë motorike dhe të koordinimit të trupit të fëmijëve dhe kryesisht diagnostifikohet në fëmijërinë e hershme. Ky studim është një hulumtim rreth trajtimeve logopedike dhe rezultateve si dhe ndikimit që kanë këto të fundit tek përmirësimi i cilësisë së jetës të fëmijëve që u duhet të bashkëjetojnë me këtë sëmundje.

Qëllimi: Vlerësimi i efektivitetit të trajtimit logopedik tek fëmijët me paralizë cerebrale .

Metodologjia: (studime rasti) Teste gjuhësore, vlerësim i aftësive gjuhësore dhe shkathtësive komunikuese tek *tri fëmijë* të cilët janë ndjekur me terapi logopedie/ terapi zhvillimi pranë spitalit pediatrik Elbasan. Ecuria e tyre është studiuar për një periudhë 6 mujore, duke zbatuar plane individuale bazuar në vlerësimin sipas shkallës së vështirësisë që fëmijët paraqesnin.

Metodat e trajtimit logopedik për fëmijët me paralizë cerebrale janë të ndryshme, ndër to përmendim: terapinë e të folurit dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore; përdorimin e mjeteve të komunikimit të asistuar (tabelat e komunikimit, kartat vizuale; stimulimi i aftësive të leximit dhe shkrimit, përdorimi i teknologjisë për të nxitur komunikimin (përdorimi Novaphon) si dhe ndërthurja trajtimit logopedik me terapi zhvillimi si një shërbim i integruar që prodhon rezultate më të qëndrueshme dhe të matshme në kohë.

Rezultatet: Trajtimet logopedike ndryshuan në varësi të moshës dhe shkallës së dëmtimit. Në 2 prej rasteve të trajtuara përkatësisht moshë 6, dhe 9 vjeç, (meshkuj) fëmijët arritën të zhvillojnë aftësi të mira gjuhësore dhe aftësi komunikuese të kënaqshme. Ndërsa në rastin e fëmijës 5 vjeç (mashkull), me një shkallë më të rëndë, zhvillimi gjuhësor edhe pas trajtimit logopedik ishte i kufizuar. Kjo vjen edhe si rezultat i frekuentimit jo të rregullt të terapive. Ndikimi i trajtimit është i lidhur ngushtë dhe me kohëzgjatjen dhe qëndrueshmërinë e ndjekjes së terapisë.

Konkluzione: Trajtimi logopedik ka një impakt pozitiv në jetën e përditshme të fëmijëve me paralizë cerebrale. Ata zhvillojnë aftësi të cilat i ndihmojnë që të kenë një jetë sociale dhe më shumë ndërveprim me të tjerët. Metodat e përdorura dhe rezultatet e arritura ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin gjuhësor dhe zhvillimin e aftësive komunikative tek këta fëmijë. Ndjekja e progresit të fëmijës dhe mbajtja e kontakteve me prindërit është një pikë kyçe për të matur dhe përmirësuar punën tonë. Trajtimi logopedik është një pjesë thelbësore e kujdesit dhe rehabilitimit për këta fëmijë, megjithatë është e rëndësishme që të theksojmë se çdo rast është unik dhe trajtimi duhet përshtatur me nevojat specifike të individit për të ofruar një praktikë klinike gjithmonë dhe më efektive.

Fjalë Kyçe: Paralizë Cerebrale, Terapi, Logopedi, Zhvillim Gjuhësor, Novaphone.

"LOGOPEDIC TREATMENT INTEGRATED WITH DEVELOPMENT THERAPY IN THE TREATMENT OF INFANTILE CEREBRAL PALSY"

MSc. Dorina HASANLLARI

*Psychologist, Italian Clinic "Umano Felice", Elbasan, Albania,
hasanllari.dorina@gmail.com*

ABSTRACT

Introduction: Infantile cerebral palsy is a disease of the nervous system that affects children's motor skills and body coordination and is mainly diagnosed in early childhood. This study is a research about speech therapy treatments and results, as well as the impact they have on improving the quality of life of children who have to live with this disease.

Aim: Evaluation of the effectiveness of speech therapy treatment in children with cerebral palsy.

Methodology: (case studies) Language tests, assessment of language skills and communication skills in three children who were followed by speech therapy/developmental therapy at the Elbasan pediatric hospital. Their progress has been studied for a period of 6 months, implementing individual plans based on the assessment according to the degree of difficulty that the children presented.

Speech therapy treatment methods for children with cerebral palsy are different, among them we mention: speech therapy and the development of language skills; the use of assisted communication tools (communication boards, visual cards; stimulation of reading and writing skills, use of technology to promote communication (Novaphon use) as well as combining speech therapy treatment with developmental therapy as an integrated service that produces results more stable and measurable in time.

Results: Speech therapy treatments varied depending on age and degree of impairment. In 2 of the treated cases, respectively age 6 and 9, (male) children managed to develop good language skills and satisfactory communication skills. While in the case of the 5-year-old child (male), with a more severe degree, language development was limited even after speech therapy treatment. This also comes as a result of irregular attendance of therapies. The impact of the treatment is also closely related to the duration and consistency of the therapy follow-up.

Conclusions: Logopedic treatment has a positive impact on the daily life of children with cerebral palsy. They develop skills which help them to have a social life and more interaction with others. The methods used and the results achieved significantly affect the language development and the development of communication skills in these children. Tracking the child's progress and keeping in touch with parents is a key point to measure and improve our work. Speech therapy treatment is an essential part of care and rehabilitation for these children, however it is important to emphasize that each case is unique and treatment must be tailored to the specific needs of the individual to provide a more effective clinical practice.

Keywords: Cerebral Palsy, Therapy, Speech Therapy, Language Development, Novaphone.

PËRTEJ BARRIERAVE, NJË ANALIZË PËRMBAJTJEJE E PREZENCËS ONLINE TË LOGOPEDISTËVE SHQIPTARË

Ertiola Lugji

ABSTRAKT

Hyrja: Ky studim depërton në sferën virtuale të logopedisë në Shqipëri, duke eksploruar praninë online të burimeve dhe materialeve dedikuar logopedisë. Ky kërkim u përpoq të shpalosë dhe pasqyrojë burimet online të logopedisë, duke investiguar përmbajtjen e tyre, saktësinë e informacionit dhe gjithëpërfshirjen, për të hedhur dritë mbi ndërlikojnë e njohurive globale dhe praktikës lokale.

Objektivat: Së pari, nëpërmjet një analize përmbajtjeje rigoroze, ky studim u përpoq të evidentojë temat dominuese në kontekstin e burimeve të terapisë logopedike në Shqipëri. Së dyti, u investigua prania e pakorrektesive dhe informacioneve të papërditësuara në materialet edukuese online. Së treti, për të vlerësuar dinamikat kulturore që luajnë rol në burimet logopedike në Shqipëri, u shqyrtua masa në të cilën këto materiale adresojnë tematika si diversiteti dhe gjithëpërfshirja.

Metodologjia: Përfaqja e përdorur për këtë studim është analiza e përmbajtjes. Për analizën e të dhënave, një skemë kodimi e posaçme u aplikua, e cila shërbeu për të kategorizuar dhe vlerësuar përmbajtjen e të dhënave të mbledhura. Mbledhja e të dhënave u bë brenda periudhës Korrik – Gusht 2023, nga e cila, u krijua një database me llogaritë online dhe website-t për logopedinë, të identifikuar nëpërmjet fjalëve kyçe specifike.

Rezultatet: Analiza e të dhënave zbuloi trende të rëndësishme në përmbajtjen e burimeve logopedike. Tematikat më të përmendura ishin zhvillimi i fëmijës dhe arritjet moshore të zhvillimit gjuhësor, ndërsa popullatat e adultëve ishin të përmendura më rrallë. Në dukje binte lobimi i kombinimit të terapisë logopedike me terapi konjitivo-bihejviorale. Rastet me informacion të pasaktë apo të papërditësuar ishin të rralla. Tematikat e gjithëpërfshirjes dhe diversitetit ishin prezente në masë të kënaqshme në burimet online të logopedisë.

Konkluzione: Studimi shpërfaq dinamikat e burimeve të logopedisë në epokën digjitale, duke kontribuar në një të kuptuar më të mirë të diskursit, adaptimit kulturor dhe ndërthurjes globalo – lokale të logopedisë në Shqipëri. Këto gjetje janë në funksion dhe ndihmë të logopedistëve, prindërve, pacientëve dhe instancave përgjegjëse për të formësuar praktikën dhe burimet logopedike në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *Logopedi, Burime Online, Analizë Përmbajtjeje, Saktësi, Trende në Logopedi*

BEYOND BARRIERS, A CONTENT ANALYSIS OF THE ONLINE PRESENCE OF ALBANIAN SPEECH THERAPISTS

Ertiola Lugji

ABSTRACT

Introduction: This study penetrates the virtual sphere of speech therapy in Albania, exploring the online presence of resources and materials dedicated to speech therapy. This research sought to unfold and reflect on online speech therapy resources, investigating their content, information accuracy and comprehensiveness, to shed light on the interrelationship of global knowledge and local practice.

Objectives: First, through a rigorous content analysis, this study attempted to identify dominant themes in the context of speech therapy resources in Albania. Second, the presence of inaccuracies and out-of-date information in online educational materials was investigated. Third, to assess the cultural dynamics that play a role in speech therapy resources in Albania, the extent to which these materials address topics such as diversity and inclusion was examined.

Methodology: We conducted a systematic content analysis. A tailored coding scheme was developed to categorize and evaluate the content of the materials collected. Data collection occurred between July and August 2023, involving social media accounts and websites, identified through specific search keywords.

Results: Our analysis of the collected data revealed several noteworthy trends. Prominent topics in Albanian SLP resources include child development and language milestones, but adults and other demographics are underrepresented. A recurrent theme within the online presence is the advocacy for speech therapy in combination with behavior-cognitive approaches. Instances of inaccuracies or outdated information were relatively rare. Moreover, the study illuminated variations in addressing diversity and inclusivity. Social media accounts of therapists demonstrated a more proactive stance compared to websites, with a particular focus on the ASD population.

Conclusions: "Beyond Borders: A Content Analysis of Albanian SLP Online Presence" unearths the dynamics of SLP resources in the digital age, contributing to a better understanding of the discourse, cultural adaptation, and the global-local dialectics in the field of speech-language pathology in Albania. These findings hold implications for practitioners, educators, and policymakers in shaping the future of SLP practice and resources in this region.

Key words: *Speech-Language Pathology, Online Resources, Content Analysis, Accuracy, Speech Therapy Trends*

ABSTRAKTE IMAZHERI

RËNDËSIA E ANGIO-CT KORONARE DHE TEKNIKA E KRYERJES NË “KAWASAKI DISEASE”

Gentjan Zervoi ¹, Albana Shahini ²

¹ Kryetëknik i imazherisë në Spitalit Amerikan Tiranë

² Mjeke radiologe- Spitali Amerikan Tiranë

ABSTRAKT

Hyrje: Kawasaki Disease është një sëmundje e rrallë autoimune, që mund të rezultojë në aneurizma të arterieve koronare. Më shpesh prek fëmijët nën 5 vjeç. Aneurizmat e arterieve koronare shihen në rreth 25% të fëmijëve me Kawasaki Disease. Angiografia invazive e Arterieve Koronare është konsideruar si standart i artë për diagnostikimin dhe ndjekjen e aneurizmave të arterieve koronare, trombozës dhe stenozës në pacientët me Kawasaki Disease, por duke qënë se rrezatimi dhe rrezikshmëria ishin të larta u kalua në diagnostikim me Angio-CT të Arterieve Koronare.

Qëllimi: Optimizimi i protokollit të Angio-CT Koronare për arritjen e një ekzaminimi me cilësi të lartë duke reduktuar sa më shumë dozën e rrezatimit X, duke qënë se kemi të bëjmë me moshë pediatrike.

Metodologjia: Ekzaminimi u realizua me CT Siemens Definition 128 slice, rikonstruksione të imazheve me 0.6 mm, përpunime në software të avancuar me program të dedikuar për imazhe kardiale. Protokollin i përdorur për kryerjen e ekzaminimit është nga rubrika “Child”, dhe gjithashtu është përdorur dhe Care Dose për të minimizuar rrezatimin. Rasti ynë studimor, fëmijë i moshës 6 vjeç femër, 25kg. U përdorën 30 ml kontrast intravenoz (Omnipol 350 mg/ml) dhe 40 ml NaCl.

Përfundimi: Nëse të gjitha kushtet e kryerjes së Angio-CT koronare janë optimale, atëherë mund të themi që ky ekzaminim është standart i artë për diagnostikimin dhe ndjekjen për pacientët me Kawasaki Disease.

Fjalë kyçe: Angio-CT koronare, pediatri, Kawasaki Disease, rreze X

IMPORTANCE OF CT CORONARY ANGIO AND PERFORMING TECHNIQUE IN "KAWASAKI DISEASE"

Gentjan Zervoi ¹, Albana Shahini ²

¹ Chief Imaging Technician at the American Hospital Tirana

² Radiologist at the American Hospital Tirana

ABSTRACT

Introduction: Kawasaki Disease is an autoimmune disease that can result in coronary artery aneurysms. It most often affects children under 5 years old. Coronary artery aneurysms are seen in about 25% of children with Kawasaki Disease. Invasive Coronary Artery Angiography was considered as the gold standard for the diagnosis and follow-up of coronary artery aneurysms, thrombosis and stenosis in patients with Kawasaki Disease, but seeing that the radiation and risk was high, it was switched to Coronary Angio-CT Artery diagnosis.

Aim: Optimizing the Coronary Angio-CT protocol to achieve a high-quality examination by reducing the dose of X-rays as much as possible, considering that we are dealing with pediatric age.

Methodology: The examination was carried out with CT Siemens Definition 128 slice, reconstructions of images with 0.6mm, processing in advanced software with a program dedicated to cardiac images. The protocol used for the examination is from the "Child" column, and Care Dose was also used to minimize exposure. Our case includes a child female patient, 6 years old, 25kg for which were used 30 ml of intravenous contrast (Omnipol 350 mg/ml) and 40 ml of NaCl.

Conclusion: If all the conditions for performing a coronary Angio-CT are optimal, then we can say that this examination is the gold standard for diagnosis and follow-up for patients with Kawasaki Disease.

Keywords: Coronary Angio-CT, pediatrics, Kawasaki Disease, X-Ray

ROLI I IMAZHERISTIT NË KRYERJEN E NJË EKZAMINIMI CILËSOR EKOGRAFIK

*Kristian Shestani*¹

¹ *Klinika "PRO JETËS" Shkodër*

ABSTRAKT

Hyrje: Realizimi i një ekzaminimi ekografik është një sfidë më vete për imazheristët. Një detyrë e tillë me kaq përgjegjësi kërkon një përgatitje shumë të mirë dhe një farë eksperience sigurisht. Njohja e teknikave të tjera radiologjike ndihmon patjetër në përfytyrimin 3D të anatomisë së njeriut, aq i domosdoshëm në ekografi. Përveç njohurive të mira anatomike, teknikisht duhet njohur shumë mirë edhe aparati që kemi në përdorim, kapacitetet dhe limitet e tij. Një aparat i ri cilësor lehtëson shumë punën e teknikut, por njëkohësisht kërkon edhe azhurnim të vazhdueshëm për implementimin e këtyre modaliteteve në ekzaminim.

Duke qënë një ekzaminim i varur nga ana cilësore kryesisht nga tekniku që e realizon, kërkon zbatim rigoroz të protokolleve, por njëkohësisht edhe improvizim në varësi të anatomisë së pacientit (përdorimi i dritareve të duhura ekografike), po ashtu edhe në varësi të rastit klinik apo pamundësive pozicionale. Përveç aftësive personale për të arritur një rezultat cilësor duhet qënë në mënyrë konstante në qendër të trinomit pacient-imazherist-radiolog. Duke qënë kontakti i parë fizik me pacientin, i duhet marrë një anamnezë e kujdesshme për t'ju transmetuar radiologut, komunikimi i vazhdueshëm me këtë të fundit dhe mbajtja e kontakteve të pacientit për çdo rast nevojë për informacione të mëtejshme ose plotësim imazhesh janë thelbësore.

Në këtë prezantim do paraqes modestisht disa raste reale nga eksperiencia ime 5 vjecare. Raste disa herë të vështira, shpesh herë sfiduese e disa herë gabime. Raste të tilla kanë shënuar pika kyçe profesionale si mundësi për tu rritur. Në mendimin tim mësohet nga pengesat po aq sa mësohet nga përgatitja e mirë. Duke shpresuar që ky prezantim tju ngjallë interes, do ndaj me ju imazhe, video dhe histori klinike nga eksperiencia jonë. Shumë nga imazhet janë të shkarkuara nga arkiva jonë, por disa të tjera janë të marra nga faqe interneti si ilustruese për rastin konkret në pamundësi për kujtesën e emrit të pacientit.

Fjalë kyçe: *Teknik imazherie, ekografi, raste klinike.*

THE ROLE OF IMAGING TECHNICIAN IN PERFORMING A QUALITY ULTRASOUND EXAMINATION

*Kristian Shestani*¹

¹ "PRO LIFE" medical clinic, Shkodër

ABSTRACT

Introduction: Performing an ultrasound examination is a unique challenge for imaging technicians. Such a task with such responsibility requires a very good preparation and some experience of course. Knowledge of other radiological techniques definitely helps in 3D visualization of human anatomy, so important in ultrasound. In addition to good anatomical knowledge, the device we use, its capacities and limits should also be technically well known. A new high-quality device facilitates the imaging technician's work, but at the same time requires constant updating for the implementation of these modalities in the examination.

Being an examination that depends on the quality mainly of the imaging technician who performs it, it requires rigorous implementation of the protocols, but at the same time also improvisation depending on the anatomy of the patient (use of appropriate ultrasound windows), as well as depending on the clinical case or positional impossibilities. In addition to personal skills to achieve a quality result, they must constantly be at the center of the trinomial patient-imaging technician-radiologist. Being the first physical contact with the patient, a careful patient history must be taken to transmit to the radiologist, continuous communication with them and keeping the patient's contacts in case of need for further information or completion of images are essential.

In this presentation, I will modestly present some real cases from my 5-year experience. Sometimes difficult cases, often challenging and sometimes mistakes. Such cases have marked professional key points as opportunities to grow. In my opinion, you learn from setbacks as much as you learn from good preparation. Hoping that this presentation piques your interest, I will share with you some images, videos and clinical stories from our experience. Many of the images are downloaded from our archive, but some others are taken from the website to illustrate the specific case of inability to remember the patient's name.

Keywords: *Imaging technician, ultrasound, clinical cases.*

CTA E AORTËS: ECG TRIGGER VS CTA E THJESHTË

Alket Çollaku ¹, Elona Dybeli ²

¹ Teknik imazherie GVM Hospital Tirana, lektor Universiteti Mjekësor i Tiranës

² Lektore Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani"

ABSTRAKT

Hyrje: Sëmundjet vasculare mund të vlerësohen kryesisht përmes ekografisë, angio-CT ose MRA, me dhe pa përdorimin e lëndës së kontrastit. Vlerësimi i matjeve të aortës është i rëndësishëm në sëmundjet vasculare.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të krahasojë cilësinë e imazhit, ndryshimet në matje dhe gjetjet midis CTA me EKG trigger dhe asaj të thjeshtë. Për të bërë krahasimin ndërmjet protokolleve ndërkombëtare dhe protokollin e përdorur në departamentin tonë të radiologjisë.

Metodat dhe materialet: Të dhëna janë marrë në intervalin kohor 2019-2023. Gjithsej janë 104 pacientë që iu nënshtruan CTA me EKG trigger të aortës të realizuar në qendrën tonë diagnostike dhe për krahasim janë mbledhur të dhëna CT nga një qendër tjetër diagnostike ku nuk ka mundësi për të kryer EKG Triggering. Të gjitha ekzaminimet CTA me EKG trigger u kryen me CT Scanner me 128 detektorë (Siemens Somatom Go Top) dhe CTA e thjeshtështë realizuar me CT Scanner me 16 detektorë (Siemens Somatom Go Now).

Rezultatet: Vlerësimi i aortës është më i mirë përmes përdorimit të CTA me EKG trigger. Me këtë metodë mund të vlerësojmë valvulën e aortës, të matim saktësisht anulusin e aortës, sinusin e Valsalvës dhe gjithë pjesën tjetër të aortës torakale. Kjo është një metodë specifike për zbulimin e disekacionit të vogël të aortës.

Konkluzioni: CT me EKG trigger është teknika më e mirë për vlerësimin e aortës dhe sëmundjeve që e prekin atë. Zgjedhja midis metodave varet kryesisht nga lloji i aparatit CT të përdorur dhe përvoja e teknikut të imazherisë.

Fjalë kyçe: CTA, EKG trigger, CTA e aortës

AORTIC CTA ECG TRIGGERING VERSUS SIMPLE AORTIC CTA

Alket Çollaku¹, Elona Dybeli²

¹ Imaging technician GVM Hospital Tirana, lecturer Medical University of Tirana

² Lecturer University of Elbasan "Aleksander Xhuvani"

ABSTRACT

Introduction: Vascular diseases can be mainly evaluated through ultrasound, angio-CT or MRA, with and without the use of contrast media agent. Evaluation of measurements of aorta is important in vascular disease.

Purpose: The aim of this study is to compare the image quality, differences in measurements and findings between ECG triggering CTA and simple one. To show changes on international protocols and the protocol used in our radiology department.

Methods and materials: Data from a period of time between 2019-2023. In total there are 104 patients who underwent aortic CTA ECG triggered on our diagnostic center and for comparison there are collected CT data from another diagnostic center where there isn't the possibility for ECG Triggering. All ECG triggering CTA examinations were performed with 128 detector row CT Scanner (Siemens Somatom Go Top) and non-ECG Triggering CTA is performed with 16 detector row CT Scanner (Siemens Somatom Go Now).

Results: Evaluation of aorta is better on ECG Triggering CTA. With this method we can evaluate aortic valve, we measure precisely aortic anulus, sinus of Valsalva and all the other part of thoracic aorta. This is an exceptional method for the detection of small aortic dissection.

Conclusion: ECG Triggering technique is the best technique for evaluation of the aorta and the diseases affecting it. The choice among methods depends mainly from the used CT machine and experience of imaging technician.

Keywords: CTA, ECG triggering, aortic CTA

MBROJTJA NGA RREZATIMI JONIZUES

Elona Hasalla¹, Ilda Taka¹, Behije Marra¹, Raimonda Hida¹, Shqipe Luta¹, Albana Sula

¹Lektore Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

ABSTRAKT

Hyrje: Ekspozimi ndaj rrezatimitjonizues përbën një shqetësim madhor si për pacientët ashtu edhe për stafin mjekësor të angazhuar në punën me rrezatim jonizues, sidomos ata të cilët punojmë në kabinetet e fluoroskopisë, ku doza e rrezatimit është më e lartë. Rrezatimi nga modalitetet e imazherisë diagnostike si CT, mamografia dhe mjekësia nukleare kontribuojnë pak në ekspozimin kumulativ të dozës së personelit mjekësor. Megjithatë, çdo ekspozim ndaj rrezatimit paraqet një rrezik potencial si për pacientët ashtu edhe për personelin angazhuar në këto departamente. Mbrojtja nga rrezatimi jonizues ka si qëllim të reduktojë ekspozimin e panevojshëm ndaj burimeve të rrezatimit jonizues, duke reduktuar në këtë mënyrë efektet e padëshiruara të tij mbi organizëm.

Studime të shumta kanë treguar se ekspozimi ndaj rrezatimit mjekësor rrit rrezikun e suprimimit të palcës kockore, kataraktës, infertilitetit, defekteve të lindjes dhe disa llojeve të kancerit, veçanërisht karcinomës së gjëndrës tiroide.

Një parim i përgjithshëm i mbrojtjes nga rrezatimi, i cili është propozuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Radiombrojtjen (ICRP), referon se mbrojtja nga rrezatimi bazohet në tre parime: justifikimi, optimizimi (ALARA) dhe kufizimi i dozës.

Fjalë kyçe: *diagnozë, personel mjekësor, rrezatim jonizues, mbrojtje*

RADIATION PROTECTION

Elona Hasalla¹, Ilda Taka¹, Behije Marra¹, Raimonda Hida¹, Shqipe Luta¹, Albana Sula

¹Lecturer University "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

ABSTRACT

Introduction: Exposure to ionizing radiation is a major concern for both patients and medical staff working with ionizing radiation, especially those who work in fluoroscopy departments, where the radiation dose is higher. Radiation from diagnostic imaging modalities such as CT, mammography, and nuclear medicine contribute fewer to the cumulative dose exposure of medical staff. However, any exposure to radiation poses a potential risk to both patients and staff working in these departments. Protection from ionizing radiation aims to reduce unnecessary exposure to sources of ionizing radiation, thereby reducing its unwanted effects on the body.

Numerous studies have shown that exposure to medical radiation increases the risk of bone marrow suppression, cataracts, infertility, birth defects, and certain types of cancer, especially thyroid carcinoma.

A general principle of radiation protection, which has been proposed by the International Commission on Radiological Protection (ICRP), refers that radiation protection is based on three principles: justification, optimization (ALARA) and dose limitation.

Keywords: *diagnosis, medical personnel, ionizing radiation, protection*

SIGURIA E KONTRASTEVE JODIKE DHE ME BAZË GADOLINIUM NË SHTATZËNI DHE GJIDHËNIE

Gerta Halilaj¹, Nebi Cemeta², Adela Ndou³

¹ *Teknike Imazherie - SU "Sh. N", Pedagoge UMT, FSHMT; UAL, FSHMT*

² *Teknik Imazherie - SU "Sh. N", Klinika Orthodhokse "Ugjillizimi"*

³ *Teknike Imazherie - QSUNT*

ABSTRAKT

Hyrje: Për të optimizuar të dhënat diagnostike të përfuara nga modalitete të imazherisë mjekësore lind nevoja e administrimit të lëndëve të kontrastit. Megjithë sigurinë dhe aplikimin e gjerë vlen të përmendet që përdorimi i tyre nuk është plotësisht pa rrezik. Një nga shqetësimet më të shpeshta në departamentet e imazherisë është përdorimi i agjentëve të kontrastit në shtatzëni dhe gjidhënie.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të sintetizojë të dhënat e punimeve shkencore me fokus përdorimin e sigurt të lëndëve të kontrastit në paciente femra shtatzëna dhe gjidhënie për të evituar shmangien e panevojshme të modaliteteve diagnostikuese ose ndërprerjen e panevojshme të ushqyerjes me gji.

Materiale dhe metoda: Ky punim është realizuar përmes sintezës së rreth 20 artikujve shkencorë, të marra në databazat online Medline, Pubmed, Google Scholar si dhe manualeve dhe udhëzuesve të përdorimit të lëndëve të kontrastit të Kolegjit Amerikan të Radiologjisë, Kolegjit Amerikan të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë, Shoqatës Europiane të Radiologjisë Urogenitale etj.

Rezultate: Të dhënat e këtyre studimeve treguan që administrimi iv i lëndëve të kontrastit me bazë jodi në paciente femra shtatzëna, në moshë gestacionale mesatare 25 javë, nuk ka gjasa të ketë efekt klinikisht të rëndësishëm në funksionin e tiroides në fëmijën e sapolindur. Gjithashtu u vu re që lëndët e kontrastit me bazë jodi dhe gadolinium të administruara iv ekskretohen në qumështin e gjirit, brenda 24 orëve të para, respektivisht në sasi më pak se 1% dhe më pak se 0.04 %, ndërsa trakti gastrointencinal i fëmijës përthith më pak se 1% të kësaj sasive. Pra, doza e absorbuar nga i posalinduri është më pak se 0.01% e dozës që i është administruar nënës për kontrastet jodike dhe më pak se 0.0004% për kontrastet me bazë gadolinium.

Konkluzione: Bazuar në sasinë e vogël të kontrastit të ekskretuar në qumështin e gjirit dhe të absorbuar në ansat intencinale të bebit, rekomandimi për ndërprerje të ushqyerjes me gji për 24 orë mbas ekzaminimit duhet të rishikohet.

Fjalë kyçe: *gadolinium, gjidhënie, kontrast jodik, shtatzëni.*

THE SAFETY OF IODINATED AND GADOLINIUM CONTRAST MEDIA ON PREGNANCY AND LACTATION

Gerta Halilaj¹, Nebi Cemeta², Adela Ndou³

Imaging Technician, Sh. Ndroqi UHC; Lecturer at University of Medicine, Aldent University, Tirana,

Imaging Technician, Sh. Ndroqi UHC and U.O. Clinic, Tirana, Albania

Imaging Technician, UHC "Mother Teresa", Tirana, Albania

ABSTRACT

Introduction: To optimize the data obtained from medical imaging modalities is needed the usage of contrast agents whose value has long been known, as indicated by their everyday use in imaging departments worldwide. Like other pharmaceuticals, these agents are not entirely harmless highlighting the need for updated information in the imaging department for every patient concerned about safety, side effects, and potential interactions. A common concern in the radiology department is the usage of iodinated or gadolinium-based contrast agents in pregnant or lactating women.

Purpose: This study aims to synthesize in a summary the data of scientific papers focusing on the safe use of contrast media in pregnant and lactating females to prevent the unnecessary avoidance of useful diagnostic tests or the unnecessary stopping of breastfeeding.

Materials and methods: This study was carried out through the synthesis of twenty relevant scientific articles, obtained from online databases Medline, Pubmed, and Google Scholar, as well as manuals and guidelines for the use of contrast media of the American College of Radiology, the American College of Obstetrics and Gynecology, European Association of Urogenital Radiology, etc.

Results: Data from these studies indicated that IV administration of iodinated contrast media in pregnant females, at a mean gestational age of 25 weeks, is unlikely to have a clinically significant effect on the function of the thyroid at birth. It was also observed that iodinated and gadolinium-based contrast agents administered iv are excreted in breast milk, within the first 24 hours, in amounts of less than 1% and less than 0.04%, respectively, while the child's gut absorbs less than 1% of this amount. Thus, the dose absorbed by the neonate is less than 0.01% of the dose administered to the mother for iodinated contrasts and less than 0.0004% for gadolinium-based contrasts.

Conclusion: Because of the tiny amount of contrast medium that is excreted in breast milk and absorbed in the baby's gut, the recommendation to stop breastfeeding for 24 hours after the examination should be reconsidered.

Keywords: *iodinated contrast, gadolinium, lactation, pregnancy*

AVANTAZHET E SOFTUERE-VE TË SIMULIMIT TË MRI NË ARSIM DHE KËRKIM SHKENCOR PËR TEKNIKËT E IMAZHERISË; NJË ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE

Fluturim Nela ¹, Sulejman Haxhi ¹, Florian Qordja ¹

¹ Asistent lektor, Universiteti European i Tiranës

ABSTARKT

Hyrje: Softueret e simulimit të Rezonancës Magnetike (MRI) janë shfaqur si një mjet i gjithanshëm me implikime të thella për edukimin dhe kërkimin shkencor në fushën e imazheve mjekësore. Të ndërtuara me anë të programeve dhe imazheve reale DICOM që gjenerohen nga Cloud.

Qëllimi: Ky punim vë në pah përfitimet e shumëanshme të përdorimit të softuereve simuluese MRI në të dy kontekstet arsimore (pra të formimit dhe edukimit të teknikëve të imazherisë), të tilla si trajnimi mjekësor dhe kërkimi shkencor.

Metodologjia: Studimi është kryer me anë të një analize gjithëpërfshirëse të përfitimeve të softuerit simulues MRI në arsim dhe kërkimin shkencor. U bë një rishikim sistematik i literaturës për të mbledhur artikuj përkatës, punime kërkimore dhe studime që eksploruan aplikimet dhe avantazhet e softuereve simuluese në MRI. Burimet e përzgjedhura u vlerësuan në mënyrë kritike për rëndësinë dhe besueshmërinë e tyre, në mënyrë që të jepet një perspektivë e plotë mbi këtë temë. Literatura u përzgjedh në faqet PubMed dhe Medline.

Rezultatet: Analiza zbuloi disa gjetje kryesore në lidhje me përfitimet e softuerit simulues MRI në arsim dhe kërkim shkencor. Në kontekstin arsimor, u zbulua se softueri përmirëson ndjeshëm përvojat e të mësuarit duke i lejuar përdoruesit të manipulojnë parametrat e imazhit dhe të vizualizojnë efektet e tyre në cilësinë e imazhit.

Në fushën e kërkimit shkencor, softueri i simulimit të MRI luajti një rol kryesor në përshpejtimin e inovacionit. Studiuesit mund të dizajnojnë dhe testojnë sekuenca të reja imazherike, të vlerësojnë përmirësimet e harduerit dhe të përsosin algoritmet e rindërtimit brenda një mjedisi virtual. Kjo lehtësoi eksperimentimin më të shpejtë, uli kostot e lidhura me provat fizike dhe përshpejtoi zhvillimin e teknikave të avancuara të MRI.

Konkluzione: Analiza gjithëpërfshirëse nënvizoi ndikimin transformues të softuerit simulues MRI në arsim dhe kërkim shkencor. Aftësia e softuerit për të krijuar mjedise mësimore dinamike rriti të kuptuarit e studentëve për konceptet komplekse të MRI. Për më tepër, roli i tyre në kërkime ishte i dobishëm në nxitjen e përparimeve, duke çuar në përmirësimin e cilësisë së imazhit, uljen e kohës së skanimit dhe zgjerimin e aftësive diagnostikuese. Studimi arriti në përfundimin se softueri i simulimit MRI është gati të luajë një rol edhe më thelbësor në formësimin e së ardhmes së teknologjisë, edukimit dhe praktikës klinike të MRI. Këto lloj softuerësh do të kenë një impakt direkt tek studentët e teknikës së imazherisë duke i ndihmuar ato të përmirësojnë praktikën klinike dhe ti bëjë ata më të aftë për tregun e punës duke reduktuar kohët për trajnime dhe njohje të aplikacioneve të aparturave MRI me të cilat ato do të punojnë më pas.

Fjalë kyçe: aplikimet klinike, dizajni i sekuencave pulsuese, edukimi arsimor, imazhe MRI, kërkim shkencor.

ADVANTAGES OF MRI SIMULATION SOFTWARE IN EDUCATION AND RESEARCH FOR IMAGING TECHNICIANS; A COMPREHENSIVE ANALYSIS

Fluturim Nela ¹, Sulejman Haxhi ¹, Florian Qordja ¹

¹ As/lecturer, European University of Tirana

ABSTARCT

Introduction: Magnetic Resonance (MRI) simulation software has emerged as a versatile tool with profound implications for education and research in the field of medical imaging. Built using software and real DICOM images that are generated from the Cloud.

Purpose: This paper highlights the multifaceted benefits of using MRI simulation software in both educational contexts (i.e. imaging technician training and education), such as medical training and scientific research.

Methodology: The study conducted a comprehensive analysis of the benefits of MRI simulation software in education and research. A systematic literature review was performed to gather relevant articles, research papers, and studies that explored the applications and advantages of MRI simulation software. The selected sources were critically evaluated for their relevance and credibility in order to provide a well-rounded perspective on the topic. The literature was selected on the pages PubMed and Medline.

Results: The analysis revealed several key findings regarding the benefits of MRI simulation software in education and research. In the educational context, the software was found to significantly enhance learning experiences by allowing users to manipulate imaging parameters and visualize their effects on image quality.

In the research context, MRI simulation software played an important role in accelerating innovation. Researchers could design and test new imaging sequences, evaluate hardware enhancements, and refine reconstruction algorithms within a virtual environment. This facilitated quicker experimentation, reduced costs associated with physical trials, and expedited the development of advanced MRI techniques.

Conclusions: The comprehensive analysis underscored the transformative impact of MRI simulation software on education and research. The software's ability to create dynamic learning environments enhanced students' understanding of complex MRI concepts. Moreover, its role in research was instrumental in driving advancements, leading to improved image quality, reduced scan times, and expanded diagnostic capabilities. The study concluded that MRI simulation software is poised to play an even more substantial role in shaping the future of MRI technology, education, and clinical practice. These types of software will have a direct impact on imaging technology students by helping them improve their clinical practice and make them more skilled for the job market by reducing the time for training and familiarization with the applications of the MRI machines they will use to work afterward.

Keywords: *magnetic Resonance Imaging, imaging parameters, pulse sequence design, educational tool, research tool*

IMAZHERIA MJEKËSORE E DREJTUAR NGA AI

Gerta Halilaj¹, Emeli Met'hojha², Klodian Celmeta², Oliana Muca²

¹Lektore, Universiteti Aldent, Tiranë

²Teknikë imazherie

ABSTRAKT

Hyrje: Tashmë është e qartë se AI e përdorur në imazhet mjekësore është një revolucion në fushën e kujdesit shëndetësor duke ndihmuar mjekët të ofrojnë mundësi më të sakta, efikase dhe të personalizuar diagnostikimi dhe trajtimi për pacientët e tyre. Shumë portale ndërkombëtare online të radiologjisë dhe të inteligjencës artificiale në tërësi (p.sh.: onixnet, radiopaedia, pubmed, etj.) mundësojnë artikuj të tërë të kontributit të AI në përmirësime të rëndësishme në saktësinë e diagnozës, efikasitetin e trajtimit dhe cilësinë e kujdesit të përgjithshëm ndaj pacientit.

Objektivat: Paraqitja e një rishikimi dhe sintetizimi të informacioneve të marra nga artikuj dhe literatura që flasin për ndikimin e AI në fushën e imazherisë mjekësore dhe rrezikut potencial në zëvendësimin e profesionistëve.

Metodologjia: Me anë të navigimit online në portale mjekësore radiologjike, si dhe në portale të specializuara me informacione mbi revolucionin e AI, krijuam një ide më të qartë se me ndihmën e algoritmeve deep-learning, teknologjia e imazhit mjekësor tani u mundëson mjekëve të identifikojnë anomalitë dhe të zbulojnë sëmundjet me një nivel më të lartë saktësie dhe shpejtësie se kurrë më parë.

Rezultate: Në këtë përmbledhje, çështjet kryesore dhe temat e diskutimit përfshijnë avantazhet e bujshme të AI në fushën e imazherisë mjekësore duke vlerësuar vazhdimisht se qëllimi i AI në vetvete nuk është të zëvendësojë teknikët e imazherisë, por t'i ndihmojë ata të përmirësojnë procesin e diagnostikimit.

Konkluzionet: Të gjitha këto burime të gjetura, flasin për një gjë të përbashkët; adaptimin në rritje të Inteligjencës Artificiale (AI) në industrinë e kujdesit shëndetësor për përmirësimin e kujdesit ndaj pacientit, diagnostikimit dhe analizës së të dhënave mjekësore të pacientit. Në një konkluzion të përgjithshëm, ne mund të themi se përdorimi i teknologjisë AI po bëhet gjithnjë e më i zakonshëm në fushën e imazheve mjekësore dhe kjo vjen në funksion të profesionistëve, dhe jo si zëvendësues i tyre.

Fjalët kyçe: imazhe mjekësore, inteligjencë artificiale, diagnozë, kujdes shëndetësor

AI-POWERED MEDICAL IMAGING

Gerta Halilaj ¹, Emeli Met'hoxha ², Klodian Celmeta ², Oliana Muca ²

¹ Lecturer, Aldent University Tirana

² Students, Aldent University Tirana

ABSTRACT

Introduction: It is clear now that AI used in medical imaging is revolutionizing the field of health care by helping doctors provide more accurate, efficient and personalized diagnostic and treatment options for their patients. Many international online portals of radiology and artificial intelligence in general (eg: onixnet, radiopedia, pubmed, etc.) provide full articles on the contribution of AI to significant improvements in the accuracy of diagnosis, efficiency of treatment and quality of general patient care.

Objectives: To present a review and synthesis of information obtained from articles and literature about the impact of AI in the field of medical imaging and the potential risk of replacing professionals.

Methodology: By online navigation in radiological medical portals, as well as in portals specialized in information on the AI revolution, we created a clearer idea that with the help of deep-learning algorithms, medical imaging technology now enables doctors identify abnormalities and detect disease with a higher level of accuracy and speed than ever before.

Results: In this review, the main issues and discussion topics include the exciting advantages of AI in the field of medical imaging while constantly appreciating that the purpose of AI in itself is not to replace imaging technicians, but to help them improve the diagnostic process.

Conclusions: All the founded sources contain one common thing: the growing adoption of Artificial Intelligence (AI) in the healthcare industry to improve patient care, diagnosis and analysis of patient medical data. In a general conclusion, we can say that the use of AI technology is becoming more and more common in the field of medical imaging and this comes as a helping function to professionals, and not as a substitute for them.

Keywords: *medical imaging, artificial intelligence, diagnosis, healthcare*

ROLI I CT NË TUMORET PRIMARE TË TRURIT

Flogert Rraku¹

¹ Spitali Rajonal Sarandë

ABSTRAKT

Hyrje: Tumore primare të trurit konsiderohen të gjitha ato masa tumorale me origjinë nga indet normale të trurit apo nga mbulesat e tij (meningjet) të cilat klasifikohen në malinje dhe beninje. Të gjitha tumoret me origjinë diku tjetër në organizëm dhe të metastazuara në indin trunor do të konsiderohen tumore sekondare, pra me origjinë jo nga truri.

Objektivat: Identifikimi i avantazheve të CT për evidentimin e tumoreve kraniale, krahasuar me teknikat e tjera imazherike.

Metoda: Është realizuar një rishikim i kujdesshëm i literaturës në Pubmed, Elsevier Journal, Radiopaedia etj. duke përdorur si fjalë kyçe: imazheri, diagnostikë, tumore të trurit, CT duke marrë në konsideratë vetëm artikujt të cilët i përshtaten qëllimit të studimit tonë.

Rezultatet: Zbulimi i tumoreve të trurit ka një rol thelbësor në fushën e aplikimit biomjekësor në drejtim të diagnostikimit të të dhënave të imazhit mjekësor. Rëndësia e identifikimit të tumoreve të trurit është rritur në vitet e fundit.

Klasifikimi i tumoreve të trurit u zhvillua për të ndihmuar stafin mjekësor të diagnostikojë sëmundjen. Në klasifikim, ka disa procese që duhet të kryhen, p.sh., procesimi, nxjerrja e veçorive dhe klasifikimi.

Tomografia e kompjuterizuar (CT) mund të jetë modaliteti i parë i përdorur në një pacient që paraqet një tumor të trurit, por në pjesën më të madhe MRI është modaliteti parësor i diagnozës në pacientët me këto tipe të tumoreve, duke mbetur si “gold standart” në ditët tona.

Fjalë kyçe: CT, diagnozë, kancer truri, protokoll imazherik.

THE ROLE OF CT IN PRIMARY BRAIN TUMORS

Flogert Rraku¹

¹ Saranda Regional Hospital

ABSTRACT

Introduction: Primary brain tumors are considered all those tumor masses originating from normal brain tissues or from its covers (meninges) which are classified as malignant and benign. All tumors originating elsewhere in the body and metastasized to brain tissue will be considered secondary tumors, i.e. not originating from the brain.

Objectives: To identify the advantages of CT for the detection of cranial tumors, compared to other imaging techniques.

Methodology: A careful literature review was carried out in Pubmed, Elsevier Journal, Radiopaedia, etc. using as keywords: imaging, diagnostics, brain tumors, CT considering only articles that fit the purpose of our study.

Results: The detection of brain tumors has an essential role in the field of biomedical application in terms of diagnosis of medical image data. The importance of identifying brain tumors has increased in recent years. The classification of brain tumors was developed to help medical staff diagnose the disease. In classification, there are several processes that need to be performed, such as processing, feature extraction, and classification.

Computed tomography (CT) may be the first modality used in a patient presenting with a brain tumor, but for the major part MRI is the primary diagnostic modality in patients with these types of tumors, remaining the gold standard nowadays.

Keywords: *CT, brain cancer, diagnosis, imaging protocol.*

ROLI I CT PERFUZION NË GODITJET NË TRU (STROKE)*Antonio Bakaj¹**¹ Teknik Imazherie, Spitali Amerikan 3***ABSTRAKT**

Hyrje: Një goditje në tru është një ndërprerje e furnizimit me gjak në ndonjë pjesë të trurit, kjo njihet gjithashtu dhe si stroke. Nëse rrjedhja e gjakut ndalet për më shumë se disa sekonda dhe truri nuk mund të furnizohet me gjak dhe oksigjen, qelizat e trurit mund të vdesin dhe aftësitë e kontrolluara nga ajo zonë e trurit humbasin. Ka dy lloje goditjesh në tru: goditja iskemike dhe goditja hemorragjike. Një goditje ishemike shkaktohet nga një mpiksje gjaku që bllokton një arterie dhe ndërpret rrjedhjen e gjakut në tru. Një goditje hemorragjike shkaktohet nga çarja ose "shpërthimi" i një ene gjaku në tru. Goditja iskemike është deri tani lloji më i zakonshëm i goditjes në tru.

Qellimi: Roli i CT perfuzion si një metode e re diagnostikimi në ndjekjen dhe trajtimin e goditjeve në tru. Trajtimi modern endovaskular në goditjet iskemike të trurit bazohet në modalitetet e avancuara imazherike për vlerësimin dhe identifikimin e zonave të dëmtuara të trurit. Ndryshe nga imazhet tomografike kompjuterike (CT) pa kontrast ose imazhet tradicionale të rezonancës magnetike, imazhi i perfuzionit CT (CTP) ofron një pamje aktive të fiziologjisë cerebrovaskulare me parametra të shumtë të përfshirë.

Metodologjia: Ekzaminimi u realizua me CT Siemens Definition 128 slices me protokoll të dedikuar për CT perfuzion. Pacienti 73 vjeç, mashkull paraqitet me humbje kohësi, pa aftësi komunikimi, pa aftësi të lëvizjes së gjymtyrëve. Për të kryer ekzaminimin përdoret protokoll i CT perfuzion me 50 ml kontrast iv omnipol, 50 ml NaCl. Koha e skanimit 40 sekonda dhe numri i imazheve të përfutuara 195.

Perfundimi: Nëse të gjitha kushtet e kryerjes së CT perfuzionit janë optimale, atëherë rezultatet e këtij ekzaminimi mund të ndikojnë në ndjekjen dhe trajtimin e pacientëve nga neuroradiologët intervencionues për pacientët me goditje akute në tru.

Fjalë kyçe: *CT perfuzion, goditje iskemike, goditje në tru*

CT PERFUSION ROLE IN BRAIN STROKE

Antonio Bakaj¹

¹ *Imaging technician, American Hospital 3 Tirana*

ABSTRACT

Introduction: A stroke is a disruption of the blood supply to any part of the brain; this is also known as a stroke. If the blood flow stops for more than a few seconds and the brain cannot be supplied with blood and oxygen, brain cells can die and the abilities controlled by that area of the brain are lost. There are two types of strokes: ischemic stroke and hemorrhagic stroke. An ischemic stroke is caused by a blood clot that blocks an artery and cuts off blood flow to the brain. A hemorrhagic stroke is caused by the rupture or "burst" of a blood vessel in the brain. Ischemic stroke is by far the most common type of stroke.

Purpose: The role of CT perfusion as a new diagnostic method in the follow-up and treatment of strokes. Modern endovascular treatment in ischemic strokes of the brain is based on advanced imaging modalities for the evaluation and identification of damaged areas of the brain. Unlike non-contrast computed tomographic (CT) imaging or traditional magnetic resonance imaging, CT perfusion imaging (CTP) provides an active view of cerebrovascular physiology with multiple parameters involved.

Methodology: The examination was performed with CT Siemens Definition 128 slices with a dedicated protocol for perfusion CT. The 73-year-old male patient presents with loss of consciousness, inability to communicate, inability to move the limbs. To perform the examination, the CT perfusion protocol with 50 ml iv omnipol contrast media, 50 ml NaCl is used. Scan time 40 seconds and number of images acquired 195.

Conclusion: If all the conditions for performing perfusion CT are optimal, then the results of this examination can influence the follow-up and treatment of patients by interventional neuroradiologists for patients with acute stroke.

Keywords: *CT perfusion, ischemic stroke, stroke*

MENAXHIMI I ARTIFAKTEVE NGA IMPLANTET METALIKE NË RM

Erjon Karaj¹

¹ *Teknik Imazherie, Spitali Amerikan Tirana*

ABSTRAKT

Hyrje: Ky studim ka si qëllim që të evidentojë sfidat me të cilat përballen teknikët e imazherisë nga artifaktet metalike në rezonancën magnetike. Prezenca e implanteve metalike mund të shkaktojë një numër të konsiderueshëm artifaktesh si: humbje sinjali, pamundësi për të kryersequencën e Fat-Sat, çrregullime gjometrike apo mbivendosje sinjali. Teknikët e imazherisë luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe minimizimin e këtyre artifakteve në mënyre që të realizohet një diagnostikim i saktë i pacientit.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që të evidentojë rëndësinë e menaxhimit të artifakteve metalike në RM. Do të trajtohen sfidat me të cilat përballen teknikët e imazherisë kur hasen me implante metalike dhe të identifikohen mënyrat për të bërë minimizimin e tyre.

Metodat: Është bërë një rishikim në literaturën aktuale për artifaktet metalike në rezonancën magnetike për të evidentuar mënyrat e ndryshme që përdoren për të minimizuar këto artifakte.

Rezultatet: Tekniket e imazherisë luajnë një rol thelbësor në menaxhimin e artifakteve metalike në RM. Duke përdorur dijet dhe aftësitë e tyre ata mund të identifikojnë edhe minimizojnë këto artifakte duke mundësuar trajtim dhe diagnozë të saktë.

Përfundimet: Studimi ka si qëllim implementimin e dijeve dhe aftësive praktike të teknikëve të imazherisë në mënyrë që të realizojnë imazhe me cilësi të lartë dhe me sa më pak artifakte, për të rritur cilësinë diagnostike të imazheve të përfutuara.

Fjalë kyçe: *artifakt, implant metalik, RM, teknik imazherie*

DEALING WITH ARTIFACTS FROM METALLIC IMPLANTS IN MRI

Erjon Karaj¹

¹ Radiographer, American Hospital Tirana

ABSTRACT

Introduction: This study aims to highlight the challenges faced by imaging technicians from metallic artifacts in magnetic resonance imaging. The presence of metallic implants can cause a significant number of artifacts such as: signal loss, inability to perform the Fat-Sat sequence, geometrical disturbances or signal overlap. Imaging technicians play an important role in identifying and minimizing these artifacts in order to achieve an accurate patient diagnosis.

Purpose: The purpose of this study is to highlight the importance of the management of metal artifacts in MRI technique. The challenges that imaging technicians face when dealing with metal implants will be addressed and will be identified the ways to minimize them.

Methods: A review of the current literature on metallic artifacts in magnetic resonance imaging was performed to highlight the various methods used to minimize these artifacts.

Results: Imaging technicians play an essential role in the management of metal artifacts in RM. Using their knowledge and skills they can identify and minimize these artifacts enabling accurate treatment and diagnosis.

Conclusions: The aim of the study is to implement the knowledge and practical skills of imaging technicians in order to realize high-quality images with as few artifacts as possible, to increase the diagnostic quality of the obtained images.

Keywords: *artifact, metallic implant, imaging technicians, MRI.*

ROLI DIAGNOSTIKUES I TOMOGRAFISË SË KOMPJUTERIZUAR NË TRAUMAT KRANIALE NË MOSHAT PEDIATRIKE

Marsela Ferhati¹, Theodhor Xhillari², Ilir Lumi¹

¹ *Teknike Imazherie, Spitali Universitar i Traumes Tiranë*

² *Krye/Teknik Imazherie, Spitali Universitar i Traumes Tiranë*

ABSTRAKT

Hyrje: Trauma kraniale i referohet një dëmtimi në kokë që është çdo lloj dëmtimi në tru, kafkë ose në skalpin e kokës. Kjo mund të variojë nga një përplasje e lehtë ose plagë, deri te një lëndim traumatik të trurit.

Metodologjia: Ky studim ka karakter deskriptiv (përshkruar), me qasje drejtimore retrospektive. Ai synon të hedhë dritë mbi sensitivitetin, specificitetin dhe saktësinë e CT krahasuar me teknikat e tjera imazherike diagnostikuese për rastet e pacientëve pediatrik që kanë realizuar shërbim imazherik pranë Spitalit Universitar të Traumave, Tiranë. Gjatë këtij studim janë grumbulluar të dhënat nga rastet e paraqitura gjatë periudhës Tetor 2021- Prill 2022.

Rezultatet: Kryerja e një ekzaminimi me anë të skanimit me CT ndihmon për diagnostikimin dhe më pas ndjekjen e sëmundjeve të ndryshme, gjithashtu përfton imazhe më cilësore dhe me rezolucion më të lartë se ekzaminimet me rreze x të përdorura deri me sot (radiografia e thjeshtë).

Konkluzion: Tomografia e kompjuterizuar është një teknikë gold standart në ekzaminimin e traumave kraniale, jo vetëm për cilësinë e imazheve që ofron, por dhe për kohën e shkurtër të marrjes së informacionit.

Fjalë kyçe: traumë, frakturë, kontuzion, Tomografi e Kompjuterizuar (CT), rrezatimi jonizu

THE DIAGNOSTIC ROLE OF COMPUTED TOMOGRAPHY IN PEDIATRIC HEAD TRAUMA

Marsela Ferhati¹, Theodhor Xhillari², Ilir Lumi¹

¹ Imaging technicians, University Trauma Hospital Tirana

² Chief/Imaging Technician, University Trauma Tirana

ABSTRACT

Introduction: Cranial trauma refers to a head injury that is any type of injury to the brain, skull or scalp. This can range from a minor bump or bruise to a traumatic brain injury.

Methodology: This study has a descriptive character, with a retrospective approach. It aims to shed light on the sensitivity, specificity and accuracy of CT scan compared to other diagnostic imaging techniques for cases of pediatric patients who underwent imaging services at the University Trauma Hospital, Tirana. During this study, the data from the cases presented during the period October 2021-April 2022 were collected.

Results: Performing an examination with a CT scan helps in the diagnosis and then the follow-up of various diseases, also obtains better quality and higher resolution images than the x-ray examinations used to date (plain radiography).

Conclusion: Computed tomography is a gold standard technique in the examination of cranial trauma, not only for the quality of the images it provides, but also for the short time of obtaining information.

Keywords: *trauma, fracture, contusion, Computed Tomography (CT), ionizing radiation*

ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE SADISFAKSIONI QË KANË TEKNIKËT E IMAZHERISË NË SHQIPËRI PËR PROFESIONIN E TYRE

Elona Dybeli¹, Ilma Toçi¹, Armela Kapaj¹, Alket Çollaku², Albana Sula¹, Haris Mema¹, Behije Marra¹, Elona Hasalla¹, Venemin Gega¹, Entela Drizaj¹, Klara Hysenaj¹

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

²Teknik imazherie GVM Hospital Tirana, lektor Universiteti Mjekësor i Tiranës

ABSTRAKT

Hyrje: Kënaqësia në punë përbën një nga elementët bazë të cilët ndikojnë në ofrimin e një kujdesi shëndetësor cilësor. Ofrimi i kushteve të mira të punës në raport dhe me nivele të mira të pagave, ul mundësitë për burnout të këtij grupimi profesionistësh të shëndetësisë.

Objektivat: Vitet e fundit është vënë re një trend në rritje që lidhet me largimin e teknikëve të imazherisë drejt vendeve përëndimore. Qëllimi i këtij studimi është të masë shkallën e sadisfaksionit që kanë teknikët e imazherisë në Shqipëri për profesionin e tyre dhe të shohim mundësitë e përmirësimit të tyre, për të frenuar largimin masiv.

Metodologjia: Një pyetësor elektronik i realizuar nëpërmjet Google form është shpërndarë në mënyrë rastësore teknikëve të imazherisë të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Të dhëna në lidhje me sadisfaksionin profesional janë analizuar në mënyrë të detajuar në raport dhe me të dhënat demografike të pjesëmarrësve. Për një periudhë të shkurtër kohore prej 2 javësh pyetësorit i janë përgjigjur 66 teknikë imazherie.

Konkluzione: Nga të dhënat e analizuara rezulton se pjesa më e madhe e profesionistëve të përfshirë në studim janë në intervalin e moshës 21-31 vjeç, të punësuar kryesisht në diagnostikë, të cilët motivimin kryesor në punë e lidhin me kënaqësinë profesionale dhe jo me nivelin e pagës, orarin e punës apo klimën sociale. Ndërsa përse i përket mundësisë për t'u larguar jashtë vendit, pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen të pavendosur në lidhje me këtë vendimmarrje. Në përfundim të plotësimit të pyetësorit kishim rekomandime nga më të ndryshmet, të cilat ishin të lidhura kryesisht me: vlerësimin profesional; orarin e punës; ofrimin e trajnimeve të ndryshme profesionale; zbatimin e protokolleve ndërkombëtare etj.

Fjalë kyçe: *teknik imazherie, sadisfaksion, vlerësim profesional, Shqipëri*

PROFESSIONAL DEVELOPMENT AND SATISFACTION OF IMAGING TECHNICIANS PROFESSION IN ALBANIA

Elona Dybeli¹, Ilma Toçi¹, Armela Kapaj¹, Alket Çollaku², Albana Sula¹, Haris Mema¹, Behije Marra¹, Elona Hasalla¹, Venemin Gega¹, Entela Drizaj¹, Klara Hysenaj¹

¹ Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

² Imaging technician GVM Hospital Tirana, lecturer, Medical University of Tirana

ABSTRACT

Introduction: Job satisfaction is one of the basic elements that influence the provision of quality health care. Providing relatively good working conditions and good salary levels reduces the chances of burnout in this group of healthcare professionals.

Objectives: In recent years, a growing trend related to the migration of imaging technicians to western countries has been noticed. The purpose of this study is to measure the degree of satisfaction that imaging technicians in Albania have for their profession and to see the possibilities of their improvement, to prevent the migration.

Methodology: An electronic survey made through Google form was randomly distributed to imaging technicians who practice their profession in the territory of the Republic of Albania. Data related to professional satisfaction were analyzed in detail in relation to the demographic data of the participants. For a short period of time of 2 weeks, 66 imaging technicians answered the survey.

Conclusions: From the analyzed data, results that the majority of healthcare professionals included in the study are in the age range of 21-31 years old, employed mainly in diagnostics, who associate the main motivation at work with professional satisfaction and not with the level salary, working hours or social climate. As for the possibility of leaving the country, most of the included persons are undecided about this decision-making. At the end of completing the survey, we had various recommendations, which were mainly related to: professional evaluation; working hours; providing various professional trainings; implementation of international protocols, etc.

Keywords: *imaging technician, satisfaction, professional assessment, Albania.*

SA KOLIMOJNË TEKNIKËT RADIOLOGË... NJË ANALIZË RETROSPEKTIVE TË KOLIMIT TË RADIOGRAFIVE PULMONARE TE PACIENTËT PEDIATRIKË DHE NEONATË

Sulejman Haxhi¹, Erla Mullalli², Fluturim Nela³, Florian Qordja³

¹ *Asistent lektor në Imazheri UET; Teknik Radiolog Spitali Amerikan.*

² *Asistent lektor në Imazheri FSHMT; Teknik Radiolog Spitali Universitar Shefqet Ndroqi.*

³ *Asistent lektor në Imazheri UET; Teknik Radiolog Spitali Hygea.*

ABSTRAKT

Hyrje: Kolimimi i tufës së rrezes parësore është një faktor i rëndësishëm në radiografi për të reduktuar dozën e rrezatimit dhe për të përmirësuar cilësinë e imazhit. Ashtu si me fotografitë dixhitale, imazhet dixhitale me rreze X mund të "priten", duke maskuar natyrshëm zonën kryesore të ekspozimit të rrezeve X. Kjo është e rëndësishme sepse rrezatimi jonizues duhet të mbahet në minimum për pacientët.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësoj se sa teknikët radiolog kolimojnë si dhe për të hetuar cilësinë e kolimacionit të fushës me rreze X në radiografitë pulmonare në moshat pediatrike dhe neonatale.

Metodologjia: U realizua një analizë retrospektive të radiografive pulmonare në 51 pacientë pediatrikë (mosha 0.5-14 vjeç) dhe 26 neonatë, gjatë një periudhe katër mujore (prill-korrik 2023) në tre spitale private dhe një klinikë private pediatrike. Të gjithë radiografitë neonatale janë realizuar me anë të radiografisë portabël me CR, ndërsapjesa tjetër në kabinet me DR. Prerja elektronike u hoq nga projektionet dhe u vlerësua madhësia e kolimacionit nëse zona e ekspozuar ishte më e madhe se një standard reference (superior-inferior kufijtë e fushës duhet të zgjerohen nga procesi mastoid deri në kreshtën iliake/lateralisht në artikualicionet akromioklavikulare).

Rezultate: Nga 51 radiografi të pacientëve pediatrikëqë u morën në studim, 29 (57%) nga këto matje ishin më pak se ose të barabarta me standardin referencë të rënë dakord. 21 (43%) ishin më të mëdha se referenca e rënë dakord. Nga 21 radiografi të pacientëve neonat, 19 (73%) ishin më pak se ose të barabarta me standardin referencë të rënë dakord, dhe 7 (27%) ishin më të mëdha se referenca e rënë dakord.

Përfundim: Studimi tregon përqindja e matjeve të marra ishte realtivisht e lartë. Kjo rezulton në një rritje të dozës së rrezatimit për pacientët dhe ndikim në reduktimin e cilësisë së imazhit.

Fjalë kyçe: kolimacion, dozë e akumuluar, radiosensitiv

HOW RADIOGRAPHERS COLLIMATE...A RETROSPECTIVE ANALYSIS OF COLLIMATION OF PULMONARY RADIOGRAPHS IN PEDIATRIC PATIENTS AND NEONATES

Sulejman Haxhi¹, Erla Mullalli², Fluturim Nela³, Florian Qordja³

¹ Asistent lektor në Imazheri UET; Teknik Radiolog Spitali Amerikan.

² Asistent lektor në Imazheri FSHMT; Teknik Radiolog Spitali Universitar Shefqet Ndroqi.

³ Asistent lektor në Imazheri UET; Teknik Radiolog Spitali Hygea.

ABSTRACT

Introduction: Primary beam collimation is an important factor in radiography to reduce radiation dose and improve image quality. As with digital photographs, digital X-ray images can be "cropped", naturally masking the main area of X-ray exposure. This is important because ionizing radiation must be kept to a minimum for patients.

Aim: of this study is to evaluate how radiology technicians collimate and to investigate the quality of X-ray field collimation in pulmonary radiographs in pediatric and neonatal ages.

Methodology: A retrospective analysis of pulmonary radiographs was performed in 51 pediatric patients (age 0.5-14 years) and 26 neonates, during a four-month period (April-July 2023) in three private hospitals and a private pediatric clinic. All neonatal radiographs were performed by means of portable radiography with CR, while the rest in the cabinet with DR. Electronic cropping was removed from the projections and collimation size was assessed if the exposed area was larger than a reference standard (superior-inferior field limits should extend from the mastoid process to the iliac crest/laterally to the acromioclavicular articulations).

Results: Of the 51 radiographs of pediatric patients that were included in the study, 29 (57%) of these measurements were less than or equal to the agreed reference standard. 21 (43%) were greater than the agreed reference. Of 21 neonate patient radiographs, 19 (73%) were less than or equal to the agreed reference standard, and 7 (27%) were greater than the agreed reference.

Conclusion: The study shows the percentage of measurements obtained was relatively high. This results in an increase in radiation dose to patients and impact on reducing image quality.

Keywords: collimation, accumulated dose, radiosensitive.

PET-CT NË DEMENCË

Besjan Kulemani¹

¹ *Teknik Imazherie, Spitali Amerikan 3*

ABSTRAKT

Hyrja: Demenca nuk është një sëmundje specifike por një grup simptomash që zakonisht prek moshat e treta. Sipas studimeve të realizuar janë evidentuar dhe moshat e reja që kanë probleme me demencën, simptomat e të cilës zakonisht janë : humbje e kujtesës, rënie e aftësisë së të menduarit dhe arsyetuarit, probleme me komunikimin etj. Duhet patur parasysh se disa shkaqe të demencës janë të trajtueshme dhe të rikthyeshme, ndërsa ato progresive janë me dekurs të pandalshëm deri në vdekje.

Qëllimi: PET-CT tani është një vlerë e shtuar për përdorim klinik në çrregullimet neurodegenerative, veçanërisht në diagnostikimin e demencës. Matjet e metabolizmit cerebral të glukozës, siç bëhen me FDG (Fluorodeoksiglukozë F-18), kanë një vlerë të rëndësishme në diagnostikimin e hershëm, diagnozën diferenciale dhe vlerësimin e trajtimit me medikamente për pacientët me demencë.

Metoda: U realizua PET Brain u realizua me Biograph TruePoint PET-CT (64 slice) Lënda e injektuar dhe doza e rrezatimit 18F-FDG dhe Low dose CT. Pacienti i gjinisë mashkull, i moshës 76 vjeç, me diagnozë klinike suspekt demencë, peshë 70 kg, gjatësia 1.70 m. U injektua në total 292.59 MBq FDG, me injektim në krahun e majtë. Para ekzaminimit glicemia ishte 76 mg/dl.

Konkluzion: Nëse të gjitha kushtet e kryerjes së PET-CT janë optimale atëherë themi që ky ekzaminim është me vlerë të lartë për diagnostikimin e demencës në fazat e hershme.

Fjalë kyçe: *F18-FDG, demenca, PET-CT.*

PET-CT IN DEMENTIA

Besjan Kulemani¹

¹Imaging technician, American Hospital 3

ABSTRACT

Introduction: Dementia is not a specific disease but a set of symptoms that usually affects the elderly people. According to the studies carried out, young people have also been identified having problems with dementia, the symptoms of which are usually: loss of memory, decline in the ability to think and reason, problems with communication, etc. It should be borne in mind that some causes of dementia are treatable and reversible, while progressive ones have an unstoppable course until death.

Purpose: PET-CT is now of added value for clinical use in neurodegenerative disorders, especially in the diagnosis of dementia. Measurements of cerebral glucose metabolism, as done with FDG (Fluorodeoxyglucose F-18), have an important value in early diagnosis, differential diagnosis and evaluation of drug treatment for patients with dementia.

Methodology: PET Brain was performed with Biograph TruePoint PET-CT (64 slices) Injected substance and radiation dose 18F-FDG and Low dose CT. The male patient, aged 76 years, with a clinical diagnosis of suspected dementia, weight 70 kg, height 1.70 m. A total of 292.59 MBq FDG was injected, with an injection in the left arm. Before the examination, blood glucose was 76 mg/dl.

Conclusion: If all the conditions for performing PET-CT are optimal, then we say that this examination is of high value for the diagnosis of dementia in the early stages.

Keywords: *dementia, F18-FDG, PET-CT*

RËNDËSIA E RADIOKIRURGJISË STEREOTAKTIKE TË FRAKSIONUAR NË SHVANOMËN VESTIBULARE

Hane PEPOSHI¹, Sabina HAFUZI¹, Valbona BALI²

¹ Studente në Programin e Studimit Imazheri dhe Radioterapi, Universiteti Aldent

² Lektore në Universitetin Aldent dhe Teknike Radioterapie QSUNT

ABSTRAKT

Hyrje: Radiokirurgjia Stereotaktike e Fraksionuar është një procedurë jokirurgjikale me rrezatim jonizues që konsiston në përdorimin e një frame-i (GTC)dhe të një blloku kafshimi (mold) duke mundësuar pozicionim dhe lokalizim sa më të saktë gjatë trajtimit të tumoreve të tilla si Shvanoma Vestibulare.

Kjo teknikë ka përparësi sepse trajton tumore të mëdha (>4 mm),me formë të çrregullt; në raport me Radiokirurgjinë stereotaktike(SRS) dhe duke përdorur doza më të mëdha krahasuar me Radioterapinë (RT).Kjo gjë ndodh duke rritur imobilizimin,ulur lëvizshmërinë e pacientit dhe duke ruajtur indet normale që ndodhen afër zonave kritike si **nervi optik**.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të theksojë rëndësinë që ka FSRS e drejtuar nga IGRT në trajtimin e tumoreve kraniale.

Metoda: Në nëntor 2022 morëm në studim një rast me Shvanomë Vestibulare (*femër,54 vjeç*).Ajo iu nënshtrua trajtimit me FSRS të drejtuar nga IGRT në *Shërbimin e Neurokirurgjisë pranë Spitalit Universitar “Nënë Tereza,Tiranë, Shqipëri*.

Trajtimi u krye me *Akselerator linear LINAC* me ndjekje të vazhdueshme si nga tekniku i radioterapisë ashtu edhe nga ekipi i mjekëve specialistë. Elementë kyç në pozicionimin adekuat të pacientit janë:Frame dhe Moldi (i cili u përgatit nga radiotekniku).

Rezultatet: Pas përfundimit të seancave të trajtimit pritej një vrasje totale e qelizave tumorale, me ruajtje maksimale të indeve kritike ngjitur me tumorin dhe një toksicitet të papërfillshëm të qelizave normale.FSRS jo vetëm që duhet ti arrijë këto në 5 seanca por duhet që qelizat e shëndosha të cilat janë dëmtuar të arrijnë të marrin veten plotësisht gjatë interвалit kohor nga seanca në seancë dhe qelizat kancerogjene të marrin nga 95-107% të dozës që të kemi sukses të plotë në trajtim.

Konkluzioni: FSRS provoi që është procedura më precize dhe e vlefshme në trajtimin e tumoreve kraniale beninje të tilla si Shvanomat Vestibulare me përmasa të mëdha duke ruajtur në maksimum nervat dhe zonat kritike apo të shëndetshme që ndodhen pranë tumorit.

Fjalë kyce: *akselerator frame, IGRT, tumorbeninj.*

THE IMPORTANCE OF FRACTIONATED STEREOTACTIC RADIOSURGERY GUIDED BY IGRT IN VESTIBULAR SCHWANNOMA

Hane PEPOSHI¹, Sabina HAFUZI¹, Valbona BALI²

¹ Student of Imaging and Radiotherapy Study Programme, Aldent University

² Lecturer at Aldent University and Radiotherapy Technician, UHC "Mother Teresa"

ABSTRACT

Background: Fractionated Stereotactic Radiosurgery is a non-surgical procedure with ionizing radiation that consists by the use of a frame (GTC) and a bite block (mold), enabling the most accurate positioning and localization during the treatment of tumors such as Vestibular Schwannoma.

This technique has advantages because it treats large tumors (>4 mm), with an irregular shape compared to Stereotactic Radiosurgery (SRS) and using larger doses compared to Standard Radiotherapy (RT). This happens by increasing immobilization, decreasing patient mobility and protecting normal tissues located near the critical areas such as: Optic nerve.

Aim: The aim of this study is to emphasize the importance of FSRS guided by IGRT in the treatment of cranial tumors.

Method: In November 2022, we took in study a case with Vestibular Schwannoma (*female, 54 years old*). She underwent FSRS treatment guided by IGRT in the Neurosurgery Service at the UHC "Mother Teresa" Tirana, Albania. The treatment was performed with a LINAC Linear Accelerator under constant follow-up by both the radiotherapy technician and the team of specialist physicians. Important in the adequate positioning of the patient are: Frame and Mold, which were prepared by the radiotherapy technician.

Results: After the end of the treatment sessions, a total killing of the tumor cells was expected, with maximum protection of critical tissues adjacent to the tumor and negligible toxicity of normal cells. FSRS not only give the opportunity to achieve this in 5 sessions, but the healthy cells that are damaged must be able to recover completely during the interval time from session to session and the cancer cells must receive from 95-107% of the dose to be a total successful treatment.

Conclusion: FSRS proved to be the most precise and valuable procedure in the treatment of benign cranial tumors such as large Vestibular Schwannomas, protecting as much as possible the nerves and critical or healthy areas located near the tumor.

Keywords: *accelerator frame, benign tumor, IGRT.*

ROLI I TEKNIKUT TË IMAZHERISË NË RADIOLOGJINË INTERVENCIONUESE

¹ *Elsi Plaku*

¹ *Teknik imazherie, Spitali Amerikan Tiranë 1*

ABSTRAKT

Në Radiologjinë Intervencionuese (IR) mjekët përdorin imazhe mjekësore për të udhëhequr procedurat kirurgjikale minimalisht invazive përmes prerjeve të vogla që bëjnë në trup, përmes së cilës diagnostikojnë trajtojnë dhe kurojnë shumë lloje gjëndjesh mjekësore.

IR është një degë e specializuar e radiologjisë e cila përdor modalitete të ndryshme imazherike si Fluoroscopia me rreze X, CT, ekografia apo MRI, të cilat përdoren për diagnostikimin dhe trajtimin e shumë gjëndjeve të ndryshme mjekësore.

Problematikat dhe kushtet: efektiviteti i trajtimit me këto teknika radiologjike shpesh herë është më i mirë se me trajtimet tradicionale.

Përparësitë e kësaj teknike përfshijnë: reduktimin e rrezatimit X, kohë më e shkurtër hospitalizimi dhe kthim më i hershëm në rutinë për pacientin; kosto më të ulëta; komoditet për pacientin dhe përmirësim i rezultateve shëndetësore.

Roli kryesor i teknikut të imazherisë në procedurat IR: optimizimi i përdorimit të rrezatimit X, dhënia e këshillave për pajisjet mjekësore radiologjike, performanca e sigurimit të cilësisë, survejimi i resurseve mjekësore radiologjike, trajnimi i praktikantëve apo stafit tjetër infermieror për teknikat e mbrojtjes nga rrezatimi, asistimi në teknika të ndryshme duke përdorur modalitete specifike imazherike, përgatitja e pacientit për procedurën dhe informimi mbi protokollin mjekësor që do ndiqet para dhe pas procedure.

Disa nga procedurat të realizuara në Spitalin Amerikan 1 lidhen kryer kryesisht me modalitetet e sipërpërmendura të CT, MRI dhe ekografisë dhe gjithashtu drenimin e rrugëve biliare i cili kërkon kushte më të specializuara për të realizuar ndërhyrjen dhe kryhen në sallë, ndjekja e të cilit behëtme C-arm.

Fjalë kyçe: *Radiologji intervenecionuese, CT, teknik imazherie, Shqipëri*

THE ROLE OF THE IMAGING TECHNICIAN IN INTERVENTIONAL RADIOLOGY

¹ *Elsi Plaku*

¹ *Imaging technician, American Hospital Tirana 1*

ABSTRACT

In Interventional Radiology (IR), physicians use medical imaging to guide minimally invasive surgical procedures through small incisions in the body, through which they diagnose, treat, and cure many types of medical conditions.

IR is a specialized branch of radiology that uses different imaging modalities such as X-ray Fluoroscopy, CT, ultrasound or MRI, which are used for the diagnosis and treatment of many different medical conditions.

Problems and conditions: the effectiveness of treatment with these radiological techniques is often better than with traditional treatments.

The advantages of this technique include: reduction of X-radiation, shorter hospitalization time and earlier return to routine for the patient; lower costs; patient convenience and improved health outcomes. The main role of the imaging technician in IR procedures: optimizing the use of X-rays, providing advice on medical radiological equipment, performing quality assurance, monitoring medical radiological resources, training interns or other nursing staff in radiation protection techniques, assistance in various techniques using specific imaging modalities, patient preparation for the procedure and information on the medical protocol to be followed before and after the procedure.

Some of the procedures carried out at the American Hospital 1 are mainly related to the above-mentioned CT, MRI and ultrasound modalities, as well as the drainage of the bile ducts, which requires more specialized conditions to carry out the intervention and are performed in the operating room, whose follow-up done with C-arm.

Keywords: *Albania, CT, interventional radiology, imaging technician*

TEKNIKAT E KRYERJES SË CT TEMPORALE (KOLESTEATOMA)

Sajmira Rexhvelaj¹

¹ *Teknike imazherie në Spitalin Amerikan 3*

ABSTRAKT

Hyrje: Veshi është organi i dëgjimit që detekton dhe analizon tingullin me anë të transduksionit (ose shndërrimit të valëve të zërit në impulse elektrokimike) dhe ruan ekuilibrin.

Humbja ose ulja e dëgjimit janë rezultat i dëmtimeve dhe patologjive që ndodhin në struktura të ndryshme të veshit. Kolesteatoma është një inflamacion kronik i veshit të mesëm që karakterizohet nga grumbullimi i epitelit skuamoz brenda kësaj hapësire. Persistenca e inflamacionit kronik çon në destruksion të strukturave përreth që janë esenciale për sigurimin e degjimit dhe ruajtjen e ekuilibrit.

Qëllimi: Është shumë e rëndësishme diagnostikimi dhe trajtimi sa më i shpejtë me qëllim sigurimin e një veshi të thatë dhe të shëndoshë.

Metodologjia: Metodot diagnostike fillestare për diagnostikimin e patologjive të veshit siç është kolesteatoma janë skanimi përmes CT i kockës temporale dhe MRI.

Ct temporale: CT me rezolucion të lartë është teknika e zgjedhjes së parë që mundëson përcaktimin e saktë të anatomisë normale të kockës temporale dhe patologjive komplekse të saj.

MRI: Në të gjithë pacientët me kolesteatomë të suspektuar rekomandohet plotësimi me një sekuençë specifike NON haste diffusion coronal DWI në MRI. Marrja e imazheve të kësaj sekuençe ka 95% saktësi në diagnostikimin e kolesteatomës. Në krahasim me CT, MRI rekomandohet të realizohet për rikontroll në pacientët post operatorë, për të shikuar nëse ka mbetje ose përsëritje.

Përfundimi: Realizimi i një CT të saktë me teknikat e rikonstruksionit si dhe plotësimin me MRI ndihmojnë në vendosjen e diagnozës për praninë e një kolesteatome e cila është shumë e rëndësishme për trajtimin në vazhdim.

Fjalë kyçe: *Kolesteatomë, CT e kockës temporale.*

TECHNIQUES OF PERFORMING TEMPORAL BONE CT (KOLESTEATOMA)

Sajmira Rexhvelaj¹

¹ *Radiology technician, American Hospital 3*

ABSTRACT

Introduction: The ear is the hearing organ that detects and analyzes sound by transduction (or the conversion of sound waves into electrochemical pulses) and maintains balance.

Hearing loss is the result of injuries and pathologies that occur in various ear structures.

Cholesteatoma is a chronic inflammation of the middle ear that is characterized by the accumulation of the squamous epithelium within this space. Chronic inflammation persistence leads to the destruction of surrounding structures that are essential for ensuring listening and maintaining balance.

Purpose: It is very important to diagnose and treat as quickly as possible to ensure a dry and healthy ear.

Methodology: Initial diagnostic methods for diagnosing ear pathologies such as cholesteatoma are CT scan of the temporal bone and MRI.

Temporal bone CT: High-resolution CT is the first-choice technique that enables the correct determination of the normal anatomy of the temporal bone and complex pathologies.

MRI: In all patients with suspected cholesteatoma, supplementation with a specific sequence NON haste diffusion coronal DWI is recommended to perform. Taking images of this sequence has 95% accuracy in diagnosing cholesteatoma. Compared to CT, MRI is recommended to be performed for recheck in patients post operators, to see if there are residues or retardation.

Conclusion: The realization of a correct CT with reconstruction techniques and mri supplementation help establish the diagnosis of a cholesteatoma which is very important for ongoing treatment.

Keywords: *Cholesteatoma, CT of the temporal bone.*

MRI FETALE*Shyqyri Çota¹*¹ *Teknik Imazherie, Spitali Amerikan***ABSTRAKT**

Hyrje: Imazhi me anë të MRI i fetusit është një teknikë që është bërë gjithnjë e më popullore për vlerësimin e trurit dhe shtyllës kurrizore të fetusit për shkak të përparimeve të fundit teknologjike. Kjo teknikë lejon vizualizimin më të mirë të zhvillimit dhe anomalive normale të trurit në mitër, duke e bërë atë një mjet të pazvëndësueshëm për diagnostikimin e hershëm të anomalive kongenitale.

Imazhi me MRI është veçanërisht i dobishëm në rastet e ventrikulomegalisë së dyshuar, keqformimeve të corpus callosum, anomalive të zhvillimit kortikal dhe anomalive të shtyllës kurrizore si dhe në raste të rralla ku kemi dhe mungesën e zhvillimit të gjymtyrëve të fetusit. Përdoret gjithashtu në shtatzënitë ku fetusi është në rrezik të shtuar për anomali të trurit, të tilla si: fetus me anomali të SNQ ose çrregullime gjenetike. Në rastet e komplikimeve të binjakëzimit monokorionik, si sindromi i transfuzionit binjak dhe vdekjes së dy binjakëve, imazhi MR i fetusit kryhet edhe në kuadër të një ekografie normale prenatale.

Për më tepër, imazhi MR i fetusit përdoret para ndërhyrjes kirurgjikale në rastet e keqformimeve Chiari II (levizjes së pasme të cerebellum përmes foramen magnum ku në përgjithësi ky ndryshim shoqërohet me gjendjen e hidrocefalusit), ku mund të identifikojë ashpërsinë e keqformimit të trurit të pasmë, anomalitë e zhvillimit të trurit dhe shtyllës kurrizore dhe lezionet destruktive. Në rastet e sindromës së transfuzionit binjak, imazhet MRI të fetusit përdoren para dhe pas çdo ndërhyrjeje kirurgjikale.

Imazhi me MR të fetusit mund të jetë gjithashtu i dobishëm në situatat kur truri i fetusit është i vështirë për t'u vlerësuar me anë të ekografisë, siç janë rastet e pakësimit të lëngut amniotik, pozicioni i vështirë i kokës së fetusit dhe mosha e avancuar e shtatzënisë, ku hija nga calvaria crani mund të ndërhyjë në imazhet me ultratinguj. Në përgjithësi, imazhet MRI të fetusit ofrojnë një mundësi unike për diagnostikimin dhe vlerësimin e hershëm të anomalive të trurit dhe shtyllës kurrizore të fetusit.

Fjalë kyçe: *diagnozë, fetus, MRI, skanim.*

FETAL MRI

Shyqyri Çota¹

¹Imaging technician, American Hospital Tirana

ABSTRACT

Introduction: Fetal MR imaging is a technique that has become increasingly popular for evaluating the fetal brain and spine due to recent technological advances. This technique allows better visualization of normal brain development and abnormalities in utero, making it an irreplaceable tool for early diagnosis of congenital anomalies.

MR imaging is particularly useful in cases of suspected ventriculomegaly, malformations of the corpus callosum, malformations of cortical development, and spinal anomalies, as well as in rare cases of fetal limb underdevelopment. It is also used in pregnancies where the fetus is at increased risk for brain abnormalities, such as: fetuses with CNS abnormalities or genetic disorders. In cases of complications of monozygotic twinning, such as twin transfusion syndrome and death of two twins, MR imaging of the fetus is also performed within a normal prenatal sonography.

In addition, fetal MR imaging is used before surgical intervention in cases of Chiari II malformations (posterior movement of the cerebellum through the foramen magnum where this change is generally associated with the condition of hydrocephalus), where it can identify the severity of the malformation of the hindbrain, developmental abnormalities of the brain and spine and destructive lesions. In cases of twin transfusion syndrome, fetal MR images are used before and after any surgical intervention.

Fetal MR imaging may also be useful in situations where the fetal brain is difficult to image by sonography, such as cases of decreased amniotic fluid, difficult position of the fetal head and advanced gestational age, where shadow from the calvaria can interfere with ultrasound images. Overall, fetal MR imaging offers a unique opportunity for early diagnosis and evaluation of fetal brain and spinal cord abnormalities.

Keywords: *diagnosis, fetus, MRI, scan.*

EKZAMINIMI SKANERIK REDUKTIMI I RISKUT TË RREZATIMIT TË PACIENTËT PEDIATRIKË QË I NËNSHTROHEN EKZAMINIMEVE SKANERIKE

*Sidorela Rexhepi¹, Bukurie Halili¹, Theodor Xhillari², Ilir Lumi¹
Teknike Imazherie, Spitali Universitar i Traumes Tiranë
Krye/Teknik Imazherie, Spitali Universitar i Traumes Tiranë*

ABSTRAKT

Hyrje: Ekzaminimi skanerik është një metodë diagostikuese tepër e rëndësishme në fushën e mjekësisë për vendosjen e diagnozave jo vetëm te pacientët adult por edhe tek ata pediatrikë. Megjithatë, duke qenë se fëmijët janë më të ndjeshëm ndaj rrezatimit, dëmtimi që rrezatimi mund të shkaktojë tek ata mbetet një shqetësim tepër i madh në fushën e mjekësisë. Prandaj paisjet skanerike duhet të përdoren në mënyre të kujdesshme, ku përfitimet e ekzaminimit të kërkuar në një pacient pediatrik t'i tejkalojnë risqet e ekspozimit ndaj rrezatimit që në këtë moshë. Kjo mbetet përgjegjësia më e madhe e ekipit shëndetësor. Në këtë studim do të tregohen risqet që vijnë nga ekspozimi ndaj rrezatimit dhe mënyrat sesi mund të reduktojmë dozat e rrezatimit te pacientët pediatrikë që i nënshtrohen ekzaminimeve skanerike, pa sakrifikuar cilësinë e imazhit skanerik.

Objektivat: Ky studim synon që profesionistët e shëndetit të njihen me përdorimin e ekzaminimit skanerik te moshat pediatrike dhe identifikimin e risqeve që vijnë nga rrezatimi. Te njihen me protokollet që përdoren për të kryer një skaner në moshat pediatrike dhe vështirësitë që mund të hasen gjatë ekzaminimit. Dhe së fundmi të informohen në lidhje me situatat në të cilat është e nevojshme të kryhet ekzaminimi skanerik temoshat pediatrike.

CONCLUSIONS: In the intervention group, we have an improvement in terms of oxygenation and a decrease in the need to perform aspiration of secretions. Children in the intervention group had an average of 2.5 days fewer days of stay compared to children in the control group 3.5 days

KEYWORD: Bronchiolitis, respiratory physiotherapy, pediatric age.

NEVOJA PËR SHËRBIME FIZIOTERAPEUTIKE PUBLIKE NË SHQIPËRINË RURALE DHE PERIFERIKE

Phd © Kristi Cela, Lecturer/Physiotherapist

European University of Albania

Faculty of Technical Medical Sciences

kristi.cela@uet.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Sipas Institutit të Statistikave të Shqipërisë, 75% e popullsisë shqipëtare jeton dhe konsiderohet si popullsi rurale. Bazuar në studimet për shëndetin e përgjithshëm të popullsisë vërehet se popullsia rurale dhe periferike raporton një prevalencë më të ulët për shëndet të përgjithshëm të mirë krahasuar me popullsinë në zonat urbane. Edhe më konkretisht, problemet muskuloskeletale shihen të kenë lidhje me mjediset rurale por shërbimet fizioterapeutike në këto mjedise mungojnë.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë nevojën për shërbime fizioterapeutike në Shqipërinë rurale dhe periferike bazuar në nivelin e njohurive të kësaj popullate për shërbimet mjekësore, përfitimet e ofruara nga ndërhyrjet fizioterapeutike dhe nivelin e pacientëve me probleme muskuloskeletale të cilët nuk kanë marrë shërbime të tilla.

Metodologjia: Ky studim përfshiu 490 subjekte, 230 meshkuj dhe 260 femra nga mosha 18 deri në 80+, të gjithë jetonin dhe merrnin shërbime mjekësore në mjedise dhe prejardhje të ngjashme.

Rezultatet: 65% e popullsisë totale kishte vuajtur të paktën një problem muskuloskeletor gjatë 3 muajve të fundit. Nga 320 subjekte që kishin këtë problem, vetëm 6% u rekomanduan të vizitonin një fizioterapist pas vizitës tek mjeku i tyre lokal. Vetëm 49% e të gjithë popullsisë kishin njohuri për shërbimet fizioterapeutike .91% e popullsisë preferonte të kishte akses në shërbimet fizioterapeutike në qendrën e tyre shëndetësore lokale dhe 81% pohuan se udhëtimi në zonat urbane ishte një shpenzim shtesë për kujdesin e tyre shëndetësor.

Përfundime: Bazuar në të dhënat e nxjerra nga studimi, Shqipëria do të përfitonte nga ofrimi i shërbimeve publike fizioterapeutike në zonat rurale dhe periferike për të promovuar shëndetin publik për popullatën. Kjo do të jepte mundësi punësimi për fizioterapistët më të rinj dhe do të parandalonte dyndjen e madhe të profesionistëve në një zonë të vetme.

Fjalë kyçe: Fizioterapi, Rurale, Suburbane, Shqipëri, Probleme muskuloskeletale.

THE NEED FOR PUBLIC PHYSIOTHERAPEUTIC SERVICES IN RURAL AND SUBURBAN ALBANIA

Phd © Kristi Cela, Lecturer/Physiotherapist

European University of Albania

Faculty of Technical Medical Sciences

kristi.cela@uet.edu.al

ABSTRACT

Introduction: According to Institution of Statistics of Albania 75% of albanian population lives and is considered a rural population. Based on studies for the general health of the population it is noted that rural and suburban population reports a lower prevalence for good general health compared to the population on urban areas. Even more specifically musculoskeletal issues are seen to have a connection with rural settings but the physiotherapeutic services are missing.

Purpose: The purpose of this study is to establish the need of physiotherapeutic services on rural and suburban Albania based on the level of knowledge of this population for the medical services, benefits provided from physiotherapeutic interventions and the level of patients with musculoskeletal issues that have never received such services.

Methodology: This study included 490 subjects, 230 males and 260 females from the age of 18 to 80+, all living and receiving medical services on similar settings and backgrounds.

Results: 65% of the total population had suffered at least one musculoskeletal issue during the past 3 months .From 320 subjects that had this issues only 6% where recommended to visit a physiotherapist after visiting their local doctor.Only 49% of the whole population knew about physiotherapeutic services .91% of the population preferred to have access of physiotherapeutic services on their local health center and 81% claimed that traveling to urban areas was an extra expense for their health care.

Conclusions: Based on the data extracted from the study Albania would benefit from providing public physiotherapeutic services in rural and suburban areas to promote public health for the population. This would give employment opportunities for younger physiotherapists and prevent the higher densities of professionists on a single area.

Keywords: Physiotherapy, Rural , Suburban , Albania , Musculoskeletal issues.

EFIKASITETI I KINESIOTAPIT NË PËRMIRËSIMIN E DHIMBJES LUMBARE

Msc. Blerina Kanushi

ABSTRAKT

Hyrje: Qëllimi i këtij studimi është të identifikoj efikasitetin e kinesiotaping në përmirësimin e dhimbjes lumbare. Gjithashtu te evidentojme ndikimin e moshes, gjinisë, peshës në intesitetin e dhimbjes lumbare.

Metodologjia: Për realizimin e këtij studimi kemi marrë 20 individë ku është aplikuar kinesiotaping në formën, “yjl”. Për vlerësimin e dhimbjes është përdorur skalla analoge VAS ndersa për matjen e fleksibilitetit është përdorur testi i fleksionit të kolonës vertebrale. Matjet e fleksibilitetit janë realizuar 3 herë. Niveli i dhimbjes është matur 2 herë.

Rezultatet: Nga matjet e bëra me anë të shkallës analoge VAS rezultoi që dhimbja maksimale ishte 7 ndersa dhimbja minimale ishte 3. Ndersa nga matja e dytë dhimbja maksimale ishte 3 dhe ajo minimalja ishte 0. Subjektet iu nënshtruan edhe testit të fleksionit të kolonës vertebrale ku nga matja e parë distanca më e largët nga toka ka qënë 37 cm dhe më e afërta ishte 3 cm. Nga matja e dytë, distanca më e largët ishte 35 cm dhe më e afërta ishte 3 cm. Nga matja e tretë e distanca më e largët ishte 32 cm dhe më e afërta 0.

Konkluzionet: Aplikimi i kinesiotaping ka ndikuar pozitivisht në ndryshimet e mobilitetit e aksit lumbar dhe në uljen e dhimbjes. Pacientët më të rinj në moshë kanë pasur ulje më të konsiderueshme të dhimbjes se pacientët më të vjetër në moshë.

Fjalë kyçe: Dhimbjet e Mesit, Kinesiotape, Shkalla VAS, Fleksion i Kolonës Vertebrale,

“THE EFFICIENCY OF KINESIOTAPE IN IMPROVING LUMBAR PAIN”

Msc. Blerina Kanushi

ABSTRACT

Introduction: The aim of this study is to identify the efficacy of kinesiotaping in improving lumbar pain. We also highlight the impact of age, gender, weight and profession on the intensity of lumbar pain.

Methodology: For the realization of this study we have received 20 individuals where kinesiotaping was applied in the form, "star". An analog VAS scale was used to assess pain, while a flexion test of the vertebral column was used to measure flexibility. Flexibility measurements were performed 3 times. The pain level was measured 2 times.

Results: From the measurements made by analog scale VAS it resulted that the maximum pain was 7 while the minimum pain was 3. While from the second measurement the maximum pain was 3 and the minimum was 0. Subjects also underwent a vertebral column flexion test where from the measurement first the farthest distance from the ground was 37 cm and the nearest was 3 cm. From the second measurement, the farthest distance was 35 cm and the nearest was 3 cm. From the third measurement the farthest distance was 32 cm and the nearest 0.

Conclusion: The application of kinesiotaping has had a positive effect on changes in the mobility of the lumbar axis and in reducing pain. Younger patients had more significant reductions in pain than older patients.

Keywords: Low Back Pain, Kinesiotaping, VAS Scale, Spine Flexion.

TRAJTIMI KONSERVATIV I SKOLIOZËS, NËPËRMJET KORSSES DHE METODËS PSSE-SCHROTH

¹SILVIO SELFO ²PERLI RUSI ³OLSA META
"Shërbimi i Fizioterapisë"

ABSTRAKT

Qëllimi: Ky studim synon të vlerësoj rezultatet e trajtimit konservativ në parandalimin e progresimit me ushtrime fizioterapeutike specifike (PSSE-Scroth) dhe në reduktimin e këndit të Cobb-it me korse dhe PSSE-Scroth duke përmirësuar cilësinë e jetës në skoliozën idiopatike adoleshente.

Metodat: Studimi përfshiu një total prej 60 subjektësh të ndara në dy grupe. Grupi 1 përbëhej nga 30 subjekte (23 vajza dhe 7 djem) që ndiqnin një trajtim konservativ të kombinuar me korse dhe ushtrimet PSSE-Scroth, me këndin e Cobb-it $\geq 25^\circ$, në grupmoshën 10-18 vjeç. Grupi 2 gjithashtu përbëhej nga 30 subjekte (22 vajza dhe 8 djem) që ndiqnin vetëm ushtrimet PSSE-Scroth, me këndin e Cobb-it 10-24°, në grupmoshën 10-18 vjeç. U mat këndi i Cobb-it dhe u përdor pyetësi SRS-22 para dhe pas trajtimit në secilin grup të përzgjedhur. Trajtimi u zhvillua në klinikën "Orthophysiotherapy", me njëkohë mesatare të trajtimit prej 9 muaj.

Rezultatet: Në grupin e parë, 20% të subjekteve mbetën të qëndrueshëm ($1,42^\circ\text{T}; 2,03^\circ\text{L}$), 7% u përkeqësuan ($8,7^\circ\text{T}; 4,2^\circ\text{L}$), dhe 73% u përmirësuan ($13,2^\circ\text{T}; 9,24^\circ\text{L}$). Në grupin e dytë, 57% e subjekteve mbetën të qëndrueshëm ($-1,04^\circ\text{T/L}$), 30% u përkeqësuan ($-4,07^\circ\text{T/L}; -5,8^\circ\text{T}; -10,4^\circ\text{L}$), dhe 13% u përmirësuan ($17,05^\circ\text{T/L}$). 93% e subjekteve në grupin e parë dhe 70% në grupin e dytë (qëndrueshmëri/përmirësim) raportuan një përmirësim të dukshëm në cilësinë e jetës (Grupi 1 nga 14.3 në 21.8; Grupi 2 nga 15.4 në 22.7), me vlera $p < .001$; $W = 0.00$ në të dyja grupet.

Konkluzione: Rezultatet e këtij studimi japin mbështetje për hipotezën alternative, duke treguar se trajtimi konservativ me korse dhe ushtrime fizioterapeutike specifike (PSSE-Scroth) kanë ndikim të rëndësishëm në parandalimin e progresit dhe reduktimin e këndit të Cobb-it te pacientët me skoliozë idiopatike adoleshente. Këto rezultate sugjerojnë se këto trajtime janë efektive në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndihmojnë në kontrollin e deformimit të kolonës vertebrale.

Fjalë kyçe: Trajtim konservativ; Skoliozaidiopatike adoleshente; PSSE-Scroth; Këndi Cobb-it; Pyetësi SRS-22.

CONSERVATIVE TREATMENT OF SCOLIOSIS, WITH BRACE AND PSSE-SCHROTH METHOD

¹SILVIO SELFO ²PERLI RUSI ³OLSA META
"Physiotherapy Department"

ABSTRACT

Purpose: This study aimed to evaluate the results of conservative treatment in preventing progression with specific physiotherapeutic exercises (PSSE-Scroth) and in reducing the Cobb angle with braces and PSSE-Scroth while improving quality of life in adolescent idiopathic scoliosis.

Methods: The study included a total of 60 subjects divided into two groups. Group 1 consisted of 30 subjects (23 females and 7 males) who underwent a combined conservative treatment with braces and PSSE-Scroth, with a Cobb angle $\geq 25^\circ$, in the age range of 10-18 years. Group 2 also consisted of 30 subjects (22 females and 8 males) who underwent only PSSE-Scroth exercises, with a Cobb angle of $10-24^\circ$, in the age range of 10-18 years. The Cobb angle was measured, and the SRS-22 questionnaire was used before and after treatment in each selected group. The treatment was conducted at the "Orthophysiotherapy" clinic, with an average treatment duration of 9 months.

Results: In Group 1, 20% of the subjects remained stable (1.42°T ; 2.03°L), 7% worsened (8.7°T ; 4.2°L), and 73% improved (13.2°T ; 9.24°L). In Group 2, 57% of the subjects remained stable (-1.04°T/L), 30% worsened (-4.07°T/L ; -5.8°T ; -10.4°L), and 13% improved (17.05°T/L). 93% of subjects in Group 1 and 70% in Group 2 (stability/improvement) reported significant improvement in quality of life (Group 1: from 14.3 to 21.8; Group 2: from 15.4 to 22.7), with values of $p < .001$; $W = 0.00$ in both groups.

Conclusion: The results of this study provide support for the alternative hypothesis, indicating that conservative treatment with braces and specific physiotherapeutic scoliosis exercises (PSSE-Scroth) have a significant impact on preventing progression and reducing the Cobb angle in adolescent patients with idiopathic scoliosis. These findings suggest that these treatments are effective in improving quality of life and helping control spinal deformity

Keywords: Conservativetreatment; Adolescent idiopathic scoliosis; PSSE-Scroth;Cobb Angle; SRS-22 questionnaire.

NDIKIMI I PNF NË PËRMIRËSIMIN E EKUILIBRIT NË STROKE KRONIK

¹PERLI RUSI, ²OLSA META, ³SILVIO SELFO
"Departamenti i fizioterapise"

ABSTRAKT

Qëllimi: Ky studim synon të sigurojë një pasqyrë, se si ndërhyrja me terapi fizike të bazuar në lehtësimin neuromuskular proprioceptiv (PNF) mund të ndikojë në ekuilibrin e pacientëve post Stroke.

Metodat: Studim instrumental. Ky studim përshkruan dy raste klinike Post Stroke, në fazën kronike. Terapia e përdorur u bazua në konceptin e Lehtësimit Proprioceptiv Neuromuskular (PNF). Subjektet u ndoqën në klinikën private "Orthophysiotherapy".

Periudha kohore e terapisë e bazuar në PNF: Subjekti M- tri herë në javë, mbi një periudhë kohore 8 mujore (Qershor 2022-Janar 2023). Subjekti F- dy herë në javë, mbi një periudhë kohore 6 mujore (Gusht 2022-Janar 2023). Metodat e vlerësimit: Mini BESTest; ABC (Activities-Specific Balance Confidence Scale); UMCT (Upright Motor Control Test).

Rezultatet: Rehabilitimi para dhe pas PNF sipas përcaktimit të testeve, në subjektin M: MiniBESTest (150-200) ABC (70-110) UMCT (100-200) Rehabilitimi para dhe pas PNF sipas përcaktimit të testeve, në subjektin F: MiniBESTest (70-130) ABC (40-60) UMCT (100-120).

Konkluzione: Si rrjedhojë e ndikimit që sjell Stroke në pavaresinë e pacient, ky studim tregon se PNF është e sigurtë dhe efektive, në përmirësimin e shpejtësisë së ecjes, duke parandaluar rrezikun e rënies dhe izolimit social.

Fjalë kyçe: Lehtësimi Proprioceptiv Neuromuskular; Ekuilibri; Stroke Kronik;
Mini BESTest; ABC; UMCT

THE EFFECT OF PNF ON BALANCE IMPROVEMENT IN CHRONIC STROKE

¹PERLI RUSI, ²OLSA META, ³SILVIO SELFO

"Physiotherapy Department"

ABSTRACT

Purpose: This study aims to provide an overview of how physical therapy intervention based on proprioceptive neuromuscular facilitation (PNF) can affect the balance of post-stroke patients.

Methods: Instrumental study. This study describes two clinical cases of Post Stroke, in the chronic phase. The therapy used was based on the concept of Proprioceptive Neuromuscular Facilitation (PNF). The subjects were followed in the private clinic "Orthophysiotherapy".

Time period of therapy based on PNF: Subject M-three times a week, over a period of 8 months (June 2022-January 2023). Subject F-twice a week, over a period of 6 months (August 2022-January 2023). Evaluation methods: Mini BESTest; ABC (Activities-Specific Balance Confidence Scale); UMCT (Upright Motor Control Test).

Results: Rehabilitation before and after PNF according to the definition of the tests, in subject M: MiniBESTest (150-200) ABC (70-110) UMCT (100-200). Rehabilitation before and after PNF according to the definition of the tests, in subject F: MiniBESTest (70-130) ABC (40-60) UMCT (100-120).

Conclusions: As a result of the impact that Stroke brings on the patient's independence, this study shows that PNF is safe and effective in improving walking speed, preventing the risk of falling and social isolation.

Keywords: Neuromuscular Proprioceptive Facilitation; Balance; Chronic Stroke; Mini BESTest; ABC; UMCT

REHABILITIMI PËR PACIENTËT PAS RIKONSTRUKSIONIT TË ACL

Perli Rusi

Spitali Universitar i Traumes, Kryefizioterapist, Klinika Mjekesore Rusi

ABSTRAKT

Rehabilitimi rigoroz pas rikonstruksionit të ruptures të ligamentit cruciat anterior është i domosdoshem për të patur rezultate të sukseshme pas operacionit. Një numer i lartë i studimeve klinike ende vleresojnë aspektet e këtij procesi rehabilitimi.

Metodologjia: 85 paciente të trajtuar në departamentin tonë të rehabilitimit, nga Tetor I 2018 deri në Janar 2023, të gjithë të operuar me graft Hamstringu, 12 prej tyre me metoden transtibial portal dhe pjesa tjetër me metoden anteromedial portal.

Në Departamentin tonë të Rehabilitimit, në Spitalin Universitar të Traumës, pacientët referohen random për fizioterapi pas rikonstruksionit të ACL.

Megjithatë, deri më sot roli dhe frekuenca e kërkuar e fizioterapisë së mbikëqyrur nuk është përcaktuar qartë.

Ne ndjekim një model, i cili është zhvilluar nga vëzhgimi klinik, ndërveprimi i pacientit dhe duke analizuar vlerat e rezultatit që rrjedhin nga pacientët në follow-up në departamentin tonë.

Rezultatet:

1. 97% e pacienteve që ndoqen fizioterapi rigorozë të mbikëqyrur kanë fituar fleksion të plote të gjurit.
2. 100% e pacienteve që ndoqen fizioterapi rigorozë të mbikëqyrur fituan ekstension të plote të gjurit.
3. 100% e tyre fituan tonus të plote të muskujve të kofshes, të vlerësuar 5/5

Konkluzioni: Rezultatet më të mira të rehabilitimit u vunë re të pacientët me program të kombinuar: ROM + STRENGTH, një grup që ndoqi rregullisht fizioterapi të monitoruar pas rikonstruksionit të ACL, krahasuar me ata që ndoqën një program jot e rregullt fizioterapie në frekuencë.

100% e pacientëve arritën ekstension normale të gjurit dhe 97% e pacientëve arritën fleksion normal të gjurit në fund të rehabilitimit

Fjalë kyçe: ACL, rikonstruksion, rehabilitim

REHABILITATION FOR PATIENTS FOLLOWING ACL RECONSTRUCTION

Perli Rusi

University Trauma Hospital, Head of Pysiotherapy Department, Rusi Medical Center

ABSTRACT

Background: Rigorous rehabilitation after anterior cruciate ligament (ACL) reconstruction is necessary for a successful surgical outcome. A large number of clinical trials continue to asses aspects of this rehabilitation process.

Methods: Eighty five patients treated in our department of rehabilitation after ACLR, from October 2018 to January 2023, all of them operated with hamstring autograft, 12 of them operated with transtibial portal and the rest with the anteromedial portal.

In our Department of Rehabilitation, in University Trauma Hospital, patients are routinely referred for physiotherapy after ACL reconstruction.

However, to date the role and amount of supervised physiotherapy required has not been clearly established.

We follow a model, which has been developed by clinical observation, patient interaction, and by analyzing outcome measures derived from prospective follow-up patients.

Results:

1. 97% of the patients that have follow up rigorous physiotherapy achieved normal knee flexion.
2. 100% of the patients that have follow up rigorous physiotherapy achieved normal knee extension.
3. 100% of them gained normal tonus of thigh muscles evaluated 5/5.

Conclusions: The best outcome scores occurred in patients with combined program: ROM + Strength, a group who attended physiotherapy regularly after ACL reconstruction, comparison with those who attended only infrequently. 100 % of patients achieved normal knee extension and 97 % of patients achieved normal knee flexion.

Keywords: ACL, reconstruction, rehabilitation.

REHABILITIMI I FRAKTURËS COLES

Perli Rusi¹ Anxhela AHMATAJ²

¹Spitali Universitar i Traumës, Shef i Departamentit të Fizioterapisë; Klinika Mjekësore Rusi

²Spitali Universitar i Traumës, Fizikoterapist, Kinika Mjekësore San Vitale

ABSTRAKT

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë problemet në performancë pas rehabilitimit të frakturave Colles dhe për të parandaluar demtimet në fazën e hershme të rehabilitimit.

Metodologjia: Vleresimet u kryen në javën e parë dhe të pestë pas heqjes së gipsit, nuk u përjashtuan pacientet me radius distal të tipit Colles të operuar. U përdorën si teste vlerësuese: The Canadian Occupational Performance Measure, ROMi dhe një shkallë dikotomike specifike prej 10 aktiviteteve për jetesën e standardizuar të përditshme. Forca e kapjes, dhimbja dhe shkathësia gjithashtu u vlersuan.

Rezultatet: 47 paciente, 30 prej tyre femra, 17 meshkuj. 40 nga moshën 40 deri në 78 vjeç, dhe 7 prej tyre nga moshën 19 deri në 27 vjeç. Vetëm 6 prej tyre të cilët ishin trajtuar me Gips, ben SUDEK.

Përmirësimet domethënëse statistikore dhe klinike u gjetën në kapacitetin dhe numrin e aktiviteteve të kryera. Problemet që u vun re ishin me përkuqdesin vetjak në 5 javë. Më gjatë 1/3 e tyre nuk ishin në gjendje të kryenin të gjitha nevojat bazike të jetesës në javën e 5 post fracture.

Konkluzione: Frakturat e radiusit distal janë fraktura me incidence të larta në urgjencën ortopedike. Ndodhin kryesisht tek femrat në periudhën post menopause për shkak të osteoporozës të shkaktuara edhe nga trauma minore. Ndodhin rralle të rinjve dhe kërkojnë trauma me energji të lartë si aksidentet automobilistike. Trajtimi i tyre varion nga ai konservativ në atë kirurgjikal (ORIF, fixator extern etj.). Fizioterapia është një procedurë e rëndësishme për të marrë rezultate klinike optimale, pas trajtimit qoftë konservator apo kirurgjikal. Rekomandohet të fillohet që në ditën e para post operatore.

Fjalë kyçe: Frakturë Colles, vleresim, Gips, operim, rehabilitim

COLLES FRACTURE AND REHABILITATION

Perli Rusi¹ Anxhela AHMATAJ²

¹University Trauma Hospital, Head of Physiotherapy Department; Rusi Medical Center

²University Trauma Hospital, Physical Therapist, San Vitale Medical Center

ABSTRACT

Purpose: The purpose of this study was to investigate problems in performing after rehabilitation st. post Colles' Fracture and to correlate activity limitation with impairments in the early stage of rehabilitation.

Method: Assessments were performed 1 and 5 weeks after removing plaster casts. The Canadian Occupational Performance Measure, ROM and a disease-specific dichotomus scale of 10 activities of daily living were used. Grip strength, pain and dexterity were also assessed according to standardized methods.

Results: 47 patients, 30 of them females, 17 males, 40 of them from age 40 to 78 and 7 of them from age 19 to 27. Only 6 of them, all treated with plaster did SUDEC complication.

Highly significant statistical and clinical improvements were found in the capacity, number and performance of activities. Problems were mainly classified as self-care activities at 5 weeks, while problems in leisure activities were practically the same. However, one-third of the patients were not able to perform all basic activities of daily living at 5 weeks.

Conclusions: Colles' fracture, the fracture of distal radius, are high incidences fractures in Orthopedics.

These fractures happen mostly in post menopausal women, due to osteoporosis. In this group, this kind of fracture happen after a minor trauma. But these fractures rarely happen in young generation, it required a high energy trauma, such as car accident.

Treatments of them varied from conservative to surgical treatment (ORIF, fixative extern, etc.).

In a part of cases we see complications.

Physiotherapy is an important procedure to get optimal clinical results, after conservative and surgical treatment.

Time to start physical therapy is recommended to start since the first post surgery days, we start with passive ROM of digital articulation to improve ROM and muscles' strength.

Keywords: Colles' fracture, assessment, plaster, operated, rehabilitation

ROLI I FIZIOTERAPISË NË TRAJTIMIN E TORTIKOLIS (RISHIKIM LITERATURE)

Shefqet Çullhaj¹ Behije Gollobërda²

¹ Student, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë

²As/Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

shefqetcullhaj@outlook.com commarrabehije@gmail.com

ABSTRAKT

Qëllimi: Ky rishikimi është realizuar me qëllim për të promovuar dhe demonstruar efektet e fizioterapisë në trajtimin e tortikolisit te pacientët pediatrik, si dhe për të treguar teknikat e reja të trajtimit fizioterapeutik në menaxhimin e dhimbjes së muskulit sternokleidomastoideus(skm).

Metodologjia: U morën në konsideratë 9 studime të mirëfillta, të publikuara në Pub Med, të realizuara nga vitit 2014-2017, në vende të ndryshme të botës. Këto studime promovojnë dhe dëshmojnë efektet pozitive të trajtimit fizioterapeutik në pacientët pediatrik që vuajnë nga tortikolis.

Rezultatet: Studimet e marra në konsideratë tregojnë se programi ushtrimor i rehabilitimit fizioterapeutik përmirëson ndjeshëm simptomat dhe cilësinë e jetës së pacientëve pediatrik që kanë shkurtim të muskulit sternokleidomastoid.

Konkluzionet: Në përfundim, ky rishikim verifikon rëndësinë e fizioterapisë në sistemin shëndetësor, në pacientët që janë diagnostikuar me tortikolis, ku rehabilitimi fizioterapeutik është një trajtim efektiv dhe i domosdoshëm për trajtimin e tortikolisit pasi kanë pak efekte anësore dhe më shumë përfitime afatgjata. Për të arritur në përfundime më të qarta dhe konkrete duhet të merren në konsideratë një numër më i madh studimesh që dëshmojnë këtë fakt.

Fjalë kyçe: tortikolis. m.sternokleidomastoid, rehabilitim, fizioterapi, pacient pediatrik.

THE ROLE OF PHYSIOTHERAPY IN THE TREATMENT OF TORTICOLLIS (systematic review)

Shefqet Çullhaj¹ Behije Gollobërda²

¹Student, Faculty of Technical Medical Sciences, Tirana University of Medicine

²Ass/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan “AleksandërXhuvani”

shefqetcullhaj@outlook.com marrabehije@gmail.com

ABSTRACT

Aim: This review was carried out with the aim of promoting and demonstrating the effects of physiotherapy in the treatment of torticollis in pediatric patients, as well as to show new techniques of physiotherapy treatment in the management of sternocleidomastoid muscle pain (skm).

Methodology: 9 different studies, published in Pub Med, conducted from 2014-2017, in different countries of the world, were taken into consideration. These studies promote and prove the positive effects of physiotherapeutic treatment in pediatric patients suffering from torticollis. These studies promote and prove the positive effects of physiotherapeutic treatment in pediatric patients suffering from torticollis.

Results: The studies considered show that the physical therapy rehabilitation exercise program significantly improves the symptoms and quality of life of pediatric patients with shortening of the sternocleidomastoid muscle.

Conclusions: In conclusion, this review verifies the importance of physiotherapy in the health system, in patients who have been diagnosed with torticollis, where physiotherapy rehabilitation is an effective and necessary treatment for the treatment of torticollis as it has fewer side effects and more long-term benefits. In order to reach clearer and more concrete conclusions, a larger number of studies proving this fact should be taken into consideration.

Keywords: *torticollis, m.sternocleidomastoid, rehabilitation, physiotherapy, pediatric patient*

BENEFITET E FIZIOTERAPISE TE PACIENTËT PAS INFARKTIT TE MIOKARDIT (RISHIKIM LITERATURE)

Behije Gollobërda¹, Elona Dybeli¹, Ilma Toçi¹, Venemin Gega¹

¹As/Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

marrabehije@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje: Sëmundjet kardiovaskulare, në veçanti, infarkti i miokardit (IM), janë kërcënimet kryesore për shëndetin e njeriut në kohët moderne. Në mbarë botën, të moshuarit kanë një prevalence më të lartë të infarktit të miokardit (IM), i cili shoqërohet me plakjen e funksionit të trupit dhe një mënyrë jetese të ulur. Përveç mjekimit, ushtrimet fizike janë një metodë plotësuese e mirëpërcaktuar për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare.

Qëllimi: Qëllimi i këtij rishikimi është të vlerësojë dhe dëshmojë efektet e terapisë fizike për trajtimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore te pacientët pas IM.

Metodologjia: Për realizimin e këtij studimi janë marrë në konsideratë 12 studime të ndryshme, të publikuara në Pub Med, të realizuara në vende të ndryshme të botës, të cilat promovojnë dhe faktojnë efektet e dobishme të rehabilitimit fizioterapeutik për parandalimin dhe trajtimin e IM.

Rezultate: Studimet e marra në konsideratë dëshmojnë se programi ushtrimor i rehabilitimit fizioterapeutik i kombinuar me notin përmirëson ndjeshëm simptomat dhe cilësinë e jetës së pacientëve që kanë kaluar IM. Pacientët i riktheheshin më shpejt aktiviteteve të jetës së përditshme dhe trajtimi i hershëm parandalonte IM.

Konkluzione: Në përfundim, rehabilitimi fizioterapeutik është një trajtim alternativë efektiv dhe i besueshëm për pacientët me IM në bazë të mjekimit dhe terapisë kirurgjikale, pasi ka më pak efekte anësore dhe më shumë përfitime afatgjata. Ky lloj trajtimi duhet të standardizohet dhe të aplikohet gjerësisht në spitale dhe klinika për të ndihmuar pacientët me IM.

Fjalë kyçe: Infarkti miokardit, sëmundje kardiovaskulare, terapia fizike, rehabilitim

BENEFITS OF PHYSIOTHERAPY IN PATIENTS AFTER MYOCARDIAL INFARCTION (LITERATURE REVIEW)

Behije Gollobërda¹, Elona Dybeli¹, Ilma Toçi¹, Venemin Gega¹

Ass/Lecturer, Faculty of Technical Medical Sciences, University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

ABSTRACT

Background: Cardiovascular diseases, in particular, myocardial infarction (MI), are the main threats to human health in modern times. Worldwide, elderly people have a higher prevalence of myocardial infarction (MI), which is associated with body function aging and a sedentary lifestyle. In addition to medication, exercise training is a well-established supplementary method to prevent and treat cardiovascular diseases.

Aim: The purpose of this review is to evaluate and prove the effects of physical therapy for the treatment and improvement of the health status of patients after MI.

Methodology: In this review we have summarized several 12 different studies, published in Pub Med, carried out in different countries of the world, which promote and prove the beneficial effects of physiotherapeutic rehabilitation for the prevention and treatment of MI.

Results: The studies considered prove that the exercise program of physiotherapeutic rehabilitation combined with swimming significantly improves the symptoms and the quality of life of patients who have undergone MI. Patients returned to activities of daily living more quickly and early treatment prevented MI.

Conclusions: Physiotherapeutic rehabilitation is an effective and reliable alternative treatment for MI patients in the basis of medication and surgery therapy, as it has fewer side effects and more long-lasting benefits. This type of treatment should be standardized and widely applied in clinics to help MI patients.

Keywords: Myocardial Infarction, cardiovascular diseases, physical therapy, rehabilitation

EFEKTSHMËRIA E KOMBINIMIT TË METODËS BOBATH DHE TERAPISË PASQYRË NË REHABILITIMIN E PACIENTËVE ME HEMIPLEGJI

Anduel Kana¹, Elona Laçi²

¹Universiteti "Aldent" anduel.kana@student.ual.edu.al

²Universiteti "Aldent" elona.laci@ual.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Hemiplegjia është një dëmtimi i sistemit nervor qendror (SNQ), trurit, që çon në dëmtime të ndjeshmërisë dhe lëvizshmërisë së gjysmës së trupit. Studimi ynë do të përqëndrohet në analizën e këtij dëmtimi dhe ndikimin e fizioterapisë në këtë grup pacientësh.

Qëllimi i temës është njohja me efikasitetin e rehabilitimit fizioterapeutik, Konceptit Bobath me terapinë pasqyrë, në pacientët me hemiplegjia.

Metodologjia: Në studim janë marrë 3 pacientë cilët janë diagnostikuar me hemiplegjia. Për përzgjedhjen e pacientëve u vendosën disa kriteret pranuese:

- Pacientë të diagnostikuar me hemiplegjia
- Pacientë të cilët dëshirojnë të rehabilitohen nëpërmjet fizioterapisë
- Pacientë të cilët pranojnë Metodën Bobath dhe terapinë pasqyrë për rehabilitimin e tyre

Në kriteret përjashtuese kemi:

- Pacientët spastik

Pacientët u ndoqën në dinamikë përgjatë 3 muajve duke ndjekur seancat e rehabilitimit çdo ditë.

Rezultatet: Sipas të dhënave na rezultoi se Koncepti Bobath dhe terapia pasqyrë rezultuan efikase në rritjen e funksionalitetit të anësive dhe në përfitimin e tonusit muskular.

Konkluzione: Rehabilitimi fizioterapeutik rezultoi i suksesshëm në përmirësimin e vigjilencës së pacientit, rritjen e tonusit muskular, përmirësimin e koordinimit të lëvizjeve dhe përmirësimin e funksionalitetit të anësive. Por rezultatet na treguan se pacientët përsëri vazhdojnë me defiqite të mëdha në anësi dhe për këtë arsye ne kemi vazhduar me rehabilitimin e tyre, por protokollit tonë rehabilitues i janë shtuar dhe teknika të tjera rehabilitimi.

Fjalë kyçe: Hemiplegjia, Bobath, terapia pasqyrë.

THE EFFECTIVENESS OF THE COMBINATION OF THE BOBATH METHOD AND MIRROR THERAPY IN THE REHABILITATION OF PATIENTS WITH HEMIPLEGIA

Anduel Kana¹, Elona Laçi²

¹“Aldent” University, anduel.kana@student.ual.edu.al

²“Aldent” University, elona.laci@ual.edu.al

ABSTRACT

Introduction: Hemiplegia is a damage to the central nervous system (CNS), the brain, which leads to damage to the sensitivity and mobility of half of the body. Our study will focus on the analysis of this injury and the impact of physiotherapy on this group of patients.

The objective of the topic is to recognition of the effectiveness of physiotherapeutic rehabilitation through the combination of the Bobath concept with mirror therapy.

Methodology: We have rehabilitated in total 3 patients who were diagnosed with hemiplegia. For the selection of patients, we set several acceptance criteria:

- Patients diagnosed with Hemiplegia
- Patients who wish to be rehabilitated through physiotherapy
- Patients who accept the Bobath Method and mirror therapy for their rehabilitation

In the exclusionary criteria we have:

- Spastic patients

The patients were dynamically followed for 3 months. They were treated every day.

Results: According to the results data, they showed us that the Bobath Concept and mirror therapy were effective in increasing the functionality of the sides and in the benefit of muscle tone.

Conclusions: Physiotherapy rehabilitation was successful in improving the patient's vigilance, increasing muscle tone, improving the coordination of movements and improving the functionality of the sides. But the results showed us that the patients still continue with large deficits in laterality and therefore we have continued with their rehabilitation, but other rehabilitation techniques have been added to our rehabilitation protocol.

Keywords: Hemiplegia, Bobath, mirror therapy.

PROTOKOLLET E REHABILITIMIT TË PACIENTËVE ME BURSIT SUBACROMIAL

Roxhensa Sula¹, Jurlind Elezi², Kejdi Keçi³

¹Universiteti "Aldent", roxhensa.sula@ual.edu.al

²Universiteti "Aldent", jurlind.elezi@student.ual.edu.al

³Universiteti "Aldent", kejdi.keci@student.ual.edu.al

ABSTRAKT

Hyrje: Bursiti subakromial është inflamacion i bursës subakromiale i cili shkakton dhimbje të shpatullës dhe një sërë simptomash të tjera bashkëshoqëruese. Bursitet ndodhin kryesisht pas moshës 40 vjeçare dhe më së shumti prek gjininë femërore, megjithatë vitet e fundit është parë se bursitet po shfaqen dhe në grupmosha më të reja.

Objektivi i temës është krahasimi i dy protokolleve rehabilituese përsa i takon funksionalitetit dhe efektshmërisë së tyre në patologjitë e bursiteve subacromiale tek pacientët. Krahasimi u bë midis kombinimit të protokollit të terapisë manuale me Konceptin Mulligan tek grupi i parë i pacientëve dhe terapisë manuale dhe Mobilizimeve të Lewit tek grupi i dytë i pacientëve.

Metologjia: Ne përzgjedhëm dy grupe pacientësh, me nga 10 pacientë secili grup. Ata u ndoqën në dinamikë përgjatë 20 seancave fizioterapeutike. Për përzgjedhjen e pacientëve u vendosëm disa kriteret:

- Pacientë të diagnostikuar me bursit subacromial
- Pacientë të cilët pranojnë të rehabilitohen nëpërmjet Konceptit Mulligan dhe Mobilizimeve të Lewit

Rezultate: Bazuar tek rezultatet u pa se kombinimi i terapisë manuale me Konceptin Mulligan rezultoi më efikas se aplikimi i terapisë manuale me Mobilizimet e Lewit.

Konkluzione: Rehabilitimi fizioterapeutik rezultoi i suksesshëm në uljen e dhimbjeve dhe rritjen e amplitudës artikulare, rritjen e funksionalitetit dhe rikthimin e pacientëve në ADL-të e tyre.

Fjalët kyçe: Bursitis subacromial, Koncepti Mulligan, Mobilizimet e Lewit.

REHABILITATION PROTOCOLS FOR PATIENTS WITH SUBACROMIAL BURSTITIS

Roxhensa Sula¹, Jurlind Elezi², Kejdi Keçi³

¹*“Aldent” University, roxhensa.sula@ual.edu.al*

²*“Aldent” University, jurlind.elezi@student.ual.edu.al*

³*“Aldent” University, kejdi.keci@student.ual.edu.al*

ABSTRACT

Introduction: Subacromial bursitis is inflammation of the subacromial bursitis which causes shoulder pain, but also a series of other accompanying symptoms. Bursitis occurs mainly after the age of 40 and mostly affects the female gender, owever, in recent years, we have seen this pathology also appearing in a younger age group.

The objective of the topic is to compare two rehabilitation protocols in terms of their functionality and effectiveness in subacromial bursitis pathologies in patients. The comparison was made between the combination of the manual therapy protocol with the Mulligan Concept in the first group of patients and manual therapy and Lewis Mobilizations in the second group of patients.

Metodology: We selected two groups of patients, 10 patients each group, in whom they were dynamically followed during 20 physiotherapeutic sessions. For the selection of patients, we set several criteria:

- Patients diagnosed with subacromial bursitis
- Patients who agree to be rehabilitated through the Mulligan Concept and Lewit Mobilizations

Results: Based on the results, it was seen that the combination of manual therapy with the Mulligan Concept was more efficient than the application of manual therapy with Lewit's Mobilizations.

Conclusions: Physiotherapy rehabilitation was successful in reducing pain, increasing articular amplitude, functionality and to improve the daily life activities of the patients.

Keywords: Subacromial bursitis, Mulligan concept, Lewit's mobilizations.

“RËNDËSIA E FIZIOTERAPISË NË FIBROZËN KISTIKE”*¹Msc. Jola Çini, ¹Prof. Asoc. Lila Shundi, ¹Prof. Dr. Evda Veveçka, ¹Prof. Dr. Eleni Nastas**¹Universiteti Barleti, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Tiranë***ABSTRAKT**

Hyrje: Fibroza kistike është sëmundje gjenetike e trashëgueshme, më e shpeshtë në racën kaukaziane, me një incidencë 1:2000 bebe të lindura çdo vit. Përparimet e shkencës kanë bërë që, pacientët me fibrozë kistike, të jetojnë njëloj si ata të lindur pa të. Fiziooterapia është një ndër shtyllat e trajtimit në fibrozën kistike ndaj dhe qëllimi i këtij prezantimi është vlerësimi i rolit që ka fizioterapia në jetëgjatësinë e këtyre pacientëve.

Metodologjia: Rishikim literature në sistemin e të dhënave elektronike të PEDro (Physiotherapy Evidence Database), Medline, Pubmed, Cochrane. U përzgjedhën 20 studime (studime të publikuara nga viti 2011-2022) të cilët vlerësonin rolin e fizioterapisë tek pacientët me fibrozë kistike.

Instrumentet: Nga 20 studimet e përzgjedhura, 19 ishin studime të kontrolluara rastësore dhe vetëm 1 studim përfshinte raportim përmes një pyetësi nga vetë pacientët e një qendre rehabilitimi të fibrozës kistike. Numri i pjesëmarrësve në studimet e rishikuara varioje nga 25 deri në 100. Moshë e pjesëmarrësve varioje nga 15 vjeç deri në 45 vjeç. Gjithashtu është bërë edhe rishikimi i regjistrit evropian të fibrozës kistike (ECFS), viti 2017 dhe viti 2020. Pas grumbullimit të dhënave u analizuan dhe u interpretuan.

Rezultatet: Nga rishikimi i literaturës rezultoi se pacientët të cilët kryenin seanca fizioterapie rregullisht, kishin një përmirësim të dukshëm të funksionit pulmonar, përmirësim të rritjes në peshë dhe gjatësi, pakësim të riakutizimeve të infeksioneve dhe forcim muskulature. Gjithashtu u vu re se pacientët të cilët e kishin filluar fizioterapinë që në moshën neonatale, kishin një cilësi jete më të mirë dhe ishin më jetëgjatë.

Diskutime: Me anë të këtij punimi, ne duam të theksojmë rëndësinë e rehabilitimit respirator dhe të nxisim fillimin e fizioterapisë sa më herët të jetë e mundur në këta pacient duke rritur gjithashtu nivelin e edukimit në lidhje me këtë gjë, jo vetëm tek profesionistët, por edhe tek familjarët.

Konkluzionet: Fiziooterapia në fibrozën kistike është thelbësore. Në këtë mënyrë parandalohen komplikacionet, përmirësohet cilësia e jetës dhe jetëgjatësia.

Fjalë kyçe: Fibroza Kistike, Fiziooterapi, Fiziooterapia e Gjoksit, Rehabilitim Respirator, Rrugët e Frymëmarrjes.

"THE IMPORTANCE OF PHYSIOTHERAPY IN CYSTIC FIBROSIS"

¹Msc. Jola Çini, ¹Prof. Assoc. Lila Shundi, ¹Prof. Dr. Evda Vevečka, ¹Prof. Dr. Eleni Nastas

¹Barleti University, Faculty of Medical Sciences, Tirana

ABSTRACT

Introduction: Cystic fibrosis is an inherited genetic disease, most common in the Caucasian race, with an incidence of 1:2000 babies born each year. Advances in science have made patients with cystic fibrosis live as well as those born without it. Physiotherapy is one of the pillars of treatment in cystic fibrosis and the purpose of this presentation is to evaluate the role of physiotherapy in the life expectancy of these patients.

Methodology: Literature review in the electronic data system of PEDro (Physiotherapy Evidence Database), Medline, Pubmed, Cochrane. 20 studies were selected (studies published from 2011-2022) that evaluated the role of physiotherapy in patients with cystic fibrosis.

Instruments: Of the 20 studies selected, 19 were randomized controlled trials and only 1 study included self-report by questionnaire from patients of a cystic fibrosis rehabilitation centre. The number of participants in the reviewed studies ranged from 25 to 100. The age of the participants ranged from 15 years to 45 years. The review of the European Cystic Fibrosis Registry (ECFS), 2017 and 2020, was also done. After the collection, the data were analyzed and interpreted.

Results: From the review of the literature, it was found that patients who performed physical therapy sessions regularly, had a significant improvement in pulmonary function, improvement in weight and height growth, reduction in re-acute infections and muscle strengthening. It was also observed that patients who had started physiotherapy since the neonatal age had a better quality of life and lived longer.

Discussions: Through this paper, we want to emphasize the importance of respiratory rehabilitation and encourage the start of physiotherapy as early as possible in these patients, while also increasing the level of education regarding this, not only among professionals, but even to family members.

Conclusions: Physiotherapy in cystic fibrosis is essential. In this way, complications are prevented, quality of life and longevity are improved.

Keywords: Cystic Fibrosis, Physiotherapy, Chest Physiotherapy, Respiratory Rehabilitation, Airways.

PËRQASJA E QYTETARËVE TË TIRANËS ME SHKENCËN MJEKËSORE TË FIZIOTERAPISË DHE KREDIBILITETI TE MJEKËT SHQIPTAR

MSc. Kleton Kadillari

ABSTRAKT

Qëllimi: Vlerësimi i shërbimit të fizioterapisë në qytetin e Tiranës.

Metoda: Pyetësorë në formë kuici , me pyetje të drejtpërdrejta. Përmbajtja e pyetjeve është e lidhur me njohuritë që kanë qytetarët e Tiranës në fushën e fizioterapisë . Kriter përjashtimi është mosha nën 18 vjec.

Rezultatet: 73.77% e individëve e njohin fizioterapinë, Vetëm 27.87% e tyre e njohin si një shërbim mjekësor. Vetëm 2.95% e individëve e kanë marrë informacionin nga mjekët. 22.95% mendojnë se një patologji nuk mund të sherohet me fizioterapi. 20.00% nuk kanë aspak besim te mjekët shqiptarë.

Konkluzioni:Qytetarët e Tiranës kanë mungesë informacioni përsa I përket shkencës mjekësore të fizioterapisë, dhe kanë besueshmëri relativisht të ulët në raport me mjekët shqiptarë.

Fjalë kyçe: Rehabilitim, Fizioterapi, Aftesi e kufizuar.

APPROACH OF CITIZENS OF TIRANA WITH MEDICAL SCIENCE OF PHYSIOTHERAPY AND CREDIBILITY AMONG ALBANIAN DOCTORS

MSc. Kleton Kadillari

ABSTRACT

Method: Quiz questionnaires, with direct questions. The content of the questions is related to the knowledge that the citizens of Tirana have in the field of physiotherapy and the trust they have in Albanian doctors. The exclusion criterion is the age under 18 years.

Results: 73.77% of individuals know physiotherapy, Only 27.87% of them know it as a medical service. Only 2.95% of individuals received the information from doctors. 22.95% think that a pathology can not be cured with physiotherapy. 20.00% do not trust Albanian doctors at all.

Conclusions: The citizens of Tirana lack information regarding the medical science of physiotherapy, and have relatively low credibility in relation to Albanian doctors.

Keywords: Rehabilitation, Physiotherapy, Disability.

DHIMBJA E SHPINËS ILIOPSOAS, SHKAQET DHE TRAJTIMI*Lindita Ibraj***ABSTRAKT**

Sfondi dhe qëllimi: Gjatë praktikës sime, kam konstatuar se dhimbja e shpinës është një nga ankesat më të shpeshta të pacientëve, e shoqëruar edhe me simptoma të tjera. Pavarësisht nga lloji i shqetësimit të shfaqur, kam vënë re se, në rreth 50% të pacientëve në klinikë, dhimbja e shpinës ka qenë e shkaktuar në njëfarë mënyre nga muskuli iliopsoas. Si jeta sedentare ashtu edhe mbingarkesa fizike (si në rastin e sportistëve) e ndihmojnë dëmtimin e tij. Iliopsoas është një muskul i madh dhe i fuqishëm, që përbëhet nga dy pjesë: muskuli iliak dhe ai psoas. Këto dy muskuj punojnë së bashku për fleksionin e ankës, zhvillojnë një rol kyç në stabilizimin e pjesës së fundshpinës dhe kanë rëndësi për ekuilibrin dhe ecjen. Qëllimi i këtij prezantimi është të përshkruajë terapinë e ushtrimeve që kanë ndihmuar në rehabilitimin e pacientëve të ndryshëm me dëmtime të muskulit iliopsoas.

